Faktet e BESIMIT dhe MREKULLITË e tij

ABDULMEXHID ZENDANI

AUTOR: ABDULMEXHID EZ-ZENDANI

Shqipëroi (për faqen elektronike “Ikra-TV”):

Altin Torba (nxënës i AbdulMexhid Ez-Zendan-it)

Rregullat logjike të Imanit-Besimit (1)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Hyrja e Episodit:

Profesor Zendani godet me një goditje demonstrative një person para kameras dhe ai thotë: Kush më goditi: Profesor Zendani ia kthen: Po nëse të them askush. Tjetri: Jo është dikush. Profesor Zendani: Po të them askush. Tjetri: Jo dikush më goditi.

Profesor Zendani: Subhan Allahu / I Dëlirësuar është Allahu nga të metat që i Përshkruajnë!

Selam alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu. Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Në vijim…

I thashë atij, nëse unë të them se nuk të ka goditur askush ti ke të drejtë të mos m'a marrësh për të mirëqenë të tillë gjë.

Temat e episodit tonë të sotëm është: **Rregullat logjike të Imanit-Besimit.**

Por unë para se të vazhdojë me këto rregulla logjike do doja të sillja ndër mend ata persona që po enden në humbje teksa atyre u ka ardhur nga Allahu sqarimi. Atë poetin që thotë:

Erdha nuk e di se nga, porse di që erdha

Pashë para meje rrugë dhe mbi të eca

Në ecje do mbetem desha apo nuk desha

Si erdha, si e pashë rrugën time? Nuk e di.

E përse nuk e di? Nuk e di.

Si nuk e di? Allahu të ka bërë ty dëgjim, shikim dhe arsyetim, ka bërë Allahu për ty burime informacioni që të rrethojnë në të katër anët, Allahu t'i dërgoi profetët që ti o njeri t'a dish se përse erdhe në këtë botë.

Tema e këtij episodi tonit është "Rregullat logjike mbi të cilat ndërtohet Imani-Besimi". Këto rregulla janë tre:

Rregulli i parë thotë: Mosekzistenca nuk mund të bëjë gjë.

E patë kur e godita atë vëllanë se si u kthye nga mua dhe tha kush më goditi. I thashë sikurse e dëgjuat nuk të goditi kush. Tha jo jo më goditi dikush. Edhe me një fëmijë po

erdhëm dhe e godasim do thotë të njëjëtën gjë. As fëmija nuk pranon të ndodhë diçka, një veprim, pa shkak, Ku kanë qenë duart tona, këmbët tona, sytë tanë, gojët tona, trupat tanë dhe zemrat tona që rrahin brenda trupave tanë, zorrët tona dhe gjthë qelizat tona ku kanë qenë para 100 vjetëve. Ja tanimë ato ekzistojnë. A erdhën nga asgjëja?! Mosekzistenca-hiçi nuk bënë gjë. Përderisa ekziston një veprim, një krijim, një ekzistencë, ajo nuk ka se si të jetë kurrsesi nga mosekzistenca pasi mosekzistenca nuk bën gjë. E studiova këtë çështje me një nga shkenctarët e Amerikës të quajtur profesor Roberti. Drejtonte një kolegj, anëtarë të të cilit ishin 75 universitete, kolegj ky që kishte bërë teleskopin kozmik që fotografonte universin nga të katër drejtimet. Mësova se ai ishte nga grupi "nuk e di" hezitues midis besimit dhe blasfemisë (mosbesimit). Debatova me të dhe i thashë. O professor mosekzistenca a bën gjë. Tha jo dhe e mori të mirëqenë këtë. I thashë mirë, o professor ti para 100 vjetësh a ekzistoje apo nuk ekzistoje. Tha jo nuk ekzistoja. I thashë a je sjellë në ekzistencë. Tha po. I thashë kush të solli në ekzistencë? Pastaj kjo bimësi para dhjetëra apo qindra vitesh nuk ekzistonte, as lulet, as degët dhe as filizat e tyre. Pastaj i thashë po kafshët, edhe ato nuk ekzistonin dhe u sollën në ekzistencë, s'kanë pas as këmbë, as sy, as aparate trupore, as qime, asgjë prej këtyre. Të gjithë këto u sollën më pas në ekzistencë ja ku i kemi. Pasatj toka, këto lumenj nuk ekzistonin, erdhën në ekzistencë pasi ranë shirat, retë nuk ekzistonin, erdhën në ekzistencë pas ardhjes në këtë ekzistencë të detërave. Detërat nuk kanë ekzistuar vetëm se pasi dolën nga brendia e tokës, ku gjendeshin në një strukturë kristaloide. Pastaj e gjithë toka malet dhe shkëmbinjtë e saj nuk patën ekzistuar, toka u soll më pas në ekzistencë dhe u sheshua. Pastaj e gjithë toka ishte pjesë përbërëse e qiellit, nuk gjendej diç të quhej tokë. Toka më pas u veçua si rezultat i shkëputjes dhe ndarjes së saj nga qielli. Sikurse ka thënë i Lartamdhëruari: "A nuk e shikojnë ata që nuk besojnë (blasfemojnë) se qiejtë dhe toka qenë njësh dhe i ndamë". Pastaj këto yje dhe këto trupa qiellor, miliarda e miliarda, nuk ekzistonin qenë tymnajë kozmike. Njeriu sot arriti t'i shikoj këto tymnaja dhe se si nga ato krijohen yjet ashtu sikurse lajmëron Kurani, ka thënë i Lartësuari: "Pastaj qëndroi në qiell teksa ai-qielli ishte tymnajë. I tha të vini me hir apo me pahir. Thanë, do vijmë me hir." Pastaj kjo tymnajë në origjinë ishte në një formë radiacionesh-rrezesh radioaktive ndërsa para se të ishin rreze radioaktive ishin diç krejt e vogël. Duke filluar nga viti 1964 shkenctarët e specializuar në lëmenj të ndryshëm të universit filluan të konkludojnë se edhe ky univers ka një fillim dhe se më parë nuk ka pas ekzistuar diçka që quhej univers. Ata përcaktuan se universi ka startuar të ekzistojë 12 bilion vite më parë. Por para kësaj çfarë ishte? Përpara nuk ka qenë universi. I gjithë ky univers nga erdhi?! Mos më thuaj erdhi nga mosekzistenca. Ky shoku ynë nuk pranoi për një goditje mbi shpinën e tij të jetë nga asgjëja. Kështu ky univers me gjithë krijesat që bart në të dëshmon se ai ka ardhur dhe se ardhja e tij në këtë ekzistencë domosdoshmërisht ka qenë nga një Krijues që e solli në ekzistencë dhe e bëri të lulëzojë në këtë ekzistencë. Allahu thotë: "A u krijuan ata nga asgjëja?! Apo ata janë krijuesit?! Apo qenë ata që i krijuan qiejtë dhe tokën?! Porse ata janë në mëdyshje." E pyeta profesor Robertin rreth kësaj dhe tha është e saktë që mosekzistenca nuk bën gjë dhe këto ekzistenca dohet medoemos t'a kenë një krijues. I thashë kush është ai? Tha

është natyra. I thashë kam një rregull tjetër që do na njohë ne me cilësitë e Krijuesit që na krijoi. Pasi të njohim cilësitë e Krijuesit arrijmë të njohim se Kush është Ai që posedon këto cilësi. Në dhomën ku gjendeshim ndodhej një llambë neoni. I thashë shikoje këtë neon. Ai që e bëri këtë llambë a posedon xham. Tha po. I thashë a je i sigurtë. Tha shihe vetë. I thashë a është i aftë ai t'a formësoj xhamin në formë cilindrike? Tha shihe vetë ka një formë cilindrike të përsosur. A posedon ai metalin që vendoset anash neonit. Tha po. A është ai i aftë t'a formësojë këtë metal në formë tape. Tha, po, shihe. E ka bërë metalin të përputhet krejtësisht me grykën e xhamit të neonit, pa asnjë çalim. E pyeta a është bërësi i kësaj llambe i mençur. Tha po. Shikoje me sytë e tu këtë mençuri. I thashë në këtë llambë do kaloj rrymë elektrike dhe atëherë ajo do bëj dritë. Ai që e bëri llambën a e din se kjo llambë kur të kaloj në të rrymë elektrike, do bëj dritë. Tha shtype çelsin dhe do e shohësh. I thashë pra profesor ti tani po dëshmon i sigurtë për cilësitë e bërësit të kësaj llambe, duke më thënë se bërësi i kësaj llambe posedon xham, është i aftë t'a formësojë atë në formë cilindrike, se ai posedon një metal të cilin falë aftësisë së tij e ka bërë perfektshmërisht të mbyllë anët e hapura të llambës, se ai e din që kur rryma elektrike do kaloj në llambë ajo do bëj dritë. I thashë a dëshmon për këtë. Tha po dëshmoj. I thashë po a e ke parë ti bërësin e llambës? A e ke parë atë që e ka bërë këtë llambë? Tha jo. I thashë atëherë si dëshmon për cilësitë e tij. Tha vepra e tij dëshmon dhe tregon për këtë. Çdo gjë prezente tek kjo vepër tregon për aftësi dhe mundësi ekuivalente tek vepruesi i saj duke qenë se ajo nuk mund të vijë nga mosekzistenca. Pra çdo gjë që gjendet në këtë produkt shërben si provë për ekzistencën e bërësit të saj dhe aftësitë e tij. I thashë faleminderit, kjo na ka sjellur tek një rregull i dytë.

Rregulli i dytë është: Krijesat janë gjurmë dëshmuese për disa nga cilësitë e Krijuesit. Ashtu sikurse arritëm të njohim disa nga cilësitë e bërësit të kësaj llambe, tani në vend që objekt i vëzhgimit të jetë llamba do të vëzhgojmë ty o profesor, tokën mbarë, qiellin dhe çfarë ka në të, të gjithë krijesat. Kjo pasi ky univers bartë tregues dhe prova, posedon gjurmë të disa prej atributeve të Krijuesit të tij, Allahut të Plotfuqishëm, që e kriojoi dhe solli në ekzistencë. E nëse ne njohim atributet dhe cilësitë e Tij, kështu do njohim Atë që i posedon ato. Ra dakord lidhur me këtë rregull dhe e konfirmoi atë. I thashë ky do jetë programi përmes të cilit do hulumtojmë. I thashë, lidhur me trupin tënd dhe temperaturën e tij, si fiksohet ajo në 37°C. Ky trup bën kondencionerin e temperaturës. Kështu kur në verë temperatura e jashtme mund të jetë tepër e nxehtë, edhe 50°C, temperatura e trupit tënd qëndron fikse 37°C. E pyeta përse nxehtësia nuk kalon nga ambienti i jashtëm tek trupi yt. A s'është kjo pasi trupi yt është i paisur me aparatura përkatëse, djersët që dalin, njomin, lagin rrobat, freskojnë gjakun duke mbetur temperature e trupit stabël 37°C. Ndërsa në dimër ti hanë shumë pasi trupit yt transformohet në një furrë që djeg ushqim, duke u bërë ushqimi lëndë djegëse që digjet në trupin e njeriut, ndaj dhe në dimër ne hamë më shumë, teksa në verë pimë më shumë. Në verë pimë më shumë për shkak të freskimit dhe në dimër hamë më shumë për shkak të nxehjes. Ky proces kryhet në mënyrë precize dhe perfekte duke e mbajtur

temperaturën konstante 37°C. Në dimër ndodh që temperatura në disa zona të zbresë në zero madje poshtë zeros minus, porse temperature e trupit të njeriut mbetet e fiksuar në 37°C. Në të gjitha stinët ajo është e njëjtë. Trupi yt është një kondencioner. Tani pyetja ime profesor është se Ai që e bëri të qënësishme këtë perfektshmëri dhe urtësi lidhur me temperaturën e brendshme të trupit dhe e bëri atë të stabilizohet në 37°C pamvarësisht nga ndryshimi i motit, e bëri këtë në një formë të tillë që në varësi të ulje-ngritjes së jashtme të temperaturës trupi merr përsipër të funksionojë pro ruajtjes së temperaturës në 37°C, temperaturë kjo që është temperatura e vetme e përshtatëshme për funksionimin kimiko-biologjik të procesit jetik të trupit të njeriut, ky ligj i stabilizimit të temperaturës së trupit pamvarësisht nga luhatjet e motit a nuk të dëshmon se ky është produkt i të Urtit që e ka bërë urtësisht të tillë gjë në trupin tënd, timin dhe mbarë njerëzve?! Ai që në mënyrë perfekte vendos një mbyllje metalike ne hapjen e qelqit të neonit the se është i mençur dhe i urtë, po Krijuesi që bëri sa parapërmendëm me njeriun a nuk duhet të jetë i Urtë?! Pastaj ti atëherë kur t'u krijuan këto aparatura që centrojnë dhe kondecionojnë fiksimin e temperaturës së trupit në 37°C, teksa u pajise me këto, gjendeshe në barkun e nënës, temperatura e të cilit është stabël 37°C, si rezultat ti nuk kishe nevojë të pajiseshe me aparatura që do të duhej t'a centronin dhe balanconin temperaturën e trupit tënd nga luhatjet e temperaturës. Kjo pasi ti gjendeshe në një temperaturë konstante aty brenda mitrës. Ai që të përgatiti brenda në mitrën e nënës me këto aparatura që e balancojnë temperaturën e trupit tënd pamvarësisht luhatjes së temperaturës së jashtme të motit, si thua a e di se ti jashtë barkut të nënës do dalësh në një ambient të ri temperatura e të cilit është e luhatëshme, herë me ngritje dhe herë me ulje, ndaj krijoi për ty aparaturë që stabilizon temperaturën e trupit tënd në 37°C, duke bërë balancuesin me temperaturën e motit, Ky a është i Ditur apo i paditur?! Ai që të përgatit aparaturën në fjalë teksa ti je në barkun e nënës, është apo nuk është i Ditur për ambientin që të pret, është apo nuk është i Urtë?! Dhe fillova t'i japë edhe shembuj të tjerë nga balancimet trupore. I thashë, trupi yt profesor, që ka miliarda qeliza, në të çdo qelizë zhvillohet në vendin e duhur, që të formojë lëkurë, damar, kockë, mish, një muskul specifik në gisht, në dorë, hundë, kofshë… ose që të formojë flokun, thoin. Kush është ai që i stabilizon dhe organizon të gjitha këto qeliza që të kujdesen për formën tonë fikse në të cilën ne jemi. Nëse balli yt do qe më i madh, sytë më të thella, kjo do reflektohej tek pamja jote. Pra kush e balancon gjithë këtë zhvillim qelizor në trup?! Dihet që kanceri në trupin e njeriut s'është gjë tjetër veçse zhvillim qelizor e trupor i pabalancuar. I përmenda atij ekuilibrin dhe balancimin e njeriut kur ai ecën. Kur njeriu ecën dhe rrëshqet djathtas trupi yt është përsosur ashtu që muskujt e tu janë programuar përmes aparatit përkatës t'a shohësh trupin tënd papritmas të anoj në anën tjetër që të ruaj ekuilibrin e të qëndrojë drejtë. Kurse kur trupi yt rrëshqet përpara, muskujt dhe aparati balancues në fjalë funksionon duke e anuar atë pasë, duke e mbajtur atë kështu në ekuilibër. Ky balancim i përsosur që ti posedon kur lëviz, pastaj balancimi i përsosur në proporcionin oksigjen-dioksid karboni në atmosferë, dihet që trupi njerëzor thith oksigjen pandarë dhe e kthen atë në dioksid karboni porse proporcioni i tij në atmosferë mbetet gjithmonë stabël i fiksuar në

masën 1/5 e komponentëve të ajrit. Cilat na ndihmojnë ne në mirëmbajtjen e kësaj vlere oksigjeni në ajër. Po, janë bimët me lejen e Allahut të cilat u krijuan si balancuese të oksigjenit që ai të mbetet në vlerën përkatëse për vazhdimësinë e jetës. Medito në këto balancime. Medito lidhur me hënën që rrotullohet rreth tokës. Kur hëna rrotullohet rreth tokës në rrotullimin eliptik të saj vjen një moment kur distanca mes tyre siç dihet është fare e afërt. Dihet se në varësi të afërsisë forca tërheqëse e tokës shtohet, prandaj hënës i duhet të shtojë shpejtësinë e saj që t'i rezistojë forcës tërheqëse të tokës, dhe ajo këtë e bën në mënyrë të shkëlqyer. Nuk është ky një shtim i rëndomtë shpejtësie porse shpejtësia shtohet përsosshmërisht ashtu që nuk shkakton devijim nga trajektorja e saj rrotull tokës. Krejt kështu ndodh edhe kur toka rrotullohet rrotull diellit. Shpejtësia e tokës ulet kur gjendet në distancat e largëta të orbitës eliptike rreth diellit dhe shtohet kur gjendet në distancat e afërta të orbitës eliptike rrotull diellit. Kjo bëhet përmes një balancimi perfekt. I tillë është edhe balancimi i zhvillimit qelizor në trup. Gjendet pra një balancim në rrotullimin e tokës, hënës, sistemit të aparaturave trupore, në lëvizjen e yjeve, galaktikave, rreth vetvetes dhe tjetërkujt, balancim ky që është i përsosur. Kjo perfektshmëri në trupin njerëzor dhe mbarë universin a nuk tregon e gjitha kjo se të gjitha këto gjëra janë krijuar nga vepra e të Urtit.

Medito edhe në funksionin e çdo organi në trup dhe formën e tij, çfarë do vëmë re? Shohim zemrën të bërë nga muskuj të fuqishëm, pse? Sepse ajo do pompojë në dobinë tonë gjakun tonë. Brenda saj janë katër dhomëza, secila prej të cilave ka rolin e saj përkatës. Midis tyre gjenden valvulat e krijuara perfektshmërisht. Duke u krijuar kështu zemra krjet në përputhje me funksionimin e saj. A nuk është kjo tregues për diturinë dhe urtësinë e Atij që e krijoi zemrën kundrejt funksionit të saj pikërisht në këtë mënyrë, si dhe për materien përkatëse me të cilën duhet të krijoheshin qelizat e zemrës. Teksa tek mushkëritë gjejmë një endje qelizore të brishtë pasi ato kanë të bëjnë me ajrin që është po ashtu i brishtë. Prandaj ato janë bërë të tilla që zgjerohen dhe ngushtohen, që të lejojnë hyrjen e ajrit përmes kalimit nga ajri në trup. Po kështu Ai që krijoi mushkëritë dhe i bëri një endje të tillë që përkon me thithjen dhe shfryrjen e ajrit si dhe konvertimin gazor s'ka dyshim që është i Gjithdijshëm lidhur me çfarë funksioni do bëjnë mushkëritë, është , i Gjithdijshëm kundrejt subtancës lëndorë të përshtatshme për mushkëritë, e përsosi strukturën e tyre, lëndën e tyre, që të jenë në përputhje me funksionimin e tyre. Përsosmëria nuk gjendet vetëm në trupin dhe organet e tij, por çdo qelizë në trup është e përshtatur me funksionin e saj kudo që ndodhet në trup teksa ajo nuk është e vetëdijshme për atë që po bën. Për shembull qeliza në mes të trurit nuk e din se çfarë po bën, porse ajo e bën detyrën e saj përsosshmërisht, asaj i është caktuar që t'a kryej rolin e saj kështu. Qelizat në stomak, muskuj, në palcën e kockës që të gjitha punojnë në përputhje me funksionin e tyre. Të gjitha ato janë formuar në një mënyrë të tillë që t'u përshtaten funksioneve të tyre specifike. Kështu, Ai i Cli i krijoi në mënyrë kaq perfekte qelizat dhe të gjitha sistemet e trupit është po Ai i Cili krijoi të gjitha qelizat, sistemet dhe pjesët e bimësisë. Qelizat tek rrënjët, funksioni i tyre është të sjellin ujin, të thithin krypërat që duhen, qelizat tek gjethet, funksioni i tyre është që të

përfitojnë energjinë nga rrezet e diellit, qelizat përgjegjëse për daljen e frutave dhe formimin e tyre funksionojnë përsosshmërisht pro kësaj. Po kështu edhe ato formuese të kërcellit dhe mbështjellës së tij, çdo qelizë e din perfektshmërisht funksionin e saj. Ka ca qeliza që janë përgjegjëse tek bima për prodhimin e ngjyrës që ndjell insektet. Kush ua vendosi atyre këtë rol specifik ngjyrosës dhe i bëri të funksionojnë në mënyrën e tyre përfekte?!

Përfektshmërisht ato tregojnë për informacionin e plotë që i Gjithdijshmi, Krijuesi, ka rreth vendodhjes së tyre, natyrës së tyre, formës së tyre dhe funksionimit të tyre. Po kështu duhet mediuar në faktin që sekrecioni që del nga syri është loti, nga veshi dylli, nga hundët mukoza, nga goja jargët. Po nëse do pësonte ndryshim vendalja e këtyre sekrecioneve? Po qe se do të dilte dylli nga syri, do t'a bllokonte. Nëse jarga do dilte nga hunda do vërshonte në fytyrë. Kështu Krijuesi i njeriut, Zoti i qiejve, yjeve dhe mbarë university është i Gjithdijshëm për çdo detaj, të vogël apo të madh. Të gjitha këto janë dëshmi se Krijuesi është i Gjithdijshëm. A e ke parë pulën, një fëmijë po t'a ngacmojë trembet e ikën, mirëpo kur është klloçkë me zogj edhe nëse një njeri shumë i fuqishëm i vjen asaj t'i trazoj një nga të vegjëlit e saj, ajo fryhet, rebelohet dhe rrinë e gatshme për t'ju vërsulur në fytyrë, si një shqiponjë, vetëm e vetëm poër të mbrojtur të voglin e saj. Kush e futi në zemrën e saj mëshirën?! Kjo është çështja e nënave me të vegjëlit. Ke lopën që me gjuhën e saj lëpin trupin e të voglit të saj të porsalindur duke e pastruar atë… Kush e inspiroi këtë mëshirë në zemrën e nënave?! Prej Kujt erdhi kjo?! A s'është ky një adoptim i mëshirës së Mëshiruesit, të Urtit, të Gjithdijshmit. Medito rreth farërave në çelje. Nuk kemi parë asnjë bimë të zhvillohet me rrënjë në ajër dhe kërcell nën tokë. Fshatari e hedh farën të përmbysur, dhe kur çel rrënjëza në pjesën e sipërme të farës, aty për aty drejtohet për poshtë. Po kështu ngjan edhe me kërcellin, kërcellëzi kur çel në pjesën e poshtme të farës merr automatikisht drejtim duke devijuar lart. Kush i orientoi të gjithë kërcellët dhe rrënjët e mbarë bimësisë në këtë mënyrë?! Kjo është çështja e çdo kërcelli dhe çdo rrënje në gjithë bimësinë. E gjen gjethen njëra të dal djathtas e tjetra majtas përgjatë gjithë degës anash dhe lart-poshtë. Kush i tha asaj të majtës dil majtas se ka dalë tjetra djathtas?! Kush e organizoi daljen e gjetheve në këtë kërcell që të ngrihet me një balancim perfekt?! Kush, Kush është Ai që orinetoi qimen në vetull të drejtohet në drejtimin e duhur që gjendet dhe i tha drejtohu në këtë drejtim deri në një limit të caktuar që mos t'i shkaktosh çrregullime syrit?! Ndërsa qimes simotër në kokë i tha zgjatu dhe rritu që të sjellësh masën e duhur të flokut që kërkohet për t'u realizuar ngrohja etj, dhe që flokun kur duam mundet edhe t'a presim. Kush e orientoi pra vetullën pro funksionit të saj?! Kush e orienton çdo organ pro funksionit të tij?! Kush e orienton hënën në pozicionin e saj, e orienton diellin në pozicionin e tij, dhe i orienton yjet të jenë në vendodhjen e tyre?! Kush e orienton çdo gjë?! Ai është Orientuesi, Udhëzuesi, Allahu i Lartmadhërishëm, "Është Ai që çdo gjëje i dha krijueshmërinë që ka e më pas e orientoi". Medito sesi Allahu e mbrojti syrin! Syri është i dobët dhe mund të dëmtohet kollaj me çdo gjë që mund t'a godas. Prandaj Ai e ruajti atë me kockat rrethuese të kafazit të syrit, eshtrës së ballit, hundës dhe mollëzës së faqes që përbëjnë

një strehë të pacënueshme për syrin, prandaj sido të vijë puna syri mbetet i ruajtur. Nëse do kishin dalë sytë në ballë do kishin patur vetëm një javë punë. Shiko edhe zemrën dhe mushkëritë sesi i mbrojti Allahu me kafazin e krahërorit, pasi janë të brishta dhe ruajtja e tyre është një domosdoshmëri. Kjo vlen edhe për trurin e brishtë që lehtësisht mund të dëmtohet ndaj për të Krijuesi bëri kafkën me kockat e saj tepër të forta që e rrethojnë anekënd dhe e mbrojnë të mos dëmtohet. Nga brenda kafkën e bëri me një shtresë të butë e të lëngshme përbrenda ashtu që kur goditet kafka kjo shtresë amortizon fuqinë goditëse. Kush e bëri këtë? Mbrojtësi apo jo?! Siç të mbrojti ty Ai e mbrojti dhe tokën. E mbrojti tokën nga rrezet vrasëse që vijnë nga dielli. Dielli çliron rreze vdekjeprurëse porse ato para se të arrijnë në tokë shkatërrohen nga mbështjella ajrore që mbështjell tokën. Ai gjithashtu e mbrojti tokën me mbështjellën magnetike e cila e rrethon tokën nga të gjitha anët. Ajo pengon arritjen e rrezeve të dëmshme kozmike nga universi dhe devijon rrugën e tyre gjë e cila bën që ato të mos arrijnë në tokë. Nëse këto rreze do zbrisnin në tokë do kishin shkatërruar çdo gjë. Subhan Allahu, Ai që e ruajti mbarë këtë univers, Ai që e bëri atë të jetë si një trup i vetëm! Në realitet ky është krijimi i Allahut, Ai është Krijuesi dhe Mbrojtësi. Medito gjithashtu rreth foshnjes në embrion teksa gjendet brenda barkut të së jëmës, derisa del nga barku pasi që është furnizuar aty brenda plot nëntë muaj, pasi këputet zorra e tij që pat qenë lidhur me gërthizën, atij furnizimi fillon i vjen nga gjinjtë e së jëmës dhe qysh kur ky fëmijë është një ditësh orientohet të thithë ushqimin e përgatitur për të nga gjinjtë e së jëmës. Kjo është vepër e Furnizuesit që furnizon të gjithë krijesat, furnizon zogun që gdhihet barkëthat dhe ngryset i ngopur, furnizon krimbin në thellësinë e tokës, furnizon peshkun në thellësi të oqeanit. Subhan Allahu, Ai është Krijuesi, Mbrojtësi, Orientuesi, Furnizuesi. Këto janë argumentat e Tij, gjurmët që tregojnë Prezencën e Tij dhe faktin e njëshmërisë së Tij. Stomaku yt është i lidhur në funksionim me zorrët, zorrët janë të lidhura në të funksionuar me gjakun, gjaku është i lidhur në të funksionuar me mushkëritë, mushkëritë janë të lidhura me ajrin, ajri është i lidhur me bimësinë, më tej bimësia kryen funksionin e saj ashtu që nxjerr për ne oksigjenin gjë të cilën s'e bën dot pa dritën e diellit, drita e diellit ka të bëjë me diellin, dielli është i lidhur dhe ka të bëjë me sistemin diellor, sistemi diellor është i lidhur me galaktikën tonë, galaktika jonë është e lidhur me galaktikat e tjera. Mendo se si stomaku yt ka të bëjë dhe është në një lidhshmëri të pazgjidhëshme me galaktikat e universit. Nëse një dëmtim do ndodh në galaktika ai do arrinte tek sistemi diellor, nga sistemi diellor tek dielli, nga dielli tek drita e tij, nga drita e tij tek bimësia, nga bimësia tek balancimi i oksigjenit, nga oksigjeni tek mushkëritë, nga mushkëritë tek gjaku, nga gjaku tek zorra… Shiko sesi ai është një univers kompakt i vetëm që dëshmon për një Krijues të Vetëm. Kush është Ai që i posedon cilësitë i Urtë, i Gjithdijshëm? Ai është Allahu.

Rregulli i tretë është se mosposeduesi i diçkaje s'mund t'a japë atë. Natyra që ti thua dhe bën fjalë për të nuk posedon as dituri, as urtësi, as përvojë, as dëshirë, as mbrojtje, as vendimarrje, as furnizim, as mund të bëj kujdes për krijesat dhe as mund t'i krijojë ato. Përkundrazi, këto janë atributet e Krijuesit të Plotfuqishëm, jo të natyrës. Nëse ti

mendon dhe mediton në këtë univers dhe komponentët e tij ato japin për ty një dëshmi, thonë dëshmojmë o njeriu i mendjes se ai që na krijoi është i Dituri, i Gjithdijshmi, i Urti, Furnizuesi, Formëdhënësi, Orientuesi, Mbrojtësi, Udhëzuesi, i Vetmi. Është pikërisht kjo çfarë muslimani dëshmon kur thotë LA ILAHE IL ALLAH-NUK MERITON TË ADHUROHET KUSH VEÇ ALLAHUT, është Ai i Vetmi që e meriton adhurimin, është Ai i Vetmi që e meriton dëgjueshmërinë dhe bindjen, Atij nuk duhet që t'i bëhet shokvurje (shirk). Ky është kuptimi i thënies sonë LA ILAHE IL ALLAH-NUK MERITON TË ADHUROHET KUSH VEÇ ALLAHUT, dëshmi argumentat dhe provat e së cilës mbushin universin. Mbetet vetëm të shikosh dhe meditosh, "A nuk shikojnë ata në mbretëritë e qiejve dhe të tokës, dhe në atë çfarë Allahu ka krijuar".

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Njohja e Allahut (2)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Sikurse thamë në episodin e kaluar ne kemi mundësi të njohim disa nga cilësitë e bërësit të kësaj llambe edhe pse ne nuk e kemi parë atë kurrë. Dimë se ai posedon xham, është i aftë që xhamit t'i japë një formë cilindrike, ai posedon metal, me të cilin ai është i aftë t'i mbyll hermetikisht dy anët e hapura të llambës së neonit, është mjeshtër ashtu që përsosshmërisht e ka mbështjellë pjesën metalike në dy anët e hapura të qelqit cilindrik të llambës, ai posedon dituri rreth energjisë elektrike dhe posedon njohuri se kur energjia të kalojë në këtë llambë, llamba e neonit do bëj dritë. Por cilat janë cilësitë e tjera të bërësit të kësaj llambe, është ai i gjatë apo i shkurtër, i bardhë apo esmer, grua apo burrë? Nuk mundemi të dimë gjë rreth këtyre cilësive të tij. S'e dimë nëse dëshiron të bashkëpunojë me ne apo jo, është bujar apo koprac? Këtë nuk e dimë. Cilësitë që kanë të bëjnë me vetveten e tij ose që kanë të bëjnë me synimin e tij nuk mundemi t'i mësojmë duke parë dhe mediuar tek vepra e tij. Ne mediuam rreth disa prej cilësive të Allahut në episodin e kaluar duke parë tek gjurmët e cilësive të dëshmueshme të gjendura tek disa prej krijesave. Por kjo formë nuk na mundëson të njohim cilësi të Allahut që kanë të bëjnë me vetveten e Tij Hyjnore, që kanë të bëjnë me synimin e Tij, çfarë deshi e synoi lidhur me krijimin tonë, pse na krijoi, pse bëri që ne të vdesim, çfarë pas vdekjes? Gjithashtu çfarë synoi me këtë ekzistencë? Fjala e Tij është ajo që gjen zbatueshmëri në këtë univers, dhe çdo gjë ka ardhur prej Tij dhe Atij i dedikohet, i Lavdishëm është Ai. Pastaj duhet që jetën tonë t'a bëjmë të rrjedhë pro kënaqësisë së Tij, atë që Ai don t'a bëjmë dhe atë që nuk don t'a shmangim. Për këtë Allahu i dërgoi profetët, sikurse edhe shprehet lidhur me këtë i Lartësuari: "Profetë përgëzues dhe vërejtje-tërheqës, që njerëzit të mos kenë justifikim pas ardhjes së profetëve". Nuk u mbetet njerëzve asnjë justifikim pas sqarimit që Allahu solli përmes profetëve, të cilët Allahu i dërgoi me fjalë të qartë, me gjuhën e popullit të tyre "Ne nuk kemi dërguar ndonjë profet përveçse me gjuhën e popullit të tij, që t'i qartësonte ato". Ne i shohim gjurmët hyjnore prej të cilave përfitojmë dhe konkludojmë disa cilësi hyjnore, pastaj çdo gjë Allahu e qartësoi prerazi duke dërguar profetët, të cilët na flasin ne popujve të tyre në gjuhën tonë, na qartësojnë dhe sqarojnë në gjuhën tonë, që "i vendosën pikat mbi i" dhe që nuk na lanë të sorollatemi të luhatur në spekulime andej-këndej. Allahu i dërgoi tek ne profetët me gjithë sa kemi nevojë lidhur me çështjen e udhëzimit -paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi ta-. Profetin që do vijë a mendoni se njerëzit do e presin mirë, t'i thonë të prisnim për Zotin, tani thuaj çfarë do e ne do e bëjmë. Ja ku i ke në dispozicion pasurinë tonë, shpirtërat tanë, fëmijët tanë. Sigurisht që jo. Është natyra e njeriut që bën që ai të mos i dorëzohet kollaj tjetrit dhe të mos i nënshtrohet kollaj

qëllimeve dhe dëshirës së tjetrit. Profeti sapo vjen gjen që njerëzit t'a përgënjeshtrojnë, madje edhe mund t'a tallin, madje mund të komplotojnë kundër tij. Dhe që profetët të mos përgënjeshtrohen, që njerëzit të mos dyshojnë në ta, Allahu i paisi ata me mrekulli të qarta si dhe i përkrahu ata me argumenta të qarta e të dallueshme, që i presin nga rrënjët dyshimet e mosbesimtarëve. Allahu i Lartësuar thotë: "Padyshim, ne i dërguam profetët tanë me shenja të qarta", pra me çfarë i sqaron ata qartazi. Kështu Allahu çdo profet e paisi me mrekulli që i vinin për shtat popullit të tij, sikurse e qartësuam këtë në episodet tona të këtij cikli.

Muhamedi -paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi të- është i Dërguari i fundit i Allahut tek mbarë njerëzia, mesazhi i tij i adresohet nomadit në shkretëtirën e thellë si dhe i drejtohet profesorit X sot në ditët tona në laboratorin apo qendrën e tij, qoftë edhe në qendrat më të kualifikuara të studimeve shkencore. Ai është i Dërguari i Allahut tek mbarë njerëzit pamvarësisht nga kultura e tyre, dituria e tyre, inteligjenca e tyre, idetë e tyre, aftësitë e tyre. Prandaj Allahu i dha Muhamedit -paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi të- mrekullinë faktike që është e vazhdueshme dhe e palimituar, Kuranin. Asnjë sot nuk është i aftë të shikojë mrekullitë e të nderuarit tonë profetit Musa, as ato të të nderuarit tonë profetit Jezus dhe as të ndonjë profeti tjetër para Muhamedit -paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi të-. Nuk mund t'i shohësh dhe për to nuk ke gjë tjetër veç bojës së penës së historianëve, gjë për të cilën mund të ndërhyjnë njerëz me interesa të veçanta, të nxitur apo laikë, dhe të mbjellin dyshime të shumta tërësore lidhur me atë histori. Porse mrekullia prezente që mbetet është ky Libër Fisnik, është ky Kuran. Mrekullia e Profetit Muhamed është prezente, ne mund t'a kemi në dorë prezente mrekullinë e Profetit Muhamed, është një mrekulli e gjallë, e qëndrueshme, mund t'a dëshmojmë sot e kësaj dite, ashtu siç e ka dëshmuar atë gjenerata para nesh. Gjithsesi njerëzit mund të thonë, ne kur shohim shkopin të shndërrohet në një gjarpër që ecë, e tillë gjë sigurisht që është një mrekulli që s'e bën dot askush përveç Allahut. Edhe kur e gjejmë të nderuarin tonë Profetin Jezus-Isa që me lejen e Allahut të ngjallë të vdekurin jemi të vetëdijshëm se të tillë gjë nuk mund t'a bëjë askush përveç Allahut. Por çfarë na tregon ne se ky Kuran është prej Allahut. Ky Kuran është i printuar e faqosur në faqe, është printuar në aparatura printimi, në kopje të madhësive dhe dimensioneve të mëdha apo të vogla, në ngjyra të ndryshme. Cila pra është shenja hyjnore në të? Allahu i Plotfuqishëm na e ka sqaruar këtë duke na thënë se Ai e ka paisur këtë Kuran me shenjë të qartë, kategorike, që vërteton lidhjen e Kuranit tek Allahu, dhe se ai është prej Tij. Cila është kjo shenjë? Kjo shenjë hyjnore është dituria e gjendur në të, dituria që ai mbart. Çdo thënie në Kuran, në gjithsecilin lëm prej lëmenjve për të cilët Ky Kuran ka bërë fjalë, bart në vetvete një dituri të plotë, që nuk është aspak e mangët, është dituria hyjnore e Allahut. Kështu kur njerëzia ngjitet në lëmin e diturive dhe shkencave si dhe përparon në këto shkenca e mundet të arrijë në një nivel në të cilin arrin të njohë realitetet që ka përmendur Kurani, këtu ajo pa pikë dyshimi bindet se ky Kuran zbriti duke mbartur diturinë e Allahut. Kjo provë e qartë, mrekulli e gjallë, prezente në mesin tonë, është mrekullia më madhështore, teksa të nderuarit tonë Profetit Muhamed -paqja dhe

lavdërimi i Allahut qoftë mbi të- i janë dhënë mrekulli të tjera të shumta. Këtë mrekulli -Kuranin- e ka përmendur Allahu po në Kuran duke thënë: "Thuaj: Çfarë gjëje përbën dëshminë më madhore?! Thuaj: Allahu është dëshmitar midis meje dhe jush, teksa mua m'u shpall ky Kuran, që unë me të t'u tërheq vërejtjen juve dhe atyre që do u arrijë". Pra edhe atyre që do t'u arrijë ky Kuran, dhe ne jemi prej atyre të cilëve u arriti ky Kuran. Ai erdhi tek ne, duke qenë në vetvete prova, argumenti, mrekullia që na erdhi, në epokën tonë dhe në atë që do të vijë në të ardhmen. Natyra e kësaj mrekullie (Kuranit) sikurse thashë është natyrë shkencore, gjë mbi të cilën i Lartësuari thotë: "Porse Allahu dëshmon me anë të asaj çfarë të zbriti ty, (dëshmon rreth vërtetësisë së asaj që i zbriti Muhamedit -paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi të- me Kuranin, me faktin se) e zbriti atë me diturinë e Tij". Pra dituria hyjnore e gjendur në këtë Libër është argumenti që vërteton vërtetësinë e këtij Libri. Dituria ndahet në dy kategori. Njëra kategori ka të bëjë me anën gjuhësore dhe me të lidhen elokuenca dhe retorika. Në të vjen sfida ndaj arabëve që krekoseshin me gjuhësinë, dhe që poemat më të mira i varnin në muret e Qabes duke i shkruar me ar. Kurani erdhi dhe i sfidoi ata me retorikën e tij. Ai u tha, nëse realisht jeni të interesuar të verifikoni nëse është ky Kuran nga Allahu, hajdeni, sillni një kaptinë, madje një thënie si të tij: "Nëse jeni dyshues kundrejt atij (Kuranit) që ne ia zbritëm robit Tonë, sillni një kaptinë sikurse kaptinat e tij dhe sillini (për të realizuar këtë) gjithë ndihmëtarët tuaj përveç Allahut, bëjeni këtë nëse vërtet doni t'i qëndroni pretendimit tuaj. Ndërsa nëse nuk e bëni këtë, dhe nuk keni për t'a bërë, (Ju sfidoj t'a bëni këtë), atëherë duhet t'i ndruheni Zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët e që është përgatitur enkas për mosbesimtarët". Mosbesimtarët kureshitë ishin njerëzit më këmbëngulës në mënyrë kategorike kundrejt synimit të tyre, përgënjeshtrimit të Muhamedit -paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi të- dhe rezistencës kundër mesazhit të tij, ishin njerëzit më këmbëngulës për t'a realizuar këtë gjë. Ndërkaq thirren të sjellin një kaptinë si ato kuranoret, ashtu që t'i lenë mënjanë përplasjet vrastare dhe humbjet në shpirtëra midis tyre, harxhimin e pasurive të tyre në luftën që kishin ndërmarrë kundër muslimanëve, porse ata, krejt siç edhe Kurani lajmëroi, nuk mundën të bëjnë gjë.

Qenë vërtetë të mahnitur teksa elokuenca e Kuranit zbriste në zemrat e tyre dhe prekte thellësitë e shpirtrave të tyre. Personit prej tyre që dëgjonte tek Kurani i lindte në zemër se Kurani është fjalë e Allahut të Lavdishëm dhe Lartmadhëruar. Prandaj ata vërejtën se gjithkush dëgjonte Kuranin ndikohej dhe bëhej musliman, kështu që mosbesimtarët u konsultuan midis tyre dhe thanë: "Mos e dëgjoni këtë Kuran! Merruni me tjetër bisedë teksa ai lexohet dhe bëni që recitimi i tij të ndërpritet, që kështu të triumfoni". Ata propozonin që teksa Kurani lexohej zëri të ngrihej ashtu që të privonin të tjerët nga dëgjimi i tij. Problemi qe se ata patën frikë që të tjerët prej jokureshitëve dhe që s'ishin prej banorëve të Mekes të vinin dhe t'a dëgjonin këtë Kuran, ndaj ranë në ujdi që të kishin një përgjigje të vetme që kur të pyeteshin nga njerëzit të mos ndryshonin përgjigjet e tyre. Filluan të konsultoheshin midis tyre dhe të shoshisnin punët se çfarë të thonin për Muhamedin, çfarë të themi për të. Ia paraqitën këtë gjë Uelid ibnul Mugiras, i

cili qe shprehur mirë për Kuranin, e kish lavdëruar duke thënë se ky nuk mund të jetë fjalë e njeriut. Ai që shkoi tek Uelidi ishte Ebu Xhehli i cili i tha se kurejshët kishin rënë dakort të kontribuonin me një shumë të madhe të hollash, teksa Uelidi ishte tepër i pasur dhe mburrej me pasurinë që kishte. Ebu Xhehli e preku atë tek pika e tij e dobët. Uelidi i tha se përse po e mblidhnin atë pasuri për të. Ia ktheu sepse ti shkon tek Ebu Bekër Sidiku të dëgjosh prej tij Kuran. Ka shkuar puna deri aty që ti ke thënë edhe fjalë të mira për Kuranin, ndaj thamë t'i japim këto. Ndërkaq i mposhtur nga sedra e sëmurë Uelidi tha, po unë jam njeriu më i pasur këtu, si unë nuk ka kush pasuri as fëmijë. Ebu Xhehli i tha se populli yt nuk t'a njohin këtë prestigj derisa të thuash për Kuranin atë çfarë njerëzit e dinë dhe duan t'a thuash. Filloi të mendonte gjatë, në fund u tha, ne e dimë poezinë në detaj, as ai s'është poet dhe as Kurani s'është poezi. E dimë edhe prekjen nga çmendia, por këtu nuk ka të tillë gjë. E dimë edhe murmurimën idiote dhe rymën e të folurit të fallxhorëve. Kjo është tjetër gjë. Por nën presionin psikologjik që ndodhej bëri të mendonte thellë dhe tha, e gjeta. I thanë e çfarë është? Tha është magji, kush e dëgjon zemra i magjepset dhe përçahet nga njerëzit dhe familja e tij. Në këtë fjalë u tubuan kurejshët, se Kurani është fjalë magjepsëse. Përse magji, sepse nuk arritën të gjejnë koment për retorikën dhe elokuencën e mrekullueshme të këtij Kurani, aq sa nuk gjetën vetëm se të thonë se ai ishte magji. Lidhur me këtë armik të thënieve të Allahut, Allahu i Lartësuar shpalli: "Lërmë Mua se kam punë me atë që e krijova tek, me atë të cilit i dhashë pasuri të madhe, i dhashë edhe fëmijë që i qëndrojnë në krah, jetën ja bëra të këndëshme, ndërkaq ai lakmon se Unë do i jap edhe më.

Jo, jo. Ai u bë armik i thënieve (argumenteve dhe shenjave) tona. Shpejt unë do e ndrydh atë në një përfundim të jetës së tij krejt të tmershëm. Ai reflektoi dhe planifikoi. I shkatërruar më është, se si planifikoi. Sërisht, i shkatërruar më është, se si planifikoi. Ai sërish thellohej në mendime. Pastaj vrenjtej dhe bëhej edhe i vrazhdë. Pastaj ktheu shpinën me mendjemadhësi. E tha: "Ky (Kur'ani) nuk është tjetër, vetëm se magji që përcillet prej të tjerëve." Kjo është historia e Uelidit dhe kjo është përgjigja e kureshitëve për elokuencën dhe retorikën e Kuranit si dhe dështimi i tyre në sfidën ku ai i ftoi. Ne sot nga kjo nuk kapim vetëm se një gjë, çdo fjalë që dëgjojmë me kalimin e kohës bëhet e konsumuar kur e dëgjojmë të përsëritet shumë, madje edhe nëse ajo shoqërohet me melodi muzikore. E dëgjon, pastaj e dëgjon sërisht, sërisht dhe bëhet një gjë e konsumuar dhe e mërzitëshme. Por Kuranin, sado t'a dëgjosh dhe ridëgjosh, ai tingëllon i ri dhe nuk konsumohet. Kështu ne nuk arrijmë të kapim me qartësinë që kapnin arabët e hershëm nga elokuenca, retorika dhe pozita superiore e Kuranit në këtë aspekt, kjo për shkak të gjuhës dhe evoluimit të saj përgjatë kohës. Ajo që ne arrijmë të kapim është kjo rini e përhershme tingëlluese e Kuranit, Librit të Allahut të Lavdishëm dhe Lartmadhëruar. Folëm kështu lidhur me anën sfidante siç thamë se ajo qëndron tek përpilimi, tek përpilimi i mrekullueshëm i thënieve të Kuranit, gjë me të cilën nuk mund të vijë askush tjetër.

Ndërkaq ne kemi mrekullinë tjetër, atë të kuptimeve dhe përmbajtjeve që mbart Kurani Famëlartë. Prej përmbajtjeve madhështore që në gjejmë të shfaqet në ditët tona është

ajo që quajmë mrekullia shkencore në Kuran. Unë dua t'ju them një histori për të shpjeguar këtë. Doktor Maurice Bukay ka qenë mjeku personal i ish mbretit Fajsal. Ai pa sesi mbreti Fajsal dhe shpura e tij faleshin dhe bëri çudi sesi një monark falej dhe e bënte këtë me përpikmëri. Pasatj kujtoi vendin dhe popullin e tij sesi ata që para 200 vitesh e patën braktisur fenë dhe se shkaku i braktisjes së fesë në Evropë kish qenë përplasja në mes fesë dhe shkencës, fesë së krishterë tekstet e të cilës qenë devijuar dhe shkencës ekzakte të eksperimentueshme. Tha me vete, në rregull, rruga e largimit të muslimanëve nga feja e tyre është e njëjta që u përdor në Evropë. Duhet t'u vërtetojmë atyre se Islame dhe shkenca përplasen dhe nuk përputhen midis tyre. Porse shkaku i përplasjes midis fesë dhe shkencës në Evropë ishte se feja (e predikuar nga Ungjilli) përmbante edhe pse në vetëm ca shprehje të numëruara, shume gjëra që flisnin rreth universit, krijesave e kështu me rradhë, ndërsa më pas erdhi shkenca dhe gjeti tjetër gjë. Dhe pyeti a ka bërë fjalë Kurani rreth krijesave dhe dukurive natyrore? I thanë po, ka folur Kurani shumë rreth kësaj. Tha me vete atëherë e gjeta fillin. Do të jetë një bombë që do t'a shpërthejë në mbarë botën. Cila ishte? Tha nëse ky Kuran ka folur shumë rreth dukurive natyrore dhe universit, po qe se ai është vepër e Muhamedit atëherë ai do flasë rreth krijesave dhe natyrës sipas kulturës së tij personale, sipas kulturës së popullit të tij dhe kohës së tij dhe asaj çfarë sundonte asokohe. Ai e dinte se kultura në atë kohë, në atë vend dhe ambient ishte e mbushur me legjenda dhe trille, prandaj do gjejmë se Kurani do jetë i mbushur me të tillë gjëra kur bënte fjalë për krijesat, mendoi ai. Por nëse Kurani do të ishte nga Allahu do shohim se ai flet rreth këtyre vërtetësive në mënyrë kulminante, dhe se shkenca do vijë këmbadorazi derisa do zbulojë faktet e përmendura në këtë Kuran. Tha, atëherë kjo gjë kërkon prej meje të bëj një hulumtim. Bëri të studiojë Kuranin dhe gjuhën arabe përgjatë dhjetë vitesh. Tha unë nuk dua t'a studiojë Kuranin përmes komentimit të tij nga një person i cili e komenton atë nën një tendencë të tij. Ai deshi t'a kuptonte Kuranin ashtu siç e kuptuan ata mbi të cilët ai u zbrit. Pastaj pas dhjetë vjetësh deklaroi se hyri në Islam dhe tha, bomba shpërtheu e mua m'u bë e qartë se ky Kuran është prej Allahut dhe dëshmoi dëshminë islame LA ILAHE IL ALLAH MUHAMEDUN RASULULLAH-NUK MERITON TË ADHUROHET KUSH VEÇ ALLAHUT, MUHAMEDI ËSHTË I DËRGUARI I TIJ -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Në këtë episod do të flasim rreth diçkaje lidhur me mrekullinë e këtillë in she Allahu, që ka dalë në pah në epokën tonë, do flasim lidhur me këtë provë madhështore. Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- Allahu e përkrahu me mrekulli të shumta, shumë mrekulli jo vetëm këtë Kuran. Por mrekullitë e tij qenë të shumta aq sa mjaftonin për të gjithë njerëzinë pamvarësisht nga kultura dhe niveli i diturisë së tyre.

Prej këtyre mrekullive janë ato që dijetarët i njohin me termin përgëzimet (lidhur me Profetin Muhamed në Librat e Shenjtë). Çdo profet i ka treguar popullit të tij mbi profetin Muhamed se ai është Vula e profetëve dhe të dërguarve nga Zoti, të cilit e gjithë njerëzia duhet t'i besojë. Ndaj në Librat e mëparshëm të Shenjtë gjejmë përmendjen e profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, të fesë së tij, epokës së

tij, vendit ku do dërgohet, përshkrim të shokëve të tij dhe armiqve të tij, dhe detaje të mëtejshme. Lidhur me këtë e gjejmë Allahun e Lartësuar të thotë: "Ata të cilët nuk besojnë thonë se ti nuk je i Dërguar. Thuaj, mjaft është që Allahu është dëshmitar midis meje dhe jush, edhe ata që posedojnë diturinë e Librit të Shenjtë." Që do të thotë se çifutët dhe të krishterët posedojnë argumenta mbi faktin se unë jam i Dërguar nga Allahu, bërja me dije për mua dhe cilësitë e mia është prezente tek ata. Këto përgëzime qenë shkak për islamizimin e shumë prej të krishterëve, qoftë prej dijetarëve të mëdhenj të tyre, priftërinjve dhe murgjërve të tyre, qoftë prej masës së gjerë të popullit si dhe ishte gjithashtu shkaku i islamizimit të një numri prej çifutëve në qytetin e Medines. Kurani ka treguar lidhur me këtë argument, thotë Allahu i Lartësuar: "…Ai-Muhamedi, është përmendur në Shkrimet e Shenjta të profetëve të mëparshëm." Abdullah ibn Selami është një nga dijetarët e mëdhenj çifutë të Medines, kur dëgjoi për ardhjen e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ishte duke shtegtuar nga Meka për në Medine dhe brohoriti ALLAHU EKBER-ZOTI ËSHTË MË I MADHI. Një prej atyre që ishte pranë tha, për Allahun nëse do kishe dëgjuar për ardhjen e Musait nuk do të kishe bërë më shumë. Tha, Muhamedi është aty aty me Musain, është vëllai Musait, dhe më tej e përqafoi Islamin. Pastaj shkoi dhe u prezantua me cilësitë e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, dhe deklaroi islamizimin e tij. Për të Allahu zbriti fjalën e Tij: "…Dhe dëshmoi një dëshmitar nga bijtë e Izraelit (çifutët) për të, besoi teksa ju u treguat kryeneçë…" Më tej do bëjmë fjalë për këto përgëzimë e profeci dhe me lejen e Allahut do flasim për to në një tjetër episod. Madje shkaku i islamizimit të medinasve përpara mekasve ishin çifutët dhe përgëzimet në fjalë.

Kur midis çifutëve dhe fiseve arabe ndodhnin luftime dhe konflikte, çifutët i kërcënonin dhe u shfrynin atyre duke u thënë duroni vetëm pak, ne gjejmë në Teurat se kjo është koha në të cilën do të vijë Profeti, ne do t'a pasojmë atë dhe me të në krye do ju sfidojmë e agjësojmë siç u bë me popullin e Adit dhe Iramit. Prandaj arabët në Medine ishin të ndrojtur asokohe, nga ajo se një profet të cilin çifutët do e ndiqnin dhe që do i luftonte arabët dhe do hakmerrej kundër tyre, do dërgohej shpejt. Prandaj delegacioni i parë medinas që shkoi në Meke shkoi të takojë Profetin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Ishin këta që i thanë njëri-tjetrit për Allahun që ky është Profeti me të cilin çifutët ju kërcënojnë. Mos lejoni t'i qasen atij para jush. Mos të shkojnë para jush tek ky Profet. Nga shkaqet më të rëndësishme të islamizimit të tyre qenë përgëzimet prezente tek çifutët të cilat ata i predikonin në bisedat e tyre me arabët. Lidhur me këtë Allahu zbriti Kuran ku lexojmë: "Kur atyre u erdhi Libër nga Allahu, në konkretizim të Shkrimeve të tyre të Shenjta, teksa para kësaj ata-çifutët u hakërreheshin mosbesimtarëve se do triumfonin mbi ta (me ardhjen e Profetit të pritur), por kur ai u erdhi nuk e njohën, e mohuan. Mallkimi i Allahut është mbi mosbesimtarët." U erdhi ky Kuran, konkretizues i përgëzimeve që thonin dhe para kësaj i luteshin Allahut të fitonin përkrahjen e Profetit të Ri që do dërgohej së fundmi (Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-) për të cilin pranuan se do vinte dhe e prisnin.

Prej mrekullive të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- është lajmërimi i tij për të fshehtën. Sa e sa lajmërime të tij për të shkuarën janë zbuluar se janë realitet, sa e sa lajmërime të tij mbi të kaluarën, rreth historisë së universit dhe evoluimit të tij, sot shkenctarët janë të aftë t'i shikojnë ato krejt në përputhje me atë me të cilën Kurani është shprehur apo ka bërë fjalë për të Profeti. Ai na flet për historitë e disa popujve nën shqyrtimin kuranor, gjë për të cilën vijnë argumente që vërtetojnë realitetin e asaj çfarë Kurani ka thënë. Sa e sa herë u foli Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- njerëzve rreth të fshehtës që ata fshihnin në shpirtin e tyre ose që ishte e fshehtë për ta dhe ndodhte në një vend të largët dhe pasiqë ata e mësonin ajo bëhej shkak për islamizimin dhe besimin e tyre. Prej këtyre qe edhe islamizimi i popullit jemenas njëherazi. Një popull i tërë hyri në Islam. Cili është sekreti i islamizimit të këtij populli. Nuk erdhi ndonjë ushtri, nuk i luftoi Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- banorët e Jemenit, porse ata shkuan dhe i kërkuan t'u dërgojë atyre mësues. Cili ishte shkaku që një popull i tërë kthehet këmbëekokë. Kjo ishte një mrekulli, mrekulli e kësaj kategorie, lajmërimit për të fshehtën.

Përgjigjja vjen në vijim… Me paktin e Hudejbijes Profeti dërgoi zëdhënësit e tij tek monarkët duke i ftuar ata në Islam. Jemeni qe nën diktatin e Persisë dhe prijësi pers Bazani asokohe me ushtrinë e tij qeveriste Jemenin i vendosur në Sana. Kur letra e Profetit i arriti Mbretit të Persisë ai u revoltua dhe i kërkoi Bazanit në Sana t'ia sillte Profetin gjallë a vdekur. Bazani dërgoi dy persona të kryenin punë. Njëri prej tyre quhej Nabug dhe tjetri Kharkhasru, që të dy arritën tek Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Persët e kishin traditë që rruanin mjekrën dhe linin mustaqet. Kur i erdhën iu kthye atij djathtas pastaj atij majtas dhe u tha kush i kishte urdhëruar të rruanin mjekrat. Ata thanë Zoti ynë, pasi ashtu si egjiptianët për Faraonin, persët besonin se mbreti i Persisë ishte Zot. I Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u tha, kurse Zoti im më urdhëroi mua t'a lëshojë këtë (mjekrën) dhe t'i rrallojë këto (mustaqet). Pastaj i vonoi për të nesërmen. Po atë natë Allahu u hakmorr për të Dërguarin e Tij dhe bëri që i biri i mbretit të Persisë t'a vriste të jatin, mbretin. Ndërkaq Allahu e lajmëroi Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se Allahu e morri hakun e tij prej atij që e kërkoi gjallë a vdekur. Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- me këtë rast i lajmëroi dy të dërguarit e Bazanit. I urdhëroi të ktheheshin tek Bazani që i kishte dërguar duke u dhënë kështu atë mesazhin që shkruhet në histori dhe aq shumë e përmendin njerëzit, në sajë të të cilit besuan banorët e Jemenit dhe u futën në Islam.Vërtetë ai ishte një mesazh por që qe një mrekulli e faktuar. I urdhëroi të kthehen dhe t'i thonë Bazanit se Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- na ka thënë se Zoti im ka vrarë zotin e tij mbrëmë, që korespondonte 13 Jumada I, viti VII hixhri, siç transmetojnë disa libra të historisë. Kalon koha dhe lajmet për vdekjen e mbretit vijnë nga Persia dhe me këtë rast Bazani tha dëshminë e fesë ESH HEDU EN LA ILAHE IL ALLAH UE ESH HEDU EN NE MUHAMEDEN RASULULLAH-DËSHMOJ SE NUK MERITON TË ADHUROHET KUSH VEÇ ALLAHUT, DHE SE MUHAMEDI ËSHTË I DËRGUARI I TIJ. Kjo u bë shkak që të hynin në Islam persianët,

populli i Jemenit dhe gjithë popujt persë në pasim të tyre. Lajmërimi mbi të fshehtën. Prej lajmërimit mbi të fshehtën është edhe ai lidhur me çfarë do ndodhë në të ardhmen gjë për të cilën Profeti gjithashtu ka bërë fjalë rreth disa prej të tillave që në vetvete përbëjnë vërtetë sfida. Për to do flasim më vonë. Disa prej lajmërimeve profetike rreth të fshehtës janë duke ndodhur sot në kohën tonë. Për to na ka lajmëruar dhe treguar vetë Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Prej mrekullive të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- është ndihma që Allahu i dha atij përmes gjërave të jashtëzakonshme, përfshirë ndihmën në beteja nëpërmjet erës apo engjëjve që luftonin në krahun e tij, shumimin e ushqimit nëpër duart e tij aq sa ushtritë hanin nga ai, uji mbaronte dhe Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- vendoste gishtat në enën e ujit dhe uji gurgullonte përmes gishtave të tij, e luste Allahun për njerëzit që i vinin dhe lutja e tij merrte përgjigje aty për aty. Të shumta ishin mrekullitë, të jashtzakonshmet dhe faktet që Allahu i dha Profetit të Tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Më pas do përmendim disa nga mrekullitë e kësaj natyre të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Gjithashtu ai që mediton rreth situatës së tij, sesi Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- qe urdhëruar nga Zoti i tij që të ecte i shoqëruar nga badigardët e tij që qenë prej shokëve të vet, që të mos e godiste dora vrastare, derisa Allahu i shpalli thënien: "O ti Profet! Përcille atë që t'u shpall nga Zoti yt. E nëse nuk e bën atëherë ti nuk e ke përçuar mesazhin e Tij. Allahu të garanton nga e keqja e njerëzve." Përcille mesazhin e mos ke frikë, mos ke ndrojtje. Pas zbritjes së kësaj thënie Profeti u tha badigardëve të tij, o njerëz lërmëni, Allahu më ka dhënë garancinë e Tij. Kush është ai që bën aventurë në kurriz të jetës së tij, përveçse duke qenë besues i paepur në Zotin e tij?! Pas kësaj, pasi i liroi nga detyra rojet personalë ai pati disa komplote që synuan vrasjen e tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Që të gjitha dështuan pasi Allahu gjithmonë e mbrojti atë. Të shumta qenë argumentet dhe faktet që e shoqëruan në situatat dhe rrethanat e tij jetike, aktet adhuruese, virtytet e tij dhe jetësitë e tij, të shumta qenë mrekullitë që iu paraqitën atij përgjatë jetës së tij, mrekulli të cilat prehnin dhe forconin besimin në zemrat e njerëzve dhe i bënin ata të dëshmonin qenien e tij Profet i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu

Atributet e Allahut të Lartësuar (3)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Po flasim në vazhdimësi për atributet, cilësitë e Allahut të Lavdishëm dhe Lartmadhëruar, për këtë çështje madhështore pa të cilën nuk duhet t'i thotë njeriu vetes se është kompletuar në lëmin e diturisë. Thamë se ne e kemi njohur Allahun e Lartësuar përmes argumenteve të Tij që ka transmetuar në këtë ekzistencë, përmes profetëve, mrekullive të tyre, përmes përgjigjes që Ai i jep lutjes së lutësit; përmes dritës logjike me të cilën ai ka ndriçuar mendjet tona dhe me të cilën Ai na orienton rreth Hyjnisë së Tij; përmes natyrshmërisë me të cilën e ka natyrizuar tek ne të tillë që në momentin e nevojës supreme të strehohemi vetëm tek Ai. Mësuam edhe për argumentet e Profetit dhe vërtetësinë e tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, argumenta këto që dëshmojnë pro tij, dëshmojnë se profecia dhe revelata e tij hyjnore është fakt, argumenta këto që i përcollëm dhe do i përcjellim në këtë emision. Thamë se ka disa cilësi prej cilësive të Allahut gjurmën e të cilave ne mund t'a shikojmë të reflektohet tek krijesat. Por thamë se ka edhe cilësi që kanë të bëjnë me Vetveten e Tij Hyjnore, me Synimin e Tij, Dëshirën e Tij Hyjnore, çfarë Ai do, kënaqet me të, çfarë nuk do dhe zemërohet me të, si dhe çfarë ka të bëjë me cilësitë e Tij Personale Hyjnore. Të gjitha këto janë nga çështjet hyjnore të fshehta, për njohjen e të cilave nuk ka rrugë përveçse duke na ardhur sqarimi nga Vetë Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhëruar, sepse më mirë se ç'e njeh Allahu veten e Tij nuk ka kush t'a njohë, ose duke na ardhur sqarimi nga i Dërguari i Tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të cilin Allahu e mundësoi të mësojë të fshehtën dhe të depërtojë në të. Arsyeja e vetme nuk mundet të depërtojë në sa në fjalë. Arsyeja është e paaftë të shikojë se çfarë gjendet brenda një sunduku të mbyllur, atëherë si do mundet ajo të përfshijë në njohurinë e saj Zotin e qiejve dhe të tokës.

Shumë prej atyre që fantazojnë se mendjet dhe arsyet e tyre janë të palimituara, në fakt kanë rënë në një fantazi pafre. Mendo, ti me syrin tënd nuk mund të shohësh vetëmse deri në një distancë të caktuar, pas asaj distance nuk mundesh të shikosh. Gjithashtu nëse një gjë t'a afrojnë shumë pranë nuk mund t'a shikosh. Edhe nëse drita është shumë e fortë njeriu s'arrin t'i hapi sytë dhe të shohë. Atmosferën, ajrin që i prek sytë e tu ti nuk mund t'a shikosh. Shikimi është i limituar. Po kështu edhe përmes dëgjimit ti mund të dëgjosh gjërat që ndodhin pranë veshit tënd, kurse më tej se kaq ti nuk mund të dëgjosh. Pastaj nuhatja, shija dhe prekja, që të gjitha janë të limituara dhe kufizuara, gjë kjo që dihet nga të gjithë. Në realitet mendja s'është veçse i izoluari brenda këtyre ndjesive dhe shqisave. Po të imagjinojmë një person që nuk ka shqisa, as dëgjim, as

shikim, as nuhatje, as shijim, as prekje, si mund t'a mësosh një person të tillë?! Ai nuk shqison asgjë. Pra, mendja punon pasi t'i vijnë të dhënat nga këto shqisa, dhe ne pamë se këto shqisa ishin të kufizuara, pra i bie që edhe mendja të jetë e kufizuar në kufijtë e këtyre shqisave. Për më tepër mendja është e kufizuar në aftësitë dhe fuqitë e saj. Nëse ti don të imagjinosh fundin e terres, çfarë ka në fund të universit apo çfarë shtrihet në skajet e përtejme të këtij universi, ke për të dështuar. Po kështu po tentove të imagjinosh në miniaturë se çfarë ka pas gjësë më të vogël të mundshme, më e vogla e thënë deri tani është atomi, cila është gjëja më e vogël se atomi, më e vogla e thënë deri tani është elektroni, cila është gjëja më e vogël se elektroni, do thonë një gjë tjetër, e kështu me rradhë derisa është thënë se gjysma apo ndarja e pjesëzës është më e vogël se e tëra, që i bie se çdo gjë të vogël që njeh i bie të ndahet në më të vogël. Kur të vijë puna për më të voglën mendja do të tërhiqet dhe ndalojë. Po u pyet mendja se çfarë ka patur në fillim të kohës, po në fundin e saj, ajo stonon të jap përgjigje. Këto çështje i kalojnë kufijtë e mendjes, pra mendja është e kufizuar në kufinjtë e shqisave dhe në kufinjtë e aftësisë së saj. Madje çuditesh kur i dëgjon inxhinierët të flasin për numrin më të madh, cili është ai. Folën e folën dhe në fund thanë është infiniti-pafundësia. E ç'është pafundësia? Thanë është ajo gjë që nuk ka fund. Pastaj filluan të bëjnë kalkulime me shifrën infinit dhe thanë 1 milion infinit plus 100 trilion infinit bëjnë sa, bëjnë infinit. Këtu mendja stonon, ndalon, e tillë gjë nuk është brenda aftësisë së saj. Kjo është mendja, e kufizuar dhe madje shkon deri aty saqë çuditet dhe çoroditet për gjëra me të cilat s'është mësuar. Kështu imagjino nëse një personi që ka jetuar 200 vjetë më parë do t'i thuhej se njerëzit e ditëve të sotme (pas 200 vjetësh) mundet kudo qofshin në tokë, në dhomë brenda, në mal, në fushë, i flasin drejtpërdrejtë njëri-tjetrit dhe mund edhe t'a shohin -sot ka videotelefonë që e bëjnë këtë-, ky njeri do t'a kishte të pamundur t'a besonte një gjë të tillë. Nuk do mund t'a përtypnin të tillë gjë njerëzit e para 200 madje qoftë edhe 100 vjetëve. Si mundet t'i flasë filani filanit në tjetër kontinent madje edhe t'a shohë. Mendjet do t'i çudiste dhe çorodiste një gjë e tillë.

Atëherë si nuk çuditet mendja lidhur me disa prej cilësive të Allahut, të Lartësuarit dhe Lartmadhëruarit, Poseduesit të cilëve të përsosura?! Ne dimë dhe bëmë fjalë rreth galaktikave dhe distancave gjigande midis tyre, drita e dalë prej të cilave është vrojtuar me teleskop, dhe drita e ardhur nga këto galaktika të vrojtuara për të ardhur tek ne në tokë ka udhëtuar afërsisht 12 bilion vjet, teksa për çdo sekondë ajo përshkon 300 mijë kilometra. Sa i bie në minutë, sa në orë, sa në ditë e sa në një vit?! Përfytyro çfarë distance e gjatësie i duhet dritës të udhëtojë përgjatë 12 bilion vitesh. Pastaj të gjitha këto yje nuk janë vetëmse stoli të qiellit të dynjasë, në afërsi të qiellit të dynjasë, pastaj vjen skaji i qiellit të dynjasë, pastaj qielli i dytë vjen pas tij, pastaj i treti, i katërti deri tek i shtati, pastaj këto shtatë qiej në krahasim me Kursinë (Ndenjësen) e Allahut janë të pallogaritshme. Pastaj Kursija në krahasim me Fronin e Allahut është e pakrahasueshme, sikurse do t'a shohim në këtë hadith të përmendur nga Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, në të cilin nga Ebu Dher el-Giferiu vjen se ai e ka pyetur Profetin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- rreth Kursisë së Allahut

gjë për të cilën Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- tha: "Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, shtatë qiejt dhe tokët krahasuar me Kursinë s'janë vetëmse si puna e një unaze e gjendur në një shkretëtirë", pra si një unazë e hedhur në një tokë shkretinore të paskajshme. Mendo se sa pjesë zë kjo unazë në shkretëtirën e paskajshme? "…shtatë qiejt dhe tokët krahasuar me Kursinë s'janë vetëmse si puna e një unaze në një shkretëtirë, ndërkaq favorizimi i Arshit (Fronit) të Allahut kundrejt Kursisë është si favorizimi i shkretëtirës përkundrejt kësaj unaze." Me "favorizimi i shkretëtirës" nënkuptohet se Arshi-Froni në krahasim me Kursinë është aq sa ç'është një shkretëtirë e gjerë përkundrejt një unaze të vockël. Dhe Mëshiruesi Allah Veten e Tij e cilësoi duke thënë: "Mëshiruesi qëndroi mbi Arsh-Fron." E si do mundej kjo mendje e kufizuar të përfshijë në të atributet e Allahut të Lavdishëm dhe Lartmadhëruar. Nuk ka rrugë për të mësuar atributet e Allahut vetëmse duke na ardhur ato nga shpallja hyjnore.

Shembull tjetër. Nëse një guri do t'i thuhej të imagjinonte njeriun, pasionet dhe dhuntitë e tij, arsyen dhe intelektin e tij, shpirtin dhe krijimtarinë e tij, a mundet guri të jetë i aftë të bëj diç prej kësaj?! Të konceptojë ndjenjat, pasionet, mendimin, krijimtarinë, a mundet një send t'a kap këtë avancim?! A munden produktet e njeriut të arsyetojnë cilësitë në fjalë të njeriut?! E pra avancimi i Krijusit tonë kundrejt nesh është edhe më i madh se avancimi midis nesh dhe produkteve tona ose sendeve. Kështu Vetvetja e Allahut qëndron më lartë se të kemi mundësi t'a përfshijmë atë në arsyetimin tonë, dhe nuk ka rrugë për të arritur tek njohja e saj vetëmse duke na njohur Allahu me Të përmes shpalljes hyjnore. Shpallja ne na vjen përmes profetëve, që është dhe rruga e vetme, përmes profetëve, lidhur me të cilët Allahu ka thënë: "… (Ai Allahu) është Njohës i fshehtësisë. Nuk ia zbulon fshehtësinë e Tij askujt, përveç atyre që u kënaq me to të jenë të dërguarit-profetët e Tij." Kjo është një çështje të cilën ne e marrim të mirëqenë. Ne i marrim për të mirëqenë kompetentët dhe specialistët ashtu që kur ti do të pyesësh për agrokulturën konsutohesh me specialistin e agrokulturës dhe i merr për të mirëqena ato që ai të thotë, edhe pse çfarë ai të thotë do të tingëlloj e çuditshme dhe i kalon shqisimet e tua. Po kështu nëse do të thonë diçka shkenctarët e gjeologjisë, astronomisë, mjekësisë, etj, ti do dorëzohesh dhe do i marrësh për të mirëqena çfarë të thonë, duke qenë i vetëdijshëm se ata janë ekspertë dhe kanë depërtuar në gjëra që ti nuk ke depërtuar. Fjalën e këtyre ekspertëve ti e pranon pasi beson në to… Po kështu ne i besojmë fjalët e profetëve duke patur besim në to, madje besimi ynë tek profetët është më madhështor se besimi i njerëzisë tek ekspertët e saj. Profetët e Allahut janë të garantuar që të mos bien në gabime, paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi to. Porse metodika e këtyre profetëve - paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi to- ishte të na mësojnë rreth cilësive të Allahut të Lavdishëm dhe Lartmadhëruar përmes të folurit, gjuhës, gjë për të cilën i Lartësuari thotë: "Ne nuk kemi dërguar ndonjë të dërguar përveçse në gjuhën e popullit të tij, që t'i sqarojë ata". Pra gjuha është mjeti i kuptueshmërisë dhe i përafrimit tonë lidhur me ato cilësi madhështore që kanë të bëjnë me Krijuesin tonë. Është obligim për ne të qëndrojmë në kufirin e gjuhës, mos t'i japim këtyre cilësive hyjnore kuptime të tjera që nuk i përmban gjuha. Shembulli në vijim na

sqaron lidhur me këtë. Një mbret urdhëron shpurën e tij të ulen, pastaj u thotë ikni, pastaj u thotë kthehuni, pastaj u thotë hani, dhe ata veprojnë çfarë u tha. Pastaj u thotë atyre, ju nuk keni vepruar sipas urdhërave të mia. Si, i thonë, ne bëmë pikë për pikë çfarë na the. Mbreti u tha, jo. Kur unë u thashë uluni unë kisha për qëllim të ngriheshit, kur u thashë ikni kisha për qëllim uluni, kur u thashë kthehuni kisha për qëllim nuk duhet të ktheheni, kur u thashë hani kisha për qëllim dilni jashtë. Çfarë do t'i thotë shpura e tij këtij mbreti? Si do justifikohen shoqëria e tij në këtë rast? Do thonë, për Zotin ne nga urdhërat që na dhe kuptojmë atë çfarë thotë gjuha në atë formë që është tradicionale për të gjithë njerëzit. Gjuha ka për funksion sqarimin dhe qartësimin. Ne bëmë çfarë na the, ndërsa lidhur me kuptimet që ti nënkuptoje nuk dimë ç'të themi, qenë të paqarta për ne. Duke u zbuluar kështu se mangësia qëndron tek mbreti në fjalë i cili nuk i përdori drejtë fjalët, që të orientojnë në kuptimin e tyre. Ata të cilët thonë, Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhëruar kur e cilësoi Veten e Tij me një cilësi të caktuar për qëllim kishte një tjetër kuptim, a mos po duan të thonë se Allahu nuk di të shprehet mirë, nuk di të qartësoj mirë, nuk di të flasë mirë?! I dëlirë është Allahu dhe shumë lartë qëndron nga një shpifje e tillë. A nuk është Allahu Ai që thotë: "Fjala e kujt mund të jetë më e besueshme se ajo e Allahut?!" Normalisht nuk ka. Fjala e Tij është fjalë e besueshme, e drejtë. Ai është thënësi: "…Kush është më i besueshëm në të folur se Allahu?!" Të folurit, biseda e Tij është ajo e besueshmja, e sakta që nuk përmban asnjë problem. Fjala e Tij është fjala më e përsosur që orienton në kuptimet e synuara, gjë për të cilën Allahu thotë: "Allahu zbriti thënien më të përsosur…" Thënia e tij është thënia më e përsosur, më e vërteta, pra ne duhet të marrim për bazë kuptimet në të cilat orientojnë tekstet të cilat na erdhën në Librin e Allahut, Kuranin, si dhe në Traditën Profetike -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, pa tentuar të bëjmë stërkomentime dhe shtesa në kuptimet e tyre jashtë kuptimit që ato shprehin. Allahu thotë: "Kuran në arabisht jo i tërthortë." Pra kuptimet e citateve të Kuranit nuk janë të dyjëzuar, të tërthortë, porse ai është arabik i qartë në gjuhën e qartë arabe, kuptimet e tij janë të dukshme. Le të japim një shembull lidhur me këtë. Nëse Allahu thotë rreth Vetvetes së Tij Hyjnore: "Mëshiruesi qëndroi në Fron." Çfarë u tha është gjë që dihet. Përgjigjja shtjelluese që do japim është po ajo që imam Maliku dha: "Qëndrimi (i Allahut në Fron) është gjë që dihet…", pra është gjë që dihet në gjuhën e arabëve, "…mënyra nuk dihet…", pra mënyra se si është mister, pasi ajo ka të bëjë me fuqinë e imagjinatës e cila nuk është e aftë të arsyetoj dhe konceptojë siç është për shembull rasti me gjumin, mendja nuk mund të imagjinojë se si është gjumi, fuqia e imagjinatës nuk është e aftë të imagjinojë se kush është ai që i bie derës. Fuqia e imagjinatës është e cunguar dhe gjithashtu të cunguara dhe kufizuara janë edhe si-të që kanë të bëjnë me këtë forcë të paaftë. Teksa fuqia e ndërgjegjes dhe arsyes, ndryshe nga ajo e imagjinatës në tym, mund t'a depërtojë pengesën që përbën dera, arrinë të reflektojë se aty pas është një person që po i bie derës, dhe mundet bazuar në zërin dhe mënyrën e goditjes së derës, të orientohet rreth atij që i bie derës. Pra çështja ka të bëjë më fuqinë e imagjinatës, prandaj imam Maliku tha se "mënyra se si qëndron Allahu mbi Fron" është e paditur. Është e paditur mënyra se si qëndron Allahu në Fron, pasi fuqia e imagjinatës sonë është

e dobët, e paaftë t'a konkludojë një gjë të tillë. Dhe vijon imam Maliku, "...të pyesësh për mënyrën se si (qëndron Allahu në Fron) është një bidat (sajesë e keqe në fe)", pra është sajesë pasi nuk e patën bërë kurrë të tillë pyetje shokët e Profetit -Allahu qoftë i kënaqur me ta-. Kështu kur na vjen sqarimi nga Allahu duhet të kemi kujdes, nëse Allahu e përshkruan Veten e Tij me një cilësi, këtë cilësi e marrim siç është, por pa u futur në atë se si është kjo cilësi, pa e përngjasuar atë, duke mos thënë kjo i përngjan kësaj gjëje tek krijesat. Jo, Allahu nuk është si krijesat. Cilësitë e Krijuesit janë ndryshe nga ato të krijesave. A s'e vërejmë dallimin midis cilësive të sendeve dhe cilësive të njeriut?! Pastaj, sa gjykon të jetë dallimi i cilësive tona dhe të mbarë krijesave me cilësitë e Allahut?! Cilësitë që atribuojnë Allahun janë madhështore, të tilla që kanë të bëjnë me Madhështinë e Tij, ndaj dhe ne nuk i përngjasojmë ato me diç prej cilësive të krijesave të Tij. Dijetarët kanë thënë se çdo imagjinim që personi imagjinon për Allahun, çdo imagjinatë që mund t'a sjellësh ndër mend lidhur me Allahun, dije se Allahu është ndryshe nga ajo. Pse? Sepse imagjinata që ti imagjinon është një imagjinatë bazuar tek krijesat që ke parë, imagjinatë bazuar tek krijesat që ke parë. Ndaj na del si detyrë të qëndrojmë në kufijtë e fjalës arabe dhe kuptimit të saj, kuptimit në të cilin orienton kjo fjalë. Nuk duhet të tentojmë të ndërtojmë dhe bëjmë përngjasime lidhur me ndonjë cilësi të Allahut, përndryshe do të biem në gabime të mëdha, sepse në të tillë gjë kanë rrëshqitur sa e sa këmbë.

Për të sqaruar dhe hetuar qartë se si rrëshqasin njerëzit në të tilla gjëra le të marrim këtë shembull: Imagjinoni një person shumë i besueshëm në mesin e popullit të vet, jeton për shembull në një tokë të largët të shkretë, pra ai njihet si person i besueshëm në popullin e vet. Vjen puna e ai shkon në një qytet ku shikon një radio, pa një paisje hekuri që flet. Kthehet tek populli i tij të cilëve u thotë, kam ardhur nga një vend ku hekuri fliste. Populli i tij thonë, njeriu jonë që e njohim për të besueshëm na tha se hekuri flet. Ndodhi që ky person vdiq dhe populli i tij filluan të filozofonin rreth hekurit që flet. Thanë, a nuk na tha ai se hekuri flet?! Thanë po, dhe e dini se ai është person i besueshëm. Thanë po e pranojmë se është i besueshëm. Por meqënëse ky hekur flet i bie që ai të ketë gjuhë. Por a mundet të ketë gjuhë e të mos ketë gojë? Thanë, nuk mundet. I bie se ky hekur domosdoshmërisht e ka edhe një gojë. Pastaj thanë, po a mund të ketë një gojë e të mos hajë dhe pijë? Thanë, jo. Pra, thanë, i bie që ai edhe të hajë dhe të pijë. Por a mundet të hajë dhe pijë e të mos nxjerrë jashtëqitje? Thanë jo. Pra ai është i tillë. Avash avash ata, këtë aparat radioje në përngjasim e sipër e sajuan në kokat e tyre në imazhin e një njeriu, që hanë, pinë... Përse ranë në këtë gabim? Kjo pasi ata përngjasuan atë që i takonte misteriozes dhe të paditurës me atë që kishin shqisuar duke bërë analogji me këtë të fundit, krahasim ky i pavlefshëm. Krahasuan çështjen e hekurit që fliste e që të tillë si ai s'kishin parë më parë, me atë që kishin parë të fliste, njeriun. Kjo përsa i përket hekurit që flet. Nëse do t'i thoshim personit të këtij populli që shikoi "hekurin që fliste" përse nuk u tregove atyre mënyrën se si fliste ky hekur ai do thoshte, nëse do t'u tregoja atyre mënyrën se si fliste ky hekur do ishin çoroditur dhe sprovuar, nuk do mundeshin t'a thithnin këtë. Nëse do u kisha thënë siç mësova në qytet, se të

folurit e këtij hekuri ka të bëjë me valët elektromagnetike që veprojnë në një kuti ku gjendet një disk metalik që bën të ndodhin amplifikime që përmes një artopolanti konvertohen në impulse elektrike, e që duke u kthyer në një disk prej disqeve të brendëshme japin për ne timbra zanorë etj etj… nëse do u kishte thënë atyre sa më sipër do kishin thënë a është i çmendur ky apo çfarë?! Tha, unë nuk u rrëfave atyre detajet pasi nuk do t'i thithnin, por u mjaftova duke u thënë se hekuri në fjalë fliste. Ata duhet të kishin qëndruar në këtë pikë, hekuri flet dhe kaq. Si? Nuk na tha se si. Kështu ata që deshën t'a dinin çështjen duke bërë krahasime dhe përngjasime, duke bërë filozofi pa asnjë argument, të tillët ranë në humbje dhe mbetën largë realitetit. Ne, me mundësitë tona të kufizuara, me mjetet e kufizuara që kemi, me shqisat e kufizuara që kemi, me mendjen e kufizuar që kemi, me imagjinimet e kufizuara që kemi, nuk mundemi t'i përfshijmë në arsyetimin tonë cilësitë e Zotit të qiejve dhe të tokës. Nuk është e mundur për ne një gjë e tillë. Ndaj na duhet t'a shmangim dhe anashkalojmë këtë hap dhe rrëshqitje të rrezikshme, që është krahasimi i atributeve dhe cilësive të Allahut bazuar mbi cilësitë e krijesave. Allahu thotë: "Asgjë nuk është si Ai, Ai është Gjithdëgjuesi, Gjithshikuesi." Atij askush nuk i ngjan, por ama i Lartmadhëruari dëgjon dhe shikon, sigurisht në mënyrën e pakrahasueshme hyjnore të Tij. Këtu Ai kundërshton ngjashmërinë me Të, ashtu që asgjë dhe askush nga krijesat nuk i ngjan kurrsesi Atij. Asgjë dhe askush nuk është si Ai. Çfarëdolloj imagjinate të të vijë në mendje për Allahun, dije se Allahu është ndryshe nga ajo, rregull të cilin e thonë vetë dijetarët. Porse kjo nuk do të thotë se Allahu nuk posedon cilësi dhe atribute, nuk do të thotë se Ai është pa cilësi dhe pa atribute. Nuk kuptohet kjo nga thënia e mësipërme Kuranore se "Asgjë nuk është si Ai", jo kurrsesi. Ai është i dëlirë nga kjo, Ai është Poseduesi i cilësive supreme. Në fakt thënia nxjerr në pah se përsa i përket përngjasimit duhet të dihet një gjë e tillë. Prandaj gjejmë thënien në fjalë t'a përjashtojë të bëmurin përngjasim dhe të verifikojë prezencën e cilësive, ashtu siç erdhi në citatin kuranor në fjalë, ku Allahu i Lartësuar thotë: "Asgjë nuk është si Ai, Ai është Gjithdëgjuesi, Gjithshikuesi." Pra Ai është Gjithdëgjues dhe edhe Gjithshikues, teksa dëgjimi i tij nuk është si dëgjimi ynë apo i krijesave dhe vështrimi i Tij nuk është si vështrimi i dikujt prej krijesave. Dëgjimi ynë është i kufizuar me vendodhjen ku gjendemi, ndërsa Allahu nuk është i kufizuar në hapësirë, asgjë nuk e pengon Atë të dëgjojë çfarë është në këtë ekzistencë kudo qoftë. Ai na dëgjon ne këtu ku gjendemi, e dëgjon atë që është në majat e maleve, atë që është edhe më lartë, engjëjt në qiell gjithashtu i dëgjon kur flasin. Dëgjimi i Tij, i Lavdishëm dhe Lartmadhëruar është Ai, është ndryshe nga dëgjimi ynë.

Ai dëgjon, verifikuar kjo nga vetë fjala e Tij, por si? Për këtë si folëm njëherë, le të sjellim ndërmend limitimin dhe kufizimin e imagjinatës, le të sjellim ndërmed hekurin që flet, dhe se si do biem në gabim sikurse në rastet që përmendëm më herët. Allahu na tha se është Gjithdëgjues, ndaj themi Ai është Gjithdëgjues, ashtu që Ai na dëgjon ne dhe çdo zë që do, gjë për të cilën nuk mund t'i bëhet pengesë asgjë, i Lavdishëm dhe Lartmadhëruar është Ai. Është Gjithshikues, do të thotë se Ai shikon gjithë çfarë do, gjë për të cilën nuk mund t'i bëhet pengesë asgjë, as distanca e tejskajshme nuk i shkakton problem Atij

lidhur me këtë, pasi vetë distancat dhe shtresat ndërmjetëse janë krijesa prej krijesave të Tij, që nuk mund t'i bëhen pengesë dëgjimit dhe vështrimit të Tij. Prandaj Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhëruar i thotë të nderuarit tonë Musait dhe vëllait të tij Harunit kur i urdhëroi të dy bashkë të shkojnë tek Faraoni: "Unë jam me ju, dëgjoj dhe shikoj." Dëgjon dhe shikon, pra distancat lidhur me Allahun nuk funksionojnë negativisht, pengesat lidhur me Allahun nuk funksionojnë negativisht, tha: "Unë jam me ju" ndërhyj dhe reagoj, "Mos keni frikë". Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhëruar na e ka bërë ne të njohur të tillë fakt, se Ai dëgjon dhe shikon, nëpërmjet argumentit shqisor, pyesni ata që e kanë lutur Allahun dhe Ai u është përgjigjur, qoftë në namazin kur duam të bjerë shi, qoftë në eliminimin e një vuajtje, qoftë në çlirimin nga stresi, qoftë në shërimin e sëmundjes. Pyesni ata rrotull jush që janë strehuar tek Allahu dhe do bëheni dëshmitarë të sa e sa historive, dhe do bëheni dëshmitar të faktit se Allahu e dëgjoi këtë njeri në dhomën e tij të gjumit, ia dëgjoi lutjen këtij tjetrit që kishte gruan për lindje në sallën e operimit dhe kur ai iu lut Allahut, gruaja e tij i shpëtoi operimit. Do gjeni të sëmurë të cilit doktorët i kanë thënë, shërimi yt është i pashpresë dhe se si pasi ai është strehuar tek Allahu duke iu lutur, Allahu ia ka eliminuar këtë sëmundje. Njëri e luste Allahun teksa gjendej në fshat, tjetri në majën e malit, tejtri në fushë, tjetri në makinë, tejtri në aeroplan e kështu me rradhë, dhe Allahu iu përgjigj të gjithë këtyre, i dëgjoi dhe i pa ata kudo që qenë ndodhur, iu përgjigj lutjes së tyre dhe iu dha atyre pikërisht atë çfarë gjithsecili kërkoi, në varësi të kërkesave të ndryshme që çdonjëri prej tyre kërkoi. Kështu pra, Allahu është Gjithdëgjues, Gjithshikues, porse dëgjimi tek Ai nuk është si dëgjimi ynë apo i dikujt prej krijesave të Tij, dhe shikimi i Tij nuk është si shikimi ynë apo i dikujt prej krijesave të Tij, prandaj themi se Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhëruar është me ne edhe pse Ai është në Fronin Fisnik.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Si ishte zanafilla e këtij universi (4)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu!

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.
Allahu i Lartësuar na dhuroi ne vështrimet dhe na urdhëroi që të vështrojmë me to, ka thënë i Lartësuari: "Thuaj, vështroni çfarë ka në qiej dhe në tokë." Dhe ka thënë i Lartësuari: "A nuk vështrojnë te qielli sipër tyre se si Ne e ndërtuam dhe stolisëm pa pasur asnjë plasaritje." Urdhëri i Tij që të shikojmë në këtë qiell argumentet e Tij orientuese rreth madhështisë dhe urtësisë së Tij, ka të bëjë me çfarë e kemi cekur më herët, pra se gjenden gjurmë hyjnore të atributeve të Allahut të Lartësuar dhe Lartmadhëruar të cilat ne i shohim dhe dëshmojmë në mbarë universin. Nëse do vështrojmë në mënyrën si ishe zanafilla e këtij universi do gjejmë se shkenctarët e astronomisë në çerekun e fundit të shekullit XX kanë rënë dakord se fillimi i këtij universi ka qenë nga një shpërthim gjigand – Big Bang, që shpërtheu në të gjitha drejtimet. Pas këtij shpërthimi dhe me një shpejtësi ekstreme filloi të ndodhë transformimi dhe ndryshimi derisa u krijuan particionet e para të rrezonancave radioaktive. Pastaj ato filluan të zgjerohen në vazhdimësi duke u larguar nga epiqendra nga ku lindën deri sa arritën në një fazë në të cilën rrezonancat mundën të shkëputen nga qendra duke lënë kështu që të mbretërojë errësira kozmike. Doli errësira dhe në vijim doli rrezatimi që pati qenë i izoluar brenda lëndës, paskëtaj në atmosferë mbretëroi errësira, situatë në të cilën u krijuar edhe galaktikat, gjë e cila korrespondon me thënien e të Lartësuarit: "A krijimi juaj është më i komplikuar, apo i qiellit, të cilin Ai e strukturoi. E lartoi thellësinë e tij dhe e rregulloi atë. Natën e tij e bëri të pllakos me errësirë..." Errësira e pllakosi qiellin ashtu që tërësia e tij ishte e tillë që nuk mund të bëhej asnjë dallim midis errësirës dhe dritës. "Natën e tij e bëri të pllakos me errësirë dhe bëri të mundur që të dalë drita e tij." Dritën që pat qenë e izoluar brenda lëndës e nxorri ashtu që ajo u përhap në çdo anë dhe bëri të lëvizte në çdo cep të hapësirës kozmike. Ky qiell me yjet gjigand që mbart, me galaktikat e pafund, posedon një bukuri dhe stolisje që i bën përvete zemrat. Kozmologjistët e NASA-s në Amerikë u befasuan dhe u mrekulluan kur panë disa foto të hapësirës kozmike. Revista amerikane "Time" në edicionin e saj të njëzet, në nëtor 1995 publikoi se Adfiller, një nga kozmollogët e NASA-s, pasi kishte parë pamje të yjeve të marrë përmes teleskopit Hubble-Hobëll tha: Kur pashë atë panoramë u mrekullova pasiqë panorama e ngacmonte mrekullisht shikimin. Realitet ky që i bëri disa nga hulumtuesit të lënë pas dore për një copë here rëndësinë e studimit të tyre kërkimoro-shkencor.
E vërtetë është fjala e Allahut, Thënësit: "Ne kemi vendosur në qiell yjet gjigandë-plejadat yjore që i kemi zbukuruar për sytë e atyre që i shikojnë." Le të shikojmë tek argumetat e Allahut në këtë qiell, tek krijesat që krijoi Allahu i Lartësuar dhe Lartmadhëruar, që të meditojmë dhe të thellohemi. Le të shikojmë trupin qiellor më të afërm tek ne, hënën. Hëna bën një rrotullim të plotë rreth tokës me një shpejtësi të caktuar dhe duke përshkuar një distancë ditore të atillë që sinkronizon një rrotullim të plotë fiks njëmujor në orbitën e saj rreth tokës. Gjendemi para një lëvizje të kontrolluar.

Nuk do t'a pengonte gjë hënën të lëvizte në hapësirë ne drejtime nga më të ndryshmet..., majtas apo djathtas, lartë apo poshtë etj.
Porse hënën e gjejmë të ecë në kordinim dhe bashkrendim perfekt me tokën, duke lëvizur në orbitën e saj rreth tokës në një mënyrë shumë të kontrolluar. Drejtimi i saj është i caktuar, shpejtësia është e caktuar në një formë të tillë që një rrotullim i plotë i saj rreth tokës bëhet në një muaj hënor jo më shumë, në dy apo tre muaj për shembull; dhe jo më pak, në një javë apo dy për shembull. Kush është Ai që e sinkronizon lëvizjen e hënës? Pastaj kur hëna në orbitën e saj eliptike i afrohet tokës, siç dihet, forca tërheqëse e tokës shtohet në tendencë për t'a thithur për nga vetja, por gjejmë se kur hëna në orbitën e saj eliptike i afrohet tokës e shton shpejtësinë që mos t'a dhe përthithë forca tërheqëse e tokës. Ndërsa kur në orbitën e saj eliptike i largohet tokës ajo e ngadalëson shpejtësinë që të sinkronizohet me forcën tërheqëse të tokës dhe mos të shkëputet prej tokës. Kush bën që hëna gjatë lëvizjes së saj të ketë këtë sinkronizim të përcaktuar, të ketë distancë të caktuar, drejtim të caktuar, shpejtësi që shtohet dhe ngadalësohet, në përputhje të plotë me planifikimin krejt të detajuar që e mban atë të lidhur me tokën. Ky planifikim tregon për prezencën e Synueshmërisë së Krijuesit, dhe vetëm falë këtij synimi mund të shpjegohen vlerat e mirëcaktuara, kaq distancë, me kaq shpejtësi, dhe në këtë drejtim. Allahu i Plotfuqishëm thotë: "Hënës i këmi caktuar fazat e saj derisa ajo kthehet si drapëri i vjetër." Më tej kemi diellin, diellin që është një yll prej yjeve dhe dihet se universi mbart në të pafundësi yjesh. Porse dielli është i vetmi yll drita dhe nxehtësia e të cilit bën për ne. Në univers gjenden yje rrezatimi i të cilëve është i zbehtë si dhe gjenden yje rrezatimi i të cilëve është shumë i fuqishëm dhe është kryesisht i përbërë nga rreze ultraviolet, rreze x dhe të tjera rreze të dëmshme. Nëse do shikonim skicën e diellit në zemër të tij do shihnim bërthamën ku fillojnë shpërthimet atomike dhe prej aty pastaj dalin në sipërfaqen e tij. Pastaj do shikonim sesi marrin rrugën e tyre rrezet duke filluar nga brendia e diellit, drejt sipërfaqes së tij, në rrugën e tyre të gjatë drejt tokës ku arrijnë në formën e çfarë ne i quajmë rrezet diellore. Rrezatimi i diellit është i vetmi që bën ekzaktësisht për ne si përsa i përket sasisë së rrezatimit që arrin tek ne ashtu edhe për sa i përket temperaturës dhe nxehtësisë që na nevojitet. Nëse një yll tjetër do zinte vendin e diellit, kjo do kishte qenë një katastrofë për tokën dhe jetën në të. Gjithashtu kemi edhe tokën e cila ecë në orbitën e saj precise rrotull diellit, nuk afrohet dhe nuk largohet më tepër se ç'duhet. Nëse do t'i afrohej diellit në gjysmën e distancës aktuale midis tyre atëherë nxehtësia e diellit do kish djegur çdo gjë dhe nëse do largohej nga dielli edhe një gjysëm distance më shumë nga ajo ekzistuese do na kishte ngrirë gjaku në vena. Kush ia sinkronizon tokës lëvizjen e saj precize e cila sikurse edhe hëna kur në orbitën e saj eliptike i afrohet diellit ecë më shpejt që dielli të mos t'a përpijë. Nëse kjo shpejtësi do shtohej më shumë se ç'duhet toka do ishte larguar nga orbita e saj diellore dhe do mbeteshim pa diell. Kush ia përcaktoi tokës ecjen e saj rrotull diellit në distancën që ka, me shpëjtësinë që lëviz, në drejtimin orbital në të cilin ajo lëviz?

Kush i përcaktoi rregullacionet e rrezeve të diellit dhe temperaturën e nxehtësisë së tyre? Jemi para një konstrukti perfekt, distancime fikse, kohë të sinkronizuara dhe drejtime të mirëorientuara. Një gjë e vetme po të shkonte gabim konstrukti do prishej. I Lartësuar është Allahu, Thënësi në Kuranin Fisnik për këtë diell: "Bëmë një pishtar të nxehtë...". Pra pishtar që flakëron dhe na jep nxehtësi. Është një pishtar që flakëron duke na dhënë dritën e përshtatëshme për ne dhe është i nxehtë ashtu që është burimi i nxehtësisë dhe ngrohjes për ne. Pamjet tregojnë sesi rrezet diellore arrijnë deri tek

shtresa atmosferike e tokës ku kjo shtresë privon rrezet e dëmshme të hyjnë në tokë, ndërkohë që lejon pjesën tjetër të rrezeve diellore të arrijnë në tokë tek bimësia e saj të cilës drita i vjen krejt në përshtatje me nevojat që ka. Dielli është njëmilionetreqindëepesëmijë (1 305 000) herë më i madh se përmasa e tokës. Ndërkohë dielli rrotullohet rreth vetes në aksin e tij 1 herë në çdo 27 ditë ndërkohë që ai është në lëvizje përqark galaktikës sonë me një shpejtësi 230 km për sekond. Ne gjendemi në galaktikën Milky Way-Rruga e Qumështit që përmban më shumë se 100 bilion yje, dhe dielli ynë gjendet i spostuar në anën skajore të kësaj galaktike. Pra kemi sistemin diellor ku bën pjesë toka jonë, dhe që në galaktikën në fjalë nuk është vetëm se një pikëz e vogël, pjesëz e së cilës jemi edhe ne, tokësorët. Pastaj galaktika jonë s'është vetëmse një pjesëz që me një shpejtësi prej 40 km në sekond lëviz në drejtim të një galaktike tjetër të quajtur Andromeda. Andromeda lëviz drejt një plejade galaktikash të quajtur Hydra Centaurus, ku galaktika jonë, duke qenë pjesë e Andromedës, lëviz me një shpejtësi prej 600 km për sekond drejt kësaj plejade galaktikash.

Ndërkaq plejada Hydra Centaurus lëviz si një tërësi drejt asaj që quhet Graviteti i Madh. Shikojini këto lëvizje të cilat dielli është i detyruar që t'i kryej; së pari lëvizje në aksin e vet, pastaj në të njëjtën kohë lëvizje përqark galaktikës mëmë, pastaj lëvizje drejt Andromedës, duke qenë pjesë e Andromedës lëviz drejt plejadës së galaktikave Hydra Centaurus, pastaj duke qenë pjesë e kësaj plejada galaktikash lëviz drejt Gravitetit të Madh; lëvizje këto që bëhen në të njëjtën kohë, në drejtime të ndryshme, me shpejtësi të ndryshme por që në fund çdo gjë është e sinkronizuar. Cili është reagimi kur mendojmë se edhe tokës i duhet të bëjë këtë itinerar, shto që ajo rrotullohet rrotull diellit dhe rrotull vetes njëkohësisht?! Cili është reagimi kur mendojmë se edhe hënës i duhet të bëjë këtë itinerar brenda grupit, shto që i duhet të rrotullohet përreth tokës dhe vetes në sinkronizim perfekt me të gjithë pjesëtarët e familjes së plejadës së saj. I Lavdishëm është Allahu Thënësi: "Dielli rrugëton drejt vendit stabël të tij, ky është përcaktimi i të Lavdishmit të Gjithdijshmit. Ndërkaq hënës i kemi caktuar fazat e saj derisa ajo kthehet si drapëri i vjetër. As dielli nuk mund t'a arrijë hënën, e as nata ditën, por secili noton në një orbitë." Pyetja që ngrihet është, këto shpejtësi të mirëpërcaktuara të këtyre trupave qiellorë të harmonizuar dhe ekuilibruar kush i vendosi dhe regulloi?! Gjejmë prezent një përpikmëri dhe nje precision perfekt, gjë të cilën e dëshmon për ne vetë kjo ekzistencë. Sa e sa përllogaritje duhen fiksuar?! Hëna duhet të ecë me përllogaritje, përllogaritje në rrotullimin e saj rreth vetes, bashkë me tokën rreth diellit, teksa nga krahu tjetër dielli rrotullohet rreth vetes dhe përreth galaktikës mëmë duke lëvizur njëkohësisht si pjesë e pandarë e kësaj galaktike në drejtim të grup-galaksisë Andromeda, dhe tok me Andromedën lëvizet drejt plejadës, e kështu me rradhë. Nënkuptoj se nuk gjendemi para një përllogaritje të vetme porse kemi të bëjmë me përllogaritje të tëra. Përllogaritjet lidhur me sa në fjalë janë të paevitueshme lidhur me çdo drejtim, distancë, shpejtësi, kordinatë; të çdo ylli, planeti e trupi qiellor. Kush i sinkronizon dhe përllogarit gjithë sa në fjalë ashtu që rezultati i gjithë kësaj është balancimi perfekt i sistemit universal?! Thotë Allahu i Lartësuar: "Dielli dhe hëna udhëtojnë sipas një përllogaritje të saktë." Dhe thotë: "…diellin dhe hënën i bëri të përllogaritur.

Përcaktim ky nga i Plotfuqishmi, i Gjithdijshmi." Pra "…diellin dhe hënën i bëri të përllogaritur…" nënkupton që ato ecin sipas përllogaritjeve të detajuara, në mënyrë sistematike, të larmishme dhe të shpeshtë, gjë e cila përbën provën e synueshmërisë, dhe synueshmëria nga ana e saj tregon për vetëdashje dhe qëllim në të vepruar. Por

kush mund të synojë dhe dojë? Natyra?! A posedon natyra synim?! A mundet ajo të përllogaris?! A posedon natyra dituri dhe përvojë?! Kurrsesi, në fakt "Ky është përcaktim nga i Plotfuqishmi, i Gjithdijshmi." Më tej, galaktika ku ne bëjmë pjesë ka një numër prej 100 bilion yjesh dhe ndërkohë që dielli ynë ka një madhësi 1 305 000 herë më të madhe se toka, disa yje të po kësaj galaktike janë miliona herë më të mëdhenj se dielli. Medito pra lidhur me këto trupa gjigand qiellor, kush kujdeset për ta, kush i mban ato varur në hapësirë, kush i vë në lëvizje dhe i sinkronizon ato me një përllogaritje precise e në drejtime të larmishme?! S'ka dyshim se Ai është Allahu, Krijuesi Madhështor, i Plotfuqishmi, Përcaktuesi, i Lavdëruar qoftë Ai. Pastaj medito sesi galaktika jonë është vetëm një prej 21 galaktikave që ka plejada e galaktikave ku ajo bën pjesë…

A është ky univers i mirëbalancuar dhe i mirësinkronizuar si një trup i vetëm, apo ai nuk është i harmonizuar? Pyetjen që sapo përmenda ia bëra profesor Robertit i cili më tha se struktura e këtij universi nuk vuan nga asnjë mungesë harmonie porse universi është tërësisht i balancuar dhe se nëse nuk do kishte qenë ky balancim preciz, universi do të ishte rrënuar. Dhe vijoi, përshkrimi me të cilin mund të përshkruhet universi e ka emrin përsosmëri, e ti tani po bën fjalë për atë që shkenctarët e astronomisë e quajnë "Universi Perfekt". Me këtë rast kujtova fjalën e Allahut: "Është Ai-Allahu që krijoi shtatë qiej palë mbi palë. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast, andaj drejtoje shikimin sheh apo jo ndonjë anomali?!" A haset ndonjë pasaktësi apo anomali në sistemin tonë diellor? I Lartmadhëruar është Allahu që e përsosi dhe perfeksionoi precizivisht këtë sistem! Faktet se planetet, yjet dhe galaktikat janë në lëvizje, konfirmojnë provën se ky univers nuk është statik e i palëvizshëm, porse ai në fakt është në zgjerim. Universi ynë nuk është statik siç ne e mendojmë. Qielli nuk është statik siç i duket syve tanë. Ai në fakt është në një zgjerim të cilin shkenctarët e përngjasojnë me një balonë që kur i fryn zgjerohet në të gjitha anët. I pari që e zbuloi zgjerimin e qiellit-universit ishte Hubble, emrin e të cilit mori edhe teleskopi i fundit survejues i hapësirës, për nder se ai zbuloi një sekret madhështor në konstraktin e qiellit, faktin se universi shtrihet dhe zgjerohet në të gjitha anët, zbulim të cilin ai e bëri në vitin 1922. Ainshtaini (Einstien) më pas e mori përsipër që vetë t'a bënte verifikimin e një gjëje të tillë, duke mos pasur asnjë informacion lidhur me këtë ashtu sikurse të gjithë njerëzit asokohe. Porse Kurani (rreth 14 shekuj para këtij zbulimi) na tregon për këtë realitet, duke sqaruar Fuqinë e Allahut, i Cili e ngriti këtë struktur universale dhe e zgjeron në vazhdimësi.

Ka thënë Allahu i Lartësuar: "Ne, me forcën tonë e ngritëm qiellin dhe Ne jemi zgjerues të tij." Fjala "zgjerues" është pjesore veprore (emër foljor) dhe kjo pjesore në gjuhësi përfton se ky veprim ka ndodhur në të shkuarën, ndodh tani dhe do vazhdojë të ndodh në të ardhmen. Është sikurse fjala e Allahut të Lartësuar: "Ne e zbritëm atë-Kuranin përkujtim dhe ne jemi mbrojtës të tij" Që do të thotë, e kemi mbrojtur atë në të shkuarën, e mbrojmë tani dhe do t'a mbrojmë në të ardhmen. E këtillë është edhe "zgjerues" në "…Ne jemi zgjerues të tij"; pra Allahu thotë se e ka zgjeruar universin në të shkuarën, e zgjeron atë tani dhe do t'a zgjerojë atë në të ardhmen. Me gjithë këtë zgjerim të vazhdueshëm, sërisht gjejmë një precizion, perfektshmëri dhe nuk gjejmë asnjë anomali midis yjeve dhe yjësive gjigande të universit. Të supozojmë se ti don të shikosh skajin e përtejmë të qiellit, si thua ku do të jetë ai? Kozmologët na tregojnë se ylli më i afërt me sistemin tonë diellor është një yll në një distancë prej afërsisht 4 vjet e 5 muaj

drite. Dihet se dritës së diellit për të përshkuar distancën diell-tokë i duhen 8 minuta, teksa distanca mesatare midis nesh dhe diellit arrin në 93 milion milje ose rreth 150 milion kilometra. Mendoje këtë distancë midis tokës dhe yllit më të afërt të saj, diellit, kur dihet se drita përshkon në një sekond të vetme 300 000 kilometra.

Ndërkaq dritës së yllit më të afërt me sistemin diellor, që të arrijë tek ne i duhen afërsisht 4 vjet e 5 muaj. Po kështu galaktika më e afërt me ne është Andromeda për të cilën bëmë fjalë më herët, e cila është larg nesh në një distancë të tillë që dritës i duhen 1 milion vjet për t'a përshkuar atë. Disa yjeve të tjerë nuk u arrin drita tek ne vetëm se pasi të ketë udhëtuar plot 240 milion vjet. Burimi më i largët i dritës që kanë kapur njerëzit të ketë arritur tokën ka ardhur nga një distancë të cilën drita e ka përshkuar për një periudhë prej 12 bilion vjet. Vërtetë gjigande është kjo distancë dhe kush e di se sa është në të vërtetë gjërësia e këtij universi! Yjet që ne shohim nuk janë në atë pozicion kozmik që po i shohim, pasi drita e tyre ka udhëtuar miliona vite për të arritur tek ne. Pra këto imazhe që na arrijnë ne tani, i takojnë miliona viteve më parë, ato yje ne i shohim në pozicionet e tyre kozmike që i përkasin kohë së miliona viteve më parë. Ndaj e gjejmë Allahun e Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm që të betohet në pozicionin kozmik të yjeve, Thënës: "Betohem në pozicionimin e yjeve. E sikur t'a dinit, ai është betim vërtet i madh!" Sikur të dinit t'a vlerësoni, betimi në pozicionimin e yjeve është vërte një betim madhështor, është një betim gjigand. Medito, medito rreth këtij strukturimi perfekt!
Lind pyetja: Nge çfarë formohet ky univers?
Ai formohet nga atomet, atomet në vetvete janë nën diktimin e forcave të ndryshme, forcës tërheqëse, forcës magnetike, forcës elektromagnetike etj, ligje këto që diktojnë si atomet mikroskopik si galaktikat gjigande, dhe kontrollojnë mbarë universin. E gjitha kjo për çfarë tregon? Tregon për njëshmërinë e Krijuesit në strukturimin që i bëri universit, ashtu që shohim për shembull tokën në sistemin diellor të lëviz në përputhje me ligjet e këtij sistemi, ndërkohë që vetë sistemi diellor lëviz në përputhje me ligjet që e lidhin me galaktikën ku bën pjesë, galaktika me galaktikat dhe galaktikat me krejt universin, duke dëshmuar kështu se ky univers është një strukturë, një qënësi, dhe është i strukturuar nga një element i njëjtë, që është atomi; teksa atomi kontrollohet nga po ato ligje që gjykojnë galaktikat, duke konfirmuar e gjitha kjo dëshminë se Krijuesi është Një, duke dëshmuar njëshmërinë e Krijuesit, dhe se gjithashtu ai e ndërtoi këtë univers me një strukturë unike që kontrollohet nga kjo paketë ligjësishë. Medito rreth këtyre argumenteve të Allahut të gjendura në qiell, mendo dhe vështro se si iu nënshtruan këto yje Vullnetit të Allahut dhe ligjeve të Tij, se si lëvizin në orbitat e tyre të vendosura nga Allahu. Allahu i Lartësuar thotë: "A fe tjetër veç asaj të Allahut duan, teksa Atij i janë nënshtruar gjithkush në qiell e në tokë, me hir apo me pahir, dhe tek Ai do të kthehen?!"

Nëse meditojmë lidhur me sa u tha më herët do të shikojmë urtësinë, do të gjejmë perfektshmërinë dhe do të hetojmë përllogaritjet e shkëlqyera, diturinë, fuqinë, novacionin, stolisjen dhe të bukurën, gjerësinë dhe madhështinë, unifikimin. Të gjitha këto çfarë shohim janë argumentet e Allahut të shpalosura para nesh, kështu urtësia reflekton të Urtin që ka vepruar me urtësi; perfektshmëria reflekton se sa në fjalë është gjurmë e të Përsosurit; dituria mbi bazën e të cilës u strukturua ky univers, galaktikat dhe orbitat e tij, reflektojnë të Gjithdijshmin; forca dhe fuqia që e vë në lëvizje këtë ekzistencë tregon për të Plotfuqishmin; unifikimi reflekton të Vetmin; novacioni,

shpikja, bukuria në krijim tregojnë për Shpikësin; madhështia gjigande e universit tregon për madhështinë e Krijuesit të Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm dhe tregon se Ai është Një Krijues i Vetëm, duke e parë kështu qiellin të na dëshmojë rreth disa cilësive të Krijuesit, të dëshmojë se Ai është Krijuesi, i Urti, i Gjithdijshmi, Synuesi, i Plotpushtetshmi, Shpikësi dhe Një i Vetmi. Universi dëshmon me të njëjtën dëshmi që dëshmojnë muslimanët, dëshmon se nuk ka krijues tjetër përveç Allahut. Dhe në fakt cilësitë në fjalë nuk i posedon askush përveç Allahut të Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm, kjo pasi natyra nuk posedon urtësi, nuk posedon perfektshmëri, nuk posedon vullnet. Kështu dëshmon muslimani sikurse dëshmon kjo ekzistencë, se njeriu dhe mbarë universi kanë një Krijues që i krijoi, duke qenë njeriu i vetëdijshëm se ai i detyrohet Krijuesit të tij, duke e ditur se duhet t'i nënshtrohet urdhëresës së Allahut të Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm, duke deklaruar dhe thënë: ESH HEDU EN LA ILAHE IL ALLAH – DËSHMOJ SE NUK E MERITON TË ADHUROHET ASKUSH VEÇ ALLAHUT.

Fakti që Kurani lajmëron për sekretet e qiellit tregon për ne një tjetër gjë, na tregon se ai që i përcolli tek ne këto thënie të Kuranit, profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, të cilit iu zbuluan këto sekrete të universit, është i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, duke dëshmuar kështu universi edhe se MUHAMEDUN RASULULLAH-MUHAMEDI ËSHTË I DËRGUARI I ALLAHUT -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, dhe kjo pasi ne pamë se si ai u revelua me të tilla sekrete të university që gjenden në Kuran qysh prej 1400 vjetësh.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu!

Anatomia-strukturimi i njeriut (5)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Njeriu. Erdhi në këtë botë nga një pikëlz uji që quhet zigotë. Kjo zigotë zhvillohet me shpejtësi ashtu që prej saj nëpërmjet shtimit zinxhir përmes procesit të shumfishimit qelizor përftohen miliona e miliona qeliza dhe grup-qeliza, që bëjnë të mundur strukturimin e qenies njerëzore. Çdo grup-qelizë ushtron funksionin e saj përkatës fiziologjik. Këto grup-qelizash i përngjajnë një dhomëze që në ndërtesën ku gjendet realizon funksionin e saj të posaçëm. Përveç saj ka dhe të tjera dhomëza, njëra funksionon si guzhinë, njëra si dhomë ndenje, njëra dhomë pritje, njëra bibliotekë e kështu me rradhë. Ndërkaq ndërtesa për të cilën ne po bëjmë fjalë është unë dhe ti, është struktura jonë e gjallë, dinamike, lëvizëse dhe mendimtare.

Për këtë do meditojmë në vazhdim, se si është krijuar dhe nga se është krijuar njeriu.

Një herë pata një diskutim me një debatues rus i cili më tha se donte të më bënte lavazh truri. I thashë hajde dhe të shohim… Në bisedë e sipër i thashë: Gjysma e trupit tënd ishte tek babai dhe gjysma tjetër ishte tek nëna, dhe pas bashkimit të këtyre dy gjysmave erdhe në këtë botë me tërësinë tënde njerëzore. A nuk e shikon se njëra gjysëm e një qeni për shembull është tek qeni femër dhe gjysma tjetër tek ai mashkull, dhe kjo gjë është e tillë tek çdo krijesë ashtu që njëra gjysëm e çdo krijese gjendet tek mashkulli dhe gjysma tjetër gjendet tek femra. Ai që e krijoi gjysmën tek mashkulli të tillë që të kompletohet ekzaktësisht më gjysmën tek femra a e di se çfarë gjendet tek femra?! E di çfarë përgatitet atje në aparatin e riprodhimit femëror dhe se çfarë përgatitet këtu në aparatin e riprodhimit mashkullor?! S'ka dyshim se Ai është i Gjithdijshëm për sa në fjalë, është i Gjithdijshëm për atë që bën, gjë që del në pah me kompletimin e kësaj strukture. Diskutova rreth kësaj teme, rreth qelizës së parë dhe çfarë ka të bëjë me të, rreth origjinës së ekzistencës së krijesës. Në fillimet e shpejta të ekzistencës së qelizës mëmë gjenet përcjellës të trashëgimisë fiziologjike prindërore hynë në ndërveprim midis tyre deri në vendosjen e gjurmës apo vulës përfundimtare të karakteristikave dominuese tek kjo krijesë e re. Çfarë do trashëgojë nga babai i saj e çfarë do të trashëgojë nga e jëma e saj. Çfarë shtati do ketë, si do t'i ketë flokët, a do të trashëgojë ndonjë nishan nga i jati, e ëma apo parardhës të tjerë të saj. E gjitha kjo planifikohet dhe përcaktohet në periudhën "Nutfah-Lëngu i ngjizur gjenital" apo që njihet ndryshe periudha e zigotës. Përmes modeleve të skicuara nga shkenctarët vihet

re struktura e qelizës në qendrën e të cilës gjendet bërthama që kontrollon rritjen dhe zhvillimin e qelizës si dhe çdo aktivitet dhe funksion tjetër të qelizës.

Kjo është qeliza e parë e cila më pas do kontrollojë dhe drejtojë çdo aktivitet të çdo qelize në trupin e njeriut. Shohim në qelizë ca si shkallë të cilat nëse do merreshin nga qeliza dhe do zmadhoheshin do i gjenim fare të ngjashme me shkallët. Këto shkenctarët i kanë quajtur aminoacidi ADN, brenda të cilit gjenden të gjitha cilësitë e krijesës së re dhe po këtu përcaktohen cilësitë që do dominojnë tek krijesa e re, përcaktohen cilësi si trajta e kockës, mishit, syve, aparatet e biosistemit në varësi të kujt do t'i përkatësojnë, do t'i përkatësojnë një burri, një zogu, apo një peshku. E gjitha kjo gjendet e regjistruar në ADN. Çdo shkallëzim i shkallëzës së ADN-së përmban në vetvete një cilësi prej cilësive të krijesës të cilin më tej ajo ia transmeton mbarë qelizave. Kemi të bëjmë me një komandë. Jemi para një përcaktimi të mirëprojektuar për çdo qelizë i cili kryhet brenda një miniature të cilën nëse do mundoheshe t'a shikoje nuk do mundje t'a bëje këtë me sy të lirë. Kush është Ai që e bëri këtë modelim në të tillë proporcion të mrekullueshëm?! Përcaktoi në këtë miniaturë këmbën, dorën, hundën, gojën, lëkurën, stomakun, zorrët dhe mbarë strukturën sesi do jetë njeriu në brendinë dhe aparencën e tij fiziologjike?! Kush është Ai që krijoi balancimin dhe plotpërputhshmërinë lidhur me gjithë këto pjesë të anatomisë së trupit të njeriut?! Kush është Ai që e perfeksionoi ecurinë e zhvllimit dhe rritjes së zigotës hap pas hapi derisa ky zhvillim finalizon me procesin e plotë të përftimit të tërësisë së qenies së mrekullueshme njerëzore?! Çështja në fjalë ka të bëjë me ty o njeri. Prej këtu filloi përcaktimi yt. Ndaj dhe e gjejmë Allahun e Lartësuar të thotë: "Qoftë mallkuar njeriu (mohues i Zotit), sa mohues i fortë është ai! Po prej çfarë e krijoi Ai-Zoti atë? E krijoi prej një pike uji dhe e përgatiti." Pra përgatiti dhe përcaktoi çdo gjë që do t'i përkasë çështjes së njeriut në të ardhmen.

A nuk tregon ky përcaktim se sa në fjalë është vepër e qëllimshme nga Ai që e realzioi një përcaktim të tillë, se Ky Përcaktues posedon vullnet, dituri lidhur me nevojat që do ketë kjo krijesë, se Ai posedon perfektshmëri, përsosmëri dhe gjithmundshmëri nisur nga fakti se gjithë sa në fjalë e realizoi brenda një qelize mikroskopike që nuk mund të shihet me sy të lirë. Ky është krijimi i Allahut, vetëm Allahu mund të krijojë kështu.

Si krijohet pamja që njeriu posedon, e imja dhe e jotja, si dhe pamjet e të gjitha qenieve të gjalla?

Femra shtatzënë ushqehet, dhe është pikërisht ky ushqim ai nga i cili e marrin zhvillimin trupat. Shkenctarët e mjeksisë thonë se është programi ADN ai që kontrollon çështjen e mbikqyrjes së embrionit dhe anatomisë që ai do ketë, program i cili siç bëmë fjalë pak më herët daton me qelizën e parë, zigotën. Por nuk është ky program kontrollues 100% pasi gjenden edhe faktorë të tjerë që ndikojnë që njeriu të marrë pamjen që ka dhe jo atë të ndonjë gjallese tjetër. Që sa më sipër të realizohet qelizat në trupin njerëzor duhet të funksionojnë sipas një programimi special që mundëson të krijohet pikërisht forma njerëzore.

Gjithashtu që njeriu të marrë tipare dhe cilësi të parardhësve të tij, gjyshërve, babait e nënës, sërisht e tillë gjë ka nevojë për programim dhe faktorë aktiv që bëjnë të mundur formësimin e të tillë trajte. Më pas që ti të marrësh atë pamje dhe trajtë që ke dhe që është specifike vetëm për ty në mesin e mbarë njerëzve është dashur domosdoshmërisht një përsosmëri, përcaktim dhe planifikim. Domosdoshmëri është edhe që pamja jote të mbetet në vazhdimësi ajo që do posedosh dhe me të cilën do të identifikohesh përgjatë gjithë jetës tënde, në fazat e tua jetike që do vijojnë. Duhet medoemos përsomëri, perfektshmëri dhe përkujdesi që e këtillë gjë të realizohet.

Në fakt trajtëzimi i paraqitjes së qenies njerëzore nuk realizohet përveçse pas javës së gjashtë, rreth 42 ditë pas ngjizjes. E tillë gjë ka qenë objekt hulumtimi tek shkenctarët e embriologjisë dhe për të është dhënë sa e sa kontribut derisa arritën në atë që ka thënë Profeti ynë Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, në një thënie të tij të transmetuar nga Muslimi në Transmetimet e tij Autentike në adresë të Profetit ku vjen nga Hudhejfe ibn Usejd el-Gifariu të ketë thënë: Ka thënë Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-: "Kur Nutfah-Zigota kalon 42 netë (në mitër) Allahu i dërgon një engjëll i cili i formëson trajtën…" Kjo vlen për çdo gjë rreth trajtësimit, në sensin e dëgjimit, shikimit, mishit, eshtrave. Shkenctarët gjetën se është pikërisht sa në fjalë ajo që ndodh përpikmërisht siç shpjegohet në këtë thënie autentike profetike. Pas ditës së 42-të fillon formësimi i trajtës njerëzore të embrionit, ndërsa përpara kësaj nuk mund të hetohej tek embrioni pamja njerëzore. I Lavdishëm është Ai i Cili na dha fizioniminë që posedojmë, dhe na e dha atë në formën më të shkëlqyer. Kush është pra Ai që na dha këtë pamje dhe fizionomi që kemi, që e përsosi atë dhe e bëri të jetë shprehi e identitetit tonë në vijimësi?! S'ka dyshim se Ai është Allahu. Nuk është natyra. Natyra nuk posedon as dituri, as vullnet, as dëshirë, as qëllim, as synim, as mençuri. Thotë Allahu i Lartësuar: "O ti njeri, po ç'të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd që është Bujar dhe i Urtë? I Cili të krijoi, të përsosi dhe të drejtoi. Të formësoi në formën që Ai dëshiroi!"

Le të zhvendosemi tani tek aparatet e trupit tënd, sesi Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhëruar i harmonizoi ato. Në skicat anatomike të trupit të njeriut vihet re qartë harmonizimi perfekt i aparateve të trupit. Shikojmë në qendër të diagramave anatomike dy mushkëritë, zemrën dhe zorrët e holla. Disa diagrama anatomike japin pamjen ballore dhe disa të tjera atë me shpinë. Mrekulli është pema e bronkeve të mushkërive, degëzimet e së cilës përcjellin ajrin në çdo qeskëz apo dhomëz në mushkëri dhe përmes tyre oksigjeni kalon më pas në gjak. Pastaj diagrama tregon aparatin muskulor që është përgjegjës për vënien në punë të çdo aktiviteti të trupit pre të cilit edhe lëvizjes së të gjithë trupit. Çdo muskul ka një funksion specifik që ndryshon në varësi të rolit dhe vendodhjes, ashtu që një muskul në pulpën e këmbës ndryshon nga një tjetër në këmbë, në dorë apo në qafë, kjo pasi secili prej tyre ka një rol dhe funksion. Medito sa mrekullisht janë skicuar dhe modeluar këto muskuj që të përkatësojnë përsosmërisht me funksionin e tyre dhe sesi janë vendosur pikërisht në vendet e tyre përkatëse.

Medito rreth muskujve që janë përreth syrit dhe ato përreth gojës, medito se sa përsosmërisht janë trajtësuar dhe vendosur në vendet e tyre përkatëse ashtu që të jenë në harmoni të plotë me funksionimin e këtyre dy organeve në trup. Medito tani rreth aparatit të tretjes i cili fillon me gojën, vazhdon me ezofagun, lidhet me stomakun, vijon me zorrët e holla e pastaj zorrët e trasha. Si arriti ky aparat të jetë në përputhje dhe harmoni të plotë me funksionin që ka? Medito lidhur me këtë…

Tani medito rreth trurit që kontrollon dhe urdhëron çdo veprim të trupit, dhe sesi çdo gjë në trupin tënd është fiksuar në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet atypëraty kësaj qendre që përmes sistemit nervor bën koordinimin dhe kontrollimin e të gjitha lëvizjeve në trup. Medito rreth Lobit Frontal, që pozicionohet në pjesën ballore të kokës e që është përgjegjës për tendencat e sjelljeve, drejtimeve dhe lëvizjeve të njeriut, madje ai është përgjegjës direkte rreth gënjeshtrës dhe sinqeritetit, prandaj Allahu i Lartësuar thotë: "Jo, jo! Nëse (pas përgënjeshtrimit dhe zmbrapsjes nga besimi) nuk heq dorë, vërtet do ta kapim për ballit. Ballit gënjeshtar dhe mëkatar." Truri (Lobi Frontal) që vjen direkt pas ballit është përgjegjës për gënjeshtrën, sinqeritetin apo thënë ndryshe sjelljen.

Medito lidhur me gjithë sa u tha dhe heto sesi janë harmonizuar këto organe të trupit në përkatësi dhe përputhje precize me funksionet e tyre. E gjejmë zemrën një organ të fuqishëm muskuloz të paisur me katër dhomëza, që pompon duke e shtyrë dhe kthyer gjakun në procesin e tij të qarkullimit në mbarë trupin e njeriut. Kush e komandon zemrën të kryej punën e saj madhështore?! Kush e mësoi zemrën e i tha se qelizat e tua duhet të jenë të forta dhe muskujt e tu duhet të jenë të mëdhenj, ndërkohë që fare pranë saj janë dy mushkëritë struktura e të cilave është e brishtë dhe e imët duke qenë se brenda tyre do të hyjë ajri ndaj ato harmonizohen me këtë gjë. Pranë zemrës është dhe zorra që ka një strukturë në përshtatje me funksionin e saj dhe ushqimin e larmishëm në lloje dhe forma që do hidhet e përcillet përmes saj, ushqim ky që mund të jetë mish, lëng etj. Kush pra është Ai që i udhëzoi dhe orientoi këto aparate?! Kush i përsosi dhe përgatiti ato?! A mos e bëri këtë natyra e verbër, e shurdhër dhe memece, që as gjykon e as arsyeton?! Si pra arriti ajo t'a realizojë sa në fjalë, t'a strukturojë, rregullojë, përsosë e përgatisë?! A mundet i tillë krijim perfekt t'i atribuohet natyrës?! I Lartësuar është Allahu nga çfarë u thonë gojët ateistëve! I Lavdishëm dhe Lartmadhëruar është Ai.

Shikoje këtë krjimtari madhështore të pashembullt pastaj medito, medito sesi t'a siguroi Allahu furnizimin, sesi t'a garantoi të ushqyerin qysh kur gjendeshe ende në mitrën e nënës tënde, teksa ti nuk ishe vetëmse një spermatozoid që ecje si pjesë e pandarë e lëngut spermatozeidal. Teksa ecje kështu edhe ushqimi ecte pas teje kudo që shkoje. Gjysma jote e gjendur në spermatozeidin e babait tënd udhëtonte e udhëtonte duke u shoqëruar nga ushqimi kudo shkonte derisa gjen dhe futet në gjysmën tjetër, vezoren e nënës, për t'u fertilizuar, gjë për të cilën iu desh një udhëtim afërsisht shtatë ditor derisa të arrijë në mitër, tek destinacioni i saj final. Aty gjen sërisht burim ushqimor tek gjaku i menstruacioneve i rezervuar në brendinë e femrës shtatzënë, që në fakt s'është gjë

tjetër përveçse ushqimi për fertilizimin e ri, ndërkaq nëse fertilizimi dhe mbarsja nuk ndodh ky gjak del përmes menstruacioneve. Këtu qëndron dhe logjika e ciklit menstrual mujor në të cilin çdo grua përgatitet fiziologjikisht për krijesën e re njerëzore që ka mundësi të vijë në ekzistencë. Këtu fetusi ka për burim ushqimor gjakun në fjalë dhe jeton duke marrë ushqim nga ai. Më pas fetusi lidhet me organizmin e nënës përmes zorrës së gërthinzës, pastaj përmes placentës e cila rregullon kalimin e ushqimit nga trupi i nënës tek trupi në zhvillim i fëmijës së vogël të krijuar. Placenta nuk lejon të hyjë tek fëmija ndonjë gjë e cila do t'a dëmtonte porse ajo lejon të hyjnë vetëm substancat dhe lëndët e dobishme si dhe lejon të dalin nga foshnja substancat e dëmshme që hyjnë me qarkullimin e gjakut të nënës. E gjitha kjo kryhet përmes placentës dhe zorrës së gërthinzës.

Në barkun e nënës ti o njeri ushqehesh plot nëntë muaj. Aty të vjen ushqimi në përputhje me çdo faze embrionale. Kur je në fazën e ndërtimit kockor të vjen kalciumi, e nëse ushqimi që të vjen nuk ka kalcium Allahu i Lartësuar t'a siguron kalciumin duke ia marrë atë kockave të organizmit të nënës tënde, prandaj dhe eshtrat e nënës në këtë fazë dobësohen, gjë për të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "… e barti në bark e ëma njeriun (gjatë shtatzanisë) dobësi pas dobësie…". Shikoje sesa i detyrohesh nënës tënde. Ushqimi të vjen në harmoni me çdo fazë. Kur je në fazën e ndërtimit të mishit ushqimi të vjen i pasur me proteinat që duhen për ndërtimin e muskujve dhe endjeve të tjera të mishta që do të krijohen e që zhvillohen nën ndikimin e proteinave. Kur del nga barku i nënës dhe i shkëput lidhjet nga magazina e mëparshme nga ku të vinte ushqimi, kur del jashtë barkut dhe shkëputet zora e gërthinzës atëherë shiko se ç'bëri Furnizuesi? Për ecurinë e mëtejshme të jetës tënde, të pajisi me dy magazina të reja (gjinjtë e nënës) të cilat sakaq mbushen me ushqim teksa pak para lindjes ato ishin të zbrazur. Pastaj sapo dole nxitove t'a thithësh përmes tyre ushqimin tanimë nga ky burim i ri. Kush të mësoi të thithësh gjinjtë e nënës teksa ti je vetëm një ditësh?! Kush ia mëson çdo foshnje këtë mjeshtëri?! Kush i mësoi ata se ç'duhet të bëjnë?! S'ka dyshim se i Tilli është Furnizuesi, Allahu i Cili bëri që furnizimi të vërshojë për tek ti në barkun e nënës dhe gjithashtu t'a solli ty furnizimin ushqimor edhe pasi dole nga barku i nënës, sikurse t'a siguron rizkun dhe furnizimin në vazhdimësi teksa rritesh e zhvillohesh.

Kudo që shkon në tokë furnizimin e gjen para teje, i gjen bimët dhe kafshët me të cilat Allahu mundëson që ti të ushqehesh kudo që je. Allahu e zbret shiun gjë që bën që bimët të rriten, për të shërbyer si burim i patjetërsueshëm përmes të cilit ushqehen njerëzit dhe kafshët e shumta. Nga këtu ti zgjedh ushqimin tënd të preferuar midis ushqimeve vegjetariane dhe produkteve të mishit. Thotë Allahu i Lartësuar: "Le të shikoj njeriu tek ushqimi i tij. Ne lëshuam shi të bollshëm. Pastaj e çamë tokën sipas nevojës së bimës, dhe bëmë që në të të mbijnë drithëra. Edhe rrush e perime, Edhe ullinj e hurma, Edhe kopshte të dendura, Dhe pemë e kullota. Gjëra të nevojshme për gjallnimin tuaj dhe të bagëtive tuaja." Kjo është vepër e Furnizuesit e po të mos ishte kjo ne njerëzit do kishim vdekur. Ne dhe mbarë bimët dhe kafshët, mbijetesën tonë e bazojmë tek fabrika e gjelbër që gjendet tek bimët, e vetmja substancë përgjegjëse për vazhdimësinë e jetës së

qenieve të gjalla, emri i të cilës është klorofil. Është pikërisht kjo fabrikë e gjelbër ajo që është e vetmja që ka aftësinë e mrekullueshme që përmes fotosintezës t'i shndërrojë dioksidin e karbonit, ujin dhe rrezet diellore në niseshtenë e cila magazinohet në trajtën e fruteve të bimëve duke u shndërruar në lyrëra të cilave pasi u bashkangjitet nitrogjeni formojnë proteinat që janë baza ushqimore e qelizave… Njeriu tentoi t'a prodhonte fabrikën e gjelbër, klorofilin, të bëjë artificialisht fotosintezën por dështoi, dështoi të sjell imitimin e saj. Allahu i Lartësuar na ka treguar në Kuran lidhur me këtë fabrikë të gjelbër, klorofilin, kur thotë: "Është Ai që lëshoi nga lartë shiun e me të nxori bimën e çdo soji dhe prej bimës nxorri lëndën e gjelbër (klorofilin) dhe prej saj nxjerrim kokrra të dendura në kallinj. E nga hurmet, nga sythat e tyre kalaveshë të afërt (për t'i vjelë). Edhe kopshtie me hardhi, ullinj e shegë të ngjashme (në dukje) e të llojllojshme (në shije). Shikoni pra frutat e tyre kur i formojnë dhe kur piqen." Është Krijuesi Ai që na furnizon. Njeriu u përpoq të bëjë një fabrikë të tillë si lënda e gjelbër por dështoi keqazi. Ai arriti t'a strukturonte atë si lëndë por ajo nuk dha asnjë produktivitet. Sa për t'u çuditur është me ata persona që bartin brenda tyre idetë idjote se furnizimi që u vjen në këtë botë është vepër e natyrës; se bimët janë vepër e natyrës dhe se vetë krijimi i tyre është vepër e natyrës, teksa shkenctarët më të mëdhenj tubohen që të produktojnë qoftë edhe një pigment të vetëm të klorofilit dhe që bën punën e tij porse dështojnë?! Nuk arritën të realizojnë pigmentin e gjelbër që sikurse origjinali, klorofili, do dhuronte për gjallesat produktimin e niseshtesë përmes procesit të fotosintezës që nuk mund të bëhet askund përveçse tek kjo lëndë e gjelbër. A mund të pretendohet se ajo është bërë aksidentalisht brenda bimës nga natyra naïve?! A nuk ka nevojë një produktim i tillë për dituri, përvojë, qëllimshmëri, urtësi, ndjesi dhe mëshire?! Klorofili s'është veçse një ndër dëshmitë e patjetërsueshme që dëshmon qartazi për Allahun porse ata abuzojnë me këto shenja të Zotit ashtu sikurse thotë Allahu lidhur me këtë në Kuran: "Sa e sa shenja në qiell e në tokë ka që ata (mosbesimtarët) kalojnë nëpër to porse sërisht bëhen kundërvënës kundrejt kësaj?!" Dhe thotë: "O ju njerëz, kujtoni mirësitë e Allahut mbi ju, a ka krijues veç Alahut që ju furnizon nga qielli dhe toka…?!" Medito mirësitë e mëdha të Allahut mbi ne.

Sërisht medito, teksa të manifestohen sa më lartë prej argumenteve ti mëson se Allahu është i Urti, i Gjithdijshmi, Furnizuesi, Mëshiruesi, Formëdhënësi, Shpikësi… Gjithashtu Ai është Mbrojtësi, shiko tek kafka e njeriut sesi është përkryer që të mbrojë pjesë të shtrenjta të trupit të njeriut, të mbrojë dy sytë delikat. E nëse sytë do kishin mbirë në mes të ballit për shembull do kishin pasur punë një javë a pak më shumë dhe me shuplakën apo godtjen e parë do kishin marrë fund. Porse Allahu u hapi atyre dy streha, dy gropëza mbrojtëse të hapura në kafkë ku sytë strehohen të sigurtë. Gjithashtu për trurin e brishtë përsosi pjesën e fuqishme të kafkës me eshtra të lehta dhe të forta brenda të cilës ai strehohet dhe krahas kësaj brendazi bëri në dobi të trurit shtresën e butë amortizuese të araknoidit që është një membranë e mbushur me fluid ashtu që kur ndonjë goditje rëndon mbi tru araknoidi është i pari që ballafaqohet me goditjen teksa lëngu i tij vibron nga krahu i goditjes porse mbetet në prehje nga krahu i trurit, për t'u

realizuar kështu mbrojtja dhe garantimi i trurit të brishtë nga dëmtimet. Kush e realizon të tillë gjë?! A nuk është ky planifikim i Mbrojtësit që deshi të të mbrojë?!

Medito gjithashtu sesi Allahu e mbrojti zemrën tënde të brishtë me kafazin e krahërorit me të cilin mbron gjithashtu edhe mushkëritë që janë shumë më të brishta se zemra. Allahu na ka dhënë shumë argumenta dhe shenja sesi Ai i mbron krijesat e Tij. Një mënyrë tjetër sesi Ai të mbrojti është me anë të lëkurës tënde duke e mbushur lëkurën plot me receptorë dhe nerva tepët të ndjeshëm që janë ato shkaku i ndjesive në momentin kur kërcënohesh nga ndonjë rrezik i jashtëm. Janë pikërisht këto radarë dhe sensorë të vendosur mjeshtërisht në lëkurën tënde të brishtë që kapin çdo ndryshim jashtë lëkurës, çdo ngacmim qoftë ai përmes shpuarjes, prerjes, shtypjes, ftohjes apo nxehjes. Është pikërisht lëkura pra ajo që përmes sensorëve të saj të mahnitshëm të përcjell gjurmët e botës jashtë teje. Lidhur me këtë temë kam diskutuar me profesor Tajatan Tajasun të cilit i thashë: Ndjesia e të ftohtit dhe të nxehtit ku gjendet? Tha gjendet në lëkurë. I thashë nëse e zhveshim lëkurën dhe muskujt ia ekspozojmë një zjarri a do të ndiejë gjë personi? Tha jo, nuk do ndiejë, thjesht do pikas se diçka nuk është në rregull por pa ndierë dhimbje sepse nervat e specializuara për të ndierë janë hequr me heqjen e lëkurës. Ndërkaq i përmenda atij thënien e Allahut përmes së cilës Ai kërcënon mosbesimtarët: "Është e vërtetë se ata që mohuan argumentet Tona, do t'i hedhim në zjarr. Sa herë që u digjen lëkurët e tyre, Ne ua ndërrojmë me lëkurë të tjera, që të shijojnë dënimin…" Ndjesimin përmes lëkurës Allahu e bëri të tillë që lëkura të jetë përfaqësuese e kufinjve të jashtëm të trupit që i qartësojnë trupit ndryshimin e temperaturës së jashtme, kërcënimet e jashtme që mund të shkaktojnë prerje, shpuarje, shtypje etj. Gjithë sa në fjalë i dedikohet lëkurës të dizenjuar enkas për mbrojtjen tënde.

Medito sesi mrekullisht funksionon pro teje ky sistem mbrojtje, po sikur lëkura të hiqej apo pritej?! Në fakt lëkura është një blind kundër depërtimit në brendi të trupit të mikrobeve dhe kërcënimeve të ndryshme dhe nëse lëkura do zhvishej mikrobet do hynin lehtësisht gjë pas së cilës trupi do kundërpërgjigjej me forcat mbrojtëse, rruazat e bardha të gjakut, që do suleshin sakaq kundër këtyre mikrobeve dhe bakterieve, pasi një prej detyrave më të rëndësishme të tyre është që t'i sulmojnë bakteriet dhe mikrobet që depërtojnë në trup nga ambienti i jashtëm. Nëse bakteriet janë të fuqishme atëherë bëhet një stimulim i tillë që të realizohet tërheqja e tyre tek gjëndrat limfatike ku qeliza të shumta janë prezente të sulmojnë dhe sfidojnë bakteriet që hynë. Në rastin kur edhe gjëndrat limfatike nuk arrijnë t'u bëjnë ballë këtyre mikrobeve dhe bakterieve atëherë bëhet një stimulim i tillë që të realizohet tërheqja e tyre për në mëlçi dhe shpëretkë me qëllim që të mundësohet neutralizimi dhe shkatërrimi i tyre. Nëse sërisht mikrobet arrijnë të rezistojnë atëherë trupi prodhon antitrupa specifikë në varësi të llojit të bakteries apo mikrobit. E prodhojnë atë në varësi të llojit të antitrupit që është adekuat për luftimin e mikrobit që ka hyrë në trup. Nga mijëra e mijëra opsionet e mundshme del nga gjaku pikërisht antitrupi që duhet për të vrarë mikrobin specifik. Kush pra është Ai që e mundësoi një gjë të tillë?! Kush është Ai që posedon njohuri rreth trajtimit të çdo soji bakterie dhe mikrobi?! Kush është Ai që i dinte specifikat e mikrobit

që hyn në trup dhe në bazë të kësaj bëri që trupi të sintetizoj antitrupin e duhur që është i vetmi që e vret dhe përballon këtë mikrob?! A s'është kjo vepër e Mbrojtësit, Ruajtësit, Përkujdesësit që deshi të të mbronte, të mbronte syrin tënd, trurin tënd dhe çdo pjesë të trupit tënd, mbrojti zemrën tënde, mushkëritë e tua dhe çdo organ tjetër përmes një sistemi dhe mekanizmi perfekt mbrojtje?! Në të njëjtën kohë Allahu është Ai që përkujdeset dhe garanton mbarë universin, i Lavdishëm është Ai.

Në këtë formë ne arrijmë të njohim disa nga atributet e Zotit tonë.

Medito më tej lidhur me mrekullinë krijonjëse të Allahut, dëgjimin, aparatin e dëgjimit që fillesat i ka me veshin e jashtëm për të vijuar më tej me veshin e mesit dhe atë të brendshëm, përfshirë në të edhe kërmillin dhe daullen e veshit. Zëri kalon nëpër veshine jashtëm, daullja e veshit e dëgjon atë teksa kërmilli i gjendur në veshin e mesit i përcjell impulset e marra për në tru. Kush t'a krijoi kaq përsosmërisht aparatin e dëgjimit që posedon?! Sigurisht Krijuesi i tij është Ai që deshi që ti të jesh krijesë që dëgjon dhe dije se gjëja e para që Ai do që ti të dëgjosh është fjala e Tij të cilën Ai e përcolli tek ti përmes profetëve të Tij të ndershëm. A është e mundur për gurin që të dëgjojë?! Po bimësia a mund të dëgjojë?! Kush është Ai që të dalloi ty me dëgjimin?! A mundet njeriu sot t'a pajisë me dëgjim atë krijesë që nuk posedon dëgjim?!

Medito tani rreth syrit, strukturimit të tij preciz. Ti tani teksa po shikon tek ky ekran, ekrani i TV, do të shohësh vetëm pamjen qëndrore të personit që ke fokusuar por nuk arrin të shohësh qartë pamjet e tjera shoqëruese të personit në këtë ekran, për shembull skenën e pasme apo detaje të tjera nga pamjet e skenës. Kjo ndodh pasi syri, që të qartësohet të pamurit e tij, ka nevojë për sinkronizimin e parametrave të pamjes ku fokusohet, gjë që do të thotë se nëse ne duam të shquajmë personin në skenë sinkronizimi i pamjes së tij bëhet i mundur duke u përqendruar fokusimi vetëm tek personi në fjalë teksa elementët e tjerë të skenës ngelen në hije, dhe e njëtja gjë vlen kur duam të shquajmë konturin e pasëm të skenës. Procesi i qartësimit të pamjes ku syri fokusohet është i atypëratyshëm, por sa e sa detaje dhe perfeksione të krijuara prej Allahut fshihen dhe ndodhin në përftimin e të pamurit tënd. Po flasim për shikimin e mrekullueshëm. Ndërkaq dihet se doktorët nuk mund t'ia kthejnë vështrimin të verbërit shikimi i të cilit është dëmtuar pakthimisht. Sado të mundohen nuk do munden, atëherë si ata thonë se natyra e verbër, memece, shurdhe dhe e palëvizëshme që nuk posedon as sy dhe as vesh, është ajo që ia krijoi njeriut dëgjimin dhe shikimin. I Lavdishëm është Allahu. Kjo është idhujtaria moderne.

Medito lidhur me pasionet dhe emocionet njerëzore si dashuria, urrejtja, armiqësia dhe miqësia, morale fisnike këto, guximi, modestia, bujaria; të gjitha këto ndjenja nga kush vijnë, a vijnë aksidentalisht?!

Medito pastaj lidhur me trurin përmes të cilit njerëzit zgjidhin problemet që kanë dhe gjykojnë kundrejt gjërave nëse janë apo jo të drejta, përmbushin dhe realizojnë planet e tyre të jetës. Kjo intelegjencë që e gjejmë tek njerëzit dhe falë të cilës njerëzit mund të

shpikin dhe produktojnë gjëra nga më të mahnitshmet a është fryt i aksidentales?! Nismat shpikëse, projektuese dhe civilizuese që kanë ndërmarrë mendjet njerëzore përmes sa e sa konferencave dhe mbledhjeve; ligjet, kodet dhe pedagogjia që njeriu ka lëvruar, e gjitha kjo a është pjellë e aksidentales dhe të rastësishmes?! E gjitha kjo na qenka një rastësi e natyrës?! A gjykojnë apo jo këta njerëz, a dinë se çfarë thonë?! Mbi ç'baza dhe argumente e mbështesin atë që thonë?!

Pas këtij krijimi qëndron vullneti, synimi, dituria, perfektshmëria, mëshira. Vetë anatomia jote o njeri, ashtu sikurse i gjithë universi, dëshmon lidhur me disa atribute të Atij që të krijoi. Nëse sheh këtu urtësinë dije se e tillë gjë është vepër e të Urtit; nëse sheh këtu perfektshmëri dije se e tillë gjë është vepër e të Përsosurit; nëse sheh këtu mëshirë dije se e tillë gjë është vepër e të Mëshirshmit; nëse sheh këtu mrekullinë krijuese dije se e tillë gjë është vepër e të Gjithdijshmit, të Gjithmundshmit, Allahut të Lartësuar; nëse sheh këtu furnizimin dije se e tillë gjë është vepër e Furnizuesit; nëse sheh këtu fuqinë dije se e tillë gjë është vepër e të Gjithfuqishmit; nëse sheh këtu madhështinë dije se e tillë gjë është vepër e të Lartmadhëruarit.

E kështu çdo gjë në univers të reflekton ty atribute prej atributeve vepruese të Allahu të Lavdishëm dhe Lartmadhëruar.

Më tej vëren se ky univers është unifikuar mbi bazën e një sistemi të njësuar dhe harmonizuar.

Medito! A di qeliza që gjendet në stomak se çfarë po bën, po ajo që gjendet në brendinë e kokës a e di se çfarë po bën?! Ndërkaq çdo qelizë e kryen në një formë perfekte funksionin dhe rolin e saj. Ai i cili ia caktoi asaj rolin të tillë që të harmonizohet, plotësohet dhe balancohet me qelizat e tjera është Krijuesi Një i Vetëm, i Lavdëruar është Ai.

Allahu gjithashtu bëri që gjithëçfarë gjendet rrotull njeriut të jetë në harmoni dhe balanc të plotë me nevojat e njeriut, dhe gjithashtu bëri që toka të jetë në harmoni të plotë dhe e mirësinkronizuar në sistemin diellor, teksa vetë sistemin diellor, galaktikën e tij dhe mbarë galaktikat dhe plejadat e galaktikave që të gjitha gjithashtu i koordinoi, përshtati dhe sinkronizoi në një formë të mrekullueshme të ecin precizivisht në orbitat e tyre të larmishme.

Kjo e gjitha sjell dëshminë e pakontestueshme se e tillë gjë është vepër e Krijuesit Një të Vetëm, i Cili e meriton t'a adhurojmë, t'i bindemi dhe nënshtrohemi. Prandaj dëshmia që muslimani dëshmon duke thënë LA ILAHE IL ALLAH-NUK E MERITON TË ADHUROHET ME TË DREJTË ASKUSH PËRVEÇ ALLAHUT, argumentet, shenjat dhe gjurmët për këtë dëshmi kanë mbushur universin, "…Edhe në vetvetet tuaja, a nuk po shikoni?!..."

Mrekullia qëndron dhe në faktin tjetër se Kurani Fisnik përmend për ne sa e sa prej sekreteve që njerëzit nuk arritën t'i zbulonin përveçse në ditët tona nëpërmjet shkenctarëve. Kjo na dëshmon se Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë

mbi të- që na lajmëroi neve për këto sekrete që kanë të bëjnë me strukturën dhe anatominë tonë dhe botës rreth nesh, kjo dituri nuk i ka ardhur përveçse nga Allahu, i Gjithdijshmi dhe i Urti, gjë që nga ana tjetër provon pa pikë dyshimi faktin e pakontestueshëm se Muhamedi është i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Argumentet e Besimit në Botën Tjetër (6)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Besimi Islam predikon se kjo botë është krijuar për njeriun, ndërsa njeriu është krijuar për Botën Tjetër.

Njeriu nuk erdhi në këtë ekzistencë thjesht për të vdekur, porse vdekja vetëm sa e transferon njeriun në jetën e varrit që është stacioni i parë i jetës së Botës Tjetër.

Njerëzit në varësi të asaj që vepruan me udhëzimet hyjnore i pret Xheneti –Parajsa– ose Xhehenemi –Ferri–.

Për çdo person që përqafon besimin Islam dhe e bën atë model të jetës së tij, besimi në Botën Tjetër është një e vërtetë e pamohueshme që është skalitur thellë në zemër dhe në mendje.

Pa të besuarin në Botën Tjetër njeriu nuk mund të rradhitet në rradhën e muslimanëve dhe as në rradhët e pasuesve dhe ndjekësve të mbarë librave të tjerë qiellor.

Nëse njeriu nuk beson në Botën Tjetër atëherë ai quhet jobesimtar dhe e meriton ndëshkimin e Allahut sepse në këtë mënyrë ky person ka përgënjeshtruar fjalën e Zotit në Kuranin Famëlart dhe nw mbarë librat e Tij. Pikërisht lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Famëlartë: "...kush nuk beson në Allahun, në engjëjt e Tij, në librat e Tij, në profetët e Tij dhe në Botën Tjetër, i tilli ka humbur një humbje të largët (ka rënë në humbëtirën e mosbesimit".

E pra kush dëshiron t'a rradhis vetveten në rradhët e besimtarëve duhet patjetër që të besojë në Botën Tjetër.

Tek besimi në Botën Tjetër hyn: "besimi në jetën pas vdekjes ku hyn sprova e varrit si dhe lumturia ose vuajtja që e pret njeriun në jetën e varrit në varësi të besimit dhe veprave të tij; besimi në shenjat që do ndodhin para Kijametit –shkatërrimit të universit– dhe pas tyre besimi në ndodhinë e Kijametit dhe në llahtaritë e tij; besimi në gjithë sa përmend besimi Islam në lidhje me ringjalljen; besimi në episodet e gjykimit prej të cilëve janë shpërndarja tek çdo njeri e librit në të cilin janë rregjistruar hollësisht të gjitha veprat e jetës së njeriut, peshimi i veprave të njerëzve në një peshore formën dhe mënyrën e funksionimit të së cilës e di vetëm Allahu i Lartësuar; besimi në Haudin (liqenin) prej ujit të të cilit, para se të kalojnë urën e Siratit, do t'u jap të pinë ujë besimtarëve të vërtetë vetë profeti Muhammed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-; besimi në urën e Siratit mbi të cilën do t'i duhet të kalojë çdo njeriu dhe që është një urë e tendosur përmbi Xhehenem që lidh tokën e gjykimit me Xhenetin; besimi në

Xhenet –Parajsë– dhe lumturimin në të; besimi në Xhehenem –Ferr– dhe dënimin në të si dhe besimi në të gjitha çështjet e tjera që kanë lidhje me Botën Tjetër dhe që janë përmendur në Kuran dhe në thëniet e sakta profetike të profetit Muhamed - lavdërimi dhe paqja e All-llahut qoftë mbi të -."

Këto të vërteta të besimit Islam mbështeten nga një sër argumentesh të cilat ne do t'i trajtojmë në vijim.

Idhujtarët e Mekes ishin njerëzit që më shumë se çdokush tjetër qenë angazhuar t'a përgënjeshtronin Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Me qëndrimin e tyre të rreptë në pusi të kapjes të qoftë një shansi të vetëm që do t'i mundësonte ata t'a përgënjeshtronin profetësinë e Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-; ata mund të konsiderohen pa frikë përfaqësuesit më të rreptë të kundërshtarëve të Shpalljes Hyjnore në të gjithë kohërat.

Një tentativë prej tentativave të përgënjeshtrimit që ata tentuan t'i bëjnë Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ishte ngjarja e tij e Israsë dhe Miraxhit (Natëngjitja Qiellore).

Porse Profeti Muahamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i sfidoi ata me argumentimin e vërtetësisë së ngjarjes në fjalë, duke sjellur argumente të pakontestueshme se ai udhëtoi me të vërtetë natën në fjalë për në Xhaminë Aksa dhe po në atë udhëtim u ngjit në Sidretul Muntehe, në pikën qiellore më të afërt me Allahun ku ai foli direkt me Allahun dhe ku nuk ka arritur para tij asnjë krijesë tjetër, madje edhe vetë engjëlli Xhebrail u ndal para se Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të vazhdontë më tej dhe i tha se ai nuk kishte leje të shkonte më tej.

Të argumentuarit e udhëtimit natën për në Xhaminë e Shenjtë Aksa shërbeu në vetvete si argument për pjesën tjetër të udhëtimit, për ngjitjen e Profetit mbi shtatë qiejt për në Sidretul Muntehe, në skajin kulminant të gjithësisë, më të afërtin në mes gjithësisë dhe Zotit të botërave, skaj në të cilin nuk ka arritur para profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të - asnjë krijesë tjetër e Allahut Madhështor.

Ngjarja profetike në fjalë përcillet nga transmetimi, autenticitetin e të cilit e konfirmojnë Imam Bukhariu dhe Imam Muslimi, ku transmetohet se Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ka thënë: "Kur kurejshët më përgënjeshtruar lidhur me udhëtimin e natës (Isranë dhe Miraxhin) që u realizua me mua, u ngrita tek Hixhri (pjesë e Qabes) ku Allahu m'a shpalosi përpara Bejtul Makdesin (Zonën e Shenjtë të Aksës) dhe bëra t'u tregoj atyre teksa po vështroja tek ajo që po përshkruaja".

Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- bën fjalë për momentin kur kurejshët mekas i thanë që meqë pretendon se ishe në Bejtul Makdes atëherë na e përshkruaj ne se si ishte ajo. Ata e dinin se Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- kurrë nuk kishte qenë atje. Qe kjo kërkesë e tyre shkak që Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- t'i mundësohej nga dhuntia hyjnore të depërtonte direkt në panoramën e gjallë të Bejtul Makdesit dhe t'ua përshkruante Mekasve fije për pe atë. Ndër të tjera Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u tregoi atyre edhe për karvanin e mekasve që u sillte

mekasve ushqime të cilin ai e kishte parë rrugës,. U tregoi atyre për vendodhjen e karvanit të tyre dhe personat që e shoqëronin atë, madje i lajmëroi dhe u tha edhe se ky karvan do arrijë tek ju në filan ditë.

Ndër gjërat që ai pa në këtë ngjitje të tij qiellore të pashembullt nga lloji i saj ishte edhe Xheneti dhe Xhehenemi.

Kthehemi tek tema jonë e argumenteve të besimit në Botën Tjetër.

Ajo që përmendëm lidhur me udhëtimin e Israsë dhe Miraxhit të Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- hedh dritë sesi Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u mundësua nga vetë Allahu i Lartësuar që t'a shikonte me sytë e tij Xhenetin dhe Xhehenemin e premtuar.

Lidhur me argumentet e mëdha të Allahut që Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- pa në këtë udhëtim qiellor vetë Allahu i Lartësuar shprehet në Kuranin famëlartë duke thënë: "Ai pa nga argumentet (shenjat) madhore të Zotiti të tij".

E sikur për vërtetësinë e ekzistencës së Botës Tjetër të ishim mjaftuar vetëm me këtë që thamë, kjo do të mjaftonte si provë e besimit në Botën Tjetër. Do të mjaftonte fakti që Ai që e krijoi Xhenetin dhe Xhehenemin e mundëson Profetin e Tij të sinqertë t'i shikojë ato.

Gjithsesi përveç faktit se Profeti u mundësua t'a dëshmonte me sytë e tij Xhenetin dhe Xhehenemin, gjenden edhe shumë fakte dhe argumente të tjera që verifikojnë vërtetësinë e pakontestueshme të Botës Tjetër:

ARGUMENTI I DREJTËSISË:

Presupozo se po shikon një burrë të fuqishëm që godet një fëmijë të vogël si do ndihesh në vetvete? Sigurisht që do ndjesh dhimbje dhe do dëshirosh të ndërhysh po pate mundësi. Por nëse një gomar do ndodhej pranë teje dhe do shihte të njëjtën pamje a do ndiente diçka?! Çfarë bëri që zemra jote të reflektojë ndërsa ajo e këfshës jo? Ajo që bëri që zemra jote të reagojë është pikërisht dëshira jote e brendshme për drejtësi. Nga këtu del në pah se njeriu e do drejtësinë. Ndërkaq a mendon se dashuria që ke ti për drejtësinë është më e kompletuar dhe më e madhe se ajo e Krijuesit tënd që të krijoi duke të natyrizuar me këtë ndjenjë dëshirë për drejtësi?! Dëshira për drejtësi e shpërndarë tek njerëzia nga njeriu I parë deri tek ai I fundit, përfshirë këtu profetët dhe njerëzity e mirë dhe të urtë, pot ë tubohej nuk do përbënte vetëmse nnjë njësi të pakrahasueshme në raport me drejtësinë e Allahut, sepse Allahut të Lartësuar i takon përsosmëria kulminante. Drejtësia e Tij është kulminante dhe absolute. A mendon se Allahu Poseduesi i drejtësisë absolute nuk ka për t'a vënë drejtësinë e plotë midis njerëzve?! Realiteti është se në këtë botë nuk vendoset drejtësia absolute. Sa e sa njerëz dalin nga kjo jetë me të drejta të nëpëkëmbura, pa i gjetur të drejtat e tyre?! Sa e sa nga zullumqarët, kriminelët, terrorristët dhe armiqësorët nuk vihen para drejtësisë absolute e të marrin ndëshkimin e merituesshëm?! Teksa në krahun tjetër ne nuk e vëmë në dyshim se Drejtësia Hyjnore e Allahut, i Cili ne krijesat e Tij na natyrizoi të tillë që kemi dëshirë të zjarrtë për drejtësi, Drejtësia Hyjnore e Krijuesit është perfekte dhe absolute, dhe pikërisht falë kësaj perfektshmërie në drejtësibërjen e Tij, Allahu i dha të padrejtit

kohë dhe shans të reflektoj dhe rishikoj këtë qëndrim dhunues të tij dhe të bëjë kthesë, i dha shans mosbesimtarit të pendohet dhe kthehet tek Allahu dhe i dha shans mëkatarit të pikëllohet. E gjitha kjo sepse Allahu është poseduesi i drejtësisë perfekte, dhe nisur nga drejtësia e Tij perfekte e patolerueshme bëri që për vendosjen e Drejtësisë Hyjnore në vend të vërë në dispozicion një ditë me një kohëzgjatje prej pesëdhjetëmijë vjet, e cila është Dita e Gjykimit e njohur me emrin JEUMU DIN-DITA E PËRGJEGJËSIMIT. A s'është Allahu thënënsi që në Kuranin Famëlartë hedh dritë mbi drejtësinë e Tij absolute duke thënë: "A (mendojnë ata që thonë se nuk ka Botë Tjetër ku do vendoset Drejtësia Absolute Hyjnore se) do t'i trajtojmë muslimanët (që iu dorëzua Allahut) si shkelësit e ligjit. Ç'është me ju (o mosbesimtar)?! Si gjykoni kështu (kaq cekët)?!" Nuk është e drejtë dhe është e papranueshme për Allahun që muslimani që iu dorëzua ligjit hyjnor t'a trajtojë njëllojë me shkelësin e ligjit hyjnor. Allahu i Lartësuar jo vetëm apelon për drejtësi por detajon edhe sesi ajo do vendoset në Ditën e Gjykimit, duke thënë: "Ne vendosim peshojat (matëset) e drejtësisë në Ditën e Gjykimit e askujt nuk i bëhet padrejtësi".

ARGUMENTI TJETËR është ARGUMENTI I PËRSOSMËRISË DHE RENDIT:

Persupozo se je duke vizituar një qytet gjigand, me emër, modern dhe të mirëorganizuar. I gjen të gjithë rrugët e këtij qyteti të ndriçuara me një sistem shtyllash të bukura ndriçimi anekënd qytetit, rrugët janë shtruar, sinjalistika është vendosur dhe çdo gjë të josh dhe lë mbresa të papërshktrueshme. Teksa po viziton këtë qytet të mrekullueshëm të takon të hysh në një rrugicë ku ndriçimi mungon dhe shtyllat e ndriçimit e gjen të hedhura anës rrugës dhe mbi trotuare shikon gropa të hapura aty këtu. Cila do jetë përgjigja që do i japësh vetes lidhur me panoramën e rrugicës në fjalë? Do konkludosh se kjo rrugicë do rregullohet medoemos? Përse pate këtë konkludim? Sepse bazuar në ligjin përfshirës të rregullsisë dhe mirësistemimit të reflektuar anekënd qytetit në fjalë nuk ka koment tjetër vetëmse kjo rrugë medoemos që do rregullohet dhe ndriçohet. Tjetër fakt që të bën të konkludosh pa hezitim në këtë fakt janë shtyllat e ndriçimit të gjendura aty dhe gropat e hapura… Pra ligjin mbisundues të rregullsisë në nivel gjithëpërfshirës për qytetin ti e zbrite për të konkluduar rreth faktit nëse pritet të vendoset apo jo rregullsia edhe në rrugicën e vogël në fjalë.

Po me këtë metodë konkludimi ne konkludojmë se Bota Tjetër e vendosjes së Drejtësisë absolute është një domosdoshmëri.

Si? A nuk e shikojmë sesi përsosmëria dhe rregullsia fillojnë qysh në elementin më të vogël përbërës të këtij universi, tek atomi. Atomi tek çdo komponent gjendet perfektshmërisht në vendin e duhur dhe në raportin e duhurm, madje jo vetëm atomi por edhe minielemntët e tjerë të tij.

E tillë është edhe çështja e qelizës. Ajo gjendet perfektshmërisht në vendine duhur dhe raportin e duhur. Falë kësaj përsosmërie gjejmë që rregullsia të sundojë endjet qelizore deri në nivel aparatesh biologjike dhe tërësi organizmash biologjik të bimëve dhe gjallesave mbarë. Përsosmëria është sinonimi i tokës mbarë, maleve, luginave, lumenjve, detërave dhe oqeaneve. Përsosmëria është karakteristikë e tokës edhe në lidhje me pozicionimin dhe mbarë parametrat e tjerë të mrekullueshëm të saj në sistemin diellor, në atë galaktik dhe kozmik.

Nëse do marrim çdo gjë në këtë gjithësi do gjejmë se është përfeksionuar dhe pozicionuar aty ku duhet dhe i takon.

E gjen veten para një universi gjigand të përsosur dhe të pozicionuar ku dhe si duhet.

Nëse pas strukturës së sendeve do të shohësh atë të gjallesave të panumërta bimore apo shtazore sërisht do mahnitesh me përsosmërinë dhe rregullsinë që dominon këtu. Të mjafton të konstatosh sesi në trupin tënd syri yt gjendet në pozicionin e duhur dhe po kështu hunda, veshi, zemra dhe çdo pjesë tjetër e trupit tënd.

Në të gjithë universin sundon rregullsia përvese në një rrugicëz të tij, të quajtur rrugica e njerëzisë. Madje dendur këtu e gjen shkelësinë e rregullit dhe ligjit të nderohet, teksa pasuesi i drejtësisë dhe ligjit diskretitohet dhe persekutohet.

Pyetja që lind është: Ai që vendosi rregullsinë, perfektshmërinë dhe rendin të sundoj anekënd universit përse nuk e vendosi atë në jetën e njeriut? Përgjigja është, sigurisht, Ai do t'a vendosi rendin në botën njerëzore dhe madje për të ka lënë Ditën Speciale pesëdhjetëmijë vjeçare të Gjykimit. Por qe Zgjedhja e Tij Hyjnore që t'a vononte atë pasi e gjithë njerëzia të kryej sezonin e saj të provës në tokë.

Pikërisht lidhur me këtë realitet Allahu i Lartësuar thotë: "Ata (mosbesimtarët) që e tepruan me të këqijat (që bënë) a menduan se si në jetën e tyre edhe pas vdekjes do t'i barazojmë me ata që besuan dhe bënë vepra të mira. Sa i keq (dhe i pasaktë) që është ky gjykim i tyre?! Allahu i krijoi qiejtë dhe tokën me një rend preciz dhe për t'u shpërblyer secili njeri me veprat që ka bërë, e atyre nuk u bëhet padrejtësi"; pra ky gjykim është një gjykim i keq të cilin s'ka sesi t'a pranojë Allahu. Allahu që e vendosi rendin në qiej dhe në tokë padyshim që do t'a vendosë atë edhe tek mbarë njerëzia dhe askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi. Argumentohet për domosdoshmërinë e Botës së Përgjegjësimit dhe Llogarisë nisur nga rendi universal që shohim të sundojë mbarë universin.

NJË TJETËR ARGUMENT ËSHTË STRUKTURA DHE NATYRA JONË.

Brenda natyrës dhe strukturës sonë gjendet argumenti se ne jemi krijuar për një tjetër botë.

Presupozo se një qenie inteligjente që nuk di asgjë rreth fazave të zhvillimit të qenies njerëzore mundësohet të shikojë fetusin njerëzor teksa zhvillohet në mitrën e nënës. Sheh se krijimi i fetusit është në kulminacionet e perfektshmërisë. Ndërkaq ai shikon tek kjo foshnje dy duar dhe dy këmbë. Nuk di se cila mund të jetë dobia e pranisë së këtyre dy duarve dhe dy këmbëve brenda mitrës tepër të ngushtë duke qenë se ai e di se duart edhe këmbët që të funksionojnë kanë nevojë për një hapësirë shumë e shumë më të madhe se ajo e mitrës. I vjen ndërmend se këto gjymtyrë janë të paqëllimta dhe hutimi i tij shtohet edhe më shumë kur sheh foshnjen t'a lerë me pahir barkun e nënës. A është mendim i drejtë mendimi që i erdhi ndërmend?! Sigurisht që jo, e në se ai do kishte qenë njeri i matur, maturia do e kishte bërë që të arrintë në konkludimin se kjo krijesë duhej të qe krijuar për një botë tjetër duke qenë se struktura e trupit të tij i përket një lëmi dhe realiteti më të madh se mitra; duke qenë se duart dhe këmbët që të funksionojnë kanë nevojë për një hapësirë shumë më të madhe se ajo e mitrës.

Perfektshmëria që sundon në strukturën krijuese të këtij trupi aty brenda barkut të nënës është antonim i kotësisë dhe nga ana tjetër prania në strukturën fizike të trupit të kjësaj foshnje të gjymtyrëve dhe realiteteve që kanë nevojë për hapësirë me të tjera diapazone dhe parametra, e bëjnë atë të konkludojë prerazi se në fakt kjo krijesë është bërë për një botë tjetër. Dhe nëse presupozohet se atij do t'i jepej mundësia t'a shihte këtë njeri pas daljes nga barku i nënës sesi ai me këmbët e tij ecën në distanca karshi të cilave mitra ku qe strehuar për shumë muaj është krejt e pakonsiderueshme, dhe i sheh duart të punojnë dhe veprojnë pasi qenë krejt të paaktivizuara e të përthyera aty brenda; pas kësaj do thoshte, hë, doli ajo që pritej.

Nisur nga fakti se mitra nuk ka hapësirën e mjaftueshme që duart dhe këmbët të kryejnë funksionin e tyre, ne konkludojmë nëmënyrë të pakontestueshme se duart dhe këmbët janë krijuar për një fazë tjetër që i takon një perudhe të mëpasshme.

Për analogji le të përqëndrohemi në qenien tonë shpirtërore njerëzore ku gjendet një diçka që i kalon dimensionet e planetit tokë e më gjerë dhe që për analogji me sa parapërmendëm tregon se ne jemi krijuar për një fazë tjetër, për një botë tjetër ku do bëhet përmbushja lidhur me këtë.

Për çfarë bëhet fjalë? Bëhet fjalë për lakmitë, ambiciet dhe dëshirat e pakufi.

Çdonjërit nga ne po t'i thoje, të kemi pronësuar një qytet; do të thoshte, nuk mjafton, qytetin tjetër kujt do ia leni?. Nëse do i thoje, ta kemi pronësuar gjysmën e tokës; do thoshte, po pjesën tjetër? Nëse do i thoje, krejt tokën t;a kemi dhënë; do thoshte, çfarë për hënën, si mund t'a bëjë pronë timen? Kjo nxjerr qartë në pah se njeri posedon në zemrën e tij dëshira ambicioze që i kalojnë dimensioned e mbarë dynjasë. Këto ambicie janë krijuar për një Botë Tjetër dhe jo për këtë dynja.

Më tej, nëse do të thonin, ke për të jetuar njëmilion vjet; do thoje, s'mjafton. Nëse do të thonin, ke për të jetuar njëmiliardë vjet; sërisht do thoje, s'mjafton. Nëse do të thonin; në rregull ke për të jetuar njëlloj me tokën, deri kur të shkatërrohet toka; do thoje, s'jam dakord, toka le të shkatërrohet, por unë dua të jetoj. Ç'e kënaq njeriun lidhur me këtë dëshirë, përjetësia?! Të përgjigjet njeriu, po, kështu po.

Dashuria që ti ke për përjetësinë është më e madhe se dynjaja dhe dimensionet e saj, kjo krahas ambicieve për pasuri dhe katandi.

Është fakt se këto dy ambicie; ajo e ambicieve pakufi dhe ajo e jetesës së përjetëshme; janë argument dhe tregues i qartë se unë si njeri jam krijuar për një Botë Tjetër dhe jo për këtë botë, për Atë Botë Tjetër rreth së cilës Allahu i Larëtsuar thotë në Kuranin Fisnik: "Kjo është dita e Përjetshmërisë, për ta në të do të ketë gjithësa dëshirojnë dhe Ne kemi shtesë". Banori i gradave më të ulta të Xhenetit posedon sa dhjetëfishi i kësaj dynjaje dhe ka në të gjithësa i dëshiron shpirti. Pas kësaj njeriu thotë, në rregull, kjo më kënaq.

Është ky strukturim i qenies sonë humane që dëshmon për ne se ne jemi krijuar për një Botë Tjetër.

KJO BOTË PREJ ELEMENTËVE BAZË TË SAJ KA SHPËRBLIMIN DHE NDËSHKIMIN, është një tjetër konkludim ku do qëndrojmë është fakti sesi. Sa e sa kriminelë dhe superdhunues kemi parë të ndëshkohen në këtë botë, ndërkaq kemi parë edhe rastet e sa e sa njerëzve të mitë e të përsekutuar që janë shpërblyer dhe kanë pasur ardhmëri të mirë në jetën e kësaj bote. Vetë historia e tokës dëshmon rreth këtij fakti.

Kjo na dëshmon se ne kemi një Zot të cilin mirëbërësia e kënaq dhe për të Ai shpërblen, teksa keqbërja e zemëron Atë dhe për të Ai ndëshkon. Porse siç e ka bërë të qartë këtë fakt Shpallja Hyjnore, shpërblimi dhe ndëshkimi kapital dhe absolut do të jetë në Botën Tjetër; gjë që vjen në Kuranin Fisnik ku Allahu i Lartësuar duke hedhur dritë mbi mosbesimtarët që u ndëshkuan në Betejën e Bedrit thotë: "Këtë shijojeni, dhe ndëshkimi me Zjarr (në Xhehenem) është (në pritje) për mosbesimtarët"; me kuptimin shijojeni këtë pjesë të ndëshkimit, që nuk është vetëmse një pjesë e tij, porse më i ashpër është ndëshkimi me Zjarrin e Xhehenemit që ju pret.

Gjithashtu, rreth muslimanëve emigrantë mekas të cilët u përzunë nga shtëpitë e tyre dhe u lënduan, dhe më pas Allahu i bëri triumfues, Allahu i Larëtsuar në Kuranin Famëlartë thotë: "Atyre të cilëve emigruan në rrugë të Allahut, pasiqë u dhunuan, do t'u mundësojmë një banim të përsosur në këtë botë, teksa shpërblimi i Botës Tjetër është më madhështor nëse janë nga ata që punojnë"; nënkupton se mirësitë dhe të mirat që sjell Allahu i jep robit në dynja për punët e mira të bëra në realitet është shpërblim i përshpejtuar në këtë botë përpara atij kulminant në Botën Tjetër.

LAJMËRIMI I PROFETIT MUHAMED -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- RRETH KIJAMETIT DHE SHENJAVE TË TIJ, është një tjetër argument që shpalos qartazi vërtetësinë e Botës Tjetër.

Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- lajmëron nën dritën e Shpalljes Hyjnore mbi shenjat e Kijametit (Shkatërrimit të Universit) dhe flet në detaj se do të ndodhë kjo e kjo gjë prej shenjave të vogla të Kijametit dhe kjo e kjo gjë prej shenjave të mëdha të Kijamtit.

Në ditët tona në shohim të jenë konkretizuar sa e sa prej këtyre parashikimeve profetike që u takojnë shenjave të vogla të Kijametit, madje shenja e vogla të Kijametit thuajse janë konkretizuar që të gjitha dhe nuk mbetet veçse të ndodhin shenjat e mëdha.

Shembulli i lajmërit profetik mbi lajmërimin lidhur me shenjat që pritet të ndodhin para Kijametit është si shembulli i një personi që lajmëron njerëzit mbi një ushtri që do t'u vijë atyre dhe u jep shenja dhe tregues rreth ardhjes së tyre. U thotë do dëgjoni jehonat e largëta të artelerisë në ecje, krisje armësh nga largësia, pastaj bombardimet në distancë dhe më tej bombardimet e aviacionit luftarak. Kur njerëzit fillojnë të dëgjojnë treguesit e parë të ofensivës ushtarake të pritëshme binden rreth vërtetësisë së fjalëve të lajmëruesit, ndërsa kur bombat e aviacionit ushtarak bien mbi kokët e tyre kjo tregon se po ndodhin treguesit dhe shenjat e mëdha rreth lajmërimit për të cilin u lajmëruan.

Ajo që duhet thënë është se shenjat dhe treguesit e vëgjël të afrimit të Kijametit janë të shumta dhe Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- na ka lajmëruar ne rreth tyre. Prej këtyre shenjave mbi të cilat Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-

na lajmëron është edhe fakti se anët apo cepat e pjesëve të tokës do të afrohen dhe aviten me njëra-tjetrën; gjë në lidhje me të cilën Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- thotë: "Koha do të qaset dhe toka avitet më pranë"; lidhur me qasjen dhe shkurtimin e kohës kjo është bërë fakt ashtu që atë që të tjerëve u duheshin muaj për t'a bërë, ti mund t'a kryesh brenda pak orëve; ndërsa lidhur me avitjen e tokës dhe qasjen e anëve të tokës cekim faktin sesi ka njerëz që mëngjesin e hanë në një continent, drekën në një tjetër dhe darkën në një tjetër; sidomos media vizive dhe e shkruar i ka bërë njerëzit që të jenë fare pranë njëri-tjetrit pamvarësisht nga vendodhja e tyre gjeografike ku gjenden, që hyn gjithashtu në avitjen dhe afrimin e anëve të planetit.

Gjithashtu Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- na lajmëron se prej shenjave të vogla të Kijametit është fakti se sendet do të flasin; gjë lidhur me të cilën Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- thotë: "Nuk do të ndodhë Kijameti derisa personit... rrypi i sandales së tij (asaj që ka mbathur në këmbë) t'i tregoj se çfarë kanë bërë anëtarët e familjes së tij në mosprani të tij"; nënkupton se sendi në fjalë do të jetë burim informacioni dhe ne në ditët tona jemi në fillimet e një revolucioni të vërtetë të aparaturave të sofistikuara të cila vendosen në objekte nga më të ndryshmet dhe sjellin informacion në distancë lidhur me aktivitetin e imët të njerëzve në ambientin ku këto paisje përgjimi zanore madje edhe vizuale gjenden. Prej këtyre risive janë edhe aparaturat e imëta të përgjimit që personi mund t'i vendosë në shtëpinë e tij, të cilat përçojnë çdo informacion që ndodh në shtëpi përgjatë gjithë kohës.

Të gjitha këto shenja që përmendëm vijën në transmetime autentike të konfirmuara për të sakta nga Bukhariu, Muslimi dhe grumbulluesit e tjerë të haditheve. Po tek Bukhariu dhe Muslimi në adresë të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- vjen se prej shenjave të Kijametit është: "...të shohësh këmbëzbathurit, të rreckosurit, të vobekëtit, barinjtë e deleve, të bëjnë kush e kush i ngrenë më lartë ndërtesat..."; gjë e cila sot është bërë e mundur të shihet sidiomos në ishzonën e varfër të gadishullit arabik ku popullata me epokën e arit të zi kapërceu nga epoka e varfërisë së thellë në atë të superzhvillimit sidomos në lëmin e ndërtimit dhe infrastrukturës...

Po në transmetimet autentike që Muslimi sjell në adresë të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- tregohet se: "Devetë e kuqe do dalin jashtë përdorimit dhe askush nuk do jepet pas tyre"; gjë që nënkupton se ato do të ngelin në hije pikërisht falë daljes së mjeteve të tjera më komforte të transportit. Po në këtë hadith të transmetuar nga Muslimi tregohet se njerëzit do të hyping mbi "Mejethir" dhe mbi to do vinë pranë dyerve të xhamive. Kur ai -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u pyet për "Mejethirët" i komentoi ato me "hypëset (shalueset) e mëdha". E çfarë veç makinave janë këto hypëse të mëdha mbi të cilat namazfalësit vinë deri pranë dyrve të xhamive?! Teksa mbi mjetet e tramsportit hedh dritë edhe thënia kuranore në të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Edhe kuajt (i krijoi), edhe mushkat edhe gomerët, për t'ju hipur atyre dhe si stoli, e Ai krijon (për hipje) çfarë ju (ende) nuk e dini"; nënkupton se njerëzit di inspirohen nga Allahu të krijojnë nga mjetet e transportit gjëra që në kohën e zbritjes së Kuranit nuk diheshin.

Tjetër shenjë rreth së cilës lajmëron Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se do të jetë prej shenjave të hershme të Kijametit është "pezullimi i diturisë" dhe se

"Allahu i Lartësuar nuk e ndrydh diturinë duke e ç'rrënjosur atë por e ndrydh dhe pezullon përmes vdekjes së dijetarëve".

Shenjë tjetër rreth së cilës lajmëron Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se do të jetë prej shenjave të hershme të Kijametit është se: "Toka ka për të vjellur dhe do të vjellë në formë cilindrike (në formë shtylle) atë që ka në barkun e saj"; ajo që më shkon ndërmend teksa dëgjoj këtë thënie profetike është nafta të cilën toka e vjell në formë shufre, e Allahu e di më së miri.

Tjetër shenjë rreth së cilës lajmëron Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se do të jetë prej shenjave të hershme të Kijametit është se: "Islami filloi i huaj (i pazakontë) dhe do kthehet sërisht i huaj"; teksa ne në ditët tona po e dëshmojmë të tillë gjë. Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- lajmëron gjithashtu se kombi islam do të jetë i dobët edhe pse i shumtë në numër dhe kombet e tjera do t'i vërsulen atij; gjë të cilën ne po e dëshmojmë sot me sytë tanë. Thotë Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-: "Shpejt do të jetë kur kombet do t'a thëarrsin njëri-tjetrin kundër jush, ashtu siç ftojnë gostibërësit njëri-tjetrin në ushqimin e tyre". I thamë: A do të jemi të pakët asokohe o i Dërguar i Allahut? Tha: "Jo, ju asokohe do të jeni shumë, porse do të jeni krunde e precipitime si ato të përrenjve".

Shenjë tjetër rreth së cilës lajmëron Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se do të jetë prej shenjave të hershme të Kijametit është se: "Gratë do t'u përngjasojnë dhe do t'i imitojnë burrat dhe se burrat nga ana e tyre do t'u përngjasojnë dhe do t'i imitojnë gratë".

Tjetër shenjë rreth së cilës lajmëron Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se do të jetë prej shenjave të hershme të Kijametit është se: "Do të ketë gra prej kombit të tij islam të cilat nuk ka për t'jua hedhur sytë, do të jenë të veshura të zhveshura, të joshura dhe joshëse në të ecur, kokët e tyre janë mu si xhunga anuese e devesë".

Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- lajmëron se prej shenjave të vogla të Kijametit është se çifutët do të jenë të fuqishëm dhe se ata do t'i luftojnë muslimanët dhe se më pas muslimanët do t'i luftojnë ata dhe do triumfojnë mbi ta.

Këto shenja të Kijametit që i pamë të realizohen dhe konkretizohen siç na lajmëroi Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i cili i quajti ato shenjat e vogla të Kijametit. Pas tyre çfarë pritet? Pritet të vijnë shenjat e mëdha të cilat janë fare pranë Kijametit.

Konkludimi i sa më sipër është se ai -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i cili na lajmëroi mbi shenjat e Kijametit të cilat i pamë të bëhen realitet, na ka thënë të vërtetën për çështjen e Botës Tjetër dhe s'ka dyshim se gjithë sa ai na ka bërë fjalë për Botën Tjetër do të bëhet realitet.

- Porse disa njerëz pyesin e thonë, e si do të jetë ringjallja?

Një gjë e tillë u duket tepër e komplikuar… Pasi të jemi bërë dhé… si?

Në fakt lypset që ne pikë së pari të meditojmë dhe mendojmë lidhur me faktin se si u krijuam.

U krijuam nga tre komponentë:

I pari, është komponenti që erdhi nga Ademi -paqja e Allahut qoftë mbi të-, gjë për të cilën Allahu bën fjalë në Kuranin Famëlartë ku lidhur me këtë thotë: "Përkujto kur Zoti Yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmues të vetes së tyre (duke u thënë): 'A nuk jam Zoti juaj?' Ata thanë: 'Posijo, dëshmuam!'. (Ashtu që) Të mos thoni në ditën e Kijametit: "Ne nuk dimë gjë lidhur me këtë (dëshmim)". Pra ky është komponenti i parë ardhur nga Ademi -paqja e Allahut qoftë mbi të- deri tek paraardhësit dhe prindërit tanë, e kështu me rradhë në vazhdim tek pasardhësit tanë.

Komponenti i dytë është komponenti që edhi nga dheu; gjë për të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Allahu u çeli ju nga toka si bima…"; kjo është përsa i përket trupit fiziologjik.

Janë këto dy komponentë që tubohen dhe evoluojnë së bashku në mitrën e nënës ku ushqehen nëpërmjet gjakut të nënës të cilin organizmi i nënës e produkton bazuar në ushqimin bimor dhe shtazor që gjithashtu origjinën e ka nga toka.

Komponenti i tretë është shpirti të cilin vjen dhe e fryn engjëlli, dhe pikërisht me hyrjen e këtij komponenti në veprim tek qenia njerëzore, fetusi përfton dimensionet e përsosura të krijesës speciale njerëzore; gjë për të cilën Allahu i Larëtsuar thotë: "Pastaj e zhvilluam dhe bëmë atë (njeriun) tejtër krijesë. I Lartmadhëruar është Allahu, më i miri Krijues"; këtu bëhet fjalë për fryrjen e shpirtit ashtu që engjëlli vjen dhe e fryn shpirtin.

Pra njeriu, ekzistenca e tij, është strukturuar nga tubimi dhe unifikimi special midis këtyre tre komponentëve. Vdekja vjen dhe bën ndarjen e këtyre tre komponentëve. Cili ishte komponenti i fundit që iu bashkangjit qenies humane, ishte shpirti, i cili në vdekje kur engjëjt vijnë e marrin, është i pari që shkëputet; gjë për të cilën Allahu thotë: "Derisa kur dikujt nga ju t'i vijë vdekja, e vdesin atë të dërguarit Tanë (engjëjt e vdekjes) që nuk bëjnë lëshime". Engjëjt marrin komponentin që u përket, ashtu që në fillimet e tij shpirti qe nën ndikimin e botës së engjëjve.

Pastaj çfarë ngelet; ngelet komponenti i ardhur nga toka dhe komponenti i ardhur nga Ademi -paqja e Allahut qoftë mbi të-. Përsa i përket komponentit të ardhur nga toka thënia kuranore thotë: "Ne e dimë atë që toka tret (mangëson) prej tyre ndërkaq ne posedojmë Regjistrin Ruajtës". Toka pra tret trupin, çfarë erdhi nga toka kthehet tek toka. Regjistri Ruajtës është një element në ruazën e kërbishtit, kockëz mikroskopike Brenda të cilës gjendet i regjistruar kodi gjenetik, ADN-ja e njeriut, për të cilën shkencëtarët e mjekësisë thonë se nëse do bëhej tubimi i saj për të gjitha qeniet njerëzore që kanë ekzistuar në të gjitha kohërat, ajo do qe në madhësi e një gështenje. Më thuaj se sa vend zë ti në këtë masë.

Është pra pikërisht kjo kockëz që mbetet e pacënuar teksa çdo gjë tjetër prej materies së njeriut tretet. Kjo nuk duhet të tingëllojë e huaj pasi ka sa e sa farëra të cilat nuk

shpërbëhen, nuk dekompozohen dhe nuk treten; si për shembull farërat e polenit të bimëve që janë prezente përgjatë mijëra e mijëra vjetësh dher nuk i ka asmiluar dhe dekompozuar dheu ku ato qëndrojnë.

Trajtimi, në vazhdim, nxjerr pyetjen se si do të jetë ringjallja? Përgjigja është se ringjallja është ristrukturimi i këtye tre komponentëve. Se si do të jetë ky ristrukturim hedh dritë shpjegimi profetik i cili tregon se "një shi do të bjerë nga qielli". Kockëza e vogël e ruazës së kërbishtit të cilën nuk e dëmtontë brejtja nga snjëlloj faktori i jashtëm, as nga zjarri, as nga shiu, as nga dheu, as nga shkrifërimi dhe as nga asgjë tjetër. Në parantezë shkencëtarët e kimisë thonë se ADN-ja që është elementi më i vogël përbërës i jetës, nëse në të vendoset ujë ajo merr jetë dhe nëse uji i hiqet ajo shndërrohet në një lënd të vdekur si çdo send jofrymor. Pra uji është sekreti i jetës tek ADN-ja; e tillë është edhe kjo kockëz, ashtu që sipas vetë përshkrimit profetik kur asaj i zbret ujë ajo merr jetë duke çelur ashtu siç çelin bimët. Pikërisht lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:" "Ai-Allahu prej të vdekurit bën që të dalë i gjalli dhe prej të gjallit bën që të dalë i vdekuri, edhe tokën e ngjall pasiqë ishte e vdekur; po kështu do të nxirreni"; më kuptimin kur të ringjalleni trupat tuaj do të nxirren siç nxirren bimët. Gjithkujt i është dhënë rasti që në një periudhë dimri të kaloj nëpër një luginë të vdekur ku nuk ka barishte dhe bimësi mbi dhé, e kur shiu zbret mbi të çelin bimët; në po këtë trajtë do të jetë çelja dhe dalja e trupave të njerëzve nga dheu në ringjallje.

Kur trupat e njerëzve të çelin nga dheu me rënien e këtij uji nga qielli, ashtu siç tregon lidhur me këtë Allahu i Lartësuar në thënien kuranore ku thotë: "Dhe me të (shiun) i dhamë jetë një vendi të vdekur, kështu do të jetë edhe dalja (ringjallja)".

Jemi në trajtimin e faktit se komponenti i pashpërbëshëm që erdhi nga Ademi -paqja e Allahut qoftë mbi të- do të marrë jetë për shkak të shiut që Allahu i Lartësuar do lëshojë nga qielli Ditën e Ringjalljes, dhe me zhvillimin e tij trupi do kthehet. Me rikthimin e trupit vjen momenti i kthimit të shpirtit në trupin përkatës ashtu që secili shpirt është i mirënjohur për trupin e tij, çdo shpirt e di mirë trupin e tij të cilit i bashkangjitet në ringjalljen e qenies së plotë njerëzore; gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "E kur shpirtërat të çiftëzohen (me trupat përkatës)".

Pas këtij shpjegimi nuk mbetet më asnjë komplikacion rreth si-së të ringjalljes. Atyre të cilëve e trajtojnë çështjen e ringjalljes si çështje problematike dhe i qëndrojnë kësaj edhe pas këtij shpjegimi të detajuar ku udhëzojnë shpjegimet e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe të Kuranit Famëllartë; u themi, Ai që të krijoi herën e parë pasiqë nuk ishe gë prej gjëje do t'a përsërisë krijimin tënd. Ai që herën e parë të krijoi nga asgjëja a nuk ka mundësi t'a përsëris krijimin tënd?! Pikërisht lidhur me këtë personazh kryeneç Allahu i Larëtsuar thotë në Kuranin Famëlart: "Ai na solli një shembull, e ndërkaq e harroi krijimin e vet (të parë); tha: 'Kush i ngjall eshtrat pasi të jenë dekompozuar?' Thuaj: 'I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i Gjithdijshëm për çdo krijim"; Allahu është i Gjithdijshëm për çdo krijim, për më tepër sipas logjikës së thjeshtë njerëzore Allahu i Lartmadhërishëm që të krijoi për herë të parë nga asgjëja, nuk ka dushim se është i Aftë t'a përsëris krijimin tënd për herë të dytë.

Në vijim, pasi përmes ringjalljes të tre komponentët përbërës të njeriut janë rikthyer, ashtu që në fillim me zbritjen e ujit jeta lëvron në komponentin e ardhur nga Ademi -

paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe trupat e gjithsecilit prej njerëzve çelin dhe zhvillohen dhe kthehen në ekzistencë, dhe së fundmi shpirtat rikthehen duke gjetur gjithsecili trupin e tij ku futet të jetojë amshimin.

"I fryhet borisë (së parë të Kijametit) dhe mbesin pandjenja (vdesin) gjithkush është në qiej dhe në tokë, përveç atyre që Allahu do; pastaj i fryhet atij një herë tjetër kur ja ata e shohin veten të ngritur në pritje (të urdhrit të Allahut)".

"Toka ndriçohet me dritën e Zotit të vet, Libri (ku janë shënimet mbi veprat) është vënë pranë dhe sillen pejgamberët edhe dëshmitarët, një gjykim i drejtë bëhet midis tyre, e atyre nuk u bëhet padrejtësi". I lavdishëm është Allahu, Thënësi: "...një gjykim i drejtë bëhet midis tyre, e atyre nuk u bëhet padrejtësi".

"Kjo është Dita e Përgjegjësisë (Logarisë), është dita kur çdokujt i ruhet e pacënueshme ajo që ka bërë dhe nuk u bëhet atyre asnjë padrejtësi".

Është pikërisht Drejtësia e Allahut ajo fal së cilës Allahu për Përgjegjësinë dhe Llogaridhënien dedikoi një ditë pesëdhjetëmijë vjeçare.

"Midis tyre bëhet gjyikimi i drejtë duke mos iu bërë padrejtësi kujt; çdokujt i ruhet e pacënuar ajo çfarë ka bërë e Allahu është më i Dijshmi mbi atë që ata bëjnë".

Pasi njerëzit ringjallen ata do të drejtohen përkah vendtubimi.

Njerëzit komandohen përtek Zoti i tyre që të qëndrojnë për të dhënë llogari para Tij dhe që të përgjegjësohen bazuar në atë që bën në këtë dynja.

Allahu i Urtë nuk na krijoi ne kot në tym, dhe nuk na len që të shkojmë dëm me vdekjen, nuk na la që të shkojmë qorrazi në këtë jetë pa ditur se përse u krijuam, përse vdesim dhe ku do të shkojmë dhe çfarë na pret; porse Ai na dërgoi profetët e sinqertë -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të cilët i përkrahi dhe mbështeti me mrekullitë dhe faktet e qarta që u dha dhe përmes tyre i shpalosi argumentat dhe faktet dhe na orientoi lidhur me gjithësa na duhet deri edhe në çështjet tona më të imta; na i dërgoi këta profetë të cilët përgëzojnë për lumturinë e Xhenetit që Allahu ka përgatitur për robtë e Tij besimtar dhe në krahun tjetër tërheqin vërejtje për kërcënimin me ndëshkim në Zjarrin e Xhehenemit me të cilin Allahu i kërcënon mosbesimtarët.

"Profet përgëzues dhe vërejtjetërheqës, që pas profetëve njerëzit të mos kenë se si të justifikohen tek Allahu".

Asnjë justifikim nuk vlen më, pasi Allahu i dërgoi profetët mbi vërtetësinë e të cilëve Allahu dërgoi argumente dhe fakte të qarta dhe të cilët sqaruan çdo gjë.

Le të përgatitemi për takimin e Zotit tonë i Lavdishëm dhe i Lartmadhërishëm duke iu bindur Atij dhe duke e adhuruar. Vërtetë na prej një llogari dhe përgjegjësi e imtësishme; duke iu ndruajtur Zjarrit të Xhehenemit tabani i të cilit është tepër i thellë dhe nxehtësia e të cilit është e fuqishme; duke medituar mbi faktin sesi Xheneti është stolisur për besimtarët.

E lus Allahun që mua dhe ju të na bëjë nga banorët e Xhenetit dhe të na shmang mua dhe ju nga Zjarri!

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin amshimisht mbi profetin Muhamed, familjen, shokët dhe ndjekësit e tij.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Beteja e Ahzabit (7)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

ALLAHU EKBER [ALLAHU ËSHTË MË I MADHI]

ALLAHU EKBER [ALLAHU ËSHTË MË I MADHI]

ALLAHU EKBER [ALLAHU ËSHTË MË I MADHI]

LA ILAHE ILA ALLAH [NUK KA TË ADHURUAR VEÇ ALLAHUT]

ALLAHU EKBER [ALLAHU ËSHTË MË I MADHI] ...

Kjo është duaja që përsërisin gjenaratat e këtij kombi, anekënd tokës, përgjatë gjithë kohërave, në përgjigje të fjalës së Allahut të Lartësuar: "O ju që keni besuar! Kujtojeni mirësinë e Allahut mbi ju, kur ju erdhën ushtri mbi të cilat dërguam erërat dhe ushtarë që ju nuk i patë...".

Kjo mirësi ishte Beteja e Ahzabit, betejë të cilën Allahu e bëri të mbarojë në dëm të partive, të aleatëve që qenë grumbulluar bashkarisht kundër të Dërguarit të Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- duke synuar asgjësimin e tij në qytetin e Medines ku ai -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- jetonte.

Në një takim që pata një herë me një profesor nga Zvicra, teksa po bisedonim rreth mrekullive të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, i thashë, nëse do kishe qenë i pranishëm do e kishe parë me sytë e tu Profetin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- sesi armiqtë e tij e rrethuan nga të katër anët dhe e izoluan përrreth një muaj me ushtrinë e tyre prej dhjetëmijë luftëtarësh ndërkohë që Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- kishte vetëm tremijë luftëtarë; pastaj arritën të bindin pikën e dobët që nuk ishte fortifikuar nga ana e Profetit, zonën e çifutëve të fisit çifut Benu Kurejdha që kishin bërë një aleancë me Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, por që e tradhëtuan dhe u bashkua me ushtritë armike të aleatëve. Kjo ushtri e ardhur kundër Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- bëri ujdi me çifutët në fjalë që t'ua hapnin rrugën që ata të kishin mundësi t'i sulmonin besimtarët në Medine.

Në këtë natë Allahu i Lartësuar e lajmëroi të Dërguarin e Tij se ndihma do vinte pikërisht në këtë natë.

Çfarë ndodhi atë natë?

Allahu dërgoi ushtarë të Tij dhe erërat që u përmbysnin enët e tyre të ushqimit dhe ujit, u fiknin zjarret që kishin ndezur, u shkulnin çadrat e tyre dhe i flaknin ato tutje. Aq sa nuk arritën të rezistojnë dhe qëndrojnë, pasiqë kishin ardhur nga një distancë shumë e largët dhe e patën mbajtur Medinen të rrethuar për afro një muaj. Këto erëra dhe ushtarë të tjerë të Allahut që syri nuk i shikonte, u bënë shkak që aleatët që kishin ardhur për të asgjësuar Profetin Muahamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe muslimanët, të merrnin arratinë dhe të dështonin në qëllimin e tyre.

Në mëngjes Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- doli të shohë dhe ç'të shihte. Aleatët ishin larguar, kishin dështuar dhe ishin kthyer të përulur.

Me këtë rast Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- tha: "Falenderimi suprem është vetëm për Allahun, e konkretizoi premtimin, e ndihmoi robin e Tij, e fuqizoi ushtarin e Vet dhe aleatët i mundi krejt i Vetëm".

I thashë profesorit në fjalë, kush i sundon erërat aqsa t'i vërë ato kundër armiqve të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-? Kanali, hendeku, ishte një ndarës i pakalueshëm si për besimtarët ashtu edhe për mosbesimtarët, ndërsa erërat ishin të çuditshme sepsa ato i sulmuan mosbesimtarët dhe nuk i ngacmuan besimtarët. Nëse bëhesh dëshmitar i kësaj gjëje a do dyshosh më pas në vërtetësinë e profecisë së Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-?! Tha, nuk do dyshoja. Nëse do isha i pranishëm dhe do e kisha parë këtë nuk do dyshoja në të tillë gjë. Por, tha, a s'e di se midis meje dhe kësaj që ti thua janë mëse 1400 vjetë?!

M'u përgjigj ashtu siç më qe përgjigjur orientalisti rus më parë, të cilin e përmendëm sesi ia sqarova faktin se pasi ngjarja ndodhi dhe lajmi u përhap pati mijëra vetë që e dëgjuan atë çfarë regjistroi Kurani lidhur me atë luftë. Kur e dëgjuan mosbesimtarët atë që Kurani shënoi në të nuk e përgënjeshtruan dhe besimtarët kur e dëgjuan këtë e shtuan besimin e tyre. Profetit të Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- lidhur me atë çfarë ndodhi, i zbriti Libri i Allahut të Lartësuar që lidhur me ngjarjen në fjalë thotë: "Kur ata u erdhën juve edhe prej së larti edhe prej së poshtmi, dhe kur shikimet u shtangën, e zemrat arritën në fyt…" Për shkak të rrahjeve të shpeshta zemrat arritën në gurmaz. "…e zemrat arritën në fyt e ju sajonit mendime të llojllojta për Allahun. Atje, në atë vend qenë sprovuar besimtarët, dhe qenë tronditur me një tronditje vërtetë të fortë". Kjo tronditje u erdhi atyre kur dëgjuan se çifutët e Benu Kurejdhas kishin tradhëtuar dhe kishin rënë dakord t'ia hapnin rrugën ushtrisë armike që i kish rrethuar. "…dhe kur shikimet u shtangën, e zemrat arritën në fyt e ju sajonit mendime të llojllojta për Allahun. Atje, në atë vend qenë sprovuar besimtarët, dhe qenë tronditur me një tronditje vërtetë të fortë. Kur hipokritët dhe ata që në zemrat e tyre kishin sëmundje, thonin: 'Allahu dhe i Dërguari Tij, nuk na premtuan tjetër vetëm se mashtrim!". Kjo korrespondon me atë që ka publikuar Bukhariu, Muslimi, Termidhiu, Ahmedi dhe Darimi, se Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- teksa po hapte kanalin i doli një shkëmb. E goditi atë tre herë dhe me çdo goditje dolën xixa me ç'rast i përgëzoi muslimanët se ai kish parë të hynte Islami në Jemen, pa

territoret e Kisras t'i çliroheshin, pa territoret e Romakëve t'i çliroheshin, gjë e cila e ktheu gjendjen emocionale të muslimanëve nga gjendja e pritjes së armikut të sulmojë në oborr të shtëpisë nga njëri moment në tjetrin, në gjendjen emocionale të çlirimit të territoreve të rëndësishme. Prandaj kur çifutët tradhëtuan, duke ua zbuluar shpinën muslimanëve përballë armikut, situata u ndërlikua së tepërmi dhe dyfytyrëshit vepruan sikurse e përshkruan këtë Kurani: "Dhe kur një grup prej tyre thanë: 'O banorët e Jethribit, nuk ka qëndresë për ju…"; pse po rrini këtu tek kanali. "…nuk ka qëndresë për ju…ndaj kthehuni!' E një grup prej tyre kërkonin lejen e Pejgamberit, duke thënë: 'Shtëpitë tona janë të pambrojtura!' Edhe pse ato nuk ishin të pambrojtura, në realitet ata nuk donin tjetër por vetëm të iknin".

Në një hartë të luftës së Ahzabit jepen koordinatat e ushtrisë armike të gjendur pranë Medines si dhe ilustrohen koordinatat e Medines asokohe, qytetit të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- pasi emigroi nga Meka e në vazhdim. Medinja kishte edhe dy lagje; atë të Uabras dhe atë të Uakim-it, përposht dy maleve vullkanike tepër të thepisura ku asnjeri, e jo më kalorës apo ushtri, nuk mund të kalonte. Ato konsideroheshin dy fortifikata të pakalueshme që e mbronin Medinen që të mos sulmohej nga ana e tyre. Muslimanët hendekun e madh e hapën midis dy masivëve të thepisur malorë. Kanali ishte vërtetë i madh dhe kishte rrethuar jashtazi shtëpitë e muslimanëve nga njëra lagje tek tjetra. Pjesa që mbetej e hapur ishte vetëm ajo e lagjes së çifutëve të Benu Kurejdhas që tradhëtoi dhe ra dakord t'u hapte aleatëve hyrjen në Medine përmes tyre. Në këtë situatë e sipër beteja pushoi.

Si pushoi kështu? Çfarë ndodhi?

Atë natë kur Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u lajmërua se do ndodhte diçka, ai urdhëroi Hudhejfe ibnul Jemenin që të depërtonte tek ushtria armike dhe të sillte informacion nga atje, duke i treguar se këtë mbrëmje atje diçka do u ndodhte aletaëve të tubuar kundër muslimanëve. Hudhejfja arriti të depërtojë deri atje dhe mundi të shikojë me sytë e tij atë që po ndodhte atje. Pa zjarret e tyre të fikeshin, çadrat e fushimit të tyre të shkuleshin, kuajt dhe devetë që iknin me të katra, asgjë nuk ishte në vendin e duhur; dhe në këtë situatë çdo prijës thirri fisin e tij dhe u thoshte mos qëndroni, mos qëndroni; dhe kështu ata u kthyen të humbur dhe të dështuar.

Këtë që ndodhi asokohe Kurani e regjistroi. Të gjithë muslimanët, që e kanë marrë këtë Kuran nga sahabet e ndershëm -Allahu qoftë i kënaqur me të-, janë unifikuar rreth faktit se ky Kuran që ne posedojmë është identik me atë që iu shpall Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, dhe me këtë status është Kurani tek të gjithë kombet islame arabe dhe joarabe. Përfundimisht të gjithë kombet islame janë unifikuar për faktin se ky Kuran që posedojmë është po ai që u ka mbërritur atyre nga shokët e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe në vijim, deri tek të parët e tyre dhe tek këta të fundit. Në këtë Kuran identik me atë që iu zbrit Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- gjendet regjistrimi lidhur me këtë ngjarje.

Nëse Kurani do kish regjstruar dhe cituar diçka që nuk ka ndodhur besimtarët do thonin, si t'a besojmë Kuranin kur ai transmeton në adresën tonë gjëra që nuk kanë ndodhur. Teksa mosbesimtarët do kishin thënë si thotë Kurani se erërat dhe ushtarë që nuk shiheshin u bënë shkak që ne të merrnim arratinë, kur ne nuk ikëm porse qëndruam? Kjo gjë do bëhej shkak që ata t'a përgënjeshtroni atë që thotë Kurani. Porse ne gjejmë se mosbesimtarët nuk bënë asnjë përgënjeshtrim, përkundrazi heshtja e tyre do të thotë "po ashtu ndodhi".

Lind pyetja se kush ishte Ai që e ndihmoi të Dërguarin e Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- duke i dërguar erërat dhe ushtarë e ndihmëtarë që syri nuk mund t'i kapte, kush e regjistroi sa në fjalë në Libër, ua tregoi t'a dëgjojnë të gjithë të pranishmëve dhe e garantoi dhe e ruajti atë për ne deri në ditët tona?! Kush tjetër veç Allahut të Lavdishëm dhe të Lartmadhërishëm.

Sa në fjalë është një nga jashtëzakonshmëritë që bëjnë përjashtim nga zakonshmëritë, është një mrekulli që erërat të luftojnë në dobi të një ushtrie kundër një ushtrie tjetër dhe që të zbresin ushtarë që nuk shihen me sy por që gjurmët e tyre u panë në përzënien dhe bërjen e alencave armike që të marri arratinë dhe të kthehen të dështuar.

Është kjo ajo çfarë ndodhi, dhe që u proklamua edhe nga i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- në mëngjesin e largimit të ushtrive aleate armike, në thënien e tij: "Falenderimi supreme është vetëm për Allahun, e konkretizoi premtimin, e ndihmoi robin e Tij, e fuqizoi ushtarin e Vet dhe aleatët i mundi krejt i Vetëm".

Sa në fjalë është nga ana e Allahut një dëshmi prej dëshmive pro Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- që i thotë, ti o Muhamed je i Dërguari Im dhe Unë do të të ndihmojë me çfarë askush përveç Meje Allahut nuk ka mundësi t'a bëjë, të ndihmojë ty me erërat, me engjëjt dhe ushtarët e ndihmëtarët që syri nuk mund t'i shikojë.

Në fakt jashtëzakonshmëritë dhe mrekullitë që i kanë ndodhur Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- janë vërtetë të shumta. Ato janë regjistruar nga Kurani si dhe nga Hadithet Profetike.

Pas çlirimit të Mekes dhe mundjes së Kurejshve Mekas që u realizua në zbarkimin që Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- bëri në Meke me dhjetëmijë luftëtarë, ushtrisë muslimane iu bashkangjitën dymijë luftëtarë prej mekasve për të arritur kështu numri i luftëtarëve të ushtrisë së Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dymbëdhjetëmijë në rrugë e sipër për të luftuar armiqtë e Islamit në Taif. Një nga muslimanët e rinj teksa pa këtë numër gjigand luftëtarësh tha, nuk mund të na mundin pakica kundërshtare. Profeti Muhamed kur e dëgjoi këtë shprehje shprehu urrejtjen e tij për të, pasi fitorja në fakt është vetëm falë Allahut dhe jo falë potencialit ushtarak. Profeti Muhamed vazhdoi rrugën e tij drejt konfrontimit luftarak me armiqtë e tij që vinin nga Taifi në mesin e të cilëve ishte edhe fisi Hauazin. Armiqtë kishin tubuar

një numër të madh luftëtarësh dhe kishin shkuar më parë dhe zënë pozicion në një luginë të ngushtë të quajtur lugina e Hunejnit. Kur ushtria e muslimanëve hyri në këtë luginë ishte mëngjez në të gdhirë. Hauazinët që ishin harkëtarë mjeshtra i derdhën lum shigjetat mbi kokët e muslimanëve. Kur muslimanët u kundërpërgjigjën fuqishëm armiqtë morën arratinë, duke lënë pas plaçkë lufte, gjë që bëri që muslimanët t'i drejtoheshin plaçkës së luftës duke menduar se beteja kish mbaruar. Por në këtë moment një lum tjetër shigjetash u derdh mbi ta, gjë që e çoroditi së tepërmi ushtrinë muslimanë saqë filluan të reagojnë rrëmujshëm dhe jashtë çdo kontrolli. Në këtë situatë kritike Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u thërriste: Unë jam Robi i Zotit dhe i Dërguari i Tij. Por në këtë çoroditje dhe kaos u zmbrapsën dhe morrën aratinë shumë e shumë prej luftëtarëve të ushtrisë së muslimanëve, madje shumica e saj. Ngeli Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe me të vetëm rreth tetëdhjetë deri njëqind njerëz. Profeti vazhdonte me zë të lartë të thërriste rishtazi: Unë jam Profet, s'është gënjeshtër, unë jam biri i Abdul Mutalibit, pastaj iu drejtua armiqve, mori një grusht dhé dhe ua hodhi atyre në fytyrë duke thënë: "U shëmtofshin këto fytyra". Pas kësaj vetë Hauazinët tregojnë dhe thonë, nuk ngeli pa i hyrë dhé në sy dhe në gojë askujt prej nesh, gjë që na pengoi të luftojmë. Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe ata që qenë më të u sulën kundër armiqve duke pasur në krah gjithashtu ushtarë dhe ndihmëtarë që zbritën nga qielli, engjëj në ndihmë të të Dërguarit të Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Kur ja, kjo ushtri që arriti të mundë ushtrinë prej dymbëdhjetëmijë luftëtarësh muslimanë, pëson disfatë dhe nuk kalon vetëmse një kohë e shkurtër e në duart e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- bien rob rreth gjashtëmijë rob lufte.

Kurani zbret duke regjistruar këtë ngjarje dhe duke u lexuar të dëgjojnë të pranishmëve, të dëgjojnë ushtrisës së muslimanëve, atyre që u zmbrapsën prej tyre, edhe pse Profeti Muhamed urdhëroi xhaxhanë e tij Abasin t'i thërriste muslimanët e çoroditur me emra specifikë që u stimulonin krenarinë, si "O ju që patët qenë prezent në Betimin e Riduanit"; gjë që bëri që muslimanët t'i përgjigjeshin kësaj thirrje dhe grup pas grup t'i ktheheshin sërisht fushëbetejës, aq sa luftëtari të cilit i ishte frikësuar deveja dhe nuk i bindej e linte atë dhe kthehej në këmbë në përgjigje të urdhërit të të Dërguarit të Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-; dhe kështu vazhdoi derisa u riorganizua ushtria e tij në një numër të konsiderueshëm. Më tej për muslimanët erdhi fitorja e madhe.

Allahu i Lartësuar thotë për këtë ngjarje, duke i kujtuar muslimanët rreth saj: "Nuk ka dyshim se Allahu ju ka ndihmuar në shumë beteja, e edhe në ditën e Hunejnit, kur juve ju mahniti numri i madh i juaji, i cili nuk ju vlejti asgjë, dhe me gjerësinë e saj që kishte toka u ngushtua për ju, pastaj ju u zbrapsët (morrët arratinë)". Ajo tokë aq e gjërë ju duk shumë e ngushtë dhe morët arratinë. "...pastaj ju u zbrapsët (morrët arratinë). Pastaj Allahu zbriti qetësinë e Vet tek i Dërguari i Tij dhe tek besimtarët, zbriti një ushtri që ju nuk e patë, i dënoi ata që mohuan, dhe ai ishte ndëshkimi ndaj mosbesimtarëve". ALLAHU EKBER. Në kohën kur ushtria muslimane u çorodit dhe po pësonte disfatë,

Profeti me tetëdhjetë deri njëqind luftëtarë përreth tij bëjnë qëndresë dhe triumfi vjen e engjëjt zbresin, ushtarët e Zotiti tend dhe zbret prehja hyjnore e Allahut mbi të Dërguarin e Tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Gjithë sa Profeti ndihmohet me të a nuk dëshmon se ai është i Dërguar nga ana e Allahut dhe se sa në fjalë është dëshmi hyjnore mbi vërtetësinë e mesazhit dhe profetësisë së tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Sa në fjalë është ajo çfarë Kurani ka regjistruar, ndërkohë që ne folëm për hadithet e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe kushtet e shkencëtarëve të Hadithit kundrejt konfirmimit dhe pranimit të Hadithit të të Dërguarit të Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Në gjeneratën e parë të sahabeve, të pranishmit shihnin dhe flisnin dhe kumtuesi prej tyre kumtonte atë çfarë i kishte ngjarë Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- teksa njerëzit e pranishëm të mbledhur enkas për të dëgjuar e dëgjonin. Asokohe ndjekja e Hadithit qe e fuqishme.

Imam Muslimi transmeton në adresë të Abdullah ibn Rabahit -Allahu qoftë i kënaqur me të- se ai transmetonte në adresë të Katades -Allahu qoftë i kënaqur me të- se ata në një udhëtim që kishin bërë i kishte marrë një etje e madhe për ujë. Kishin sjellë enën e lëkurtë të ujit të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- pasi ai kishte bërë dua. Më tej me këtë enë të vogël nga ku Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- merrte abdes i kishin dhënë të pijnë ujë të gjithë njerëzve të ushtrisë. Ky ujë nga kjo enë e vogël i mjaftoi një ushtrie të tërë. Në mesin e të pranishmëve që po dëgjonin fjalët e Abdullah ibn Rabahit i cili po tregonte historinë ishte Imran ibn Husejni që tha: Kam qenë vetë prezent në këtë udhëtim. I tha: Atëherë ty të takon që t'a thuash atë para meje. I tha: Jo, e ke memorizuar atë që the në formën më të mirë të mundshme.

Pra ndjekja dhe survejimi i përçimit të Hadithit ishte në qendër të vëmendjes së sahabeve -Allahu qoftë i kënaqur me ta- dhe të tebi-inëve (gjeneratës pas sahabeve). Pas kësaj doli në skenë kush guxoi të trillojë në adresë të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- duke shkruar hadithe të rreme, ndaj të cilave bënë rezistencë dijetarët e Hadithit që e standartizuan Shkencën e Hadithit me rregula dhe standarte të përpikta të pamanipulueshme, gjë për të cilën në fakt kemi folur edhe më parë.

Në Hadthet e sakta Pofetike janë transmetuar shumë transmetime rreth jashtëzakonshmërive dhe mrekullive që i kanë ndodhur Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Prej tyre është rasti ku tregohet se i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- kur mbante ligjëratën e së premtes mbështetej në trungun e një palme hurme. Kur bënë për të minberin-podiumin e xhumasë dhe hypi mbi minber, trungu i pemës rënkoi duke nxjerrë një zë si zëri i devesë femër që ka humbur të voglin e saj. Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- zbriti, e mbështolli dhe e qetësoi derisa u qetësua dhe nuk nxori më zë. Këtë e transmeton për ne Muslimi në adresë të Xhabir ibn Samura-së.

Në një tjetër transemtim të gjendur në librat e Hadithit tek autorët Bukhariu dhe Muslimi vjen se Xhabir ibn Abdullahu kishte një deve të avashtë prej së cilës ai ngelte pas të tjerëve, por kur Profeti bëri dua për të dhe e nxiti të ecte ajo u bë më e shpejta ndër devetë.

Gjithashtu siç dihet Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- jetonte në një territor ku ushqimi nuk ishte me bollëk, ndërkohë që atij dhe muslimanëve u duhej të udhëtonin, luftonin dhe dilnin shumë shpesh. Të shumta kanë qenë rastet kur ata janë gjendur në udhëtim apo kanë qenë në Medine dhe ushqimi i tyre ka qenë shumë i pakët. Me këtë rast sahabet i sillnin atë pak ushqim që u kish mbetur dhe pasi Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- e luste Allahun, Allahu i jepte bereqet këtij ushqimi saqë ai bëhej i mjaftueshëm për të gjithë të pranishmit që ishin të shumtë në numër me qindra e ndonjë herë mijëra vetë. Sikurse në Betejën e Tebukut ku numri i luftëtarëve muslimanë ishte tridhjetëmijë vetë, ushqimi i tyre për shkak të marshimit tepër të gjatë ishte drejt mbarimit dhe nuk mund të gjenin ushqim tjetër pasi ata gjendeshin në shkretëtirë. I sollën Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- atë çfarë u kishte ngelur nga ushqimet e tyre dhe Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- e luti Allahun pastaj urdhëroi furnizuesit e ushtrisë të merrnin ushqim nga ushqimi për bereqetin e të cilit ai qe lutur dhe t'ia shpërndanin të gjithë ushtrisë. Ajo që ndodhi ishte që e gjithë ushtria hëngri, i mbushi rezervat ushqimore dhe sërisht ushqimi teproi. Pas kësaj Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- tha: ESH HEDU EN LA ILAHE IL ALLAH UE ESH HEDU EN NI RASULULLAH – Dëshmoj se nuk e meriton të adhurohet askush përveç Allahut dhe dëshmoj se unë jam i Dërguari i Allahut.

Tjetër mrekulli profetike është ajo e qengjit të Xhabirit. Xhabir ibn Abdullahu, në kohën e hapjes së kanalit në pritje të Betejës së Ahzabit, therri qengjin e tij, bëri ushqimin e paktë që mund të bëhet me të dhe e ftoi Profetin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- duke parë gjendjen e urisë që kishte pushtuar Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Me këtë rast Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i thirri të gjithë ata që po punonin për hapjen e hendekut. Hajdeni! Hajdeni! Pastaj bëri dua për bereqet të ushqimit të përgatitur nga familja e Xhabirit dhe mrekullia ndodhi ashtu që ky ushqim u mjaftoi të gjithë personave të hendekut që arrinin një numër prej rreth njëmijë personash, hëngrën që të gjithë nga ky qengj dhe përsëri ushqimi teproi.

Hadithet Profetike janë të mbushura përplotë më ngjarje të kësaj natyre. Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe bashkëkohësit e tij që e shoqëronin jetonin në një territor shkretinor dhe ndodhte që profeti të dilte shpesh në këto territore shkretinore nën shoqërimin e sa e sa njerëzve për të shkuar në vende të ndryshme.

Sërisht librat e Hadithit tregojnë për një tjetër rast kur Pofeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- me ushtrinë e tij gjendeshin në një ekspedite luftarake në

shkretëtirë teksa uji që patën me vete kishte mbaruar për pike dhe gjurmë shiu apo uji nuk shihej gjëkundi. I sjellin Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- atë pak ujë që arritën të mbledhin nga ushtria dhe Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- bën dua për bereqetin e këtij uji dhe e gjithë ushtria pi dhe ngopet me ujë.

Gjithashtu në Tebuk sërisht patën problem etjeje dhe profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u dha atyre një shigjetë që u tha t'a ngulnin tek një pus i tharë aty pari dhe uji buroi prej tij.

Në Paktin e Hudejbies i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- e luti Allahun të bekonte ujin e paktë që ishte në pusin atypari që thuajse po shteronte dhe Allahu ua shtoi atyre ujin pasi Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- bëri dua dhe mori abdes në të, madje pas kësaj uji doli me shumicë në atë pus.

Në një tjetër ekspeditë luftarake të gjatë ku të pranishmit kishin dalë me të Dërguarin e Allahut pllakos një etje e madhe dhe Profeti vjen dhe e lut Allahun e Lavdishëm dhe të Lartmadhërishëm teksa kishte vendosur dorën e tij në një enë që kishte ca ujë dhe nga gishtat e tij të pranishmit panë të rridhte ujë krua, me të cilin e shujatën etjen të gjithë njerëzit e pranishëm.

E gjitha kjo i vjen Porfetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- falë përkrahjes dhe mbështetjes së Allahut të Lartësuar dhe Lartmadhëruar kundrejt të Dërguarit të Tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Mrekulli me qindra e qindra.

Sa e sa njerëz i erdhën atij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe i kërkuan të lutej për ta qoftë për shkak të thatësirës qoftë për ndonjë gjë tjetër. Tek kjo kategori është rasti i personit që i del nga vendi kokërdhoku i syrit dhe ai i vjen Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i kërkon t'i bëj dua dhe pas lutjes së Profetit syri i vrarë i personit në fjalë bëhet më mirë se ai i shëruari.

Rast tjetër kemi rastin e Ali ibn Ebu Talibit -Allahu qoftë i kënaqur me të- të cilin profeti dëshironte t'a nxirrte flamurtar të muslimanëve në betejën çlirimtare të Khajberit por merr vesh se ai lëngonte nga një krizë syri. Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- bëri dua për shërimin e syrit të Aliut -Allahu qoftë i kënaqur me të- dhe aty për aty syri iu shërua. Pas kësaj Aliu -Allahu qoftë i kënaqur me të- mori në dorë flamurin dhe iu sul armiqve.

Rast tjetër kemi atë të njërit prej sahabeve të quajtur Abdullah ibn Atiku, të cilin Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- e urdhëroi të shkonte të eliminonte një armik prej armiqve të Islamit, çifutin Ebu Rafi që dëmtonte nderin e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Abdullahu arriti të depërtonte tek ai dhe t'a vriste por në dalje iu thye këmba. U kthye tek Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut

qoftë mbi të- me këmbën e tij të thyer, e cila pasi Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- bëri dua u shërua sikur të mos qe dëmtuar fare.

Një tjetër rast është ai i Ebu Selemes në Betejën e Khajberit ku iu thye kërciri i këmbës me ç'rast Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- bëri dua për shërimin e tij dhe ai u shërua.

Mrekullitë dhe nderimet me të cilat Allahu e përkrahu dhe mbështeti Profetin e Tij Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, janë vërtetë të shumta. Ato janë të shumta dhe librat e hadithit janë të mbushura me to, dëshmues të kësaj mirësie me të cilën Allahu e përkrahu dhe mbështeti të Dërguarin e Tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Kurani na tregon, Hadithi na tregon, Sijra (Biblografia Profetike) na tregon; teksa ato nuk janë burime informative si ato të historisë së rëndomtë rreth të cilave njerëzit kanë folur lidhur me historitë e kombeve dhe popujve.

Po të shohim sesi e shkruajnë historianët historinë do gjejmë se ato e shkruajnë atë duke u bazuar në transemtime individësh apo kronikash popullore të cilat i shkruajnë pa e vrarë mendjen shumë për autenticitetin apo vërtetësinë e tyre.

Ndërsa Kurani Fisnik e transmeton historinë duke ia treguar atë t'a dëgjojë atij që ka qenë prezent kur historia në fjalë ka ngjarë, si të jetë një takim prezantues ku konfirmojnë praninë e tyre të gjithë ata që marrin pjesë. E dëgjojnë këtë prezantim mosbesimtarët dhe e dëgjojnë besimtarët dhe mosbesimtari as që merr guximin të përgënjeshtrojë diçka nga çfarë Kurani informon për të, teksa besimtarit e tillë gjë ia rrit besimin më shumë, madje disa mosbesimtarë dalin nga rradhët e mosbesimtarëve dhe hyjnë në rradhët e besimtarëve, në Islam. Këto të fundit që u kthyen në rradhët e besimtarëve qenë më pas pjesë e ushtrisë muslimane dhe kur u patë ndodhur të falin namazin duke lexuar thëniet kuranore lidhur me ngjarjet e Luftës së Ahzabit: "O ju që keni besuar, përkujtojeni të mirën e Allahut ndaj jush, kur juve u erdhi një ushtri..." thonin me vete, po, ne ishim ata që shkuam atëherë; "...e Ne kundër tyre lëshuam një furtunë dhe ushtri që ju nuk e shihnit..." thonin me vete po, unë isha pjesë e asja ushtrie, isha në këtë zonë të fushimit ushtarak kur filluan të frynin erërat, u çoroditëm dhe u lemerisëm nga duar të fshehta të ushtarëve të fshehtë që po punonin kundër nesh dhe e pamë veten në arrati në filan vend etj etj. Ata teksa lexoheshin këto thënie të gjalla kuranore e dinin mirë atë që kish ndodhur...

Hadithin e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- duke qenë se çdo fjalë që Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- thotë është fe, Allahu e ngren në gradat e larta të diturisë dhe rrjedhimisht e ngren në gradat e larta të dijetarëve atë që e afron dhe përcjell Hadithin Porfetik tek brezat që nga sahabet e në vijim, teksa gjithkush e dëgjon atë dhe punon me të fiton shpërblim prej Allahut. Besimtari që dëgjon Hadithin Profetik angazhohet të punojë dhe veprojë me të pasi ai është burim i pakontestueshëm i fesë Islame, përmes zbatimit të udhëzimeve të tij hyhet në Xhenet dhe i shpëtohet Zjarrit. Prandaj në çdo moment qoftë edhe në ecje të Profetit -lavdërimi dhe paqja e

Allahut qoftë mbi të- sytë e shokëve të tij, sytë e sahabeve -Allahu qoftë i kënaqur me të- e përcillnin atë në çdo gjë që bënte, vështronin dhe memorizonin veprimet, reagimet, fjalët dhe miratimet e tij, pasi kjo ishte feja që u përcillej me të cilën ata afroheshin tek Allahu i Lartësuar dhe Lartmadhëruar.

Nëse do i bënim vetes tonë pyetjen nëse ka ndonjë personalitet të shquar, të njohur, të qartë, të hapur dhe të zbuluar si Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, përgjigja me siguri do ishte se nuk ka ndonjë personalitet më të shquar, më të njohur, më të qartë, më të hapur dhe më të zbuluar se Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Nëse marrim për shembull liderin më të njohur të kohës sonë dhe pyesim vetet tona se cili është emri i nënës së këtij lideri, babait të tij, cilat ushqime janë ushqimet e tij të preferuara, si u edukua, si u rrit, cilët janë shokët e tij më të afërt, ç'biografi ka etj etj? Do gjejmë se nuk dimë shumë e shumë gjëra për të, madje këto gjëra lidhur me këtë personalitet nuk i dinë as bashkëkombasit e tij dhe personat që i qëndrojnë atij pranë.

Ndërsa biografia e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- është e hapur, e zbuluar, e qartë dhe e ditur që para lindjes së tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, një komb i tërë, kombi musliman, i dinë mirë karakteristikat e tij fizike, morale, vepruese, e dinë biografinë e tij në detaj, emrin e të jatit, emrin e nënës, i dinë gjyshërit e tij, gjeneologjinë e tij, fëmijët e tij dhe biografinë e tyre, çfarë ushqimi i pëlqente, preferencat dhe çfarë urrente; dinë në detaj çdo gjë lidhur me të -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Pse? Sepse ai ishte objekt shikimi nga ku njerëzit merrnin fenë e tyre Islame, bashkëkohësit e tij ishin të angazhuar jo vetëm t'a merrnin për vete këtë dituri të reflektuar nga ai -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, por edhe t'ia përcillnin atë brezave.

Sa më sipër qe shkak që të ruheshin dhe memorizoheshin mirë mrekullitë, jashtëzakonshmëritë, provat, faktet dhe shenjat e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, si pjesë e patjetërsueshme e tërësisë së fesë së Allahut të Lartësuar dhe Lartmadhëruar. Ata që e shikonin Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dëshmonin dhe dëgjonin me kujdes, sytë e tyre ishin si kamerat regjistruese dhe veshët e tyre ishin si regjistruesit zanor; dhe më pas të gjitha këto i shkruajtën dhe memorizuan bazuar në standarte të pamanipulueshme transmetimi të transmetuesve që i përcillnin këto Hadithe Profetike, duke i fiksuar këto jashtëzakonshmëri dhe mrekulli madhështore dhe të shumta profetike të cilat i përmendëm, në përpilimet madhështore që arritën të pacënuara tek ne në ditët tona.

Askush nuk mundet të vijë me të tillë mrekulli të jashtëzakonshme përveç Allahut të Lartmadhëruar, për të qenë të gjitha këto jashtëzakonshmëri që i ka përmendur Kurani, Hadithi dhe Sijra (Biblografia Profetike) dëshmi, vula, argumente dhe prova që vërtetojnë vërtetësinë e profetësisë së Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, vërtetësinë se ai ishte i Dërguari i Allahut. Këto mrekulli shërbyen si baza mbi të cilat besuan në profetësinë e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi

të- njerëzit, madje edhe vetë sahabet -Allahu qoftë i kënaqur me ta-, gjenerata më e dëlirë, që i panë dhe dëshmuan me sytë e tyre këto prova dhe argumente.

Prandaj nëse duam t'a rinovojmë besimin duhet t'i përforcojmë njohuritë tona lidhur me këtë dituri, t'a përhapim atë në mesin e kombit musliman dhe t'a ngjallim në rradhët e muslimanëve; t'i përforcojmë, përhapim dhe ringjallim njohuritë lidhur me mrekullitë e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, faktet dhe argumentet e tij, pasi mësimet e tjera hyjnore të Islamit që angazhojnë muslimanët janë ndërtuar mbi këtë bazë.

E lusim Allahun e Lartmadhërishëm, Zotin e Arshit Madhështor, që t'u japë sukses muslimanëve në rinovimin dhe ringjalljen e besimit të tyre si dhe në përhapjen e këtyre të vërtetave të besimit Islam tek mbarë njerëzia.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Beteja e Bedrit (8)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Muslimanët transmetuan, duke shkruajtur dhe memorizuar në një formë tepër korrekte, rigoroze dhe shkencore, çdo gjë lidhur me jetën e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe mbarë jetën e strategëve të mëtejshëm ndikues muslimanë. U shkruajtën të gjithë librat e prijësve dhe liderëve prej dijetarëve musliman në lëmenj të ndryshëm të shkencave islame. Ne jemi kombi i verifikimit, dokumentimit dhe memorizimit. Askush si ne nuk e ka verifikuar, ruajtur dhe saktëtransmetuar historinë e tij. Memorizuam çdo gjë që na erdhi nga i Dërguari i Allahut Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- mbështetur mbi shkencën e hadithit, ashtu që nëse zinxhirin e transmetimit të thënies në adresë të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- e transmeton një transmetues i besueshëm nisur nga devocioni, përkushtimi, përdëllimi, ndrojtja, mirëafirmimi i tij shkencor dhe intelektual, standarti i tij korrekt memorizues dhe përcjellës, cilësi këto që e kanë karakterizuar atë, vetëm në këtë rast thënia merret për bazë të jetë thënë vërtetë nga i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Lidhur me cilësitë në fjalë të transmetuesit të hadithit dhe hadithet e transmetuara shkencëtarët muslimanë kanë përpiluar sa e sa vepra. Udhëtuan në distanca tepër të largëta në shërbim të një hadithi të vetëm profetik. Kështu udhëtonte dijetari, që të arrinte të konfirmonte qoftë edhe një hadith profetik të vetëm që përkundrejt sillte mirësi pambarim.

Kështu e garantoi Allahu hadithin nëpërmjet shkencëtarëve të hadithit.

E tillë e ndritur dhe e garantuar është historia jonë.

Kështu pra, burimi ynë nga ku na vjen informimi lidhur me mrekullitë e Islamit është Kurani që u ruajt dhe garantua më së miri, gjë të cilën e trajtuam më pare; dhe burimi i dytë është Hadithi i të Dërguarit të Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të cilin e kanë standartizuar dhe garantuar dijetarët muslimanë më së miri.

Tani do bëjmë fjalë për Betejën e Bedrit dhe për çfarë ndodhi në të.

Lidhur me këtë betejë transmetohet se Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- doli me armatën e tij pasi u bëri thirrje shokëve që të konfrontoheshin me Karvanin e Kurejshëve (në të cilin gjendeshin plaçkat që Mekasit u kishin plaçkitur emigrantëve

besimtarë që emigruan nga Mekja në Medine). Për këtë manovër u përgatitën rreth 317 burra të cilët dolën të armatosur me armatimet e tyre normale pasi ata prisnin që të vetmit persona më të cilët do të konfrontoheshin do ishin rojtarët e karvanit. Porse Karvani ra në gjurmë se Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- do konfrontohej me ta. Devijoi në anën e bregdetare dhe dërgoi dikë tek Kurejshët që t'u kërkonin atyre që t'u vinin në ndihmë duke u thënë se Muhamedi kish dalë të konfrontohej me Karvanin e tyre. Kurejshët të nxitur nga sedra e tyre nxorën kundër muslimanëve një ushtri ku vetëm kalorës ishin njëqind, teksa një kalorës konsiderohej potencialisht sa dhjetë ushtarë. Numri i ushtrisë së Kurejshëve arrinte afërisht 1000 persona. U sulën drejt përpara në rrugë e sipër për të shpëtuar Karvanin e tyre. Ndërkohë Karvani kish arritur t'i shpëtonte Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Profetit gjithashtu i vijnë informatat se Kurejshët janë mobilizuar kundër tij. U konsultua me shokët e tij dhe i erdhën prej tyre sugjerime të kënaqëshme. Në ecje e sipër (të bisedimeve) pati persona që flisnin nga përvoja dhe pati të tjerë që flisnin bazuar në atë që mendonin. Ca u shprehën se po qe se çështja kapej logjikisht i binte të mos futeshin në luftë pasi ata kishin dalë vetëm pas Karvanit, të papërgatitur, teksa po të luftonin i binte të konfrontoheshin me krejt Kurejshët të armatosur gjer në dhëmbë. Me këtë mundoheshin të argumentonin se nuk duhej të konfronteheshin me ushtrinë e Kurejshve pasi ata ishin shumë të fuqishëm për t'u përballuar.

Të gjithë këtë Allahu e regjistroi në Librin e Tij, në Kuranin Madhështor. Porse mënyra e regjistrimit që Kurani u bën këtyre ngjarjeve bart përvojë vërtetë madhështore.

Çdo gjë fillon në momentin e fundit të Betejës kur muslimanët arritën të posedojnë një plaçkë vërtetë të madhe lufte dhe gjithashtu kundrejt shpërndarjes së kësaj plaçke lufte kishin opinione të ndryshme. Ata që e shtinë në dorë të parët plaçkën e luftës thanë janë tonat. Ata që iu qepën pasë mosbesimtarëve kurejshas në arrati thanë edhe ne duhet të kemi pjesë sepse edhe ne kemi merita lidhur me këtë plaçkë lufte. Edhe ata që qenë badigardë të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- thanë edhe ne kemi pjesë. Përfundimisht thanë le të pyesim Profetin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Me këtë rast Allahu u zbriti përgjigjen këtyre personave që pyesnin rreth plaçkës së luftës.

Në lidhje me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "Të pyesin ty (o Muhamed) për plaçkën (e fituar në luftë), thuaju: "Plaçka, (mënyra e ndarjes së saj) është çështje e Allahut dhe të Dërguarit, prandaj kini frikë Allahun, përmirësoni gjendjen e unitetit tuaj dhe nëse jeni besimtarë, bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij". Pastaj Kurani fillon dhe u bënë me dije atyre se cilët janë besimtarët e vërtetë dhe më pas fillon t'ju kumtojë çfarë ngjau që nga fillimi i betejës, si të donte t'u thoshte: Tani ju jeni në diversitet rreth ndarjes së plaçkës së luftës. Unë do t'ju kujtojë me ngjarjen. I la pa përgjigje. Përgjigjen ua jep vetëm pas dyzet thëniesh kuranore. Në këto thënie paraprake u kujton atyre në ç'gjendje ishin. U tha: "(Mospajtimi i tyre për plaçkën e luftës është) Ashtu si ai kur të

nxori Zoti yt nga shtëpia jote për të vërtetën, e një grup nga besimtarët nuk ndihej i kënaqur. Bëjnë polemikë me ty për të vërtetën pasi që e kishin të qartë (se ti vepron me lejen e Zotit) sikur të komandoheshin drejt vdekjes së sigurt. Përkujtoni kur Allahu ua premtoi njërin prej dy grupeve se ai është i juaji, e ju dëshironit t'ju takojë ai (grupi) i paarmatosur (Karvani), ndërsa Allahu dëshiroi që me premtimet e Tij ta vendosë të vërtetën e ta zhdukë në themel mbeturinën e mohuesve".

I nderuari ynë Umar ibn Khatabi na tregon sesi Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i tregonte para betejës vendet ku do vriteshin luftëtarë prej Kurejshasve. Imam Ahmedi, Muslimi, Nesaiu dhe të tjerë veç tyre, konfirmojnë që Umar ibn Khatabi të ketë thënë: I Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- na i tregonte vendet ku do vriteshin që një natë më parë duke na thënë: "Këtu është vendvrasja ku ka për t'u vrarë nesër filani in she Allahu dhe këtu është vendvrasja ku ka për t'u vrarë nesër fisterku in she Allahu, e kështu me rradhë". Vijoi Umari duke thënë: Puna shkoi që ata u vranë pikërisht në ato vende. Tha Umari, thashë: Betohem në Atë që të dërgoi ty me të vërtetën nuk u gabuan në ato vende por u vranë pikërisht në to.

Kjo është prej çfarë përgëzoi paraprakisht Profeti i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Ndërkaq Kurani vjen e rregjistron pozicionimin e sahabeve -Allahu qoftë i kënaqur me ta-, dobësi njerëzore që dolën prej tyre, gjë në lidhje me të cilën thotë: "...ju dëshironit t'ju takojë ai (grup) i paarmatosur (Karvani) ndërsa Allahu dëshiroi që me premtimet e Tij ta vendosë të vërtetën e ta zhdukë në themel mbeturinën e mohuesve". Ju nuk deshët atakimin me ushtrinë armike por donit Karvanin. E tani po flisni për plaçkën e luftës.

Pastaj fillon e u kujton atyre atë që ngjau, gjë në lidhje me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Kujtoni kur ju lutët Zotit tuaj t'ju ndihmojë!". Profeti i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- kur morri vesh se Kurejshët janë mobilizuar kundër tij dhe ishin në rrugë e sipër, u strehua tek Allahu duke i kërkuar ndihmë Atij me fjalët: "O Allahu im bëje realitet atë që më premtove. O Allahu im, n'u shkatërroftë ky grup prej muslimanëve kurrë nuk do të ketë adhurimtarë nga të cilët do adhurohesh në tokë". I bie të mos kishte më adhurimtarë që do e adhuronin ndonjëherë Allahun. Kërkonte e kërkonte ndihmë prej Allahut me duart ngritur derisa i ra nga supet rroba e tij dhe Ebu Bekri ia rivendosi robën e tij dhe iu afrua që t'a qetësonte. Lidhur me këtë zbriti fjala e Allahut të Lartësuar: "Përkujtoni kur kërkuat ndihmë prej Zotit tuaj, e Ai u është përgjigjur: "Unë do t'ju ndihmoj me një mijë engjëj që vijnë një pas një (grup pas grupi). Allahu nuk e bëri atë (ndihmën me engjëjt) për tjetër, vetëmse që t'ju gëzojë dhe për t'i prehur me të zemrat tuaja, sepse ndihma në realitet është vetëm prej Allahut. Allahu është Mbizotërues, i Urtë". Me ardhjen e këtyre njëmijë engjëjve u realizua prehja e zemrave të sahabeve gjë që vjen në librat e haditheve që na tregojnë në adresë të sahabeve atë çfarë ngjau në atë betejë me hyrjen në efiçencë të engjëjve ashtu që u vu re forcimi numerik i rreshtave të muslimanve dhe ndihmesa e engjëjve në fushbetejë ku u panë të fluturojnë në ajër sa e sa koka për të cilat komenti i vetëm i pranueshëm ishte se

u prenë nga shpatat e engjëjve. Normalisht faktori i ndihmës së engjëjve ndikoi në ecurinë e betejës në një mënyrë të tillë që në të u zunë shumë robë nga ushtria armike.

Në libra specifikë vijnë sa e sa histori të detajuara lidhur me atë çfarë dëshmuan sahabët me sytë e tyre përsa i përket pranisë së engjëjve në këtë betejë. Prandaj Allahu kur flet rreth kësaj thotë: "Allahu nuk e bëri atë (ndihmën me engjëjt) për tjetër, vetëmse që t'ju gëzojë dhe për t'i prehur me të zemrat tuaja…". Për t'i prehur zemrat kur t'a hetoni këtë ndihmesë që japin engjëjt gjatë betejës duke ju ardhur në ndihmë përmes këtij transformimi dhe potenciali engjëllor.

Në një tjetër situatë lidhur me ngjarjen në fjalë mediuesi që mediton se beteja do të ishte të nesërmen kupton faktin se çdo të thoshte që ushtria muslimane të ishte joeqetë. Një relaksim ishte i domosdoshëm për ushtrinë muslimane një ditë para kësaj beteje vendimtare.

Kurani na bën me dije edhe se disa muslimanë të ndikuar nga arsyetimet njerëzore lidhur me betejën qenë depresionuar. Saqë nuk nguruan të shpreheshin se nuk ishin këtu për të luftuar por vetëm për Karvanin, krejt siç e përjeton këtë moment në Kuran Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm duke thënë: "Bëjnë polemikë me ty për të vërtetën pasiqë u qartësua (se ti vepron me lejen e Zotit) sikur të komandoheshin drejt një vdekje të sigurt". Allahu i nderoi, u dha prej fisnikërive që vetëm Ai di të japë, që atyre kjo frikë t'u eliminohej, i bëri të dremisin, gjë për të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Dhe kur Ai-Allahu bëri që ju t'ju kaplojë dremitja, si siguri për ju nga ana e Tij, dhe kur ju lëshoi shi nga qielli për t'ju pastruar me të dhe për t'i larguar prej jush cytjet e djallit…". Gjëja e parë ishte dremitja që Allahu bëri t'i kaplonte besimtarët në pozicione vërtetë të habitshme ashtu që dikush prej tyre flinte përmbi shpatën a shtizën që e mbante në dorë duke qenë në gadishmëri, ndërsa të tjerët dremitën teksa të nesërmen i priste një ditë vërtetë e përgjakëshme. U zhytën në dremitjen e tyre aq sa u ndjenë shumë të fjetur. Teksa gjumi i ëmbël i kaploi disa prej sahabeve panë ëndërra erotike të cilat u shkaktuan ejakulim dhe kur u zgjuan e panë veten xhunub. Me këtë rast djalli i ngacmoi duke i cytur përbrenda dhe shkaktuar vesvese se si do hynin në luftë duke qenë xhunub? Duke tentuar t'i çorodiste dhe stresonte. Por Allahu i Lartësuar zbriti një shi të dobishëm me të cilin do pastroheshin sahabet në fjalë dhe do eliminohesh shanset që djalli t'i ngacmonte. Në krahun tjetër ky shi qe në dëm të mosbesimtarëve zona e të cilëve u baltos dhe dëmtua, teksa për besimtarët shërbeu që të ngjeshej toka ku ata ishin dhe këmbët të kishin bazament më të fuqishëm në ecje, pasi ata kishin vetëm 70 deve mbi të cilat ndërroheshin në udhëtimin në fjalë çdo tre persona për një deve. Shikojmë teksa Kurani i përkujton ata me këtë duke thënë: "Dhe kur Ai-Allahu bëri që ju t'ju kaplojë dremitja, si siguri për ju nga ana e Tij, dhe kur ju lëshoi shi nga qielli për t'ju pastruar me të dhe për t'i larguar prej jush cytjet e djallit…" Pra shiu zbriti ndër të tjera edhe që të eliminoheshin prej tyre vesveset e djallit që i vinte në dyshim duke u shtirë ndërmend se si do hyni në betejë duke qenë xhunub?

Thënia kuranore vazhdon me dobitë e rënies së shiut ashtu që thotë: "...e (prej dobive të këtij shiu ishte) që të lidhë (forcojë) zemrat tuaja dhe t'ju përforcojë këmbët tuaja". Pra tjetër dobi e shiut ishte që t'i lidhte dhe fuqizonte zemrat.

Por cila është lidhja midis shiut dhe lidhjes së zemrave dhe pse pikërisht përdori fjalën "jerbita-lidh"?

Studimet mbi zemrën dhe strukturën anatomike të saj nxjerrin në pah se muskujt e zemrës janë endje muskulore që i mbështillen zemrës duke e qarkuar për së gjati. Nëse i bën zemrës një përvijim do i gjesh këto endje muskulare të të japin përshtypjen sikur je duke lidhur një fill.

Kur zemra zgjerohet këto endje lirohen dhe kur këto endje muskulore forcohen dhe shtrëngohen ato me formën e tyre duken sikur përbëjnë një lidhje, krejt sikur ke një fill dhe është bërë një lidhje që e lidh zemrën. "...që të lidhë (forcojë) zemrat tuaja...".

Doktorët thonë se tek njeriu në gjendje frike në trup lëshohet lënda hormonale e adrenalinës që shkaktojn shtimin e rrahjeve të zemrës, dhe për shkak të gjithë kësaj vjen edhe dridhja e gjymtyrëve, këmbëve dhe duarve, gjë që bën që këmbët të mos fiksohen mirë gjatë ecjes. Zbritja e shiut që solli ujin që njomi trupin e tyre, që i freskoi ata dhe atmosferën rrotull tyre, u bë shkak për dy gjëra; e para lidhjen e zemrës duke e larguar efektin e hormonit adrenalinë dhe duke bërë që të shtrëngohen endjet muskulore në formë filli të zemrës duke u bërë një si lidhje për zemrën; dhe e dyta "...që t'ju përforcojë këmbët tuaja" qoftë në ecje mbi dheun e ngjeshur ose duke e eleminuar dridhjen e gjymtyrëve që u ndodh disave për shkak të frikës dhe stresimit.

Vërejini këto regjistrime të përpikta të këtyre ngjarjeve dhe ndodhive.

Vetëm pas kësaj Allahu ua solli atyre dispozitën për ndarjen e plaçkës së luftës. Pasi ua tha dispozitën i kujtoi sërisht me një tjetër gjë që ndodhi gjatë betejës, i kujtoi me momentin e betejës kur dy ushtritë qenë përballë njëra-tjetrën.

Qe përcaktimi i Allahut ai i cili bëri që kjo betejë të bëhet realitet dhe për këtë solli disa shtysa të cilat nxitën që edhe besimtarët edhe mosbesimtarët të jepeshin pas luftimit atë ditë. Shtysat e Zotit tonë të Lartmadhëruar dhe të Lartësuar ishin në formë të tillë që Ai i bëri muslimanët të dukeshin pak në sytë e mosbesimtarëve dhe në krahun tjetër i bëri mosbesimtarët të dukeshin pak në sytë e besimtarëve, me qëllim që gjithsecili të tregohej i vendosur për t'u bërë pjesë e kësaj lufte.

Komentuesi i shquar i Kuranit, Ibn Mes'udi -Allahu qoftë i kënaqur me të- thotë: U bënë pak në sytë tanë Ditën e Bedrit saqë unë një personi në krah i thashë, shtatëdhjetë janë ë? Tha, jo, ndoshta janë edhe njëqind, (teksa ata ishin njëmijë). Saqë një person prej tyre e zumë rob dhe e pyetëm sa ishit? Tha, ishim njëmijë. Ishim njëmijë luftëtarë. Kështu bëri Allahu që mosbesimtarët të dukeshin pak në sytë e besimtarëve aq sa Abdullah ibn Mes'udi i kujtoi ata për shtatëdhjetë veta, teksa tjetri i çoi maksimalisht në njëqind veta.

Shiko sesi veproi mrekullia duke bërë të mos dallohet ndryshimi midis 1000 dhe 70-100 personave, teksa diferenca midis këtyre dy numrave ushtarësh është vërtetë shumë e madhe. Pikërisht për sa parathamë vjen dhe bën fjalë Kurani i cili e regjistron ndodhinë në fjalë (të Ibn Mes'udit) dhe u flet dhe dëshmon atyre të dëgjojnë atë që ndodhi, me qëllim që të bëhet fakt kjo mrekulli dhe të prehen me të zemrat e njerëzve deri në Kijamet. Thotë Kurani lidhur me këtë: "Përkujtoni kur u takuat (në sheshin e betejës), e Ai bëri që ata në sytë tuaj të duken pak, e po ashtu edhe ju të dukeni në sytë e tyre pak; e bëri këtë për t'a zbatuar Allahu një çështje që ishte e vendosur". Pra gjithë këtë e bëri që të konkretizohej dhe bëhej realitet një çështje që Allahu e kishte vendosur të bëhej realitet, dhe kjo çështje ishte beteja.

I Lavdishëm është Allahu. Sa në fjalë i takon momenteve përpara se të fillonte beteja. Ndërsa gjatë betejës kur dy frontet u përzinë çfarë ndodhi?

Ajo që ndodhi është se Allahu zbriti engjëjt në përkrahje dhe ndihmë të besimtarëve, gjë që bëri që numri luftarak i tyre të shtohej, dhe bëri që mosbesimtarët t'i shikonin sy për sy muslimanët të dyfishuar në numër.

Këtë gjë Allahu e shpalli në Librin e Tij ku lidhur me këtë thotë: "Ju keni patur argument (nga Allahu) ne betejën ku u atakuan dy grupe; njëri që luftonte në rrugë të Allahut dhe tjetri që ishte mosbesimtarë dhe besimtarët i panë sy për sy në dyfishin (e numrit real) të tyre". Kjo mrekulli e dyfishimit të numrit të luftëtarëve besimtarë në sytë e mosbesimtarëve erdhi tepër e fuqishme, përmëtepër sepse përpara kësaj çdo grupi i ishte dukur tjetri më i pakët numerikisht se numri real.

Madje mosbesimtarët kur panë se besimtarët muslimanë me të nderuarin tonë Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ishin pak, bile duke ua bërë Allahu ata edhe më të pakët nga ç'ishin në realitet, u bindën se fitorja e tyre do të ishte e sigurtë, ndaj krahas fitores materiale për të cilën nuk patën pikë dyshimi deshën të korrnin edhe një fitore shpirtërore, që tentuan t'a realizonin duke e lutur Allahun që t'i japë fitoren grupit të drejtë prej këtyre dy grupeve, ashtu që pasi t'i kishin vrarë muslimanët dhe Muhamedin (gjë e kryer për ta) t'u thonin njerëzve: Ne para betejës e lutëm Allahun që t'i jepte fitoren atij që ishte në rrugën e drejtë prej dy grupeve.

E gjejmë Kuranin t'i kujtoj mosbesimtarët kurejshas lidhur me këtë pozicionim që ata mbajtën, gjë në lidhje me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Nëse kërkoni fitoren (e grupit në të drejtë) fitorja u erdhi". Pra nëse ju kërkuat përmes lutjes suaj që të fitonte grupi në rrugë të drejtë, fitorja që kërkuat erdhi, ju e patë dhe përmes kësaj e morët përgjigjen se cili grup është në të drejtë.

I gjithë ky sqarim dhe rrëfim kuranor bëhet duke ecur me rrjedhën e ngjarjeve të betejës, me atë sesi u konkretizua fitorja; sesi Allahu e zbriti mbështetjen dhe përkrahjen e Tij Hyjnore me engjëjt, me dremitjen, me shiun; gjë që del sërisht në pah në thënien kuranore: "Dhe kur Zoti yt u kumtoi engjëjve se: "Unë jam me ju, pra,

inkurajojini ata që besuan! Unë do të hedh frikë në zemrat e atyre që nuk besuan, goditini në qafë e lartë, goditini në çdo gjymtyrë (mollëz gishtërinjsh)".

Do dëgjojmë në fund tek fjalët e disa sahabeve -Allahu qoftë i kënaqur me ta- që kanë ardhur tek ne lidhur me sa në fjalë, përmes hadithit profetik.

Pas kësaj vjen përgjigja lidhur me pyetjen e tyre me të cilën filloi kaptina kuranore në fjalë "Të pyesin ty për plaçkën e luftës". U kujtoi sesi shkoi puna dhe u kujtoi sesi u bë e mundur fitorja falë së cilës tani ata po diskutonin për plaçkën e luftës, për dispozitën e shpërndarjes së saj. Vetëm pas kësaj vjen dispozita hyjnore lidhur me plaçkën e luftës, lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Ju (besimtarë) t'a dini se një e pesta e asaj që e fituat, prej plaçkës, i takon Allahut, të Dërguarit të Tij, të afërmve të tij (të Dërguarit), jetimëve, nevojtarëve dhe shtegëtarëve të mbetur në rrugë, (ky është përcaktimi i Zotit dhe këtë duhet t'a kryeni) nëse e keni besuar Allahun dhe atë (Kuranin) që ia zbritëm robit Tonë (Muhammedit) Ditën e Furkanit (ditën e Bedrit, kur u dallua e vërteta nga e shtrembëra), ditën e konfrontimit midis dy grupeve...". Allahu thotë duke iu adresuar besimtarëve se nëse e besoni Allahun dhe Kuranin që zbritëm Ditën e Furkanit-Bedrit, që zbritëm në ditën e kësaj beteje vendimtare në të cilën u konfrontuan dy grupet, grupi besimtar me atë jobesimtar; o ju besimtarë në engjëjt që zbritën, o ju besimtarë në dremitjen dhe gjumin që ju kaploi falë mirësisë së Allahut, o ju besimtarë në shiun që ua forcoi këmbët përgjatë ecjes tuaj dhe i lidhi dhe shtrëngoi zemrat tuaja; nëse jeni besimtar në këtë, ja ku e keni dispozitën e plaçkës së luftës, zbatojeni pra këtë dispozitë "...nëse e keni besuar Allahun, dhe atë (Kuranin) që ia zbritëm robit Tonë (Muhammedit) Ditën e Furkanit (ditën e Bedrit, kur u dallua e vërteta nga e shtrembëra), ditën e konfrontimit midis dy grupeve...".

Kështu i regjistroi Kurani në këtë kohë këto ngjarje me të cilat u bëri dobi njerëzve prezentë në to. Nëse ato do ishin të sajuara si do vente halli?

Nëse nuk do kishin ngjarë besimtarët do thonin, ç'është kjo, përmendet një vlerë që nuk ka bërë vaki, përmend engjëjt të cilëve nuk u kemi nuhatur asnjë gjurmë, përmend shi e ne s'dimë gjë për të, përmend të na ketë zbritur një përgjumje në front kur kjo s'i ndodhi askujt prej nesh, përmend se na u dukën pak kur ne s'na ka ngjarë asgjë e tillë?!

E tillë gjë do ishte shkak që ata t'a linin fenë e tyre, t'a linin besimin në Allah. Përkundrazi, cili ishte rezultati? Një ushtri prej njëmijë luftëtarësh mes të cilëve dyqind kalorës, teksa muslimanët ishin pak më shumë se treqind dhe në disa transmetime vjen se kishin vetëm dy kalorës. Fillon lufta dhe në disa orë ajo mbaron me një fitore të bujshme të muslimanëve ku u vranë shtatëdhjetë prej armiqve si dhe u zunë rob shtatëdhjetë të tjerë. Në krahun tjetër prej muslimanëve u vranë jo më shumë se katërmbëdhjetë. Disa transmetime transmetojnë se njëri prej këtyre muslimanëve që vdiqën në Betejën e Bedrit vdiq kur pa engjëjt në pamundësi t'a përballonte këtë emocion, siç thuhet në gjuhën e mjekësisë bashkëkohore nga infarkti. Po ashtu një tjetër

musliman prej katëmbëdhjetëshes që vdiq ishte në prapavijë kur atë e zuri një shigjetë pa adresë. Pra, numri i atyre që vdiqën në fushëbetejë ishte vetëm dymbëdhjetë.

Disa prej atyre që qenë personazhë të kësaj lufte na tregojnë rreth çfarë ngjau. Kemi Enes ibn Malikun -Allahu qoftë i kënaqur me të- që transmeton se e kishte dëgjuar Ebu Talhan -Allahu qoftë i kënaqur me të- të thoshte: "Teksa gjendeshim në llogoret tona Ditën e Bedrit na kaploi dremitja. -dhe Ebu Talha vijon:- Unë isha një prej atyre të cilët i kaploi dremitja atë ditë. Shpata më ra nga dora prej dremitjes. E mora dhe më ra sërisht. Dhe prapë e mora".

I Lavdishëm është Allahu. Dremitja zbriti nga Allahu që t'i relaksonte dhe përforconte besimtarët. Hadithin në fjalë e kanë konfirmuar Imam Bukhariu dhe Imam Ahmedi.

Gjithashtu Imam Ahmedi në "Musnedin" e tij ka konfirmuar në adresë të Ebu Daud el Meziniut që ishte prej atyre që qenë prezantë në Betejën e Bedrit, se ai ka thënë: "Po ndiqja një person prej mosbesimtarëve idhujtarë që t'a godisja. Kur ja, koka e tij ra para së të arrinte tek ai shpata ime. E kuptova se tjetërkush e vrau atë".

Ishin engjëjt pra ata që i godisnin mosbesimtarët në zonën në qafë e sipër të trupit, gjë që e dëshmuam të vijë në Librin e Allahut, Kuranin Famëlartë.

Abasin e zuri rob një prej muslimanëve të vobekët prej medinasve e që ishte shtatshkurtër. E solli tek kryesia e ushtrisë muslimane dhe e dorëzoi duke thënë, ky është rob që e zura unë. Abasi ia ktheu, jo, nuk më zuri ky rob por më zuri rob një person tjetër që qëndronte mbi kalë dhe kishte tjetër paraqitje; me ç'rast Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahu qoftë mbi të- e lajmëroi atë se ai kishte qenë një engjëll që e kish ndihmuar këtë besimtar musliman medinas.

Njerëzit nuk hynë në Islam në tym, nuk besuan në tym, thjesht se Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahu qoftë mbi të- u tha unë jam i Dërguar i Allahut. Porse ata hyne në Islam dhe besuan pasi panë me sytë e tyre argumentet, mrekullitë dhe faktet, panë engjëjt që zbritën, dremitjen që i kaploi në kulmin e stresit të luftës, panë pakësimin numerik në sytë e të pranishmëve që kjo luftë të ndodhte. Të gjitha këto shenja të pranishmit i dëshmuan dhe i panë, dhe ndërkaq kemi Kuranin që regjistron dhe fikson sa në fjalë, në po atë kohë që ndodh, duke ua lexuar besimtarëve t'a dëgjojnë, gjë që u shtoi atyre besimin, prehjen, qëndresën, dhe nga thellësitë e zemrave të tyre dëshminë LA ILAHE IL ALLAH MUHEMEDEN RASULULLAH -lavdërimi dhe paqja e Allahu qoftë mbi të-.

Ne muslimanët i kemi të rezervuara dhe regjistruara këto mrekulli në Regjistruesin më madhështor, në Librin e Allahut, teksa ky Kuran u lexua në mesin e të dy palëve në konflikt, besimtarëve dhe jobesimtarëve, e dëgjuan të dy grupet dhe askush nuk mohoi gjë nga çfarë thoshte dhe regjistronte ky Kuran. Në vijimësi Allahu bëri që ky Kuran të mbetet i garantuar.

Gjthashtu Allahu i Lartësuar garantoi për Hadithin Profetik armata të tëra të dijetarëve kompetentë dhe të zellshëm muslimanë të cilët e standartizuan, testuan, verifikuan, memorizuan dhe ruajtën Hadithin thënie për thënie. Asnjë hadith nuk merret i mirëqënë të jetë thënë nga Profeti përderisa të hetohet zinxhiri i transmetuesve të tij nëse kanë qenë të saktë, ashtu që të krijohet bindja e sigurtë se ai është vërtetë i ardhur nga i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahu qoftë mbi të-.

Kështu prehet muslimani në besimin e tij Islam teksa dëgjon këto mrekulli nga burimi i tyre i konfirmuar dhe i dokumentuar, nga Libri i Allahut dhe Tradita e të Dërguarit të Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahu qoftë mbi të-. Pas gjithë kësaj ai konkludon se vërtetë Muhamedi është i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahu qoftë mbi të-.

Çdo njeri i arsyeshëm duhet që t'i kushtojë vëmendje dhe respekt këtij Regjistruesi Historik, Kuranit, që ka dokumentuar dhe konfirmuar ngjarjet e ndodhura në kohën e tyre dhe ua ka kumtuar t'i dëgjojnë atyre që qenë prezentë në atë kohë. Çdo njeri i arsyeshëm duhet që të besoj plotësisht se qëndrimi konfirmues i këtyre gjeneratave bashkëkohore të mëparshme të Kuranit, paraqet një provë më tepër përkundrejt mrekullive që ai bart.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Bota e Përgjegjësimit – Xhehenemi (9)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Kjo botë është bota e punës, teksa ne dhe të gjithë banorët e tokës, madje të gjithë gjeneratat që vijuan, vdekja i transferon në Botën e Përgjegjësimit dhe Shpërblimit.

Allahu i Lavdishëm dhe i Lartmadhërishëm ka përgatitur një Ditë të tërë me dimensione speciale kohëzgjatje që arrijnë në pesëdhjetëmijë vjet me këto të dynjasë, enkas për çështjen e Përgjegjësimit.

Gjithsesi Bota Tjetër është një realitet ku shqisat tona nuk mund të depërtojnë dhe rruga e vetme për t'u informuar rreth saj është përmes atyre të cilët Allahu i mundësoi të depërtonin në Botën e Fshehtësisë, në Botën e Pashqisueshme, profetëve të Allahut, që janë dritarja jonë përmes së cilës ne mund të marrim informacion rreth kësaj fshehtësie.

Kur të dëgjojmë atë çfarë Allahu Fuqiplotë ka përgatitur për ndëshkimin e mosbesimtarëve në dënimin e Zjarrit të Xhehenemit, ndokush mund të pyes se përse këta njerëz i pret një ndëshkim i tillë?!

Përgjigjja lidhur me këtë është se Allahu i Lavdishëm dhe i Lartmadhërishëm është Sundimtari Absolut, Ai është sundimtari i çdo gjëje, prej më elementares e deri tek ajo më gjigandja; dhe karshi Sundimtarit duhet të tregohet bindshmëri.

Të tillë realitet Allahu i Lartësuar e argumenton qartë në Kuranin Famëlartë ku lidhur me këtë thotë: "Vërejtje! Krijimi është i Tij e edhe urdhërimi"; gjë që nënkupton se përderisa Ai është Krijuesi, Atij dhe vetëm Atij i takon urdhërimi dhe bindshmëria.

Ndërkaq këta njerëz, mbi të cilët vjen pyetja në fjalë, nuk iu bindën Krijuesit të tyre, madje edhe më keq…

Allahu i Larëtsuar thotë: "…E kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, të tillin Ai e fut në Xhenete përposhtë të cilëve rrjedhin lumenj; e kush e kundërshton (Allahun dhe të Dërguarin e Tij), Ai atë e ndëshkon me një dënim të dhembshëm." [48:17]

Le të japim një shembull sqarues për përgjigjen lidhur me sa më sipër:

Nëse një person do t'a mësynte shtëpinë tënde, bahçen tënde apo fabrikën tënde dhe do t'a shkatërronte atë; pasi t'a kishe paralajmëruar dhe t'i kishe tërhequr vërejtje; çfarë do t'i bëje? Do ta leje ashtu?!

Ti o njeri je vepër e Allahut, qenia dhe trupi yt është krijesë e Allahut, dhe po kështu edhe toka, qielli dhe çdo gjë tjetër; teksa mosbesimtari abuzon me veprën e Allahut, e prish, dhe dhunon, duke i përdorur mirësitë që Allahu ia besoi, në kundërshtim me çfarë kënaqet Krijuesi dhe Sundimtari Absolut i çdo gjëje, dhe duke iu kundërvënë të Plotfuqishmit; prandaj i tilli sigurisht që e meriton këtë ndëshkim.

Pastaj nëse mendon lidhur me mirësitë madhështore që Krijuesi na ka dhuruar, natyrshëm konkludon se falenderimi i Dhuruesit me fjalë dhe vepra përkundrejt këtyre mirësive është detyrë; teksa mosbesimtarit as që i bie ndërmend t'a falenderoj Krijuesin, të Cilit i detyrohet për të gjitha dhuntitë që posedon.

Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Ata i njohin të mirat e Allahut, pastaj i injorojnë, e shumica e tyre janë jobesimtarë." [16:83]

Allahu i Lartësuar na dha mekanizma të cilat lehtësisht bëjnë të mundur njohjen e Tij, porse mosbesimtarët nuk denjuan t'i venë në punë këto mekanizme, nuk i vunë në shërbim të njohjes së Allahut dëgjimin, vështrimin, përceptimin, intelektin dhe arsyetimin e tyre. Ky fakt sqarohet nga thënia e Allahut të Lartësuar ku lidhur me këtë thuhet: "...i pajisëm ata me shqisat, të dëgjuarit, të parit e edhe intelektin (të arsyetuarin), porse atyre nuk u bëri dobi asgjë, as të dëgjuarit e tyre, as të parit e tyre e as zemrat (të arsyetuarit) e tyre, e kjo sepse ata abuzivisht i mohonin argumentet e Allahut, andaj ata i pllakosi ndëshkimi si pasojë e përçmimit që treguan." [46:26]

Mosbesimtarët jo vetëm që nuk denjuan t'i përdornin mekanizmat e diturisë për të njohur Krijuesin e tyre, Atë që ua dha atyre çdo mirësi që posedojnë, ndër të cilat edhe mekanizmat e diturisë, pa të cilët s'do ishin këto krijesa superiore që janë; porse aritën deri aty se ata u tallën me atë çfarë u erdhi nga Allahu i Lartmadhërishëm.

Mosbesimtarët e meritojnë ndëshkimin pasi ata argumentin e qartë hyjnor që u arriti përmes profetëve të dërguar prej Allahut nuk denjuan t'a merrnin në considerate; gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Profetë përgëzues dhe vërejtjetërheqës, që pas profetëve njerëzve mos u mbetet tek Allahu asnjë justifikim"; ashtu që Allahu profetët e Tij i mbështeti dhe përkrahu me sa e sa mrekulli dhe fakte të pakontestueshme, sikurse e thotë këtë Allahu i Lartësuar në Kuranin Famëlartë: "I dërguam profetët tanë me fakte të qarta..."; që çështja të qartësohej në mënyrë të pakontestueshme për njerëzit.

Gjithashtu atribut i Allahut të Lartësuar është se Ai është Triumfues dhe Hakmarrës kundër kriminelëve dhe shkelësve të rendit dhe ligjit hyjnor; gjë lidhur me të cilën Ai thotë: "E kush është më i padrejtë se ai që kështillohet me argumentet e Zotit të vet, e pastaj ua kthen shpinën atyre?! Ne me siguri do të hakmerremi kundër kriminelëve (shkelësve të rendit)." [32:22]

Çfarë i bën shteti atij që del kundra rendit dhe ligjit të tij, e për më tepër që i nënçmon mesazhet e tij legjitimuese dhe tallet me to?! E pra Allahu është Sovrani Absolut dhe po kështu Allahu është i Drejti Absolut që refuzon të barazoj midis dhunuesit dhe të dhunuarit, të padrejtit dhe atij të cilit i është bërë padrejtësi; gjë në lidhje me të cilën

Allahu i Lartësuar thotë: “Sot (në Ditën e Gjykimit) askujt nuk i bëhet asnjë padrejtësi dhe nuk shpërbleheni me tjetër vetëm se me atë që vepruat.” [36:54]

Ajo që duhet ditur është se ndëshkimi i Allahut nuk i përngjason ndëshkimit të asnjërit prej njerëzve, e të tillë fakt Allahu e thekson në Kuran ku thotë: “Atë ditë askush nuk mund të dënojë si Ai. Dhe askush si Ai nuk mund të lidhë me pranga.” [89:25-26]; pra ndëshkimi i Allahut vjen përkatësisht drejtësisë, fuqisë dhe madhështisë së Tij.

Para se të hyjmë në përshkrimin e këtij ndëshkimi do donim të ceknim thënien e disa dyshuesve që thonë:

Si mund të jetë i tillë ndëshkim i rreptë dhe i përjetshëm në pafundësi për këta njerëz, sidoqoftë, çfarëdoqoftë dhe sadoqoftë e keqja që ata kanë bërë? A s’duket se kohëzgjatja e këtij ndëshkimi është shumë më tepër nga ajo ç’ka meritojnë këta shkelës të rendit?

Përgjigjja për këta dyshues është t’u themi se:

Këta kriminelë dhe shkelës të rendit e merituan këtë ndëshkim kapital për shkak të mosbesimit, blasfemisë, kundërshtisë së tyre etj, dhe krahas kësaj ata e merituan këtë ndëshkim të përjetshëm sepse ata vdiqën dhe e lanë këtë botë duke qenë brenda tyre të përbetuar përjetësisht mbi këtë armiqësi dhe kundërshti të tyre karshi Krijuesit Sovran, Ligjit dhe Mesazhit Hyjnor të Tij; ashtu që nëse ata do jetonin në këtë botë përjetësisht po përjetësisht do kishin qenë mohues dhe kundërshtarë të Zotit. Dhe ndëshkimi vjen në përputhje me të tillë mosbesim dhe kryeneçësi që ata bartnin në zemrat e tyre.

Ky Zjarr të cilin Allahu e përgatitit për mosbesimtarët gjendet në pusi dhe pritje për viktimat e tij, kriminelët shkelës të rendit dhe ligjit hyjnor, që t’i rrënojë dhe ndëshkojë vrazhdë ata. Allahu i Lartësuar, lidhur me këtë Zjarr që u qëndron në pusi atyre që do të meritojnë të jenë viktimat e tij, na e ka tërhequr vërejtjen duke na thënë: “Dhe ruajuni zjarrit që është përgatitur për pabesimtarët.” [3:131]; dhe thënë: “E Xhehenemi është në pritë (në pusi). Është vendstrehim i arrogantëve.” [78:21-22]

Edhe Zjarrin e Xhehenemit edhe Xhenetin njerëzit e shohin shpejt pasi vdesin, gjë të cilën e konfirmon hadithi i publikuar nga Bukhariu dhe Muslimi përmes Abdullah ibn Umarit që thotë: "Kur dikush nga ju vdes atij i paraqitet vendqëndrimi i tij në mëngjes dhe në mbrëmje. Nëse (ky vend është) tek banorët e Xhenetit ai do të jetë prej banorëve të Xhenetit dhe nëse është tek banorët e Zjarrit (të Xhehenemit) ai do të jetë prej banorëve të Zjarrit. I thuhet: Ky është vendqëndrimi yt derisa të të ringjall Allahu në Ditën e Ringjalljes."

Një pyetje që do trajtojë tema jonë është ajo se: **Ku gjendet Zjarri i Xhehenemit?**

Në fakt në tekstet hyjnore islame nuk gjendet ndonjë tekst i qartë që sqaron ku gjendet vendodhja e Zjarrit të Xhehenemit.

Gjithsesi, falë teksteve hyjnore islame, ne dimë se dielli dhe hëna janë të rrotulluar (vërtiten) në Zjarr të Xhehenemit; gjë kjo e përcjellur në tekstin e hadithit të publikuar nga Bejhakiu, Bazari, Ismailiu dhe Khatabiu, të konfirmuar nga Albaniu në zingjirin e

haditheve të tij të saktësuara, në adresë të Dërguarit të Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se ai ka thënë: "Dielli dhe hëna janë të rrotulluar në Zjarr."; me kuptimin se dielli do të vërtitet dhe do të hidhet në Zjarrin e Xhehenemit, pra ai është një pjesë e Zjarrit që do t'i bashkangjitet atij. Gjithashtu, po në këtë kuadër, Ibnu Merdeuejhi publikon në adresë të Aishes -Allahut qoftë i kënaqur me të- e cila transmeton nga Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se ai ka thënë: "Sixhini është toka e shtatë"; teksa dihet se Sixhini është pjesë e Zjarrit të Xhehenemit, dhe në këtë hadith thuhet se ai-Sixhini është toka e shtatë. Ibn Ebi Hatimi ka publikuar në adresë të Ibn Abasit -Allahut qoftë i kënaqur me të- se ai ka thënë: Sixhini është më e poshtmja e tokave. Dhe Sixhini është vendi ku do burgoset shpirti i mosbesimtarit teksa shpirti i besimtarit bredh në Xhenet sipas dëshirës.

Zjarri i Xhehenemit është gjigantesk dhe egërsisht djegës.

Në "Sahihun" e Muslimit në adresë të Ebu Hurejrës -Allahut qoftë i kënaqur me të- vjen se ai ka thënë: "Ishim me të Dërguarin e Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- e ndërkohë dëgjuam jehonën e rënies së një guri. I Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- tha: "E dini se ç'është?" I thamë: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri." Tha: "Është një gurë që është hedhur në Zjarr (Xhehenem) e ndërkohë ai gremiset në Zjarr që prej 70 vjetësh derisa tani sosi (ra) në tabanin e tij."

Nga çfarë hedh gjithashtu dritë mbi superhapësirën e këtij Zjarri dhe gjigandizmin e tij, është edhe çfarë ka thënë Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- në përshkrimin e engjëjve që do t'a komandojnë Zjarrin në Ditën e Gjykimit, ditë në të cilën siç ka thënë Allahu i Lartësuar: "Atë Ditë vihet me Xhehenemin…" [89:23].

Lidhur me këtë Muslimi publikon se Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- thotë: "Atë Ditë Xhehenemi sillet duke pasur shtatëdhjetëmijë fre, teksa tek çdo fre gjenden shtatëdhjetëmijë engjëj."

Zjarri i Xhehenemit ka dyer. Teksa mosbesimtarët komandohen përkah Xhehenemi, këto dyer, pasiqë ishin të mbyllura, aty për aty do t'u hapen në fytyrë; gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "E ata që nuk besuan sillen grupe-grupe në Xhehenem, e teksa arrijnë tek ai, dyert e tij hapen dhe rojet e tij u thonë atyre: 'A nuk ju patën ardhur të dërguar nga mesi juaj t'ju lexojnë shpalljet e Zotit tuaj dhe t'ju tërheqin vërejtjen për ballafaqimin tuaj në këtë ditë?' Po, (na kanë ardhur...) ata thonë, por fjala (vendimi) mbi dënimin domosdo është bërë realitet kundër jobesimtarëve! U thuhet: 'Hyni nëpër dyert e Xhehenemit, aty do të jeni përgjithmonë, sa vend i keq është ai për kryeneçët!" [39:71-72]; siç erdhi në thënien e mësipërme kuranore, ky Zjarr ruhet nga rojet e tij, engjëj të fuqishëm dhe pamëshirshëm, kundrejt torturimit të të cilëve Allahu i Lartësuar gjithkujt merr këshillë ua tërheq vërejtjen përmes Kuranit Famëlart duke thënë: "O ju që besuat! Ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikqyrin engjëj të rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe që veprojnë atë që janë të urdhëruar." [66:6]

Engjëjt që ruajnë rendin në Xhehenem janë natyrizuar të vrazhdë në një formë të tillë që nuk e njohin mëshirën. Për kriminelët që torturohen në Xhehenem asnjë ndjesi mëshire

nuk gjen strehë në qenien e rreptë dhe të superfuqishme të rojeve të Xhehenemit, të natyrizuar enkas për ndëshkimin e merituar të këtyre shkelësve të rendit e ligjit hyjnor.

Zjarri i Xhehenemit është i shtresëzuar në shtrate gradësh ndëshkimi, të cilët janë të tillë që ndëshkimi shtohet sa më poshtë të zbritet.

Teksa Xhenetit ka gradë në rritje, Zjarri i Xhehenemit ka shtrate në zbritje.

Allahu i Lartësuar hedh dritë rreth këtij fakti në Kuranin Famëlartë ku thotë: "Hipokritët janë në shtratin më të poshtëm të Zjarrit (të Xhehenemit)."; thënie kjo ku bëhet fjalë për njerëzit dyfytyrësh që për arsye të ndryshme shfaqen si besimtarë teksa në zemrat e tyre ata fshehin mosbesimin.

Zjarri i Xhehenemit ka për lëndë djegëse njerëzit dhe gurët, ashtu që ai ushqehet me trupat e banorëve të Xhehenemit dhe me gurë. Në lidhje me këtë fakt Allahu i Lartësuar thotë: "Frikësojuni Zjarrit (të Xhehenemit) lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët, ai është përgatitur për mosbesimtarët."

Nxehtësia e Zjarrit të Xhehenemit është e skajshme. Në lidhje me këtë fakt Allahu i Lartësuar thotë: "Ndërsa, përsa i përket atij që e ka lehtësuar peshojën e veprave të veta, vendi i tij do të jetë në Havije. E ç'të bëri ty të dish se ç'është ai (Havije)? Është Zjarri (i Xhehenemit) me nxehtësi shumë të lartë." [101:8-11]

Gjithashtu në një hadith që Bukhariu dhe Muslimi e publikojnë në adresë të Profetit - lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- vjen: "Ky zjarr i juaji të cilin e ndez biri i Ademit (njeriu) s'është veçse sa 1/70 (një e shtatëdhjeta) e nxehtësisë së Xhehenemit." I thanë: Do të kishte mjaftuar (po të ishte i nxehtë edhe sa zjarri i dynjasë) o i Dërguar i Allahut. (Tha:) "E pra ai (zjarri i Xhehenemit) është superior ndaj atij (të dynjasë) 69 fish, secili prej këtyre (shumëfishëve) është si nxehtësia e tij (e zjarrit të dynjasë)."

Pra zjarri që ne kemi në këtë botë dhe që na duket aq i nxehtë dhe përvëlonjës, në fakt është vetëm një prej shtatëdhjetë njësive të Zjarrit të Xhehenemit.

Ndërsa, uji atje në Zjarrin e Xhehenemit është përvëlonjës, i quajtur Hamijm; atmosfera është e helmatisur, e quajtur Semum dhe është i zhytur në hijesinë e tymit dhe Smogut të Zi pis, të quajtur Jahmum; gjë lidhur me të cilën Allahu thotë: "E të majtit (banorët e Xhehenemit), ç'është puna e të majtëve? Janë në Semum (atmosferë të helmatisur) dhe Hamim (ujë të valuar). Dhe në errësirë nga Jahmimi (Smogu i Zi pis)." [56:41-43]

A s'është çudi që në Zjarrin e Xhehenemit paskërka hije?

Në këtë kontekst përmendim sesi në ditët tona është bërë e mundur të shikohen nga toka përmes qoftë edhe dylbive normale hijëzime dhe zona apo njolla të zeza në diell. Kur këto njolla të zeza u studiuan u gjet se ato janë zona që kanë një nxehtësi më të ulët se ajo e zonave të pjesës tjetër të diellit; ashtu që teksa temperature e zonave të tjera sipërfaqësore të diellit arrin në 6000 gradë, tek këto njolla ajo arrin vetëm në 4000 gradë. Është pikërisht ky diferencim i temperaturës që i bën këto njolla të shfaqen në sytë tanë si njolla të zeza të hijëzuara; thotë Allahu i Lartësuar: "Shkoni te ajo hije që ka

tre degëzime. Që nuk bën as hije, as nuk mbron prej flakës." [77:30-31]; kjo pasi ajo që në dukje shfaqet si hije, në realitet është zjarrmuese, teksa kur shihet të jep përshtypjen se është një zonë e hijezuar.

Zjarri i Xhehenemit zjarrmohet së tepërmi teksa banorët e këtij Zjarri sillen të futen në të; gjë në lidhje me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Dhe kur xhehennemi të jetë ndezur fort." [81:12] Dhe thotë: "Vendi i tyre është Xhehenemi, sa herë që të pushojë flaka Ne ua shtojmë flakën e Zjarrit." [17:97]

Zjarri i Xhehenemit i shkrumbon mosbesimtarët duke shfryrë dhe zjarrmuar me tërbim kundër tyre. Tërbimi dhe egërsia e tij sa s'i shpërthen dhe bën copash trupat e tyre. Pikërisht në lidhje me këtë karakteristikë të egër të Zjarrit të Xhehenemit Allahu i Lartësuar thotë: "Ata që nuk e besuan Zotin e tyre i pret dënimi në Xhehenem; sa vend i keq është ai! Kur të hidhen në të, ata do t'ia dëgjojnë atij ushtimën teksa ai gëlon. Nga zemërimi, ai gati copëtohet. Sa herë që hidhet në të ndonjë turmë, rojet e tij i pyesin: 'A nuk ju pati ardhur ndonjë Profet (t'ju tërheq vërejtjen për këtë që gjetët)?" Ata thonë: 'Po, na erdhi Profeti, por ne e përgënjeshtruam dhe thamë: "Allahu nuk shpalli asgjë, e ju nuk jeni tjetër vetëm se në një humbje të madhe!' Dhe thonë: 'Sikur të kishim dëgjuar dhe pasur mend, ne nuk do të ishim ndër banorët e Zjarrit.' Pra, i pranojnë mëkatet e veta; rrënimi qoftë mbi banorët e Zjarrit Shkrumbonjës." [67:6-11]

Zjarri i Xhehenemit është i përjetshëm dhe mosbesimtarët do të jenë banorët e tij të përjetshëm.

Disa çifutë, në emër të hebraizmit, janë shprehur se Zjarri i Xhehenemit nuk është i përjetshëm dhe se mosbesimtarët nuk do të mbeten përjetësisht në Xhehenem.

Porse Allahu i Lavdishëm dhe i Lartmadhërishëm ka sqaruar se mosbesimtarët do të jenë banorët e përjetshëm dhe përhershëm të Zjarrit të Xhehenemit. Lidhur me këtë thënie të këtyre çifutëve dhe faktit se ajo nuk qëndron, Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Famëlartë: "Ata thanë: "Ne nuk do të na kaplojë Zjarri vetëmse për disa ditë të numëruara.' Thuaj: 'A mos keni marrë prej Allahut ndonjë premtim (lidhur me këtë që po thoni), e Allahu nuk e thyen premtimin e Vet; apo jeni duke thënë për Allahun atë që nuk e dini? Posijo, (zjarri do t'a mbërthejë) atë që bën keq dhe që e pllakosën gabimet e tij; të tillët janë banorë të zjarrit, aty ata janë përgjithmonë." [2:80-81] Dhe thotë: "Ata përpiqen të dalin nga Zjarri (i Xhehenemit), por s'kanë të dalë nga ai; për ta është dënimi i përhershëm." [5:37]; pra i përhershëm dhe i vazhdueshëm i tillë që nuk përfundon dhe nuk eliminohet kurrë.

Banorët e Zjarrit të Xhehenemit janë dy llojesh:

Lloji i parë janë të përhershmit në Zjarr. Këta të përhershëm janë mosbesimtarët për të cilët Allahu i Larëtsuar thotë: "E ata që i mohuan dhe përgënjeshtruan argumentet tona, të tillët janë banorë të Zjarrit (të Xhehenemit), ata do të jenë aty përgjithmonë." [2:39]

Tek këta mosbesimtarë hyjnë edhe idhujtarët të cilët i vunë shok Allahut, ashtu sikurse e shpjegon Allahu i Lartësuar të tillë gjë në Kuran, ku lidhur me këtë thotë: "Nuk është e drejtë e idhujtarëve të kujdesen për xhamitë e Allahut, duke qenë se vetë dëshmojnë për

veten e tyre se janë femohues. Të tillëve u shkuan kot veprat e tyre dhe ata janë përgjithmonë në zjarr." [9:17]

Tek kjo kategori hyjnë edhe hipokritët dhe hipokritet, meshkuj dhe femra, lidhur me të cilët Allahu i Lartësuar thotë: "Hipokritëve e hipokriteve edhe jobesimtarëve, Allahu u ka përcaktuar Zjarrin e Xhehenemit, ku do të jenë përgjithmonë, ai mjafton për ta, dhe ata i ka mallkuar Allahu. Ata kanë dënim të pandërprerë." [9:68]; pra ndëshkim të vashdueshëm dhe të përhershëm. Hipokritët në fjalë janë ata të cilët shfaqin Islamin teksa brenda tyre nuk i besojnë Islamit.

Po cilat janë krimet e këtyre mosbesimtarëve?

Krimi i parë është blasfemia, mosnjohja dhe mohimi i Allahut; kufri-mosbesimi i tyre në Zot, në Qenien e Tij Hyjnore ose Mesazhin dhe mesazhierët e Tij; qoftë ky mohim total ose i pjesshëm; gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "S'ka dyshim se ata që nuk besuan do të thirren (do t'u thuhet në Jetën e Pasosme): 'Hidhërimi i Allahut është më i madh se urrejtja juaj ndaj vetvetes; pse ju u ftuat të besoni (në Dynja) dhe nuk besuat." [40:10]

Krimi i dytë është politeizmi-shokvurja Allahut; gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "…sepse ai që i përshkruan Zotit shok, të tillit Allahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) Xhenetin dhe vendi i tij është Zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmëtar." [5:72]

Krimi i tretë është se ata i kthyen shpinën Kuranit, Fjalës Finale të Zotit, ashtu që ata nuk ia vunë veshin Librit të Allahut të Lartësuar; gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "...Ne të dhamë ty nga ana Jonë Përkujtim (Kuranin); kush i kthen shpinën atij, i tilli do t'a mbajë Ditën e Kijametiti barrën e rëndë (për fajin e rëndë të mosvënies veshin Kuranit, Fjalës së Zotit), nën të do të jetë përgjithmonë; vërtetë barrë e keqe do të jetë ajo në Ditën e Kijametit." [20:99-101]

Krimi i katërt është arroganca dhe kryeneçësia që mosbesimtarët treguan kundër fesë, dijetarëve e pasuesve të saj; gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Hyni në dyert e Xhehenemit ku do jeni përjetësisht. Sa vendbanim i keq është ai për arrogantët kryeneç." [16:29] Dhe thotë: "E ata që i përgënjeshtruan argumentet tona dhe u treguan kryelartë ndaj tyre, të tillët janë banorë të zjarrit, ata do të jenë në të përgjithmonë." [7:36]

Krimi tjetër i madh i mosbesimtarëve është ai i dezertimit nga feja dhe i braktisjes së saj; gjë kryerësi i së cilës meriton ndëshkim të përhershëm në Zjarrin e Xhehenemit, bazuar kjo në fjalën e Allahut të Lartësuar: "...E kush prej jush (muslimanëve) dezerton (zbrapset) nga feja e tij dhe vdes pabesimtar, veprat e të tillëve do të humbin dhe zhduken në këtë jetë dhe në Botën Tjetër. Këta janë banorë të Zjarrit dhe në të do të qëndrojnë përjetësisht." [2:217]

Krim tjetër është ai i atyre që i kundërvihen fesë Islame dhe dispozitave të saj, që kundërshtojnë dhe polemizojnë se përse Allahu ka vënë këtë dispozitë e pse jo atë, sikurse në rastin e ndarjes së trashgimnisë apo gjetkë; të tillë që nuk iu pëlqen gjykimi i Allahut, si të duan të thonë se gjykimi që ata sjellin në kundërshtim me gjykimin e

Allahut është më i mirë, me fjalë të tjera se ata janë më të drejtë në të gjykuar se Allahu; për këta persona që i gjenë t'i bëjnë opozitë Allahut dhe të Dërguarit të Tij në dispozitat dhe ligjet hyjnore të vendosura prej Allahut dhe të përcjella prej të Dërguarit të Tij; për ta Allahu i Lartësëuar thotë në Kuranin Famëlartë: "Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe i shkel dispozitat e Tij, atë e shtie në Zjarr të përjetshëm; për të është një dënim poshtërues." [4:14]

Ndërsa lloji i dytë i banorëve të Zjarrit, të cilët nuk do të jenë përjetësisht në të, janë mëkatarët e mëdhenj prej muslimanëve që nuk i kanë bërë blasfemi dhe mohim Allahut, nuk i kanë vënë shok Atij dhe nuk kanë qenë dyfytyrësh apo hipokrit në atë besim që kanë patur. Këta nuk do të qëndrojnë në Zjarrin e Xhehenemit përjetësisht. Këta mbeten nga ata që besuan në Zot, porse që ranë në mëkate të mëdha.

Lidhur me këta persona Allahu i Lartësuar thotë: "...S'ka dyshim se Allahu nuk falë t'i përshkruhet Atij shok (t'i vihet shok) dhe falë çdo gjë tjetër veç kësaj për atë që do." [4:48] Dhe thotë: "Thuaj: "O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, vërtetë që Allahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është Falës i Madh është Mëshirues!" [39:53]

Këta persona duke qenë se mëkatet e tyre kanë rënduar më shumë se të mirat e tyre, futen në Xhehenem në bazë të krimeve dhe shkeljeve të të tilla përmasave që ata kanë bërë. Prej krimeve që ata bënë është se ata vepruan në kundërshtim me udhëzimet e Allahut dhe të Dërguarit të Tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, duke iu kundërvënë kështu Allahu dhe të Dërguarit të Tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-; gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Thuaj unë nëse i kundërvihem Zotit tim kam frikë ndëshkimin e Ditës Madhështore."

Përsa i përket njeriut që do ndëshkohet më së paku në Xhehenem, nga Muslimi publikohet në adresë të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se ai ka thënë: "Njeriu me dënimin më të lehtë ndër banorët e zjarrit (të Xhehennemit) është dikush që ka (të mbathura në këmbë) dy këpucë prej zjarri dhe dy rrypa (që ja mbajnë këpucët të shtrënguara për këmbësh e që janë) po prej zjarri. Prej (nxehtësisë së) tyre (këtij personi) i vlon truri i tij, ashtu siç vlon tenxhéreja (ena) e gatimit. (Ky person) Nuk mendon të ketë (në Xhehenem) ndonjë që vuan më shumë se ai. E ndërkohë ky është ai që ka dënimin më të lehtë prej tyre (banorëve të Zjarrit të Xhehenemit)."

Që mosbesimtarët t'a vuajnë dhe shijojnë sa më shumë ndëshkimin Allahu u jep atyre trupa gjigandë të cilët i vijnë përshtat këtij ndëshkimi të tyre, aq sa për madhësinë e trupit të mosbesimtarit në Zjarrin e Xhehenemit Muslimi publikon në adresë të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se ai ka thënë: "Distanca në mes dy supeve të mosbesimtarit në Zjarr (në Xhehennem) është sa distanca që përshkon një kalorës i shpejtë përgjatë 3 ditëve"...

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin amshimisht mbi profetin Muhamed, familjen, shokët dhe ndjekësit e tij.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Fitorja e Romakëve (10)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Kemi bërë fjalë për mrekullitë e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- prej të cilave përmendëm sesi ai lajmëroi për të fshehtat e të shkuarës së hershme dhe për fshehtësitë që ndodhnin në kohën e tij.

Prej të fshehtës që ndodhi në kohën e tij dhe Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- e zbuloi në distancë shumë të largët prej vendngjarjes së saj ishte ngjarja e luftëtarëve të Betejës së Mu'etes që dolën në luftë kundër romakëve.

Në transmetimine transmetuar nga Imam Ahmedi vjen se Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- lidhur me zhvillimet e atypëratyshme të luftës së Mu'etes u ka thënë të pranishmëve që ishin me të: "A nuk doni t'ju tregoj për ushtrinë tuaj që po lufton?! -Pastaj siç transmeton Bukhariu, Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- tha:- Tani flamurin e ka marrë në dorë Zejdi (i cili ishte komandanti i ushtrisë muslimane) ja ai ra dëshmor; tani është marrë nga Xhaferi që ra dëshmor gjithashtu; tani është marrë nga Abdullah ibn Raueha që ra dëshmor gjithashtu". Ndërkaq sytë e Profetit të Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- rridhnin lot. Pastaj Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- vijoi: "E ka marrë flamurin tani Khalid ibnul Uelidi duke mos qenë komandant dhe atij do i shkruhet triumfi". Atëherë ai urdhëroi që t'u përgatitej ushqim familjarëve të të rënëve në luftë. Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- tha: "Përgatisni ushqim për familjen e Xhaferit!" Bazuar në këto lajme që përcjell, Profeti ndërton vijueshmërinë e veprimeve, në rastin në fjalë orienton që pas lajmit të vdekjes së Xhaferit të bëjnë ushqim për familjarët e tij. Më pas vijnë lajmet nga fronti vërtetuese të asaj që tha Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Prej depërtueshmërisë që Allahu i mundësonte Profetit të Tij tek e fshehta është sesi atij i zbulohej e vërteta që njerëzit fshihnin në krahërorët e tyre.

Muslimi ka publikuar në adresë të Ebu Hurejrës -Allahu qoftë i kënaqur me të- se ai ka thënë: Ensarët (medinasit) në ditën e çlirimit të Mekes u cytën se Profetin e kishte pushtuar dëshira e simpatia për të afërmit e tij dhe ndjesia e tij për farefisin e vet. Kjo kur ai i fali kurejshët duke thënë kush hynë në shtëpinë e Ebu Sufjanit është i siguruar (nuk do i bëhet keq), kush hynë në shtëpinë e tij është i siguruar, kush strehohet në Qabe është i siguruar; me ç'rast ensarët medinas ndjen në zemra një cytje të tillë. Sakaq shpallja hyjnore zbriti t'i zbulojë Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- atë

çfarë i kishte cytur ensarët në zemrat e tyre. Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u tregoi atyre lidhur me këtë dhe ata pranuan. Me këtë rast Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u tha atyre: "Jeta ime është jeta juaj dhe vdekja ime është vdekja juaj". Pra me ju dhe tek ju do jetoj dhe do vdes. Allahu i zbuloi Profetit të Tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- atë që fshihej në krahëroret e tyre, ua tregoi atyre dhe ata e pranuan këtë fakt. Kush mund të dijë çfarë gjendet në thellësitë e shpirtrave?! Vetëm Allahu është Ai që e di atë që fshehin shpirtrat.

Sot do bëjmë fjalë për një tjetër lajm prej lajmeve të të fshehtës për të cilën Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- lajmëroi përpara se ajo të bëhet realitet. Njerëzit rreth këtij lajmi shfaqën shumë interes dhe morën qëndrime të ndryshme ashtu që u ndanë në dy grupe; grupi i muslimanëve me në krye Ebu Bekër Sidikun dhe grupi i mosbesimtarëve që u tubuan pas Ubej ibn Khalefit.

Bëhet fjalë për konfliktin që kish ngjarë asokohe midis persëve dhe bizantinëve. Në këtë konflikt të armatosur midis tyre persët kishin triumfuar ndaj bizantinëve. Një gjë e tillë i kish gëzuar idhujtarët e Mekes të cilët u thanë muslimanëve se ndiheshin krenar për faktin se idhujtarët persë, që adhuronin zjarrin dhe ishin idhujtarë sikurse idhujtarët e Mekes, kishin triumfuar ndaj bizantinëve që ndjekin një libër dhe fe hyjnore si ju. Kjo gjë i hidhëroi shumë muslimanët. Ebu Bekër Sidiku shkoi dhe i tregoi Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- rreth kësaj. Me këtë rast Allahu zbriti shpalljen e Tij hyjnore: "Elif Lam Mim. Bizantinët u mundën. Në tokën më të ulët. E ata pas mundjes që pësuan do triumfojnë. Kjo ka për të ngjarë brenda pak viteve". Në këtë revelim hyjnor Allahu lajmëron për disfatën e ushtrisë bizantine, që kish ngjarë në luftën e zhvilluar midis tyre në ultësirën më të ulët të zonës. Kjo ishte diçka që tanimë ishte një fakt i kryer. Pas kësaj Allahu bën fjalë për një lajm të ri duke thënë: "E ata (bizantinët) pas mundjes që pësuan do triumfojnë. Kjo ka për të ngjarë brenda pak viteve". Pra Allahu i Lartësuar lajmëron për një fitore të bizantinëve në konfliktin e ardhshëm midis tyre dhe persëve duke e specifikuar periudhën kohore kur kjo do ndodhte me fjalën arabe "bid'a sinin" që presupozon periudhën kohore prej tre deri nëntë vjetësh. Përdorimin e fjalës arabe "bid'a" e gjejmë dhe në thënien profetike ku Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- thotë: "Besimi është shtatëdhjetë e ca segmente". Fjala "ca" vjen nga fjala arbe "bid'a" dhe nënkupton mbi shtatëdhjetë por pa u plotësuar tetëdhjetë, pasi po u plotësua tetëdhjeta, fjala arabe "bid'a" nuk përdoret më me shtatëdhjetën.

Kur ky revelim u zbrit Ebu Bekri kudo shkonte fliste rreth kësaj. Ubej ibn Khalefi kur e dëgjoi i tha: A e vejmë me bast? Që do të thoshte a vendos bast me mua se bizantinët do fitojnë kundër persëve brenda nëntë vjetësh? Asokohe nuk qe i ndaluar dhe lejohej basti ndaj dhe Ebu Bekri vu bast me Ubejin për sa në fjalë. Pas vendosjes së bastit njerëzit u grupuan në varësi të besimit të tyre me Ebu Bekrin dhe Ubejin. Muslimanët iu bashkangjitën Ebu Bekrit dhe idhujtarët mosbesimtarë iu bashkangjitën Ubej ibn Khalefit. Koha kalonte dhe të gjithë prisnin se çfarë do ndodhte lidhur me çfarë kish

lajmëruar ky lajm kuranor. Pa kaluar shtatë vjet ajo që Allahu kish thënë u bë realitet. Allahu i Lartësuar e kish theksuar faktin se kjo gjë do bëhej realitet duke thënë në Kuran: "E ata (bizantinët) pas mundjes që pësuan do triumfojnë. Kjo ka për të ngjarë brenda pak viteve. Çështja është vendim i Allahut, fillim e mbarim (si për disfatë ashtu edhe për fitore). E atë ditë (kur të fitojnë bizantinët) besimtarët do të gëzohen, për ndihmën e Allahut. Ai ndihmon atë që do dhe Ai është i Gjithëfuqishëm, Mëshirues. Ky është premtimi i Allahut, Allahu nuk e thyen premtimin e Vet, porse shumica e njerëzve nuk e dinë këtë".

Pas kësaj një numër shumë i madh njerëzish hynë në Islam dhe thanë Muhamedi është i vetëdijshëm për atë që bëri, ai është vërtetë Profet, pasi nëse nuk do kishte zbulimin hyjnor, ai nuk kishte për të bërë aventurë me profetësinë e tij dhe t'a lente atë peng dhe bast të një shteti që sapo kishte dalë i thyer keqas nga lufta; si dhe duke caktuar edhe kohën e fitores së luftës në një kohë të shkurtër, vetëm tre deri në nëntë vjet, brenda kohës kur ai do qe gjallë dhe prezent; madje duke e vulosur këtë me thënien: "Ky është premtimi i Allahut, Allahu nuk e thyen premtimin e Vet, porse shumica e njerëzve nuk e dinë këtë". Nëse kjo që ai tha nuk do kishte ngjarë brenda kësaj dekade, çdo gjë do kishte mbaruar, feja ku ftonte, pasuesit e tij, profetësia e tij, mesazhi i tij. Por duke qenë se ai ishte mëse i bindur në shpalljen hyjnore që i shpallej, për këtë ai bën këtë theksim dhe përcaktim, e deklaron këtë deklaratë duke e vulosur me "Ky është premtimi i Allahut, Allahu nuk e thyen premtimin e Vet, porse shumica e njerëzve nuk e dinë këtë".

Ngjarja rrodhi ashtu që Persianët erdhën përmes Irakut, vijuan nga ana e Detit të Vdekur dhe lumit Jordan derisa arritën në rrethinat e lumit Jordan, në luginën e atjeshme që është dhe me e ulëta në botë.

Në një takim që kisha me ish-Kreun e Akademisë Gjeologjike Amerikane, profesor Alison Palmer, i thashë, profesor, Kurani na tregon se kjo është ultësira më e ulët në botë, dhe kjo bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar: "Elif Lam Mim. Bizantinët u mundën. Në tokën më të ulët". Korja e tokës ka variacione relievore, të ngritura dhe të ulta. Kurani na tregon se toka në fjalë është më e ulëta në planetin tokë. Ai m'u kthye e më tha, jo, ka edhe ultësira të tjera më të ulëta. Debati midis nesh u thellua dhe kur pa qëndrinim kryeneç që unë po mbaja, iku dhe solli një maket të relievit të tokës ku ilustroheshin të minimizuara të gjtha luginat e tokës. M'a afroi dhe më pyeti, ku është ajo zona për të cilën po më flisje? I thashë në Kuds. Tha ku i bie? I thashë në Jordani, në Oshalim. Vendosi gishtin aty, kur ja, aty gjendej një shigjetë treguese dhe në anën e saj shënimi "toka (ultësira) më e ulët në botë".

I Lavdishëm është Allahu, mrekullia vjen e rinovohet në kohën tonë kur arrihet të zbulohet se ku qëndron sensi i mrekullisë.

Lajmet mbi të fshehtën për të cilën ka lajmëruar Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- janë të shumta.

Prej tyre është ai kur Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u tregoi muslimanëve në Medine se ata do rrotulloheshin rreth Qabes kokërrujatur dhe kokëqethur (pra do vizitonin Qaben). Pas kësaj u nis për në Meke që të bënte Umran teksa ai ishte në gjendje lufte me mosbesimtarët e Mekes. Kur mosbesimtarëve mekas u arriti lajmi u mobilizuan për luftë kundër muslimanëve, por qe ndërhyrja e disa paqedashësve që bëri që përfundimisht midis mosbesimtarëve mekas dhe Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të bëhej një armëpushim me disa kushte prej të cilave ishte edhe kthimi i tyre mbrapsht në Medine pa e kryer Umran këtë vit dhe t'a kryenin atë në vitin tjetër. Muslimanët që kishin veshur ihramin (rrobën e bardhë) si parakusht për të vizituar Qaben, u ngushtuan dhe u mërzitën shumë që nuk arritën që t'a vizitonin Qaben, sidomos sepse ata kishin menduar se vizita e Qabes që Kurani u kishte premtuar do të ishte në këtë vit; saqë Umari -Allahu qoftë i kënaqur me të- bisedoi edhe me Ebu Bekër Sidikun dhe edhe me Profetin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, dhe Profetit i tha: A nuk na premtove o i Dërguar i Allahut se do vizitonim Qaben dhe do bënim tavaf (rrotullim) rreth saj?! Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i tha: "Posi jo, por a të thesh se kjo do bëhet këtë vit?!". Umari u përgjigj, jo. Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- vijoi: "Ti ke për të shkuar dhe ke për të bërë tavaf rreth saj". Thëniet kuranore zbresin dhe bëjnë fjalë për ngjarjen e Hudejbijes. Allahu zbret kaptinën kuranore "Fet'h" ku Allahu i Lartësuar thotë: "Allahu ëndrrën e të Dërguarit të Vet e vërtetoi se është një e vërtetë...". Pra Allahu thekson se ëndrra që i Dërguari i Tij pa është një e vërtetë që do të ndodhë dhe vetë Allahu bëhet garant për konkretizimin e kësaj ëndrre. "Allahu ëndrrën e të Dërguarit të Vet e vërtetoi se është e vërtetë; me vullnetin e Allahut do të hyni në Xhaminë e Shenjtë (në Qabe) të sigurtë, kokërruajtur dhe kokëqethur e duke mos patur frikë! Ai dinte atë që ju nuk e dinit dhe veç kësaj ju ka bërë një fitore të shpejtë". Armëpushimi i Hudejbijes ishte pra një fitore para realizimit të tavafit në Qabe. Ishte kaptina kuranore "El Fet'h-Fitorja" që e shpalli Armëpushimin e Hudejbijes si fitore dhe në fakt ky armëpushim qe vërtetë një fitore madhështore, sepse brenda dy vjetësh pas Armëpushimit të Hudejbijes u shumëfishua numri i muslimanëve. Kur Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- bëri Armëpushimin e Hudejbijes, me të ishin njëmijëekatërqind muslimanë dhe vetëm dy vjet më pas, kur mosbesimtarët mekas e tradhëtuan dhe prishën armëpushimin, numri i muslimanëve që ishin me Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- arriti dhjetëmijë; prandaj ky armëpushim ishte vërtetë një fitore e madhe.

Po kështu, në kaptinën kuranore "Fet'h" Allahu i premtoi të Dërguarit të Tij se do përfitonin një sasi të madhe plaçke lufte, gjë në lidhje me të cilën Allahu i Larëtsuar thotë: "Allahu ju premtoi juve pre (plaçkë lufte) të shumta që do t'i merrni, e këtë (të Hajberit) ua shpejtoi dhe pengoi që duart e njerëzve t'ju dëmtojnë...". Në po këtë kaptinë kuranore Allahu u tregoi se kur ata të niseshin për tek plaçka e luftës, dhe plaçka e luftës të cilën Allahu ua premtoi në thëniet në fjalë është ajo e Betejës së Khajberit, ata që nuk patën marrë pjesë në Armëpushimin e Hudejbijes do vepronin sikurse thotë Kurani për

to: “Kur të shkoni për të mbledhur plaçkën e luftës, ata që ngelën pas (nuk erdhën me ju kur ndodhi Armëpushimi i Hudjebijes) do të thonë: ‘Na lejoni edhe ne të vijmë me ju!’ Ata duan të ndryshojnë vendimin e Allahut! Ti thuaj: ‘Kurrsesi, ju nuk keni për të ardhur me ne, kështu ka thënë Allahu që më parë!’ E ata do t'ju thonë: ‘Jo, por ju na keni zili!’ Po, ata janë persona që kuptojnë pak”. Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, ata që nuk kishin qenë të pranishëm midis muslimanëve kur ndodhi Armëpushimi i Hudejbijes, nuk i lejoi që të ishin pjesë e ushtrisë muslimane që u nis për në Khajber; dhe kjo sepse plaçka e luftës që pritej të merrej nga Beteja e Khajberit ishte premtim vetëm për ata që kishin qenë të pranishëm në Armëpushimin e Hudejbijes. Këtë gjë Allahu e bëri argument për besimtarët, gjë lidhur me të cilën Allahu i Larëtsuar thotë: “Është Ai që i pengoi duart e tyre t’u kanosen ju dhe duart tuaja t’u kanosen atyre, gjë që ndodhi në luginën e Mekes, pasi që u dha fitoren kundër tyre, e Allahu është Mbikqyrës për atë që punoni”. Pra është Allahu i Larëtsuar Ai që e rregulloi punën të ndodhte kështu, Ai u pengoi ju që të vrisnit me duart tuaja mosbesimtarët që takuat aty në luginë, ndërkohë që në krahun tjetër pengoi që ata të vrisnin a kamosnin me duart e tyre dikënd nga ju; gjë që do të shkaktonte luftë dhe përkeqësim të situatës por që në fakt falë ndërhyrjes së Urtësisë Hyjnore u mbyll në fund me armëpushimin që u bë dhe që pas tij erdhi edhe fitorja dhe çlirimi i Mekes, dhe gjithashtu shpejt pas Armëpushimit të Hudjebijes, Allahu i shpërbleu ata me plaçkën e luftës të marrë nga Beteja e Khajberit, sikurse thotë thënia kuranore: “Allahu ju premtoi juve pre (plaçkë lufte) të shumta që do t'i merrni, e këtë (të Hajberit) ua shpejtoi dhe pengoi që duart e njerëzve t’ju dëmtojnë e që sa në fjalë të jetë argument për besimtarët dhe që t'ju drejtojë në rrugën e drejtë”. Argumenti ishte fitorja e Khajberit, argument se Allahu e vërtetoi ëndërrën e të Dërguarit të Tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- “Do të hyni në Xhaminë e Shenjtë”, ashtu që në vitin menjëherë pas armëpushimit Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- me shokët e tij -Allahu qoftë i kënaqur me të-, prej të cilëve edhe Umari -Allahu qoftë i kënaqur me të-, dhe të gjithë muslimanët bënë tavafë të sigurtë dhe jo në gjendje lufte, disa kokërruajtur dhe disa kokëqethur, krejt siç kishte sqaruar dhe premtuar thënia kuranore.

Ishte ky një lajm mbi të fshehtën që shkaktoi zhurmë tek muslimanët aq sa Umari e pyeti Profetin “A nuk na the…?!” dhe Profeti ia ktheu: “Të thashë por nuk thashë se në këtë vit”. Koha kalon dhe premtimi bëhet realitet krejt siç lajmëroi për të Allahu I Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm në Librin e Tij.

E gjitha kjo është regjistruar në Librin e Allahut dhe regjistrimi i kësaj në Librin e Allahut nuk është si regjistrimet që bëhen në librat e historisë, porse është i tillë që të gjithë e dëgjojnë dhe lexojnë atë që Kurani regjistron dhe përmend. E nëse do kishin gjetur diç nga çfarë Kurani regjistronte dhe thoshte, të mos ishte realitet kjo gjë do bëhej okazion i artë që mosbesimtarët t’a përgënjeshtronin Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- si dhe që muslimanët të reagonin ashtu siç reagoi Umari, ose akoma më keq t’a linin dhe braktisnin fenë e tyre -Zoti na ruajtë-.

Do përmendim tani një tjetër lajm prej lajmeve kuranore mbi fshehtësinë.

Allahu e lajmëron të Dërguarin e Tij se Ai do t'a garantojë atë -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- nga e keqja e njerëzve. Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ruhej nga rojet e tij personal, kishte badigardët e tij, dhe kjo sepse komplotistët kundër tij ishin të shumtë, prej të krishterëve, prej hebrenjve, prej idhujtarëve dhe prej hipokritëve. Teksa dihet se tre prej katër khalifëve (udhëheqësve) të parë të muslimanëve, i nderuari ynë Umar ibn Khatabi, i nderuari ynë Uthmani dhe i nderuari ynë Aliu -Allahu qoftë i kënaqur me ta- madje pasi Islami triumfoi, u vranë nga komplotuesit, e për më tepër -siç e thamë më herët- në një kohë kur Islami ishte bërë një forcë triumfatore.

Pra ishte e natyrshme që Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, në periudhat e themelimit të shtetit islam dhe rezistencës ndaj gjithë kundërshtarëve, të kishte rojet personalë që me lejen e Allahut e mbronin nga duart e liga.

Ndërkaq lajmi hyjnor vjen dhe i thotë: O Muhamed, Allahu është garantues për jetën tënde. Kjo vjen në thënien kuranore ku Allahu i Lartësuar thotë: "O ti Profet! Përcille atë që t'u zbrit nga Zoti yt. Po qe se nuk e bën këtë, atëherë ti nuk e ke përçuar mesazhin e Tij. Allahu të mbron ty nga njerëzit". Pra Allahu të mbron dhe garanton ty nga njerëzit që synojnë të të vrasin, mos u ruaj më prej tyre, Unë jap garancinë Time për jetën tënde -thotë Allahu i Lartësuar-.

Ky lajm mbi të fshehtën që priste të verifikohej, kishte për çmim jetën e Profetit.

Në lidhje me këtë Aishja -Allahu qoftë i kënaqur me të- thotë: "Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ruhej (nga rojet e tij personalë). Deri kur zbriti thënia kuranore 'Allahu të mbron ty nga njerëzit', me ç'rast nxorri kokën e tij nga dritarja dhe tha: "O njerëz (roje)! Shkoni. Më ka garantuar se do më mbrojë Allahu". Shkoni, nuk jeni më të nevojshëm, tani m'a ka garantuar jetën Allahu. Jep jetën e tij si çmim që të vërtetohet premtimi i Allahut të Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm. Pas kësaj, komplotet që bënë mosbesimtarët, hipokritët dhe çifutët qenë vërtetë të shumtë. Por Allahu ua zbuloi atyre të gjitha komplotet dhe e mbrojti Profetin e Tij prej gjithë komploteve të tyre; për t'u bërë realitet kështu premtimi i Allahut të Lartësuar dhe të Lartmadhëruar.

Ashtu siç Allahu lajmëroi dhe i bëri të ditura në Kuran këto të fshehta, ashtu rrodhën ato dhe u bënë realitet, dhe disa prej tyre u bënë realitet në kohën e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Ka dhe lajme rreth të fshehtës të zbuluara nga i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- që do ndodhnin pas vdekjes së tij e në vazhdim deri në fundin e botës. Të shumtë janë librat e profilizuar enkas në këto të fshehta të zbuluara nga Kurani dhe Profeti Muhamed. Gjithashtu librat e Hadithit Profetik bartin kapituj më vete me thënie profetike ku Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- flet lidhur me këto zbulesa hyjnore.

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se hadithet profetike zbulojnë për ne të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Kemi për shembull lajmet profetike mbi zgjerimet territoriale islame; shumë hadithe vijnë në këtë kontekst, prej të cilëve përmendim për shembull: "Do çlironi Egjiptin, Persinë, tokën e Çezarit etj etj". Dhe pas gjithë këtij triumfi hadithet profetike zbulojnë se muslimanët do dobësohen dhe feja do kthehet e panjohur (e huaj), sikurse kur filloi që ishte e panjohur. Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, teksa Islami ishte në periudhën e dobësisë, përmend se Islami do triumfojë, do pushtojë botën e do përhapet anekënd tokës dhe pastaj do kthehet e bëhet gjithnjë e më i dobësuar dhe do njoh gjithnjë e më pak frekuentim; gjë që do ndodhë me dobësimin e muslimanëve. Ja ku jemi ne në këtë kohë, në kohën e dobësimit të muslimanëve, në atë periudhë për të cilën ka lajmëruar Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Nga çfarë Kurani lajmëron lidhur me gjendjen në të cilën do ishin muslimanët në të ardhmen e dobësimit të tyre pas fuqizimit, është thënia kuranore ku Allahu i Lartësuar thotë: "Thuaj: 'Ai ka fuqi (t'ju shpëtojë, por edhe) t'ju sjellë dënim prej së larti ose prej së poshti nën këmbët tuaja apo t'ju ndajë në grupe e ta luftoni njëri-tjetrin...". Kur zbriti kjo thënie kuranore Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe muslimanët u frikësuan së tepërmi nisur nga kërcënimi dhe ultimatumi që ajo përmbante. Lidhur me pjesën e thënies kuranore ku Allahu thoshte: "Thuaj: 'Ai ka fuqi (t'ju shpëtojë, por edhe) t'ju sjellë dënim prej së larti…"; Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- tha: "O Allah mbrohem me fytyrën Tënde!" Pra i kërkoi Allahu t'a mbrojë nga ndëshkimi që vjen së larti. Vijon thënia profetike –pastaj lexoi: "…ose (t'ju sjellë dënim) prej së poshti nën këmbët tuaja…"; sërisht Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- tha: "O Allah mbrohem me fytyrën Tënde!" Profeti i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- kërkoi kështu mbrojtjen e Allahut nga ndëshkimi që vjen së larti nga sipër kokave dhe së poshtmi nga poshtë këmbëve. Kur Xhibrili i lexoi pjesën e thënies kuranore që thotë: "…ose (t'ju sjellë dënim ashtu që) t'ju ndajë në grupe e ta luftoni njëri-tjetrin..."; i Dërguari i Allahut tha: "Kjo është më e lehtë". Ky është një transmetim i konfirmuar nga Bukhariu.

E gjejmë Profetin e Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të kërkoj mbrojtjen e Allahut lidhur me zbritjen e ndëshkimit nga sipër ose ardhjen e tij nga poshtë këmbëve. Ky kërkim-mbrojtje profetik me të cilin Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u strehua tek Allahu do t'u bëjë dobi muslimanëve për sa kohë të jenë në rrugën e drejtë. Por pasiqë muslimanët derdhën gjakërat e njëri-tjetrit dhe tejkaluan kufinjtë e Allahut të Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm, pas gjithë kësaj ky ndëshkim do t'ju bjerë të tillëve. Po në këtë kontekst Ahmedi, Tirmidhiu dhe Ibn Ebu Hatimi transmetojnë në adresë të Sead ibn Ebi Uekasit -Allahu qoftë i kënaqur me të- se ai ka thënë: Kur zbriti kjo thënie kuranore sahabet -Allahu qoftë i kënaqur me të- u frikësuan dhe e pyetën të Dërguarin e Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- (kjo qe pasi Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i kërkoi mbrojtje Allahut): O i Dërguar i Allahut: A do ngjajë kjo gjë? Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut

qoftë mbi të- i lajmëroi se ky ndëshkim do bjerë por mbi një popull tjetër që do i kundërvihen Allahut dhe do devijojnë nga Rruga e Allahut. Tekstualisht Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- tha: "Sa për të ndodhur ai (dënimi që përmend thënia kuranore) ka teksa realiteti i komentit të tij nuk ka ardhur ende". Pra ndodhia e tij dhe bërja realitet ende s'ka ardhur por do të jetë mbi muslimanët në të ardhmen. Shumë prej komentuesve asokohe kanë hezituar dhe mbetur pa fjalë se si t'a komentonin ndëshkimin që do vijë nga sipër dhe atë që vjen nga poshtë këmbëve. Disa prej tyre thanë me ndëshkimin përposhtë këmbëve bëhet fjalë për tërmetet; dhe për dënimin përsipër kokave përmendën ato lloje ndëshkimesh dhe fatkeqësish që njiheshin asokohe; përmendën për dënimin përsipër kokave shthurjen dhe prishjen e krerëve përgjegjës të njerëzisë, elitarëve dhe udhëheqësve, kurse për dënimin përposhtë këmbëve përmendëm prishjen e masës së gjerë të muslimanëve.

Porse thënia kuranore në fjalë në fakt bën fjalë për një ndëshkim që vjen direkt përsipër ose përposhtë. Në ditët tona kemi parë sa e sa dëmtime dhe ndëshkime t'u vijnë nga sipër kokave muslimanëve përmes bombardimeve të aviacionit armik; si dhe kemi parë sa e sa ndëshkime dhe dëmtime t'u vijnë nga poshtë këmbëve muslimanvëe përmes minave që fshihen poshtë këmbëve të këmbësorëve.

Është ky një lajm që e anoncon Kurani, teksa shumë detaje dhe imazhe të tij arrijmë që t'i shohim vetëm në ditët tonë.

Siç e kemi përmendur rishtazi, Tradita Profetike gjithashtu është e mbushur me informacion rreth të fshehtave. Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ka lajmëruar lidhur me çfarë do ngjasë nga koha e tij e derisa të mbarojë bota, pra të shkatërrohet universi, madje edhe në vijim, në përjetësi, kur të hyjnë banorët e Xhenetit në Xhenet dhe banorët e Zjarrit në Zjarr.

Hadithet Profetike që trajtojnë zbulimin e këtyre të fshehtave janë vërtetë të shumtë. Prej tyre kemi informacionin e Hadithit të Xhebrailit në momentin kur Xhibrili e pyet të Dërguarin e Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- duke i thënë: Më lajmëro për Kijametin? Profeti iu përgjigj: "I pyeturi për të, nuk di gjë më tepër se pyetësi (pra Profeti i thotë Xhibrilit, asnjëri prej nesh nuk e di kur është Kijameti)". Pastaj Xhibrili i tha: Më trego për shenjat e tij? Profeti iu përgjigj: "Që skllavja të lindë padronen e saj; të shohësh këmbëzbathurit, të rreckosurit, të vobekëtit, barinjtë e deleve të konkurojnë në stërlartësimin e ndërtesave". Në fakt kjo ka qenë gjendja e shteteve arabe dhe islame në fillesat e shekullit XX-të. Gjendja jonë asokohe ishte shumë e dobët, dominonte varfëria e thellë. Njerëzit ishin këmbëzbathur, të rreckosur, të vobekët, kështu ishte masa e gjerë. Pastaj në fundet e këtij shekulli Allahu bëri të mundur të shpërthejnë burimet nëntokësore dhe atë që dje e kishe parë të zbathur, të rreckosur, të vobekët që s'kishte patur bukë për të ngrënë, ai filloi të ngrejë pallate të stërlarta.

I Lavdishëm është Allahu! A mund të imagjinohet që këmbëzbathuri që s'ka këpucë të vesh, i rreckosuri që s'ka rroba të vesh, i vobekti që s'ka bukë të hajë; të ndërtojë një ndërtesë të stërlartë, e lëre më pastaj të konkuroj me konkurentin e tij, unë do e ndërtoj ndërtesën time më të lartë e unë më të lartë?! Kjo është vërtetë gjë e çuditëshme, njerëzit as mund t'a imagjinonin; porse Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- me shpallje nga Allahu i Lartësuar lajmëron rreth një dukurie që do vinte koha dhe do dilte në pah për të qenë prej shenjave të Kijametit, e kjo dukuri do ishte pra që të shihje këmbëzbathurit, të rreckosurit, të vobekëtit, barinjtë e deleve të konkurojnë në stërlartësimin e ndërtesave; mrekulli kjo që nuk mund të imagjonohej se si do ishte përveçse kur u pa e konkretizuar në ditët tona.

Një tjetër gjë për të cilën lajmëroi Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- është thënia e tij: "Dy kategori njerëzish nga kombi im nuk kam për t'i parë, nuk do të hynë në Xhenet dhe as kanë për t'ia ndjerë aromën edhe pse aroma e Xhenetit nuhatet nga kaq e kaq distancë largë. (Kategoria e parë janë) Një popull që mban në duar një kamxhik si bishtat e lopëve me të cilët ata godasin njerëzit". Komentuesit e këtij hadithi thanë se bëhet fjalë për policët e Kohës së Fundit që do godasin padrejtësisht njerëzit. Pastaj Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- përmend kategorinë e dytë duke thënë: "Gra të veshura të zhveshura, të joshura dhe joshëse në të ecur, kokët e tyre janë mu si xhunga anuese e devesë". Për këtë kategori të dytë tha: "të veshura të zhveshura". E si mund të jetë e veshura e zhveshur?! Në fakt e veshura nuk është e zhveshur; porse sot në kohën tonë kemi parë dhe shohim edhe në shumë vende të muslimanëve shumë të tilla, që edhe pse janë të veshura ato janë të zhveshura si rezultat i rrobave të tyre transparente, të shkurtëra ose të ngushta; ose i sheh të veshura në jetën e përditëshme dhe të zhveshura në brigjet e detit apo në disko e dasma. Të veshura të zhveshura pra. Cilësimi i dytë "të joshura dhe joshëse në të ecur"; ashtu që të ecurit tundues në ditët tona është bërë "art" më vete, si topmodelet me takat e larta. Gjithashtu Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- thotë "kokët e tyre janë mu si xhunga anuese e devesë"; dhe xhunga e devesë anon majtas, djathtas por edhe pas; gjë që doli qartë kur pamë gratë të përdornin paruket apo stilin e kapjes së flokëve që i ngjan krejtësisht xhungës anuese të devesë.

Fjalët e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- skicojnë dhe konturojnë fare qartë për sytë tanë atë që do të jetë.

Po nga këto të fshehta është ajo në të cilën Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- na tregon lidhur me Mesihun (Jezusin) -paqja qoftë mbi të- se si ai do vijë. Kjo vjen edhe në Kuran ku lidhur me këtë Allahu i Larëtsuar thotë: "E ai (Mesihu-Isai) është 'ilmun-dituri apo shenjë' për Kijametin". Në një tjetër lexim kuranor vjen: "E ai (Mesihu) është 'alemun- shenjë' për Kijametin". Kthimi i të nderuarit tonë Mesihut -paqja qoftë mbi të- është një shenjë prej shenjave të Kijametit. Sot komunitetet e të tre feve (hebrenjtë, të krishterët dhe muslimanët) presin ardhjen e Mesihut -paqja qoftë mbi të-. Çifutët e presin si mbi prush madje ata punojnë për të ngritur shtetin e

madh çifut që Mesihu të vijë. Ndërsa disa të krishterë janë bashkuar në ndihmë të çifutëve që t'ju ndihmojnë çifutëve të ndërtohet shteti i madh çifut me qëllim që të vijë Mesihu e të gjejë një territor të madh siç i takon. Të krishterët e kanë të shkruar në librat e tyre se Mesihu -paqja qoftë mbi të- do të kthehet. Edhe ne muslimanët e dimë se ai do të kthehet, por problemi midis tre feve është tek fakti se tek cili komunitet fetar do shkojë ai. Kështu çifutët thonë se ai do të kthehet tek ata sepse ai është çifut prej bijëve të Izraelit. Muslimanët thonë, jemi ne ata që besuam tek ai dhe e besuam vërtetësinë e qenies së tij i Dërguar i Zotit, prandaj ai do të kthehet tek ne dhe s'ka sesi të kthehet tek ata që e përgënjeshtruan kur erdhi herën e parë.

Ky është një tjetër lajm prej lajmeve të revelatës islame mbi të fshetën, e gjithë bota pret për të; dhe padyshim çfarë do ndodh është ajo çfarë ka reveluar revelata hyjnore islame përmes Kuranit dhe Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, që na ka treguar çdo gjë lidhur me ardhjen e Mesihut -paqja qoftë mbi të- dhe vazhdimësinë e çështjes së tij deri në ndodhinë e Kijametit, madje edhe më tej, kur të hyjnë banorët e Xhenetit në Xhenet dhe banorët e Zjarrit në Zjarr.

A s'është kjo një mrekulli që lajmëron për të fshehtën, një mrekulli e freskuar dhe rezistuese prej mrekullive të nderuarit tonë Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-?! Dhe realiteti do të vijë, si në të gjitha rastet e tjera, dëshmitar dhe vërtetues në anën e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Jashtëzakonshmëritë (11)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Kemi folur rreth argumenteve, provave dhe mrekullive me të cilat Allahu i Lartësuar e përkrahu dhe mbështeti Profetin e Tij, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Kemi folur në të kaluarën lidhur me elokuencën e Kuranit që i sfidoi dhe ende i sfidon arabët dhe mbarë njerëzimin, madje edhe xhindët, që të sjellin qoftë edhe një kaptinë, madje qoftë edhe një thënie të vetme sikurse ato të këtij Kurani, por të gjithë dështuan t'a bëjnë një gjë të tillë. Biseduam gjithashtu rreth mrekullisë shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike, duke servirur shumë raste rreth kësaj shkence.

Sot do të bëjmë fjalë për diçka tjetër me të cilën Allahu e ka përkrahur dhe mbështetur të Dërguarin e Tij dhe që ishte nga shkaqet më të rëndësishme të islamizimit të shumë prej shokëve të Profetit të cilët i dëshmuan këto prova të qarta dhe mrekulli.

Bëhet fjalë për atë që e quajmë "Jashtëzakonshmëritë".

Çfarë nënkuptojmë me Jashtëzakonshmëri?

Është bërë i zakonshëm për ne fakti se çdo gjë që të ndodhë duhet të funksionojë në përputhje me ligjet dhe shkaqet që Allahu ka bërë të rrjedhin lidhur me atë gjë.

Por që argumenti hyjnor të shpaloset dhe që mrekullitë e profetit që Allahu dërgon të dalin në pah, mu për këtë shkak Allahu i thyen këto zakonshmëri.

Për shembull zjarri që në gjendje të zakonshme është bërë nga Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm që të djegë, u bë i freskët dhe paqësor për Ibrahimin kur Allahu e urdhëroi: "O Zjarr, bëhu i freskët dhe paqësor për Ibrahimin". Edhe pse zjarri djeg, ai nuk e dogji të nderuarin tonë Ibrahimin, dhe është pikërsht kjo Jashtëzakonshmëri që e bëri zjarrin në rastin e Ibrahimit të jetë një mrekulli. Po kështu shkopi në origjinë është një copë druri, send i ngurtë, porse Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm bëri që kur ai hidhej nga dora e të nderuarit tonë Musait bëhej gjarpër që zvarritej. E kështu mund t'i përmendim me rradhë shembujt e tjerë të mrekullive hyjnore me të cilat Allahu i pajisi mesazhpërcjellësit e Tij.

Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, Allahu e mbështeti dhe përkrahu me shumë mrekulli dhe jashtëzakonshmëri.

Por dikush mund të vijë e të thotë: Jashtëzakonshmëritë dhe mrekullitë që i kanë ndodhur Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- kufizojnë vetëm ata

persona që i kanë parë dhe dëshmuar ato, ndërsa e tillë gjë nuk mund të thuhet për ne, pasi ne nuk i kemi parë ato. Midis nesh dhe atyre ka kaluar një kohë vërtetë e gjatë. Si të sigurohemi se ato kanë ndodhur kur me to na ndajnë mbi 1400 vjet?

U përgjigjemi, është një diferencë e madhe midis asaj që njerëzit kanë shkruar në histori dhe çfarë është regjistruar në Kuran rreth asaj që ka ngjarë nga duart e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- në kohën e tij. Në fakt Kurani është regjistri më i mirë lidhur me ngjarjet që kanë ndodhur në kohën e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe jashtëzakonshmëritë e mrekullitë që atij i ndodhën.

Dikush mund të thotë: Regjistrimet brenda Kuranit janë obligative vetëm për besimtarët. Them, jo, ato përfshijnë edhe mosbesimtarët, gjë që del në pah qartazi për ta nëse ata e përdorin siç duhet arsyen dhe logjikën e tyre.

Është zhvilluar një debat midis meje dhe një orientalisti rus rreth çështjes në fjalë. Më tha, si do më vërtetosh se jashtëzakonshmëritë dhe mrekullitë që ju pretendoni në adresë të Muhamedit kanë ndedhur në realitet?

Debati midis nesh po zhvillohej rreth jashtëzakonshmërisë së çarjes së hënës që i ndodhi profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Ndarja më dysh e hënës ndodhi pikërisht në kohën e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Rrethanat e kësaj ngjarje ishin të lidhura me kërkesën që anëtarët e fisit të Kurejshëve të Mekes i patën bërë Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- që t'u shfaqte atyre ndonjë shenjë apo argument të Allahut. Argumenti që Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm zgjodhi t'u shfaqte atyre ishte ndarja më dysh e hënës dhe në fakt njerëzit e dëshmuan me sytë e tyre hënën të ndarë mëdysh.

Mosbesimtarët kurejshas u mahnitën nga hëna e ndarë mëdysh që panë; por siç është çështja e mosbesimatrëve nxituan të thonin, Ebu Kebshe (duke synuar Profetin) na ka bërë magji. Disa prej tyre thanë: I ka bërë magji hënës. Më tej thanë, nëse ai ka arritur të na bëjë magji ne, ai nuk ka mundësi t'u bëjë magji udhëtarëve që e kanë parë hënën. T'i presim udhëtarët të vinë dhe t'i pyesim. Kur udhëtarët erdhën nga të katër anët, kurejshitët i pyetën, a e patë ndarjen e hënës? Ata thanë po, e pamë ndarjen e hënës. Me këtë rast kurejshitët mosbesimtarë dolën sërisht në derën e tyre dhe thanë, Muhamedi ka bërë një magji gjithëpërfshirëse.

Sigurisht jo të gjithë reaguan në këtë formë. Realiteti është që pati disa që u ndikuan pozitivisht në shpirt nga kjo mrekulli e pashoq dhe hynë në Islam. Përsa i përket besimtarëve, atyre kjo gjë ua rriti besimin.

Orientalisti në fjalë më tha, unë nuk kam parë ndonjë hënë të jetë ndarë mëdysh. Po t'a kisha parë do e kisha mësuar se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.

I thashë, përqëndrohu dhe arsyeto lidhur me sa do të them dhe do të jesh në pozitën e atyre që kanë qenë asokohe dhe që e panë argumentin mrekulli. Tha, e si bëhet kjo?

I thashë, ndarja mëdysh e hënës ka ndodhur në kohën e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Gjendeshin asokohe dy grupe të kundërt, rival dhe të irituar me njëri-tjetrin. Secili prej tyre i gjuante rastin tjetrit. Grupi besimtar synonin që t'a thërrisnin grupin e mosbesimtarëve tek e mira duke synuar që ata të udhëzoheshin në rrugën e drejtë, ndërsa grupi mosbesimtar donin që t'a përgënjeshtronin, izolonin dhe mposhtnin grupin e besimtarëve. Në këtë situatë e sipër ndodh dhe ngjarja e ndarjes mëdysh të hënës. Mosbesimtarët kurejshas ishin totalisht të angazhuar që të gjenin një gjë sado të vogël për të përgënjeshtruar të Dërguarin e Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Pasi ndodhi kjo ngjarje zbriti Kurani që u përcillte lexuesve me përpikmëri atë që kish ndodhur dhe regjistronte pozicionimet e tyre në këtë ngjarje. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "Momenti (i Kijametit) është afruar, e hëna është çarë (më dysh). Porse ata (mosbesimtarët idhujtarë mekas) edhe nëse shohin ndonjë argument (mrekulli) zbrapsen e thonë: "Kjo është magji e vazhdueshme (gjithpërfshirëse)!" Regjistrimet kuranore mbi mosbesimtarët kurejshas lidhur me pozicionimin e tyre në këtë ngjarje vijnë dhe thonë se ata: "U bënë përgënjeshtrues dhe ndoqën dëshirat e veta (bënë sipas kokës së tyre), por çdo çështje e ka një cak". Kurani thotë se qenë pasionet e tyre që ata ndoqën që i bënë ata që edhe pasi panë argumentin e jashtëzakonshëm në fjalë të shpifin duke thënë se kjo ngjarje s'ishte veçse një magji.

Nëse Kurani do regjistronte një gjë që nuk kishte ngjarë, pra nëse hëna nuk do ishte ndarë mëdysh, ky do kishte qenë shans i artë për mosbesimtarët kurejshas që të thonin: Muhamedi pretendon se hëna është ndarë mëdysh dhe se ne e kemi parë këtë gjë dhe kemi thënë se është magji, por asnjë gjë nga këto që ai thotë nuk ka ngjarë, as hëna është ndarë mëdysh, as e kemi parë atë të ndahet mëdysh, dhe as kemi thënë se është magji. Ja ku e keni Muhamedin që po thotë për ne gënjeshtra.

Kjo gjë do të ishte një shans i florinjtë që ata t'a përgënjeshtronin Profetin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Teksa në këtë kontekst edhe muslimanët do ishin sprovuar së tepërmi, madje shumëkush prej tyre do e linte fenë. Po të ishte fallso ndarja e hënës vetë besimtarët do thonin, si po e thotë këtë gjë të pavërtetë, hëna nuk është ndarë mëdysh; si pretendon se e kanë parë mosbesimtarët kur ata nuk kanë parë gjë; si pretendon se ata thanë kështu e ashtu kur e panë, ndërkohë që ata nuk e kanë parë ndarjen mëdysh të hënës e jo më të kenë thënë gjë për të?! Gjë që do ishte shkak që ata t'a linin fenë.

Por çfarë ndodhi në fakt?

Ajo që ndodhi është se muslimanët u përforcuan, rritën besimin dhe u bënë më të qëndrueshëm në fenë e tyre, teksa pati shumë që lanë rradhët e mosbesimtarëve dhe u bënë besimtarë, për t'u bërë në të ardhmen ajka e muslimanëve.

Kështu pra, qëndrueshmëria e besimtarëve në fenë e tyre, është në këtë rast një vulë konfirmimi që konfirmon faktin se ngjarja e ndarjes së hënës mëdysh për të cilën Kurani lajmëroi ishte një e vërtetë që ata e kishin dëshmuar me sytë e tyre. Po kështu kthimi

me këtë rast i shumë personave prej mosbesimtarëve nga mosbesimi në Islam, ishte një vulë konfirmimi nga ana e tyre se ajo çfarë Kurani përmendte lidhur me ngjarjen si dhe ajo çfarë ai regjistronte në adresë të mosbesimtarëve të kishin thënë për ngjarjen e ndarjes së hënës, e gjitha ishte një e vërtetë që kishte ngjarë dhe për vërtetësinë e së cilës ata po jepnin dëshminë e tyre pro, aq më tepër pasiqë pas kësaj ata e lanë gjendjen e mosbesimit dhe u kthyen në Islam duke besuar tek Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Këto ishin fjalët e mia që i thashë orientalistit të historisë sonë. Ai m'u përgjigj, kjo është e saktë, por më thuaj se çfarë mund të më bind mua se ky Kuran që ju po lexoni tani është i njëjti Kuran që regjistroi atë ngjarje që e dëshmuan dy grupet në atë kohë? Mund të ketë ndodhur ndonjë ndërhyrje, ndonjë ndryshim në të.

I thashë, dëgjo!

Këtë Kuran e kemi marrë përmes zinxhirit të transmetimit më të besueshëm të mundshëm të quajtur muteuetir (ku më së paku çdo dhjetë transmetues të devotshëm e transmetojnë Kuranin zinxhir, brez pas brezi, nga të paktën dhjetë të tjerë të devotshëm, që nga dalja e Kuranit prej gojës së Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- e deri në ditët tona). Gjenerata më e dëlirë njerëzore, sahabët (shokët) e Profetit Muhamed dhe të gjithë gjeneratat e dëlira njerëzorë që kanë vijuar më pas tek ne muslimanët janë unifikuar rreth faktit se ky është po ai Kuran që ju zbrit Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Është po ky që kemi sot. Kurani memorizohej me një interesim kulminant, shkruhej nga shkrues eminentë të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, më pas vazhdoi dhe vazhdon të shkruhet nga shkrues eminentë të mëvonshëm deri në ditë tona dhe kështu do vijojë në vazhdim. Në shtëpinë e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u realizua shkrimi i krejt Kuranit nga shkruesit eminentë. Shumë shokë të Profetit i shkruanin vullnetarisht shkrimet e shenjta Kuranore, shumë të tjerë i memorizonin ato dhe i lexonin në faljet e tyre dhe jashtë faljeve çdo ditë, sepse Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i ishte reveluar se në leximin e një gërme të vetme të Kuranit ka dhjetë shpërblime. Prej tyre, siç thamë, pati sahabe që përveçse i shkruajtën thëniet e Kuranit edhe i memorizuan ato duke i mësuar përmendësh dhe përsëritur e ruajtur përmendësh deri në vdekje. Të gjitha këto konfirmojnë se thëniet e Kuranit që kemi në duart tona sot, janë po ato që iu zbritën Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Një tjetër qëndrim mbrojtës dhe garantues i ruajtjes së Kuranit nga çdo ndryshim dhe shtrembërim, qe ai i kohës së Uthman ibn Afanit, kohë në të cilën u bënë shumë kopje të Kuranit zyrtar që u shpërndanë anekënd botës joarabe. Në këtë Kuran zyrtar që u publikua në kohën e Uthmanit u vendosën shenjat e drejtleximit të Kuranit, pasi në disa vise joarabe Kurani kish filluar që të lexohej me gabime. Këto kopje të përpikta të Kuranit mbi të cilat u unifikuan shokët e profetit (sahabet) dhe mbarë muslimanët, iu dorëzuan kombeve të ndryshme, persianëve, romakëve, kinezëve, afrikanëve dhe më pas edhe evropianëve, asirianëve dhe kombeve të tjera, ku krahas origjinalit të Kuranit

në arabisht ishin sjellur dhe komentimet e tij në qindra e mijëra gjuhët e këtyre kombeve. Kështu arriti rigorozisht ky Kuran tek të gjithë popujt, në veri apo jug të globit, lindje apo perëndim. Ata e morën këtë Kuran në fillimet e zgjerimit islam direkt nga sahabet dhe më pas ia mësuan Kuranin fëmijëve të tyre, mësuan shkrimin e tij dhe përsosën drejtleximin e tij. Kështu u arrit të bëhej në kohën e Uthman ibn Afanit përçimi i Kuranit me kaligrafinë që u zgjodh dhe duke e drejtlexuar siç e lexoi atë Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Kur të ndodh të takohesh me muslimanët nga vendet joarabe dhe u thua të lexojnë Kuran ata e lexojnë shumë saktë atë, indiani e lexon Kuranin në arabisht, po kështu iraniani, turku, evropiani, rusi, afrikani, e kështu me rradhë të gjithë muslimanët që dinë të lexojnë Kuran në arabisht. Nëse u thua atyre, a i përdorni në vendin tuaj gërmat arabe, të thonë jo. Nëse u thua, a e kuptoni atë që lexoni, thonë jo. Porse ata gërmat arabe dhe drejtleximin e Kuranit me to i mësuan që nga gjyshërit e tyre të hershëm e në vazhdimësi dhe ua dorëzuan atë fëmijëve dhe nipërve të tyre në vijim ashtu siç u arriti të parëve të tyre, direkt nga shokët fisnik të Profetit (sahabet). Në qoftë se do t'i grumbullosh kuranët nga çdo vend i botës, nga çdo vis prej viseve të muslimanëve do gjesh se ata janë identik në gërmat dhe tërë shkrimin e tyre. Është i njëjti Kuran që lexohet për të gjithë, është i njëjti Kuran që lexohet në të gjitha mediat, radiot dhe televizionet dhe gjendet në arkivat e tyre. Kuran identik me origjinalin do gjesh në Bibliotekën e Kremlinit, në Bibliotekën e Kongresit Amerikan dhe kudo gjetkë. Kështu pra gjenerata e dëlirë që jetoi me Profetin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u unifikuan rreth këtij Kurani se ai është Kurani që përmban pikë për pikë fjalët që Allahu i zbriti Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Më tej të gjithë gjeneratat e dëlira të kombeve islame janë unifikuar kundrejt unifikimit të sahabeve dhe gjithashtu dëshmuan dhe dëshmojnë se ky është Kurani mbi të cilin qenë unifikuar sahabet. Pas gjithë kësaj a ka më vend për dyshim?

Orientalisti rus m'u përgjigj, jo. Përderisa të tillë gjë (çarjen mëdysh të hënës) e përmendi Kurani në kohën e tij dhe e dëgjuan këtë bësimtarët dhe mosbesimtarët duke mos e përgënjeshtruar një gjë të tillë askush prej tyre, por përkundrazi duke iu shtuar besimi besimtarëve musliman dhe duke u konvertuar në Islam shumë prej mosbesimtarëve, përderisa ky libër, Kurani zyrtar që posedojmë të shumëfishuar në miliona kopje, u memorizua dhe u garantua se është i njëjti me origjinalin, gjë rreth së cilës janë unifikuar shokët e Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, arabët dhe të gjithë muslimanët nga popujt e tjerë muslimanë joarabë; përderisa konfirmohet e gjitha kjo s'ka dyshim se çarja mëdysh e hënës ka ndodhur.

Qëndrojmë tek jashtëzakonshmëria e çarjes mëdysh të hënës.

Le të përcjellim atë që komentuesit e Kuranit përcjellin teksa e komentojnë dhe shpjegojnë këtë thënie.

Komentuesi i shquar i Kuranit Ibn Kethiri dhe dijetari i shquar imam Sheukani në librin e tij "Fet'hul Kadir" përcjellin: Lidhur me këtë ngjarje (çarjen mëdysh të hënës) kanë ardhur hadithe meteuetira (superautentikë) me zinxhirë transmetimi të saktë, gjë që do të thotë se kjo ngjarje është verifikuar me shkallën më të lartë të mundshme të konfirmimit të autenticitetit. Pra çarja mëdysh e hënës është konfirmuar në Kuran dhe gjithashtu është konfirmuar edhe në hadith.

Lind pyetja si është konfirmuar kjo ngjarje në hadith?

Ata të cilët e panë këtë ngjarje dëshmuan. Gjithkush e pa atë tha, pashë hënën sesi u nda mëdysh. Pash një gjysëm këtu dhe një gjysëm tjetër të hënës atje. Pati prej tyre kush tha, pashë malin mes dy gjysmave të hënës, dikush tjetër tha, pashë gjysmën e hënës para malit ndërsa gjysma tjetër nuk shihej pas malit. Dikënd mund t'a habis ky fakt e të thotë? Si është e mundur një gjë e tillë? Porse një gjë e tillë vjen në varësi të këndit dhe pozicionit të vendodhjes së tyre kur e kanë parë çarjen mëdysh të hënës. Ky e ka parë nga një kënd dhe ky nga një kënd tjetër. Pra transmetimet e sahabeve -Allahu qoftë i kënaqur me ta- lidhur me këtë gjë kanë qenë muteuetira (dhjetë shokë e lartë të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- për çdo transmetim) dhe në këtë rast është pikërisht ky konfirmim i sahabeve ai që e bën qenien e transmetimit në fjalë hadith.

Pasi erdhi kjo dëshmi e jashtëzakonshme hyjnore pro profetësisë së Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe u tha njerëzve dëshmoni, gjejmë sot që kjo ngjarje të rifreskohet sërisht.

Më ka treguar Profesor Zeglul en Nexhar se ai njëherë kish mbajtur një leksion mbi Mrekullitë Shkencore të Kuranit dhe Traditës Profetike për një auditor të gjerë njerëzish në Angli. Një nga të pranishmit e kishte pyetur, Kurani ka bërë fjalë së tepërmi rreth Mrekullisë Shkencore, ndërkaq Kurani ka lajmëruar se hëna është ndarë mëdysh dhe tani njerëzit arritën të shkojnë në hënë. Astronautët arritën të marrin mostra prej shklëmbinjve të hënës. A i kanë dëshmuar ata gjurmët e ndarjes mëdysh të hënës?

Profesor Zegluli i kish thënë, nuk kam ndonjë informacion rreth kësaj. As kam lexuar dhe as di gjë rreth kësaj. Fakti që posedoj është ai që ka përmendur Kurani dhe e ka përmendur Tradita Profetike e përcjellur nga sahabet -Allahu qoftë i kënaqur me ta- në librat e hadithit.

Doktor Zegluli vijoi, në mesin e auditorit ishte njëri që ngriti dorën dhe kërkoi leje të fliste. A e dini se cili ishte ky person? Ishte Dauosy Moussa Bescock.

Ai në fjalën e tij ndër të tjera tha:

Kam qenë një prej grupit që po debatonim me një treshe të shkencëtarëve elitarë amerikanë të Agjensisë Amerikane të Hapsirës NASA. Në diskutim e sipër u thamë atyre. Njerëzit po vdesin urie teksa ju shpenzoni miliardat që të shkoni në hënë dhe të na vini nga atje me ca gurë. Ç'vlerë kanë këto gurë? Tha, kjo pyetje i iritoi ata së tepërmi dhe u

kundërpërgjigjën duke thënë, jo! Nuk i dërguam astronuatët thjeshtë për ca gurë pa vlerë por një tjetër motivim fshihej në këtë ekspeditë kozmike. Ky motivim është se ne kemi vënë re një dukuri që ka të bëjë me hënën dhe që na ka çoroditur vërtetë. Kemi konstatuar se hëna është ndarë mëdysh, por pasi është ndarë nuk është ribashkuar ekzaktësisht si më parë por është spostuar paksa. Ky spostim që ka ngjarë ka sjellë për pasojë formimin e një rripi shkëmbinjsh të transformuar të cilët nuk kishte sesi të formoheshin përveçse nën një presion shumë të fuqishëm dhe temperaturë tepër të lartë. Kur u kthye hëna dhe u ribashkua vetëm falë këtij presion super të madh dhe temperature kulminante u realizua saldimi i saj. Shkencëtarët arritën t'a identifikojnë rripin në fjalë përmes studimeve sizmologjike që kryen në sipërfaqen e hënës. Ajo që ata u bindën për të është fakti se hëna është ndarë mëdysh dhe është salduar sërisht.

Bescocku vijoi, kur dëgjova nga ju (Profesor Nexhari) këtë që po thoni, mësova se Muhamedi është i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe nisur nga kjo u binda lidhur me çfarë na informuan me të gjeneratat muslimane.

Kjo ngjarje ka ndodhur këto kohët e fundit në vitin 1420 (hënor) ose 1999 (diellor). Një muaj pas islamizimit të tij profesor Bescocku teksa po mbante një leksion para studentëve të tij në Sheffield të Anglisë u përmendi studentëve të tij historinë e tij të islamizimit për shkak të ngjarjes në fjalë.

Një tjetër gjë që vlen të përmendet nga aktiviteti vital i Dauosy Moussa Bescock është fakti sesi ai themeloi një parti politike të madhe të quajtur Partia Islamike Britanike, kryetar i së cilës është ai vetë.

Jemi gjithmonë në kontekstin e kësaj ngjarje. Allahu e dinte se do vijë dita që njerëzit do kenë mundësi të arrijnë në hënë dhe tani njerëzit arritën t'a shohin me fakte mrekullinë e ndarjes mëdysh të hënës. Gjurmët e saj bëhen shkak për islamizimin e këtij lideri britanik që u konvertua në Islam dhe themeloi këtë parti politike.

Kush mundet t'a ndajë hënën mëdysh? Një gjë të tillë nuk mund t'a bëjë askush veç Allahut të Lartmadhëruar dhe të Lartësuar.

Kjo është një jashtëzakonshmëri. E zakonshmja është që hëna është një trup i pandashëm por ajo u nda mëdysh në përgjigje të dëshirës së Profetit të Allahut që përmes kësaj ndarje t'u jepej një shenjë e qartë pabesimtarëve se ai ishte i Dërguar i Allahut. Hëna u nda mëdysh që të ishte një argument i pakontestueshëm në mbështetje të faktit që Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ishte i sinqertë në atë që thoshte, se Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ishte i përkrahur nga Allahu i Plotfuqishëm që e mbështeti atë me këtë mrekulli të jashtëzakonshme.

Nuk qe vetëm kjo jashtëzakonshmëria me të cilën Allahu e përkrahu të Dërguarin e Tij, porse ky kapitull është shumë shumë i gjërë.

Dijetarët e Shkencës së Hadithit kanë tubuar qindra e qindra jashtëzakonshmëri dhe shenja të qarta mrekullishë. Teksa disa dijetarë të tjerë kanë tubuar në imtësi çdo jashtëzakonshmëri dhe mrekulli duke shënuar një numër që arrin mijëshen e ndodhive dhe jashtëzakonshmërive që i mundësoi Allahu i Lartmadhëruar dhe Lartësuar të Dërguarit të Tij duke ndryshuar dhe shbërë ligjet e zakonshme në deklarim të vërtetësisë së Profetit që i dërgoi mbarë njerëzisë.

Do bëjmë fjalë për një ngjarje që daton në kohën para se të dërgohej si profet Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- lidhur me mbrojtjen e vendlindjes së tij. Bëhet fjalë për ngjarjen e vitit të Elefantit kur Abisinasi Abraha ndërtoi një faltore si Qabja e Mekës në zonën e Kalisit në qytetin e Sanasë të Jemenit që si zonë është ende ekzistuese. Deshi që me të të sfidonte Qaben dhe thithte adhuruesit që të mos peligrinonin drejt saj por të peligrinonin tek kjo faltore e madhe dhe superluksoze që ai kishte ndërtuar.

Transmetimet historike përcjellin se disa arabë kurejshas të irituar nga kjo kishë që kishte ndërtuar Abraha e dëmtuan atë duke bërë disa dëme në të si dhe hodhën në të disa plehra por pa lënë gjurmë. Kur Abraha dëgjoi për këtë u zemërua dhe u betua se për t'u hakamarrë për çfarë këta mekas i bënë do t'a shkatërronte Qaben. Në rrugë e sipër për të shkatërruar Qaben, teksa ai ishte në krye të ushtrisë së tij gjigande të përforcuar me elefantë të fuqishëm, i bënë rezistentë disa fise arabe por ai i asgjësoi ata. Disa që i kapi gjallë i mori me vete që të dëshmonin me sytë e tyre shkatërrimin që do t'i bënte Qabes. Erdhi momenti në të cilin ai hyri në Mekë në rrugën pranë Qabes ku karvanin e ushtrisë e prinin elefantët në krye të të cilit ishte elefanti gjigand i quajtur Mahmud. Sa herë e drejtonin atë drejt ndërtesës së Qabes ai ngulej në vend dhe edhe pse e godisnin rreptë nuk lëvizte aspak. Por nëse e drejtonin në çdo drejtim tjetër ai lëvizte me revansh. Me këtë rast Abraha kërkoi të takojë disa liderë të Mekës prej të cilëve takoi Abdul Mutalibin që në fakt e trajtoi fisnikërisht. Abdul Mutalibi i tha, më ke marrë devetë dhe unë dua të m'i ktheshë ato. Abraha ia kthen, unë mendova se do më flisje për këtë Qaben që kam ndërmend t'a shkatërrojë dhe jo për sa më the. Abdul Mutalibi ia ktheu, unë jam Zot i deveve ndërsa Qabja ka të Zotin që do e mbrojë atë.

I Lavdishëm është Allahu. Bëhet fjalë për kurejshët që adhuronin idhujt teksa Abraha ishte i krishterë, qëndronte më lartë fetarisht pasi nuk ishte adhurues i idhujve. Porse Allahu u hakmorr për Qaben duke ndëshkuar Abrahan dhe ushtrinë e tij mbi të cilët dërgoi shpezë tufë-tufë të cilët u lëshuan atyre gurë nga balta e gurëzuar dhe i bëri ata si bima e ngrënë.

Këtë ngjarje e regjistron Kurani duke u treguar të pranishëmve që dëgjojnë rreth kësaj historie. Thotë Allahu i Lartësuar: "A nuk e ke parë se ç'bëri Zoti yt me poseduesit e elefantit? A nuk bëri që përpjekja e tyre të dështojë? Dhe Ai kundër tyre lëshoi shpezë që vinin tufë-tufë! Dhe i gjuanin ata (Abrahan dhe ushtrinë e tij) me gurë nga balta e gurëzuar! Dhe ata i bëri si gjeth i grimcuar (i përtypur)!". Kurani flet për këtë teksa shumë dëshmitarë ende ishin gjallë tanimë në të gjashtëdhjetat apo diçka më shumë a

më pak. Asokohe patën qenë të rinj. Askush nuk doli t'a përgënjeshtronte Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- lidhur me këtë. Askush nuk tha se kjo nuk kishte ngjarë, se ai s'po thotë të vertetën etj etj. Përkundrazi e dëgjuan dhe u kuptua se ashtu kishte qenë.

Kështu, regjistrimi i lajmeve dhe ngjarjeve në Kuran dhe dëgjimi i tyre nga ana e mosbesimtarëve duke mos i përgënjeshtruar ato; pamvarësisht angazhimit të tyre maksimal për të përgënjeshtruar, refuzuar dhe cënuar Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-; e tillë gjë është dëshmi e pakontestueshme se sa në fjalë ka ngjarë dhe mosbesimtarët s'kanë pas çfarë të bëjnë tjetër përveçse të heshtin para këtyre të vërtetave.

Në interes të kujt qe mbrojtja e Qabes? Mësojmë duke shikuar vijueshmërinë se kjo ishte një mbështetje për Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- në dobi të tij dhe Mesazhit të Ri që do të kishte për Faltore dhe Pikëorientimi pikërisht këtë Qabe të cilën Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm e mbrojti nga shkatërrimi që synuan t'i bënin asaj Abraha me ushtrinë e tij.

Profetin tonë Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, Allahu e ruajti gjatë gjithë jetës së tij, e mbështeti dhe ndihmoi kundër armiqve të tij. Njerëzit në masë komplotonin kundër tij siç është parë të ndodhte në Meke nga mosbesimtarët kurejshas që ia prunë vërtetë ngushtë Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, që zbuan dhe keqtrajtuan ndjekësit dhe mbështetësit e tij të cilët u detyruan të emigrojnë për në Abisini dy herë dhe më pas në qytetin e\Medines ku filluan të bëheshin një forcë e re ligjbërëse. Mosbesimtarët kurejshas nisur nga frika që kish filluar t'i kapte për këtë forcë të re që po rritej dita-ditës në Medine u rebeluan dhe së fundmi vendosën të komplotojnë vrasjen e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- që ende gjendej në Meke. Porse Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- revelohet të emigrojë për në Medine duke u ikur mrekullisht sy për sy komplotuesve. Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- projektoi një plan krejt ndryshe nga ai që kurejshasve mund t'u vinte nëpër mend ashtu që fillimisht u drejtua dhe lëvizi përkah Jemeni e pastaj u drejtua për nga linja veriore paksa në perëndim, pra në veriperëndim dhe në fund e ktheu kursin e udhëtimit përkah Medinja pasi u fsheh për tre ditë në shpellën ku kurejshët qenë aq pranë tyre saqë Ebu Bekri që e shoqëronte në shpellë prononsohet për frikën e rrezikut që kishte kaluar përkrah Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- duke thënë se nëse dikush prej gjurmuesve mosbesimtarë kurejshas do hidhte sytë në tabanin e shpellës do na kishte parë. Por Allahu zbriti mbi Profetin e Tij prehjen dhe e mbështeti dhe përkrahu me ndihmues prej engjëjve të cilët njerëzit nuk kishin mundësi t'i shikonin. E gjitha kjo është e regjistruar në Kuran. Me këtë Allahu informoi besimtarët se Profeti edhe pse i mbetur pa ndihmën e besimtarëve ishte ndihmuar nga Allahu teksa qe i vetëm dhe pa asnjë përkrahje, teksa njerëzit i ishin qepur pas dhe kurejshasit e kërkoni gjallë a vdekur kundrejt një çmim shumë të majmë. Por, thotë Allahu në Kuran, Unë e ndihmova

atë, i bëra të dështojnë komplotet dhe tentativat kundër tij gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar bën fjalë në Kuran ku thotë: “Nëse ju s’e ndihmuat atë (Profetin), atë e ndihmoi Allahu; kur ata që nuk besuan e nxorën atë vetë të dytin; kur që të dy ishin në shpellë, kur (Profeti) po i thoshte shokut të vet (Ebu Bekrit): "Mos u pikëllo (frikëso për mua), Allahu është me ne!..." Në këtë rrethanë vjen transmetimi në adresë të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- sesi ai i drejtohet shokut të tij Ebu Bekrit duke i thënë: “Ç’mendim ke për një dyshe i treti ndër të cilët është Allahu?!” Shikoni këtë shprehje, këtë besueshmëri. Ebu Bekri thotë se nëse dikush prej atyre që u qenë qepur pas për t’i gjetur dhe kapur gjallë a vdekur, do kish ulur kokën në tabanin e shpellës do na kishte parë. Kemi të bëjmë me përkrahjen hyjnore që mundëson që situata në fjalë të bëhet një jashtëzakonshmëri në mbrojte të Profetit të Allahut, ashtu që gjithë ata njerëz e gjurmojnë Profetin Muhamed pas gjurmëve që i çojnë në shpell dhe nuk arrijnë t’a shohin teksa ishte vetëm një vështrim pranë i ulur atypari. Më tej Suraka ibn Maliku, lakmitar në shpërblimin që do merrte për kapjen e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- gjallë a vdekur, i afrohet fare pranë por befasohet ky kalorës i sprovuar kur këmbët e kalit të tij pengohen dhe e rrëzojnë rishtazi, saqë ai nuk kërkon më të kapë Profetin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- por ajo që kërkon është që t’i japë besën t’a lerë të shkojë në siguri dhe pa e gjetur gjë e keqe, sepse e ndjeu se ai i kish qenë vënë pas një Profeti të Zotit.

Kështu e ruajti Allahu të Dërguarin e Tij: “Nëse ju s’e ndihmuat atë (Profetin), atë e ndihmoi Allahu; kur ata që nuk besuan e nxorën atë vetë të dytin; kur që të dy ishin në shpellë, kur (Profeti) po i thoshte shokut të vet (Ebu Bekrit): "Mos u pikëllo (frikëso për mua), Allahu është me ne! Allahu i zbriti qetësi (në shpirt) atij, e fuqizoi me një ushtri që ju nuk e patë; e fjalën e atyre që nuk besuan e bëri më të ultën, kurse fjala e Allahut (është) më e larta…”.

Kjo pra është ndihma dhe garancia e Allahut dhënë të Dërguarit të Tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- përmes së cilave ai shbënë dhe tjetërson zakonshmëritë duke bërë jashtëzakonshmëri përmes të cilave e ndihmon të Dërguarin e Tij kundër armiqve të tubuar kundër tij në të katër anët. Gjithashtu Allahu i jep atij mbështetje dhe e bën të aftë të përhapë thirrjen dhe mesazhin hyjnor të Tij.

Këto janë prej provave të mesazhit të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, janë prej fakteve dhe mrekullive të jashtëzakonshme të mesazhit të tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Kurani dhe shkencat e marinës (12)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Në këtë episod do të diskutojmë rreth mrekullisë shkencore të Kuranit në lëmin e shkencës së oqeanisë dhe hidrologjisë detare.

Dihet se Kurani ka bërë fjalë për detërat e oqeanet dhe shumë nga dukuritë që ndodhin në sipërfaqen dhe tabanin e tyre. Përshkrimi i tyre është bërë në një mënyrë tepër të përpiktë, gjë e cila u arrit të përshkruhet nga shkenca shumë më vonë, atëherë kur u bë i mundur produktimi i paisjeve dhe aparaturave shkencore të nevojshme për të tilla zbulime shkencore. Sa e sa armata shkencëtarësh u rekrutuan në shërbim të studimeve dhe grumbullimit të të dhënave derisa u krijua panorama e plotë mbi këto hulumtime.

Kurani Fisnik e krisi detin më dysh duke treguar rreth sekreteve dhe mistereve të tij dhe teksa profeti Musa -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u mundësua nga Zoti të ndajë mëdysh me shkopin e tij detin që u ngrit në dy anët e tij sikurse malet e lartë për të kaluar popull i tij në anën tjetër të detit përmes kësaj të çare, po kështu Kurani na jep mrekulli lidhur me sekretet dhe misteret e detit duke i krisur ato dhe bërë të zbulueshme për ne. E gjitha kjo u zbulua nga Kurani në një kohë kur trillet dhe legjendat kishin sunduar edhe kokat e mbarë njerëzve madje edhe të elitës së asaj kohe.

Për shembull egjiptianët e hershëm, ata të kohës së Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- si dhe të kohëve të mëvonëshme kur Islami u përhap në Egjipt, që të gjithë kishin bestytninë se lumi Nil kishte shpirtin e tij që kur zemërohej shkaktonte përmbytje dhe që të shuante zemërimin ai donte një nuse.

Trillet dhe legjendat kishin dominuar gjithashtu në kokat e mbarë marinarëve dhe njerëzve që jetonin në brigjet e detërave dhe oqeaneve, saqë njeriu nuk guxonte të lundronte në thellësitë e tyre pasiqë ato njiheshin si tepër të rrezikshme.

Por njeriu me progresimin e teknikave dhe teknologjive të lundrimit sidomos pas lundrimit të ekspeditës së anijes britanike të eksplorimeve detare “Challenger” në 1873, që i ra kryqetërthor të gjithë detërave dhe oqeaneve në udhëtimin e saj që zgjati për tre vjet me rradhë, bëri që shkenca e oqeanisë dhe hidrologjisë detare të fillojë që të vendosë bazat e saj të sakta.

Shkencëtarët e marinës na përshkruajnë në detaje gjithësa ndodh mbi sipërfaqen, nën sipërfaqen dhe në tabanin e detërave dhe oqeaneve.

Le të udhëtojmë së bashku në këtë udhëtim ku Kurani do na shoqërojë drejt sekreteve dhe fakteve të detërave dhe oqeaneve.

Le të fillojmë nga sipërfaqja, le të fillojmë me erërat detare.

Klasifikimi ndërkombëtar i ndan erërat në 12 kategori të ndryshme në akordim me shkallën Beaufort të shkallës së erës që fillon me zero dhe që është kategori më vete e ndarjes së erërave në të cilën erërat nuk fryjnë dhe kanë fuqinë zero. Në këtë rast deti nuk ka asnjë dallgë të fortë në sipërfaqen vertikale të detit si dhe duke qenë se erërat nuk bëjnë as korrent për këtë nuk trazohet as sipërfaqja horizontale e detit. Në një rast të tillë anijet mbeten të palëvizëshme sikur të jenë mbi një sipërfaqe të ngurtësuar. Lidhur me këtë domëthënje vjen dhe fjala e Allahut të Lartësuar: "Nëse Ai-Allahu do, i pushon erërat për të mbetur kështu ato-anijet të palëvizura mbi tabanët e tyre". Rast ky në të cilin deti nuk ka as lëvizje vertikale (dallgë) dhe as horizontale (rrymë erërash).

Kategorizimi ndërkombëtar i shkallës Beaufort bën fjalë për grupin e erërave të tipit fllad apo puhizë të cilat i ndan në kategori të ndryshme nga dyshi tek gjashta. E para pra ishte niveli 0; e dyta, me të cilën fillojnë puhizat, është era e lehtë, e treta puhiza e butë, e katërta puhiza mesatare, e pesta puhiza aktive dhe e gjashta puhiza e fuqishme Nga 1 deri tek 6 rradhitja bëhet sipas shkallës specifike të matjes së fuqisë dhe shpejtësisë së erës të quajtur pra Beaufort, që bën pjesë tek parametrat detarë ndërkombëtar. Të gjithë erërat që u thanë konsiderohen erëra të mbara e të mira që priten mirë dhe me kënaqësi nga marinarët. Kurani të gjitha erërave që i përkasin grupit në fjalë u ka dhënë një emër të vetëm, i ka quajtur erëra të mira apo të mbara. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "Ai-Allahu ua bëri të mundshëm udhëtimin në tokë e në det, ashtu që kur jeni në anije me të cilat (udhëtarët) lundrojnë nën efektin e një ere të mirë ata i gëzohen asaj…" Kështu i tuboi Kurani të gjitha këto kategori në një të vetme të quajtur erë e mirë apo e mbarë në shprehi të faktit se ajo kundrejt udhëtarëve në det është e tillë që nuk bën asnjë dëm dhe është e tillë që ata gëzohen dhe ndjehen të kënaqur me të.

Më tej kategorizimi ndërkombëtar vijon të klasifikojë erërat e tjera. Ai vijon me grupin e shtrëngatave. Ky është grupi i erërave të fuqishme që mund t'u shkaktojnë katastrofa anijeve, marinarëve dhe njerëzve në bordet e anijeve që lundrojnë aty ku këto erëra fryjnë. Klasifikimi i tyre fillon nga shtata, dhe vijon me tetën, nëntën, dhe dhjetën. Të gjitha këto erëra pra i takojnë grupit të shtrëngatave dhe emërtimi i tyre është bërë po me këtë titull, shtrëngatë mesatare, shtrëngatë aktive, shtrëngatë e fuqishme dhe shtrëngatë tufan. Shkak i shtrëngatës në fjalë është pikërisht fryrja e një ere të tillë mbi sipërfaqen e detit. Këto erëra kur fryjnë mbi sipërfaqen e detit apo oqeanit ushtrojnë presion atmosferik mbi to gjë që shkakton uljen e nivelit sipërfaqësor të tyre. Me uljen e sipërfaqes ujore ku fryjnë erërat ndodh fryrja dhe ngritja e ujit të anëve periferike prej dhjetë deri pesëmbëdhjetë kilometra largë detit apo oqeanit. Anija mbetet në zonën që ka pësuar ulje sikur të jetë në mesin e një vatre të gjerë vullkanike. Pereferitë ujore të ngritura më tej për inerci lëvizin drejt zonës së shtypur apo ulur nga era, gjë që

demonstrohet me ardhjen e dallgëve të egra drejt zonës së ulur nga shtypja atmosferike e erës. Nëse i ka takuar që anija të jetë në të tillë zonë, asaj dallgët i sulen nga të gjitha anët, gjë që në fakt nuk korrespondon me dallgët e zakonshme që i shikon njeriu teksa ato i drejtohen brigjeve.

Grupin e erërave të shtrëngatave Kurani e përmend duke e sjellur direkt pas erës së lehtë ashtu që Allahu pasi tha: "...ata i gëzohen asaj (erës së mirë)..." vijoi: "...ia beh një erë e fortë dhe dallga u vjen nga të gjitha anët...". Vëreni sesi Allahu ardhjen e dallgëve nga të gjitha anët e lidh me shtrëngatën që ushtron trysni atmosferike mbi sipërfaqen e detit duke u bërë kjo erë shkak për ardhjen e tallazëve të dallgëve që vërshojnë në të katër anët. "...ia beh një erë e fortë dhe dallga u vjen nga të gjitha anët ashtu që ata mendojnë se janë të rrethuar e pa rrugëdalje...", në këtë situatë pra, anija anon sa andej këndej dhe ai që udhëton mbi bordin e saj mendon se për të ky është fundi. Çfarë rezulton nga e gjithë kjo? Kjo shpjegohet në vijimësinë e thënies kuranore që thotë: "(në këtë situatë kur s'kanë shpres për shpëtim) ata me sinqeritet të plotë i luten Allahut për shpëtim...". Pra ata i luten Allahut të Lartësuar dhe Lartmadhëruar që t'i ruaj. Pastaj, pasi dalin në breg, me kalimin e kohës harrojnë se si i qenë lutur dhe se çfarë i premtuan Allahut se do bënin nëse do i shpëtonte. Kurani u kthehet këtyre harraqëve duke u thënë se Allahu posedon erëra të tjera, që nuk janë as si puhizat dhe as si shtrëngatat, por që u takojnë shkallëve më të egra të erërave.

Klasifikimi ndërkombëtar i klasifikon erërat e tilla me emërtimin ciklone të cilët i rëndit në dy shkallë, duke i takuar që ato në klasifikimin total të erërave të pushtojnë vendin e njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë. Këto erëra shkaktojnë thyrjen e trupit të anijes. Ata duke fryrë egërsisht thyejnë dhe shkatërrojnë direkët dhe pjesët e tjera të anijes ku përplasen dallgët e irituara dhe të egërsuara prej tyre. Kurani orienton për tek kjo kategori erërash duke e lidhur atë me rastin e personave që pasi shpëtuan nga tufani harruan premtimet dhe lutjet e bëra Allahut, thotë Kurani Fisnik lidhur me këtë: "A u siguruat se Ai nuk do t'ju kthej herë tjetër në të (në det) e t'ju dërgoj atë shkallmuesen prej erërave...". Shkallmimi ka për kuptim thyerjen. Gjejmë në këtë rast që kjo erë të jetë përshkruar me një cilësi tjetër, jo e mbarë, jo shtrëngatë, jo e qetë, porse Kurani i dha kësaj ere cilësinë "shkallmuese". Me shkallmimin dhe thyerjen e direkëve të anijes dhe skeletit të saj vjen edhe mbytja dhe po kështu, për mbytjen e sigurtë, shprehen edhe shkencëtarët e marinës në rastin kur anijet atakohen nga ciklonet.

Vëreni këtë klasifikim të thjeshtë, orientues, plotkuptim dhe qarkues lidhur me gjithësa ndodh mbi sipërfaqen e detërave dhe oqeaneve prej sojeve të erërave.

Kush ia mësoi këtë Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-? Pa dyshim se ai që ia mësoi ishte Revelimi Hyjnor që i erdhi nga Allahu i Lartësuar dhe i Lartmadhëruar.

Ngelemi tek detërat, teksa lind pyetja, a kemi të bëjmë me një det të vetëm apo ato janë të shumtë? Përgjigjja është se nuk kemi të bëjmë me një det të vetëm porse gjenden shumë detëra edhe pse ata i takojnë masës ujore të një oqeani të vetëm.

Kur u bë i mundur ky konstatim? Në fakt një konstatim i tillë u arrit pas një udhëtimi vërtetë të gjatë shkencor. Qe udhëtim i gjatë me motiv shkencor i Ekspeditës "Challenger" ai që e konstatoi një gjë të tillë duke marrë ekzemplarë ujorë që u vërtetua se ishin të ndryshëm. Ky zbulim u bë i mundur vetëm pas vitit 1873. Më vonë, në vitin 1933, një Ekspeditë amerikane ndërmorri një udhëtim në gjirin e Meksikës ku instaloi qindra stacione ujore. Ajo gjeti se stacionet u ndanë në dy grupe. Njëri grup jepte të dhëna dhe parametra të caktuara unike, nënkuptojmë, të njëjtën temperaturë uji, të njëjtin nivel krype, dendësi të njëjtë, parametër të njëjtë të pranueshmërisë së tretjes së oksigjenit, madje edhe krijesa ujore specifike për atë territor ujor. Grupi tjetër i stacioneve kërkues jepte një grup tjetër unikal të dhënash. Me këtë konkluduan se prania e këtyre dy leximeve, e këtyre dy grupe unikale të dhënash, tregonte për faktin se kishim të bëjmë me dy detëra, dy detëra të ndryshëm të gjendur në të njëjtin vend dhe në të njëjtën rrethinë ujore. Pastaj në vitin 1942 u bënë kërkime mbi supozimin se si këto dy detëra që puqen në të njëjtën rrethinë ujore mbeten me specifika krejt unikale që nuk ndryshojnë nga njëri-tjetri? Me këtë rast gjetën nga studimet shkencore praninë e një brezi ujor që bënte ndarjen midis dy deteve dhe shkencëtarët këtë brez ujor ndarës e quajtën barier, me kuptimin brez ndarës. Së fundmi, me përdorimin e satelitëve, shkencëtarët e marinës arritën që të filmojnë ndyshimin dhe dallimin e territoreve specifikë ujorë të detërave. Në këto pamje që sjell sateliti janë qartësuar dukshëm kufinjtë midis masiveve ujorë të secilit det nga tjetri si pasojë e ndryshimit të temperaturës së masivit ujor të tyre. Më tej një pyetje tjetër që doli në mesin e shkencëtarëve ishte nëse ndodhte apo jo përzierje midis dy detërave, pra a përziheshin apo jo mes tyre këto dy detëra kufitarë të ndarë nga bariera ndarëse e brezit ujor ndërmjetës? Ky fakt u zbulua vetëm pas vitit 1960. Shkencëtarët survejuan masivet ujorë që hynin nga njëri det tek tjetri dhe gjetën se uji i njërit det hynte tek uji i tjetrit por përmes barierës ndarëse ujore. Por dihet se një hyrje e tillë e ujit të njërit tek ai i tjetrit donte të thoshte se specifikat e njërit do dominonin mbi ato të tjetrit, gjë që sidomos do qe evidente për dominimin e masivëve ujorë të oqeaneve gjigand mbi ato të detërave. Për shembull ujërat e Oqeanit Paqësor hyjnë në ato të Detit të Kuq dhe i bie që këto të fundit do ndryshojnë specifikat e tyre, ujërat e Oqeanit Atlantik hyjnë në ato të Detit Mesdhe dhe i bie që këto të fundit do ndryshojnë specifikat e tyre. Pra specifikat dhe veçoritë e Detit të Kuq dhe Detit Mesdhe do tjetërsohen dhe asgjësohen nga masat gjigande ujore të këtyre dy oqeaneve. Por, jo, asnjë frikë, kjo nuk ndodh. Po përse? Sepse bariera ndarëse ujore është ajo që ka si funksion konvertimin e ujit të oqeanit duke mos e lënë atë të depërtoj nga oqeani në detin në fjalë vetëm se pasi me hyrjen në barierë të fitoj veçoritë dhe karaktersistikat e detit ku do hyjë dhe të humbasë karakteristikat e oqeanit nga ku erdhi. Po kështu në kompensim të këtij uji që hyn do kemi një masiv ekuivalent ujorë që do dalë nga deti por që nuk lejohet të dalë nga bariera ujore vetëmse

pasi të ketë fituar karakteristikat e oqeanit dhe të ketë humbur karakteristikat e detit nga ku doli. E njëjta gjë siç ndodh midis detërave dhe oqeaneve ndodh edhe midis detërave kufitar që i përkasin të njëtit rrethi ujor ose të njëjtit oqean. Kështu pra funksioni i kësaj bariere ujore është të pajisë me karakteristikat përkatëse gjithsecilën masë ujore që kalon nga njëri det apo oqean tek tjetri.

Kurani Fisnik ka bërë fjalë për këtë, gjë në lidhje me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Ai i lejoi dy detet të puqen midis tyre. Ndërmjet atyre të dyve është një pengues e ato të dy nuk dominojnë (dhunojnë) njëri-tjetrin." Medito edhe njëherë tek thënia kuranore në fjalë ku Allahi i Lartësuar bën me dije se këto dy detëra janë një përzierje që i takon të njëjtit oqeani apo rrethine ujore, ato puqen dhe takohen midis tyre por nuk e dhunojnë njëri-tjetrin sepse kanë një pengues-barierë të cilës i dedikohet mosdhunimi. Po të shohësh me kujdes gjen se roli i barierës ujore nuk është të pengojë hyrjen e një masivi ujor tek tjetri por është që uji i njërit det mos të dhunojë veçoritë dhe specifikat e ujit të detit tjetër, gjë që realizohet nëpërmjet moderimit dhe rregullimit të veçorive të masivëve ujorë që hyjnë përmes kësaj bariere nga njëri det tek tjetri.

Që të dy masivet e mëdha ujorë, detërat, janë të krypur apo?

Komentuesit e hershëm të Kuranit ngelën gojëkyçur rreth përgjigjes për pyetjen në fjalë sidomos kur lexuan thënien e dytë kuranore: "Prej tyre dalin perla dhe korale", që duke treguar se prej çdonjërit prej tyre nxirren perla dhe korale, nënkupton se ato janë të krypur sepse perlat dhe koralet nuk nxirren vetëmse nga masivet e krypura ujorë, detërat. Ngelën gojëkyçur, sesi dy detëra që të dy të krypur janë njëkohësisht të ndryshëm? Si janë të ndryshëm kur që të dy janë të krypur, kanë ngjyrë të njëjtë, kanë peshq, dallgë dhe tallaze, madje janë edhe të puqur me njëri-tjetrin? As që mundën t'a imagjinonin të tillë gjë. Disa shprehën mendimin se bëhej fjalë për takimin midis lumit dhe detit, pra për deltat midis lumenjve dhe detërave. Por realiteti qëndron se Kurani e ka përmendur edhe çështjen e takimit midis lumenjve dhe detërave duke e përshkruar takimin midis tyre me të tjera përshkrime, të ndryshme nga përshkrimet me të cilat përshkron dy detërat në thënien kuranore në fjalë. Për rastin e takimit të lumenjve me detërat Allahu i Lartësuar thotë: "Ai la të lirë të bashkohen dy dete (dy masive të mëdhenj ujorë), ky i ëmbël, shumë i ëmbël, e ky tjetri i njelmët dhe i hidhur, e midis tyre bëri një pendë (barierë) dhe izolues të izoluar". Këtu Kurani bën fjalë për deltën e lumit, zonën që bën ndarjen midis lumit dhe detit…

Mbetën gojëkyçur, përshkrimi i atjeshëm është i ndryshëm nga ky. Këtu kur përmend se uji i tij është i ëmbël këtë ëmbëlsi e specifikon me epitetin shumë i ëmbël, nënkupton lumë i pastër, teksa detin e përshkruan të njelmët të hidhur, nëkupton se ka shumë krypësirë, pra det i pastër. Përse Kurani në këtë rast e ka sjellur shtesë këtë specifikim? Përgjigja është sepse me këtë specifikim Kurani i identifikon detin dhe lumin si të ndryshëm nga delta midis lumit dhe detit, e cila nuk është as krejtë e krypur dhe as ujë krejt i ëmbël, porse përmban një përzierje midis njelmësisë dhe ëmbëlsisë, pra është një zonë më vete. E përshkruan deltën si zonë më vete, barierë brezi ujor që është një

pengues që nuk lejon takim direkt të lumit me detin. Por barierës këtu i shtoi një tjetër gjë, duke thënë: "...bëri një pendë (barierë) dhe izolues të izoluar". Tha fjalën arabe "hixhër" që do të thotë izolues. Në gjuhën bankare thuhet që filanit i janë ngurtësuar, izoluar kaq para nga pasuria, dhe me këtë rast pasuria në fjalë quhet e izoluar apo ngurtësuar. Krahas fjalës arabe "hixhër" Kurani sjell edhe fjalën tjetër arabe "mahxhura" që do të thotë zonë e izoluar ku s'lejohet hyrja. Pra zonën e deltës Kurani e përshkruan me fjalët "izolues i izoluar", e para do të thotë se ndalohet dalja dhe e dyta se ndalohet hyrja në këtë zonë. Vjen shkenca sot dhe e zbulon këtë mister të mahnitshëm, ashtu që gjeti se krijesat e lumit dhe të detit nuk munden të hyjnë në zonën e deltës, pra ajo është e izoluar ashtu që nuk lejon të hyjë në të ndonjë specie nga jashtë. Gjithashtu gjetën se speciet e gjalla të gjendura në zonën e deltës nuk munden të dalin nga ajo e të hynë në det ose lum, duke qenë kështu kjo zonë izolim për këto specie të gjalla. Kështu pra kjo zonë është izolim dhe burg për speciet e gjalla të gjendura në zonën e deltës dhe është e izoluar ashtu që nuk mund të hyjnë në të speciet e gjalla as nga lumi dhe as nga deti.

Heto sesi Allahu ndarësin midis detit dhe lumit e përshkruan me një tjetër përshkrim nga ai me të cilin përshkroi ndarësin midis detërave me njëri-tjetrin. Këtu për ndarësin, barierën, midis lumit dhe detit thotë: "...e midis tyre bëri një pendë (barierë) dhe izolues të izoluar", ndërsa për barierën e gjendur atje ku ndodhte takimi det-det tha: "Ndërmjet atyre të dyve është një pengues e ato të dy nuk dominojnë (dhunojnë) njëri-tjetrin". A ka përpikmëri dhe detajim më të madh sesa ky? Kush ia mësoi këtë Muhamedit - lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-? Kush ia zbuloi atij misteret e specieve të gjalla prezente në zonën e deltës dhe atyre prezentë në det dhe në lum? S'ka dyshim se e tillë dituri dhe njohuri është e pamundur të jetë përveçse nga Ai që njeh dhe din misteret e qiejve dhe të tokës, nga Krijuesi.

Nëse do zhyteshim në thellësinë e detërave dhe oqeaneve çfarë do gjenim?

Shkencëtarët thonë se është tepër e vështirë për njeriun të zhytet më shumë se 20 metra. Maksimumi që njeriu mund të arrijë të zhytet është 30 metra, kjo pasi njeriu nuk arrin t'a përballojë shtypjen e ujit që shtohet sa më tepër që ai zhytet në thellësi. Është krejt e pamundur që njeriu të zbret në thellësinë prej 50 ose 70 metra, sepse një gjë e tillë do të sillte vdekjen e sigurtë të këtij njeriu.

Do bëjmë fjalë tani për një dukuri që pikaset duke filluar me thellësinë 70 metra nën ujë dhe vijon të vërehet deri në thellësitë 240 metra. Cila është kjo dukuri?

Gjejmë se deti apo oqeani është i ndarë në dy pjesë; deti apo oqeani i cekët që është zona deri ku mund të arrijnë rrezet e diellit, ngrohtësia dhe temperatura pozitive e tyre si dhe ku gjendet një florë dhe faunë specifike. Poshtë kësaj zone vjen një zonë ku ngrohtësia shpërndahet dhe humbet për të sunduar i ftohti, ku drita mungon, dhe ku jetojnë ca specie tepër specifike, zonë kjo që i takon thellësisë së detit apo oqeanit të quajtur zona e thellë. Ajo që bën ndarjen midis zonës së cekët dhe asaj të thellë është një dallgë që që quhet dallga e brendëshme, e cila është një dallgë shumë gjigande që i

lëkund edhe nëndetëset e mëdha dhe të rënda. Kjo dallgë është më e fuqishme se dallga sipërfaqësore që i tund dhe lëviz anijet në sipërfaqe. Kjo dallgë u bë e mundur të zbulohet vetëm në vitin 1900 nga një grup marinarësh skandinav.

Po poshtë kësaj dallge të brendëshme çfarë ka?

Ajo që vërehet është se sa më poshtë që të zbresim vertikalisht drejt thellësisë së detërave dhe oqeaneve errësira shtohet dhe drita shpërbëhet ashtu që nivel pas niveli gjatë zbritjes poshtë në thellësi një dritë prej ditave të spektrit të dritës zhduket. Madje që në kontaktin e parë të rrezeve të dritës së diellit me sipërfaqen e detit një turbullirë fillon të pllakosë duke filluar me turbullirën e ngjyrës së kuqe, më tej me turbullirën e ngjyrës portokalli, më tej me turbullirën e ngjyrës blu, më tej me turbullirën e ngjyrës jeshile, e kështu me rradhë shtresë pas shtrese në errësim e sipër. Këto turbullira i gjejmë të ndodhin edhe brenda në det për shkak të përthyerjes së mëtejshme që rrezet e dritës pësojnë pasi përplasen mbi dallgët e detit. Dallgët sipërfaqësore janë pikërisht ato që kthejnë një pjesë të rrezeve të dritës mbrapsht duke mos i lejuar ato të udhëtojnë më tej drejt thellësive, prandaj ne kur shohim dallgët gjejmë një pasqyrim të na vezullojë në sy i reflektuar pikërisht nga dallgët, gjë kjo që na tregon për kuotën e rrezeve që dallga kthen pas. Kjo realizohet për shkak të qenies së dallgëve një sipërfaqe e lëmuar e pjerrët, gjë së cilës i dedikohet rezatimi që vezullohet nga dallga tek sytë tanë. Kështu dallga sipërfaqësore konsiderohet si një pengesë për rrezet e dritës që ndikon në errësimin e spektrit të dritës. Dallga e brendëshme gjithashtu është një tjetër provokues i errësirës për shkak të disa specieve të brishta jashtëzakonisht të shumta (bimore dhe shtazore) që jetojnë në mbështjellën e saj dhe që i reflektojnë duke i kthyer pas rrezet e dritës që arrijnë deri në atë thellësi. Gjithashtu dallga e brendëshme duke qenë se është një masiv uji i pjerrët, për këtë shkak ajo bën reflektimin dhe kthimin pas të akoma më shumë rrezeve të dritës që kanë arritur deri aty dhe tentojnë të depërtojnë më në thellësi. Si rezultat i kësaj, zona poshtë dallgës së brendëshme posedon një dendësi, temperaturë dhe florë e faunë të ndryshme nga zona e cekët e detit përsipër saj. Procesi i avullimit që ndodh në vazhdimësi mbi dete dhe oqeane, është një tjetër faktor që shkakton krijimin e masiveve të mëdhenj të shtëllungave të reve, gjë që vërehet qartë përmes satelitit që sjell imazhe të qiellit me re të dendura që mbulojnë zona të tëra mbioqeanike. Edhe retë në vetvete bëjnë pengimin e disa rrezeve të dritës së diellit që i drejtohen sipërfaqeve ujore. Kështu, nëse arrijmë në thellësinë 500 metra poshtë detit do të gjejmë se aty dominon një errësira e plotë.

Ndërsa nëse presupozohet se njeriu do zbresë në thellësinë një kilometër, pra njëmijë metra, aty ai nuk do mund të shikojë gjë prej gjëje, ndaj dhe peshqit që jetojnë në këto thellësi në përgjithësi janë të verbër e edhe ato që posedojnë sy kanë në trupin e tyre burim ndriçimi falë kockave të tyre fosforoshente që del nga trupi dhe u ndriçon syve që të mund të shohin. Këto zona janë kështu të errëta edhe kur është mesi i ditës dhe në sipërfaqe dielli vezullon në kulm. Pra edhe në mesin e ditës nëse zhytesh në këto zona të thella të nën 500 metrave do bëhesh dëshmitar i këtyre errësirave të thella.

Kurani i ka përshkruar edhe këto errësira edhe dallgën e brendëshme. Allahu i Lartësuar duke dhënë shembull me këto errësira për errësirat që kanë pllakosur zemrën e msobesimtarit, thotë në Kuranin Fisnik: "Ose (pirgjet e errësirave që kanë mbuluar zemrat e mosbesimtarëve) janë si errësirat në det të thellë…". E specifikon këtë det si të thellë, pra jo çdo lloj deti porse deti i thellë, nuk bëhet fjalë për në detin e cekët ku ne gjejmë që polumbarët të zhyten e të kenë mundësi të shikojnë ç'bëhet aty poshtë. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për detin e cekët, jo jo, por bëhet fjalë për detin e thellë dhe deti i thellë është aq i thellë saqë në distancën e tij vetëm prej 70-100 metra polumbari nuk mund të zbresë. Asnjë qenie njerëzore nuk do t'i të bënte ballë shtypjes së detit në këto thellësira. Pra Kurani e ka fjalën këtu për errësirat në detin e thellë, gjë lidhur me të cilën fjala e Allahut të Lartësuar vijon: "Ose (pirgjet e errësirave që kanë mbuluar zemrat e mosbesimtarëve) janë si errësirat në detin e thellë që mbulohet nga një dallgë…". Pra kemi detin e thellë poshtë detit të cekët. Detin e thellë e mbulon përsipër një dallgë që gjendet midis tij dhe detit të cekët. Thotë: "Ose (pirgjet e errësirave që kanë mbuluar zemrat e mosbesimtarëve) janë si errësirat në detin e thellë që mbulohet nga një dallgë që ka mbi të një dallgë…". Bëhet fjalë për dallgën sipërfaqësore që mbulon detin e cekët. Thotë: "Ose (pirgjet e errësirave që kanë mbuluar zemrat e mosbesimtarëve) janë si errësirat në detin e thellë që mbulohet nga një dallgë, që ka mbi të një dallgë, që ka mbi të re, errësira të vendosura pirg mbi njëra-tjetrën. Nëse njeriu do nxjerrë (në atë thellësi) dorën e tij as që ka për t'a parë. Atij që Allahu s'i ka dhënë dritë nuk ka për të dritë". Kush ia mësoi këto Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, kush i tregoi atij për këtë dallgë të brendëshme që mbulon detin e thellë dhe kush ia bëri atij me dije faktin se errësirat në dete janë pirg njëra mbi tjetrën si pasojë e pengesave që i pengojnë rrezet e diellit të depërtojnë e që përfaqësohen nga dallga e brendëshme, dallga sipërfaqësore dhe retë. Kush e informoi Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- lidhur me këto mistere? Kush ia tha atij sa në fjalë? Kjo është një gjë që nuk u bë e ditur vetëmse pasi njeriu shpiku nëndetëset dhe arriti të zhytet me to në këto thellësira. Nuk ka dyshim se këto informata atij i erdhën nga njohuritë hyjnore të cilave e kota nuk mund t'u qaset asesi.

Po nëse zbresim në tabanin e detit apo oqeanit dhe arrijmë në taban çfarë do gjejmë atje? Në vende të veçanta të tabanit të detërave dhe oqeaneve do të shohim të çara dhe plasaritje që e çajnë tej pë tej tabanin e detit apo oqeanit. Të tilla janë konstatuar në Detin e Kuq, në Gadishullin Arabik, në Oqeanin Paqësor si edhe në Oqeanin Atlantik dhe atë Indian. Këto plasaritje dhe të çara gjigande gjithashtu gjenden përqark kontinenteve, përqark Amerikës, Afrikës dhe përqark Australisë. Por siç thamë ato gjenden në zona të veçanta dhe jo kudo. Shkencëtarët sot kanë arritur t'a gjejnë vendodhjen e tyre, kanë arritur t'i filmojnë ato dhe t'i skicojnë në harta specifike që përcaktojnë precizivisht vendodhjen e tyre. Gjëja tjetër që gjetën është se nga këto të çara dalin zjarre vullkanike burimi i të cilave është barku gjigand i zjarrtë i tokës.

Ky burim madhështor i zjarrit të barkut të tokës me nxjerrjen e zjarrit të tij shfryn në tabanin e detit dhe oqeanit ku ndeshet me ujin e tyre dhe kështu në vazhdimësi ndodhin

shfryrje të mëdha të zjarreve të nënujshëm pikërisht nga tabani i detërave dhe oqeaneve. Pra kemi të bëjmë me ekspozimin e detërave dhe oqeaneve përballë të tillë zjarreve gjigandë. Nuk bëhet fjalë për një det të vetëm të zjarrmuar nga zjarret që burojnë nga tabani por të tillë zjarre ndodhin në një shtrirje tepër të gjerë të sa e sa detërave dhe oqeaneve varg. Ka raste kur zjarri që çlirohet nga tabani i thellë i detit apo oqeanit është aq i fuqishëm saqë arrin të dalë në sipërfaqe. Ishujt që gjejmë në mesin e oqeaneve i gjejmë si pasojë e këtyre shpërthimeve zjarrmuese vullkanike që dalin nga tabani i detërave dhe oqeanëve dhe depërtojnë deri në sipërfaqet e tyre. Zjarri i tillë që nga tabani mund të depërtojë lartë mbi sipërfaqen e detërave dhe oqeaneve ndodh të sjellë shkatërime gjigande.

Në fakt Kurani jo vetëm e ka përmendur detin zjarrmues por madje është betuar në këtë det që zjarrmon dhe digjet përbrenda me zjarrin dhe llavën që janë pjesë e tij. Kurani me këtë rast ka përdorur fjalën "mesxhur" e cila është një kundrinor që buron nga folja arabe "sexhere" që do të thotë djeg. Këtë folje Allahu i Lartësuar e ka përdorur kur ka bërë fjalë për dënimin e banorëve të Xhehenemit: "...më pas ata digjen në zjarr...". Allahu i Lartësuar shpesh në Kuran betohet në krijesa prej krijesave të Tij gjë që është e drejtë e Tij sublime. Në këtë rast Ai betohet në detin që zjarrmon dhe digjet, betohet nisur nga madhështia e këtij fakti, pasi në fakt Allahu nuk betohet përveçse për gjëra madhështore. E gjejmë këtë betim të vijë në vazhdën e fjalëve të Allahut të Lartësuar: "Pasha Turin (malin Tur). Dhe librin e shkruar në rreshta. Në lëkurën e tendosur. Pasha shtëpinë (Qaben) e vizituar (ose Bejti Mamurin në qiell). Pasha kulmin e ngritur (qiellin). Pasha detin e zjarrmuar." Pra betohet në detin e zjarrmuar, që do të thotë se kemi të bëjmë me një fakt, atë të ekzistencës së detit të zjarrmuar në të cilin Allahu betohet. Ku është ky det? Kur ja, konfirmimi vjen nga thellësitë e tabanit të detërave dhe oqeaneve të gjendur në distancat katër, pesë, gjashtë e deri njëmbëdhjetë kilometra, teksa njeriu më i stërvitur nuk ka mundësi të zhytet më shumë se tridhjetë metra. Kush pra ia zbuloi Muhamedit sekretin e këtij deti të ndezur e të zjarrmuar në të cilin Allahu është betuar në Librin e Tij. S'ka dyshim se ky sekret buron nga dituria hyjnore që i erdhi Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- nga Allahu i Lavdishëm dhe i Madhërishëm.

Nga ku erdhi kjo dituri dhe kush ia solli atë Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- teksa dihet se ai kurrë në jetën e tij nuk udhëtoi mbi det dhe teksa këto njohuri njerëzia nuk arriti t'i zbulojë vetëmse pasi shpiku paisjet e sofistikuara të cilat e ndihmuan për të bërë të tilla zbulime shkencore.

Pamë pra sesi një përshkrim i detajuar i detërave dhe oqeaneve nga sipërfaqja e tyre e deri në taban vjen e përshkruhet qartazi nga Kurani në përputhje të plotë me përshkrimet shkencore të zbuluara vonë.

Është kjo prova e qartë përpara gjithë botës, përpara gjithë njerëzve që u thotë atyre hë pra, prej ku erdhi Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- me të gjitha këto?! Pikërisht për këtë Allahu i Lartësuar përgjigjet në Kuran duke thënë: "Porse

Allahu dëshmon pro atij-Kuranit që të zbriti. E zbriti atë (të pajisur) me diturinë e Tij…", dhe thotë: "Do t'ua bëjmë atyre të shqueshme argumentet tona në horizont dhe në vetvetet e tyre derisa atyre t'u bëhet fare e qartë se ai-Kurani është e vërteta e pakontestueshme. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?!"

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed. Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Lutja e Ibrahimit (13)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Do përjetojme sot ndër të tjera disa nga çastet e bukura të lutjes që bëri Ibrahimi -paqja e Allahut qoftë mbi të-, lutje kjo të cilën Kurani e sjell përmes gjuhës së Profetit të nderuar Ibrahimit -paqja e Allahut qoftë mbi të- si në vijim: "Zoti ynë, dërgo tek ata nga mesi i tyre, të Dërguar që t'u lexojë ajetet-argumentet e Tua…".

Këtë lutje Ibrahimi e bëri teksa gjendej në Meke dhe në përgjigje të kësaj lutje Allahu i Lartësuar dërgoi Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Le të shohim gjithashtu se çfarë thuhet lidhur me këtë në Teurat (Dhjatën e Vjetër) të ditëve tona, në Librin e Gjenezës, kapitulli 17, artikulli 19-21. Në të, Zoti i thotë të nderuarit tonë Ibrahimit kështu: "Sa për Ismailin të kam dëgjuar për të. Ja ku po e begatoj, po e bëj të jetë i frytshëm dhe të shumohet së tepërmi, dymbëdhjetë prijësa do lindë dhe do t'a bëjë atë një komb madhështor". Dihet se ai që Shpallja Hyjnore quan komb madhështor konsiderohet kombi që ka një mesazh hyjnor madhështor dhe është i angazhuar në të.

Po në Librin e Gjenezës, kapitulli 21, artikulli 12-13, vjen: "Dhe të birin e robëreshës (Ismailin të birin e Haxhiresë që ishte robëresha e Ibrahimit) do t'a bëjë një komb, sepse ai është bërthama jote". Pra me birin e robëreshës këtu nënkuptohet Ismaili -paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Pyetja që shtrohet këtu është se ç'e bën një komb të jetë madhështor sipas standartit hyjnor të madhështisë?

Përgjigja është se një komb nuk mund të jetë madhështor përveçse me marrjen e mesazhit madhështor hyjnor të cilin e mori në fakt Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Po kështu në Librin Deuteronomia, kapitulli 18, artikujt 17-18, vjen: "Zoti më tha: 'Folën shumë mirë në atë që thanë. Do t'u bëjë një Profet nga mesi i vëllezërve të tyre si ti dhe fjalën Time do t'a vendos në gojën e tij"; kjo pra është ajo çfarë Allahu i ka thënë Musait. Me "Do t'u bëjë një Profet nga mesi i vëllezërve të tyre" nënkuptohet se Profeti që Zoti do sjellë nuk do të jetë nga fëmijët e Is'hakut por nga fëmijët e vëllezërve të tyre. Lind pyetja: Kush i bie të jenë vëllezërit e bijve të Is'hakut? Përgjigjja është se vëllezërit e bijve të Is'hakut janë bijtë e vëllait të Is'hakut, pra bijtë e Ismailit dhe siç dihet arabët ishin bijtë e Ismailit -paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Mund të pikaset qartazi sesi ky tekst është i drejtpërdrejtë dhe hedh dritë shumë qartë mbi faktin se profetësia do të jetë tek bijtë e Ismailit, përndryshe, nëse Profeti për të cilin bën fjalë shkrimi i shenjtë në fjalë do të ishte prej çifutëve, do thuhej në të "Do t'u bëjë një Profet nga mesi i tyre" dhu nuk do të thuhej "Do t'u bëjë një Profet nga mesi i vëllezërve të tyre".

Ndërsa në Ungjill (Dhjatën e Re) gjejmë frazat në vijim:

Së pari thënia në Ungjillin e Mateut, kapitulli 21, artikujt 41-44, ku Jezusi-Isai -paqja e Allahut qoftë mbi të- thotë: "A s'keni lexuar asnjëherë në shkrimet e shenjta për gurin që e kanë refuzuar ndërtuesit e që është bërë prej Zotit kreu i kulmit. Kjo ka qenë e mahnitëshme në sytë tanë prandaj po ju them se mbretëritë e Allahut do t'ju hiqen ju dhe do t'i jepen një populli që do t'i bëjë të japin fryte". Këtu kemi të bëjmë me deklaratën biblike se Mesazhi Hyjnor do t'u merret izraelitëve dhe do t'i jepet një kombi tjetër. E kush tjetër është ky komb prej të cilit është dërguar Profet përveç kombit të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-?!

Kjo ishte përsa i përket linjës profetike…

Në shkrimet e hershme të shenjta gjithashtu hidhet dritë edhe rreth vendit nga ku do shfaqet dhe ku do dërgohet ky Profet. E tillë gjë është prezent edhe në shkrimet e hershme të shenjta të çifutëve dhe të krishterëve të ditëve tona.

Në lidhje me sa në fjalë, në shkrimet e shenjta, në Librin e Isaias, kapitulli 2, artikulli 11, thuhet: "Le t'a ngrejë terreja dhe vendbanimet e saj zërin lartë, shtëpitë e banuara nga Kidari…" Me kuptimit se zërat që do thërrasin dhe ftojnë në fe do shfaqen nga shtëpitë dhe vendbanimet e banuara nga Kidari. Lind pyetja Kidari kë presupozon? Përgjigjen e jep Teurati (Dhjata e Vjetër) duke na treguar se ai ishte një nga djemtë e Ismailit -paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe siç dihet Ismaili -paqja e Allahut qoftë mbi të- jetoi në Meke të cilën shkrimet e shenjta në Teurat e sjellin me definicionin Paran.

Ndërsa në Psalmet e Daudit, në versionin në anglisht, version ky bashkëkohor dhe në qarkullim në ditët tona në Amerikë, Evropë etj, thuhet: "…ata do të kalojnë për në Peligrinazh nëpër luginën e Bekes…"; kështu gjendet emri Beke, me gërmën e parë me të madhe, gjë që do të thotë se kemi të bëjmë me një emër të përveçëm vendi. Kurse më tej perifrazimi vijon "…luginën e Bekes që do të bëhet vendi i kroit… "; gjë që presupozon kroin apo burimin e Zemzemit. Fraza në fjalë e Psalmeve flet për një vend ku do të bëhet peligrinazh, në të cilin gjendet një krua nga ku buron ujë. Fakti që ai është një vend ku do kryhet peligrinazh na tregon qartë se e tillë gjë nuk presupozon tjetër përveçse faktin se një Mesazh i Ri Hyjnor do të vijë dhe se ky vend do të bëhet objekt peligrinimi dhe adhurimi pikërisht përmes këtij Mesazhi të Ri Hyjnor. Po në Psalmet e tij, Daudi -paqja e Allahut qoftë mbi të- thotë: "Një ditë adhurim në tempullin Tënd është më mirë se njëmijë ditë në tjetër vend". Ne kuptojmë se Daudi -paqja e Allahut qoftë mbi të- bën fjalë këtu për Qaben pasi dimë se në Qabe namazi, që është një nga format më

madhështore të adhurimit të Zotit, është i barazvlefshëm me njëqindmijë namaze diku gjetkë...

Ajo që është për të ardhur keq është se qëllimisht dhe për motive dezinformuese emri "Beke" i vendit në fjalë, që në versionin në anglisht vjen me gërmë të madhe për të treguar se ai është emër i përveçëm i një vendi të caktuar, në përkthimin në arabisht shndërrohet në "Buka" që do të thotë lugina e Lotëve për t'u tjetërsuar fraza në fjalë nga "...ata do të kalojnë për në Peligrinazh nëpër luginën e Bekes..." në "...ata do të kalojnë për në Peligrinazh nëpër luginën e Lotëve...". I Dëlirësuar është Allahu nga dashakeqësia e tyre për të deformuar të vërtetën. Ç'është kjo Luginë e Lotëve?! Jo, jo, këtu bëhet fjalë thjeshtë për Beken-Meken. Ku është kjo Luginë e Lotëve? Ajo nuk figuron gjëkundi as në historikun e hershëm dhe as në atë bashkëkohor të këtyre territoreve?! Keqinformim i qëllimshëm dhe i qartë që mund të konstatohet pa shumë mund si i tillë qoftë edhe nga një studiues modest i Ungjillit të ditëve tona.

Po kështu në Librin e Gjenezës, kapitulli 21, artikujt 21-22, versionin bashkëkohor, vjen: "Dhe Zoti ishte me djaloshin..."; ku bëhet fjalë për të nderuarin tonë Ismailin -paqja e Allahut qoftë mbi të-, atëherë kur i nderuari ynë Ibrahimi -paqja e Allahut qoftë mbi të- e la Haxhirenë dhe djalin e tij Ismailin në Meken e shkretë dhe të pabanuar të asaj kohe, në përmbushje të urdhërit të padiskutueshëm hyjnor. "Dhe Zoti ishte me djaloshin, i cili u rrit dhe jetoi në shkretinë. U rrit duke u bërë një harkëtar i aftë. Ai jetoi në shkretinën e Paranit ..."; dhe Parani siç është përmendur më herët, shpjeguar nga vetë shkrimet e shenjta ungjillore, presupozon Beken-Meken.

Gjithashtu në Librin e Deuteronomisë, në kapitullin 30, artikullin 2, vjen: "Zoti erdhi nga Sinai, agoi nga Sairi dhe ndriçoi nga mali i Paranit". "Sairi" janë disa vargmale në luginën Akabe ku jetoi i nderuari ynë Jezusi-Isai -paqja e Allahut qoftë mbi të-, ndërsa mali i Paranit është zona e Mekes.

I Dëlirësuar është Allahu! Çfarë do të thotë kjo frazë e Biblës?! Ajo që kjo frazë e qëllimtë do të thotë është se në zonën e tretë të përmendur (zonën e Paranit-Mekes) do ketë një Shpallje Hyjnore. Pse? Sepse në frazën biblike në fjalë thuhet: "Zoti erdhi nga Sinai..." ashtu që në këtë zonë iu zbrit Shpallja Hyjnore të nderuarit tonë Musait -paqja e Allahut qoftë mbi të-; "...agoi nga Sairi..." ashtu që në këtë zonë iu zbrit Shpallja Hyjnore të nderuarit tonë Jezusit-Isait -paqja e Allahut qoftë mbi të-; dhe vjen më tej "...vezulloi nga mali i Paranit-Mekes" që në kontekstin në fjalë do të thotë se në këtë zonë do sillet nga Allahu i Lartësuar një Shpallje Hyjnore edhe më e ndritëshme se dy të parat.

Fakti që po përcjellim, vjen shumë qartë në Librin e Isaias, duke e nxjerrë sheshazi këtë gjë ashtu që thuhet: "...shpallje nga viset e arabisë...". ALLAHU EKBER. Pra do sillej një Shpallje Hyjnore që do kishte për vatër viset arabe.

Një sërë pyetjesh kërkojnë përgjigje kundrejt faktit se cili është në të vërtetë ai Profet që karakterizohet dhe posedon karakteristikat me të cilat lajmi i mirë biblik karakterizon Profetin që pritet të vijë:

Cili qe ai profet që erdhi nga pasardhësit e të nderuarit tonë Ismailit -paqja e Allahut qoftë mbi të-?! Kush ishte ai Profet që u titullua "Kreu i Kulmit"?! Kush ishte ai Profet që ishte prej vëllezërve të izraelitëve?! Kush ishte ai Profet përmendja e të cilit do ngrihej lartë e më lartë në Meke, e cila nën udhëzimet profetike të tij do bëhej një destinacion mbarëbotëror peligrinimi?! Kush ishte ai Profet nga viset arabe të cilit iu shpall Shpallje Hyjnore?! Kush tjetër veç Profetit Muahamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-?!

Perifrazimet e përmendura vijnë nga vetë shkrimet e shenjta biblike dhe ende janë prezente në to; dhe nëse një studiues sado modest i tubon dhe sinkronizon, ato nuk vijnë përveçse në funksion të profetësisë së Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Një tjetër fakt që vlen të përmendet është se në shkrimet e shenjta vijnë gjithashtu cilësi dhe tipare të personit të Profetit që do dërgohet; dhe ne do bëjmë fjalë për ato prej tyre që i gjejmë prezente në shkrimet e shenjta biblike edhe sot në ditët tona.

Këtë fakt Allahu i Lartësuar e përmend në Kurani Famëlartë ku lidhur me sa në fjalë thotë: "Ata të cilët ndjekin Profetin, Lajmëtarin, që s'din shkrim dhe këndim, të cilin e gjejnë të përmendur tek ta në Teurat dhe Ungjill…".

Kur iu futa studimit që po prezantoj, mendova se kundërshtarët e Kuranit dhe Islamit, sidomos në Biblën e ditëve tona, nuk do kishin lënë asgjë ku të bëhej fjalë pro kësaj tematike që po trajtojmë; por në fakt gjeta se një e gjë e tillë ishte prezente në Bibël.

Në Librin e Isaias, hidhet dritë qartë mbi cilësitë dhe karakteristikat e Profetit të Ri që do dërgohet; porse kjo mund të hetohet vetëm në kopjen e Biblës që qarkullon në versionin anglisht, ndërsa në atë që qarkullon në gjuhën arabe janë bërë tjetërsime dhe dezinformime. Ndoshta fakti qëndron në atë se anglezët nuk e disponojnë kulturën e pranishme në vendet arabe rreth detajeve të personit të Profetit tonë të nderuar Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, teksa tek arabët një gjë e tillë njihet mirë. Në këtë kuadër, tek Libri i Isaias, lidhur me Profetin që do sillet thuhet: "I thuhet atij: 'Lexo'; dhe ai thotë: 'Unë nuk jam i mundshëm të lexoj". ALLAHU EKBER! Cili është Profeti të cilit iu tha "Lexo" dhe ai tha "Unë nuk jam i mundshëm të lexoj", përveç Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-; i cili ndërkaq ceket se ishte prej viseve arabe, nga vendbanimet ku patë jetuar Kidari; i cili ishte nga Parani-Mekja?! Kush tjetër veç të nderuarit tonë Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i mishëron në personin e tij karakteristikat në fjalë?!

Ndërsa tani ju ftoj të shikoni sesi e kanë keqpërkthyer dhe keqinterpretuar në arabisht perifrazimin biblik në fjalë, ashtu që ky perifrazim në arabisht është deformuar në: "I

thuhet atij: 'Lexo'; dhe ai thotë: 'Unë nuk di të shkruaj". Lind pyetja atij iu tha: "Lexo" apo iu tha: "Shkruaj"? Shiko sesa naivisht kanë manovruar ata të cilët kanë bërë përkthimin e Biblës në versionin në gjuhën arabe… duke pretenduar se nuk kanë dalë nga konteksti duke qenë se ai që nuk di të lexoj nuk di as të shkruaj; teksa pyetja që imponon vetveten është: Përse kjo ndërhyrje e paprecedent tek tekstet hyjnore?! Përse ato nuk janë përkthyer në përputhje me materialin mëmë në gjuhën angleze?!

Po në Librin e Isaias, kapitulli 9, artikulli 6, flitet rreth një shenje në shpatullën e Profetit që do dërgohet; tekstualisht thuhet: "Shenja e legjitimitetit të tij është në shpatullën e tij dhe emri i tij me të cilin do të thirret do të jetë i çuditshëm". LA ILAHE IL ALLAH-NUK E MERITON ME TË DREJTË TË ADHUROHET ASKUSH PËRVEÇ ALLAHUT. Emri i Profetit tonë -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ishte Muhamed dhe ishte një emër i çuditshëm, i pazakontë në mesin e arabëve. "Shenja e legjitimitetit të tij është në shpatullën e tij dhe emri i tij me të cilin do të thirret do të jetë i çuditshëm"; kështu pra shkruhet në Librin e Isaias. Ne muslimanët disponojmë në transmetimet autentike të Bukhariut dhe Muslimit në adresë të një numri prej disa shokësh (sahabeve) -Allahu qoftë i kënaqur me to- të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, se ata e kanë dëshmuar tek Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- këtë shenjë apo damkë-vulë e cila ishte damka apo vula e profetësisë së tij. Tek Bukhariu vjen se Sejib Ibn Jazidi ka thënë: "…më pas u ngrita i shkova nga shpina dhe pashë midis shpatullave të tij një damkë-vulë". Nga Xhabir ibn Semura -Allahut qoftë i kënaqur me të-, në një thënie të konfirmuar nga Muslimi si autentike vjen: "Pashë një vulë mbi shpinën e Profetit Muhamed që i përngjasonte vezës së pëllumbit". Po në këtë kontekst dhe ngjashëm me këtë vjen edhe ajo që përcjell Abdullah ibn Serxhesi -Allahu qoftë i kënaqur me të-, në një thënie të konfirmuar nga Muslimi dhe Ahmedi si autentike. Në vazhdën e sa në fjalë tregohet se i nderuari ynë Ebu Dheri -Allahut qoftë i kënaqur me të- kërkonte dhe hetonte në lidhje me Profetin që do dërgohej, pasi në udhëtimin e tij në kërkim të fesë së drejtë i patë ndodhur të robërohej nga kusarët e të bartej nga një vend në tjetrin derisa përfundoi në Medine ku ende mbante në kokë thënien e një murg që i kish treguar se kjo ishte koha kur pritej të dërgohej dhe shfaqej një Profet që posedonte disa shenja ndër të cilat ishte vula profetike në shpatullën e tij. Në vijim të historisë së tij në kërkim të fesë së vërtetë, thotë: Kur erdha tek Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i dhashë selam, pastaj u rrotullova të shikoja tek shpina e tij nëse ishte vula e cila m'ë ishtë përshkruar. Kur Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- më pa t'i sillesha nga pas shpine e kuptoi që unë desha të verifikoja diçka që më qe përshkruar, me ç'rast e mënjanoi rrobën e tij nga zona e shpinës dhe unë pashë vulën dhe e kuptova".

Ndërkaq një tjetër frazë që është ende prezente në Bibël është ajo në Psalmet e Daudit -paqja e Allahut qoftë mbi të- ku thuhet: "Është derdhur mirësia në dy buzët e tua, prandaj dhe Allahu të ka bekuar amshimisht. Ngrehe shpatën tënde…"; mirësia e derdhur në dy buzët është pra Shpallja Hyjnore dhe aludim për faktin se ky Profet nuk di as të lexojë dhe as të shkruaj, porse përmes buzëve të tij ai e përcjell Shpalljen

Hyjnore që i zbret Allahu; teksa me "...Allahu të ka bekuar amshimisht..." aludohet tek salavatet dhe bekimet që të gjithë ne dërgojmë mbi Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- në çdo namaz që falim, kur themi në pozicionin e namzit të Tehijatit-Përshëndetjes: O Allah dërgo lavdërimin tënd mbi Profetin Muhamed dhe familjen e Profetit Muhamed ; dhe themi vazhdimisht "O Allah dërgo bekimin tënd mbi Profetin Muhamed dhe familjen e Profetit Muhamed...". Kush është ai Profet të cilit i dërgohen lutje të pandërprera për bekime hyjnore që prej kohës kur këto shkrime të shenjta bëjnë fjalë për këtë gjë?! Ai është Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Normal që ne bëjmë lutje t'i dërgohen bekime hyjnore edhe të nderuarit tonë Ibrahimit -paqja e Allahut qoftë mbi të- por ai dihet se pati jetuar para Daudit -paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe Psalmeve të tij, teksa këtu bëhet fjalë për Profetin e Pritshëm. Ndërkaq në vijim psalmet e Daudit vijojnë duke i thurrur lavde këtij Profeti dhe thonë: "...Allahu të ka bekuar amshimisht. Ngrehe shpatën tënde..."; duke aluduar në faktin se ai posedonte shpatë dhe me të do luftonte; gjë kjo që përputhet me Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- epoka e të cilit i përkiste asaj të shpatës, teksa tanimë kjo epokë ka mbaruar.

Nga frazat biblike që në përshkrimin e viseve ku do sillej Profeti i Ardhshëm orientojnë qartazi rreth vendit dhe viseve të banimit të Profetit tonë të nderuar Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- është fraza në vijim e cila gjendet prezente sot e kësaj dite në Librin e Isaias, kapitulli 20, artikujt nga 13-16, ku thuhet: "Shpallje nga viset arabe, në pyjet, në viset arabe do bujtoni o karvanët e Dedenijëve (Dedamitëve)...". Dedenijtë janë prej një zone të quajtur Deden, një qytet fqinj i Tejmesë, dhe që aktualisht gjendet më pranë qytetit të Medines sesa Tejmei, teksa dihet që Tejmei konsiderohet nga zonat që janë nën juridiksionin administrativ të Medines. "Sillni ujë të eturve o banorët e tokës së Tejmesë. Të arratisurit sillini bukë sepse ata nga përpara shpatave janë arratisur". Shikoni sesi bëhet fjalë për Profetin që vjen në Medine nga arratia dhe u thuhet banorëve të saj t'i sjellin bukë dhe ujë, ai ka ardhur duke iu shmangur shpatave. Kush është ai Profet të cilit i përgjigjen dhe i vijnë për shtat këto karakteristika, kush, kush tjetër veç Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-?!

Në vazhdën e shkrimeve të heshme të konsideruara të shenjta veç atyre të hebrenjve dhe të krishterëve, të cilat i cekëm më herët, kemi dhe Librin e Shenjtë Hindus "Bihoshi Bihoshi Branëm" ku vjen qartazi përshkrimi lidhur me ndjekësit-shokët e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-; gjë lidhur me të cilën këtu thuhet: "Ata janë të tillët që bëhen synet, nuk e kultivojnë të qethurën kazea (pjesën e sipërme të flokëve të gjata dhe pjesën poshtë kësaj krejt të shkurtuar), i rrisin mjekrat e tyre, janë luftëtarë dhe i thërrasin njerëzit në lutje me zë të lartë (bëhet fjalë për namazin definicioni gjuhësor i të cilit është lutje, ndërsa zëri i ngritur thirrës në namaz është ezani), i hanë shumicën e kafshëve përveç derrit, nuk e përdorin Durben për t'u pastruar (gjethe pemësh që përdoret nga hindusët për pastrim mëkatesh) porse tek ata

martirët janë të pastërtit; këta quhen musli". "musli" nënkupton muslimanët por për shkak të kohezionit të teksteve dhe deformimit të tyre vjen "musli".

Kush Profet ka ndjekës të cilët përshkruhen me gjithë karakteristikat në fjalë, kush veç Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-?!

Ndërsa përsa i përket përmendjes së fesë së tij dhe fesë që ai solli kemi atë që thamë pak më herët në librin e Isaias ku thuhet: "Le t'a ngrejë terreja dhe vendbanimet e saj zërin lartë, shtëpitë e banuara nga Kidari, që banorët e vendbanimeve të brohorasin nga kreshtat e maleve të cilët do thërrasin duke brohoritur lavdinë e Zotit"; nga kreshtat e maleve kush brohoret, e përgjigja është se ata janë muslimanët që brohorasin lavdinë e Zotit përmes thirrjes së ezanit.

Në Librin e Sofonias, kapitullin 3, artikujt 9-10, vjen: "Sepse Unë atëherë do t'i shndërroj popujt (tërësisht) në një gjuhë të pastër me qëllim që të gjithë të thërrasin në emrin e Zotit duke e adhuruar në një sup të vetëm (sup më sup)". Kuptimi "në një sup të vetëm" është duke qenë në një rresht të vetëm sup në sup, gjë që është evidente për adhurimin më madhështor të muslimanëve, namazin, i cili, siç vjen edhe në frazën biblike në fjalë, ka unifikuar besimtarët e vërtetë në adhurimin e Zotit.

Allahu i Lartësuar në Kuran thotë: "T'a zbritëm Librin (Kuranin) sqarues për çdo gjë". Le të shikojmë atë që vjen në Librin e Johanës, përmes gjuhës së të nderuarit tonë Jezusit-Isait -paqja e Allahut qoftë mbi të-: "Por kur të vijë Shpirti i së vërtetës, ai është ai i cili do t'ju orientojë tek e mira në tërësi, sepse ai nuk flet nga vetvetja porse flet nga ajo që dëgjon (me kuptimin se ai nuk di të lexojë por shpalljen e merr përmes dëgjimit dhe e përcjell) dhe ju bën ju me dije rreth çdo gjëje që do të vijë".

Po kështu Ungjilli prezent sqaron se drejtimi i të falurit drejt Shtëpisë së Shenjtë (Bejtul Makdesit) në Palestinë do të ndryshohet dhe anullohet. Kjo vjen në historinë e gruas nga Samaria e cila shkoi të vizitonte Jezusin dhe ai i tha: "Baballarët tanë patën bërë sexhde (lëshoheshin në lutje me ballë përtokë) në këtë mal. Dhe ju thoni se në Orshalim (Kuds-Jeruzalem) është vendi ku duhet rënë në sexhde. Jezusi i tha asaj: O grua! Besomë, do vijë koha që as në këtë mal dhe as në Jeruzalem keni për të bërë sexhde"; nënkuptohet se do vijë koha që drejtimi i të falurit nuk do jetë as atje dhe as atje, porse ai do të ndryshojë. Kjo vjen në konkretizim të faktit se kur Allahu i Lartësuar solli urdhëresën përmes së cilës bënte ndryshimin e venddrejtimit të faljes tha: "Drejtoje (kur të falesh) fytyrën tënde drejt Xhamisë së Shenjtë (Qabes) dhe kudo që të gjendeni fytyrat tuaja t'i drejtoni drejt asaj. Ata të cilëve u janë dhënë shkrimet e shenjta e dinë se e tillë gjë është e vërteta prej Zotit të tyre".

Për të konkluduar, edhe pse emri i Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- në versionet bashkëkohore biblike është eliminuar, sërisht kanë mbetur të qarta në të cilësitë e Profetit të Pritshëm të cilat nuk përputhen përveçse me Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-; duke u dëshmuar kështu

njerëzve për këtë të vërtetë të qartë e të pakontestueshme, që përcjellin shkrimet e shenjta nga hershmëria. Teksa në disa prej shkrimeve jobiblike të konsideruara të shenjta, sikurse ç'e përmendëm më herët përbri referencave përkatëse, tekstet referojnë qartazi emrin e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

E gjithë kjo tregon se lajmi i mirë përgëzues mbi ardhjen e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ka ngjarë, se profetët e kanë sjellur dhe përçuar këtë lajm të mirë, se shkrimet e hershme të shenjta e kanë mbartur këtë emër fisnik, dhe se ai që vihet në kërkim të së vërtetës dhe në ndjekje të saj ka për të gjetur këtë që thamë.

Bazuar në këtë, një tjetër argument i fuqishëm prej argumenteve arrin dhe njerëzit mësojnë vërtetësinë e profetësisë së Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Marshall Xhonson (14)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Në episodet e kaluara kemi folur rreth pozicionimit të disa prej krerëve të shkencave ekzakte kundrejt mrekullisë shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike.

Sot do vijojmë bisedën rreth një grupi tjetër prej krerëve të këtyre shkencave.

Do bëjmë fjalë rreth profesorit Marshall Xhonson dhe një grupi shkencëtarësh të tjerë. Profesor Marshall Xhonson është nga Amerika dhe i takon stafit pedagogjik të Universitetit të Mjeksisë në Xheferson të Filadelfias. Ishte pjesëmarrës në një konferencë ndërkombëtare prej atyre që organizoheshin në kuadrin e Mrekullive Shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike në fillimin e të cilës më pyeti se përse e kisha thirrur në atë sallë. I thashë, kjo është një dhomë enkas për Bordin e Mrekullive Shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike. Më tha, e ç'është Mrekullia Shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike?! I thashë, Mrekullia Shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike është një shkencë lëmi i hulumtimit të së cilës janë provat shkencore të vërtetuara në kohët tona të cilat janë përmendur në Kuran dhe në Traditën Profetike para 1400 vjetësh. Sakaq m'u kthye dhe më tha, si çfarë për shembull? I zgjodha atij një shembull në lëmin e njohurive të tij, i thashë, ju shkencëtarët në shekullin XVII shpreheshit se njeriu në fillesat e tij gjendej i zimpuar brenda spermatozeidit në trajtën e qenies së plotë njerëzore. Këtë skicim, që sjell të skicuar presupozimin shkencor të asaj kohe sesi njeriu në lëngun gjenital spermatozeidal gjendej në trajtën e qenies së plotë njerëzore, e gjen të ilustruar edhe në librat e sotëm shkencor. Më pas ky presupozim ndryshoi duke u zhvendosur tanimë në vezoren e nënës, gjë kjo që daton me shekullin XVIII. Kështu pra e tillë gjë mund të shihet qartazi në librat e mjekësisë që flasin për fazat e zhvillimit të shkencës së embriologjisë. Do gjesh aty një foto të spermatozeidit brenda të cilit paraqitet njeriu një i tërë, me kokën të stërzmadhuar e të drejtuar përnga koka e spermatozeidit dhe me dy duart, trupin dhe dy këmbët e tij. Ky presupozim u morr si i mirëqenë nga shkencëtarët e asaj kohe përgjatë gjithë shekullit të XVII-të. Më pas, në shekullin e e XVIII-të, pasiqë u zbulua vezorja, shkencëtarët e asaj kohe u tërhoqën nga kjo bindje dhe thanë, jo, e sakta është se miniatura e njeriut të plotë nuk gjendet në spermatozoid por gjendet brenda vezores së nënës, bindje kjo që në fakt dominoi deri në mesin e shekullit të XIX-të. Pastaj, i thashë, ju shkencëtarët profesor Marshalli, u tërhoqët edhe nga kjo bindje dhe thatë jo, jo, anotomia e njeriut kompletohet në disa faza. Tha, po, kjo që the është e saktë. I thashë, tek ne e tillë gjë gjendet e përmendur në Kuran, ku në kuadrin e kësaj thuhet se njeriu në realitet është

krijuar në disa faza. Ishte ulur… U ngrit e tha, jo, jo, jo, s'ka mundësi. I thashë, ulu o profesor. Refuzoi të ulej derisa ia dërguam Kuranin dhe i thamë, urdhëro, ja ku e ke, duke i lexuar komentimin e thënies në fjalë në gjuhën angleze, ku Allahut i Lartësuar thotë: "Si është puna juaj që nuk po i jepni Allahut respektin e duhur, teksa është Ai që ju krijoi në faza". Më tej i lexuam atij edhe fjalën e Allahut të Lavdishëm dhe të Lartmadhërishëm: "Vërtetë që Ne e krijuam njeriun prej një ajke (lëngu), e një balte. Pastaj atë (ajkë - baltë) e bëmë (e shndërruam) pikë uji (zigotë) në një vend të sigurt. Më pas, atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të mpiksur e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruam në eshtra, dhe eshtrave ua mveshëm mishin, pastaj atë-njeriun e bëmë krijesë tjetër (me shpirt). I lartë është Allahu, më i miri Krijues!". Më tha, tani po, ulu. Dhe vijoi e tha, porse sa në fjalë është peng i tre supozimeve. I thamë, e cilat janë ato? Tha, ka gjasa që Muhamedi t'a ketë thënë këtë rastësisht. I erdhëm me 25 tekste nga Kurani dhe Tradita Profetike që flisnin të gjitha për fazat e zhvillimit embrional të foshnjes në barkun e nënës duke e titulluar gjithësecilën fazë me emrin përkatës. I thashë, Kurani e ka emërtuar çdo fazë me emrin e saj, si pra të jetë sa në fjalë një rastësi teksa Kurani secilës faze i jep një emërtim adekuat, Nutfa-Pikëlz, Alaka-Vemëz, Mudga-Çapëz, e kështu me rradhë. Tha, e pranoj, supozimi se e tillë gjë është një rastësi nuk qëndron. I thashë, mirë, e ç'tjetër ngeli? Tha, Muhamedi posedonte mikroskopë të fuqishëm. Diskutuam rreth këtij presupozimi dhe sesi çështja e mikroskopëve ka të bëjë me teknologjinë e lenteve dhe thjerrëzave, gjë që nëse do kish qenë evidente në kohën e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- nënkupton që asokohe të ketë patur fabrika moderne produktuese për të tillë mjete dhe gjithashtu i bie që edhe fabrikat edhe produktet e tyre të kenë qenë të trashëguara nga pararendësit e epokës së Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe të kenë qenë në evoluim e sipër pas epokës së Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Gjithashtu logjikisht duhej që teknologjia në fjalë të ishte refkeftuar në epokat në fjalë në aspektet e ndryshme të jetës. I thashë, profesor, në Kuran gjenden detaje të përpikta rreth përshkrimit të jetës së embrionit të cilat nuk i keni ditur as ju përveçse pas vitit 1945. Kurani ka përmendur edhe çfarë ka të bëjë me përcaktueshmërinë dhe përgatitjen seksuale të embrionit teksa ai është Nutfa-Pikëlz në fazën e fertilizimit, gjë rreth të cilës ju nuk posedonit asnjë dijeni derisa u zbuluan kromozomet. Tha, si çfarë për shembull? I lexova thënien e Allahut të Lavdishëm dhe të Lartmadhërishëm: "Qoftë mallkuar njeriu, sa mohues i fortë është ai! Po prej ç'gjëje e krijoi Ai-Allahu atë? E krijoi prej një Pikëlze Gjenitale dhe e përgatiti." Vini re sesi citohet se Allahu teksa embrioni njerëzor qe Nutfa-Pikëlz Gjenitale e krijoi dhe e përgatiti atë, ashtuqë i tërë programi i përcaktueshmërisë së karakteristikave njerëzore është përmbushur në fazën e Nutfas-Pikëlzës Gjenitale. Dhe, i thashë, pjesë e kësaj përcaktueshmërie dhe përgatitje është edhe përcaktimi i seksit. Në fakt ajo që dihet nga masa e gjerë e njerëzve është se seksi del në pah në fazën e mveshjes së mishtë dhe kockëzimit kur krijohen organet gjenitale. Ndërsa në fazën e Nutfas-Pikëlzës Gjenitale nuk janë prezentë as mishi, as kockat dhe as organet gjenitale. Porse vjen shkenca, pas vitit 1945, periudhë në të cilën u zbuluan kromozomet, dhe njeh faktin se seksi dhe përkatësia gjenitale e embrionit përcaktohet

në varësi të kombinimit gjenetik nëpërmjet programimit të bërë përmes niveleve të kodit gjenetik, ashtuqë spermatozeidët e ardhur nga babai që përmbajnë kromozomet Y, pra kanë formën e Y-së, në rastin e pranisë së tyre në fertilizim do të thotë se embrioni do jetë mashkull, ndërsa nëse këto spermatozeidë janë të formës X kjo do të thotë se në rastin e pranisë së tyre në fertilizim embrioni do jetë femër. Ju jeni te vetëdijshëm lidhur me këtë fakt i cili është përmendur edhe nga Kurani që revelon se organi gjenital i embrionit përcaktohet që në periudhën e Nutfas-Pikëlzës Gjenitale: "Është Allahu Ai që krijoi palën njerëzore, mashkullin dhe femrën, nga lëngu gjenital-sperma kur lëshohet". E vuri buzën në gaz. I thashë, përse qeshe? Tha, më erdhi ndër mend se mikroskopi i parë në botë u projektua në shekullin XVI dhe kur e përdora atë pashë se nuk detajonte ndonjë gjë, dhe pikërisht duke qenë se ai nuk zmadhonte dhe detajonte gjë ky qe edhe shkaku përse shkenctarët e skicuan njeriun si qenie e plotë brenda strukturës së spermës. Ky mikroskop ishte i paqartë ndaj dhe imazhin që po studjonin e përmbushën nga koka e tyre. I thashë, çfarë gjëje tjetër mund të thuhet o profesor? Tha, mbeti të thuhet një gjë e vetme, se Muhamedi është i Dërguar i Allahut - lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Është ky profesor ai që më pas qe pjesmarrës në një sërë konferencash mjekësore ku prezantoi hulumtime të detajuara dhe të përpikta rreth embrionit në barkun e nënës përgjatë fazës së Lëngut Gjenital deri tek ajo e Zigotës. Paraqiti një hulumtim shumë të arrirë rreth embrionit njerëzor në fazën e Nutfas, hulumtim që gjendet edhe në një libër të përpiluar lidhur me Mrekullinë Shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike, autor të të cilit janë një grupautorësh elitarë të perëndimit të profilizuar pikërisht në shkencën e embriologjisë. Hulumtimi i tij në këtë libër ilustrohet me figura reale lidhur me fazën embrionale nga spermatozeidi dhe vezorja e deri tek zigota. Këto hulumtime ai i prezantoi në konferencat ndërkombëtare mbajtur në kuadrin e Mrekullive Shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike, prej të cilave qe dhe Konferenca e Moskës. Në një rast kur po bisedonim me të ai na tha: Tanimë unë studentëve të mi (teksa studentët e tij janë ata që synojnë të mbrojnë nivelin e doktoraturës) u mësoj termat kuranor të embriologjisë: nutfe, alaka, mudga, idham, duke qenë se ato i kamë parë t'u vijnë atyre në ndihmë më mirë. Në një rast tjetër na tha: Nëse ne do kishim këto realitete që ju posedoni do e kishim trazuar mbarë botën dhe s'do e kishim lënë të qetë.

Ndërsa me profesor G. C. Gouringer që punon për Universitetin George Town, në Washington D. C. kryeqytetin amerikan, patëm një takim të gjatë ku diskutuam dhe hulumtuam lidhur me historikun e shkencës së embriologjisë. Prej sa ai u shpreh ishte edhe prononsimi i tij se e gjithë historia nuk kishte cekur dhe dhënë lidhur me fazat e embriologjisë asnjëherë terma të përpiktë dhe të detajuar ashtu siç i kishte përmendur dhe i kishte dhënë ato Kurani, gjë e cila në fakt i përmbahej fjalës së Allahut të Lartësuar: "Nuk u treguam neglizhentë karshi kreaturës Sonë".

Ky profesor gjithashtu mbajti një referat lidhur me çështjen në fjalë si dhe qe pjesmarrës në një sër konferencash ndërkombëtare mbi Mrekullitë Shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike. Në një prej hulumtimeve të tij profesor G. C. Gouringer

përmend një çështje që është vërtetë e rëndësishme, faktin se është krejt e mundur të ndodhë që të vijë në ekzistencë një gjallesë mashkullore pa patur atësi, pa qenë e nevojshme prania e babait, gjë e cila është evidente në botën e kafshëve. Shembull për sa në fjalë kemi tek bleta, ku mashkulli vjen në ekzistencë vetëm nga bleta femër pa qenë pjesë e fertilizimit pala mashkullore, pra pa qenë i nevojshëm pllenimi midis mashkullit dhe femrës. I thashë, ju si të krishterë a nuk gjeni në këtë gjë përafrim lidhur me problematikën e lindjes pa baba të Jezusit, i cili u lind vetëm nga nëna e tij?! Paskemi gjallesa të cilat janë të lindura vetëm nga femrat prej sojit të tyre dhe pa qenë nevoja për një baba. Pastaj shembulli i Ademit -paqja qoftë mbi të- është edhe më i mahnitshëm, sesi ai erdhi në jetë pa nënë dhe pa baba.

Një tjetër shkencëtar amerikan nga Tennessee i Memphisit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që punon për llogari të universitetit të Memphisit, është shkencëtari i famshëm i atjeshëm profesor Julius Simpson, i specializuar në gjenetikë. Ai gjithashtu ka qenë pjesmarrës në disa konferenca ndërkombëtare mbi Mrekullitë Shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike ku tha fjalën e tij rreth mrekullisë shkencore të Kuranit dhe Traditës Profetike. Prej hulumtimeve që ai prezantoi përmendim atë të disa sekreteve të shkencës së gjenetikës që konsistojnë në faktin se tek i sapolinduri mund të dalë në pah një karakteristikë që nuk gjendet as tek i jati dhe as tek etërit e tij të afërm, porse që mund të ketë qenë karakteristikë e ndonjë paraardhësi prej etërve të tij të mëhershëm. Shkak për këtë është fakti se e tillë karakteristikë është e prapambetur në spikatje dhe nuk është shfaqur as tek babai dhe as tek gjyshi, porse kjo karakteristikë vjen e spikat tek i sapolinduri si rezultat i triumfimit të dejeve apo kromozomeve të etërve të tij të mëhershëm. Sot shkenca e mjekësisë dhe embriologjisë e ka trajtuar sa në fjalë dhe pranon se një gjë e tillë është rezultat i karakteristikave (gjeneve) të prapambetura dhe të abdikuara-dorëhequra nga hershmëria atërore që vjen koha dhe mund të spikasin në breznitë e gjeneratave shumë të mëvonëshme. E ceku këtë fakt duke cituar se kjo është ajo që është përmendur nga i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- kur atij i erdhi një nomad (bedeuin) nga bijtë e fisit Fezera i cili ishte i në një gjendje të trazuar për shkak të një fëmije që i kishte lindur zezak teksa as aid he as e shoqja nuk ishin zezak. Me ç'rast Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i dha atij një mësim lidhur me faktin se ku qëndronte çështja, duke i dhënë shembull me atë të deveve. I tha, a ke deve? Ai i tha, po. I tha, çfarë ngjyrash i ke? Tha, të kuqërremta. Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i tha, a ke midis tyre ndonjë gri? A ke ndonjë ne ngjyrë hiri? Ai iu përgjigj, kam një prej tyre që është ngjyrë hiri. Profeti i tha, ç'thua lidhur me këtë? Me kuptimin që nga erdhi ajo, të gjitha të kuqërremta ndërsa ajo ngjyrë hiri, nga ku i erdhi ngjyra e hirit? Duke e bërë nomadin të vetëperceptojë se ngjyra e të birit ishte karakteristikë e etërve të mëhershëm, ishte vetëmohuar për ca kohë e më pas ishte shfaqur në një gjeneratë të vonëshme. Kështu nomadi perceptoi dhe ju përgjigj Profetit për pyetjen që i bëri duke i thënë, ka gjasa të ketë dominuar tek ai ndonjë damar trashëgimnie. Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut

qoftë mbi të- ia ktheu, edhe tek ky fëmijë ka gjasa të ketë dominuar ndonjë damar (gjen) trashëgimnie.

Pas kësaj hyrje me këtë hadith të mrekullueshëm peofetik, në vijim ai foli rreth cilësive të abdikuara-vetëmohuese dhe atyre dominuese gjenetike, duke i trajtuar ato mirë e bukur dhe duke konkluduar se i tillë fakt i përmendur nga Muhamedi nuk mund t'i dedikohej një njeriu dosido, porse kjo e dhënë e pakontestueshme shkencore i kishte ardhur Muhamedit padyshim prej Allahut të Lartësuar.

Një tjetër profesor për të cilin dua të bëj fjalë është Taxhata Taxhoson, Rektor i Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Shiang Mait në Tailandë. Në takimin e parë që patëm më tha, edhe ne në fenë budiste kemi shkrime që bëjnë fjalë për realitete që hedhin dritë mbi të dhëna që përputhen me shkencat bashkëkohore. I thashë, jam në pritje të m'i sjellësh. Në vitin në vijim kur u takuam më tha, bëra një verifikim lidhur me atë që të pata thënë dhe më doli në pah se paskërkam qenë i gabuar. Ajo që të pata përcjellur më kishte arritur nga një doktoreshë që nuk ish bazuar në burime autentike. Me tëj patëm së bashku diskutime të gjata... Rezultati ishte që në një prej konferencave ndërkombëtare mbi Mrekullitë Shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike ai deklaroi se po pranonte publikisht hyrjen e tij në Islam. Ajo që kam dëgjuar më tej në adresë të tij është fakti se qindra të tjerë janë influencuar pozitivisht më pas nga ky profesor i nderuar dhe nga islamizimi i tij.

Një tjetër profesor, këtë radhë nga Japonia, nga Tokio, është profesor Yushidu Cozai, që punon në Departamentin Shkencor të Observatorit. Pasi u takuam me këtë profesor dhe iu bënë të ditura të vërtetat shkencore Kuranore dhe Profetike që flasin në lidhje me universin tha, ky Kuran flet dhe e përshkruan universin nga kulminacioni më superior i tij. Kështu, Ai që e përshkruan universin përmes Kuranit e përshkruan atë nga sipër-poshtë duke nxjerrë në pah sesi Ai është Gjithkqyrës i çdogjëje në këtë ekzistencë. Teksa në kontaktin e parë që patëm me këtë profesor të shquar të shkencës së Monitorimit të Lëkundjeve Sizmike (tërmeteve) ai na tha, ju fetarët nuk keni gojë të flisni për shkencë. I thamë, e përse? Tha, sepse ju po folët ndizni luftëra botërore. I thashë, mos u nxito o profesor! M'u përgjigj pak se kush e ndezi Luftën e Parë Botërore, po Luftën e Dytë Botërore kush e ndezi?! Heshti. Tha, i lemë këto e futemi në diskutimin tonë. Pasiqë diskutuam dhe pa mrekullitë shkencore të Kuranit, në takimet e fundit që patëm u shpreh se do i dedikohej leximit të Kuranit që të depërtonte në realitetet që ai përmban.

Një professor tjetër është profesori Elison Palmer, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ish-Kryetar i Shoqatës së Gjeologëve Amerikanë. Në takimin që patëm, në fillim pati një si tip fërkimi midis meje dhe tij, debat dhe fërkim mbi baza shkencore jo tjetër, kjo rreth ultësirës më të ulët në botë. Kur dëgjoi t'i thoja se zona përbri qytetit të Kudsit të Palestinës, e quajtur Al Ghaur dhe e gjendur në territorin e Jordanisë, ishte ultësira më e ulët në botë, filloi të përdridhej duke thënë jo ka edhe në Evropë, Azi, Shtetet e Bashkuar të Amerikës, ka këtu e aty, në botë zona që janë ulëtsira më të ulëta, madje më të ulta se ajo që thua ti. Kur pa që unë po insistoja në opinionin tim erdhi me një maket të rruzullit

tokësor që përmbante të trupëzuar të gjitha ultësirat dhe lartësitë e botës mbi kriterin e nivelit të detit. Më tha, ku është zona për të cilën po bën fjalë? Ia tregova, ja ku është Kudsi, ja Jeruzalemi, ja dhe ultësira. Aty ai hetoi një shigjetë përbri së cilës shkruhej "Ultësira më e ulët në botë". Tha, në rregull, në rregull, ti je në rregull, por nga e ke konkluduar këtë? I thashë, nga thënia e Allahut të Lartësuar: "Elif, Lam, Mim. Bizantinët (romakët) u mundën, në tokën më të ulët...". Në arabisht {edne} bartë edhe kuptimin {më të ulët} edhe kuptimin {më të afërt}. Pastaj një tjetër debat ishte ai në lidhje me faktin se a posedonin apo jo malet rrënjë? Ai e refuzoi këtë dhe tha, do të sjellë një hartë që përmban në të të gjitha malet e Amerikës nga njëri skaj në tjetrin. E solli por ajo hartë nuk ishte skicë e relievit dhe strukturave malore por ishte hartë e mineralogjisë së maleve. S'kaluan vetëmse pak kohe deri kur një revistë shkencorë amerikane publikoi disa hulumtime dhe kërkime shkencore që kishin hedhur dritë mbi malet dhe rrënjëzimin e tyre, me ç'rast ky professor u bind rreth asja që kishim biseduar.

Një tjetër debat shkencor që patëm me këtë profesor ishte ai rreth origjinës së qiellit. Unë i thashë se origjina e qiellit është tymnaja kozmike. Tha jo, është mjegullnaja kozmike. I thashë, por mos harro se mjegullnaja është e ftohtë dhe tymnaja është e nxehtë teksa dihet logjikisht se origjina nga ku erdhën yjet ka qenë e nxehtë dhe e nxirë. Më tha, t'ja lëmë këtë hulumtimeve! Pas ca kohësh ai vetë kish parë në një revistë shkencore amerikane një studim të profesor Macanin që bënte fjalë se origjina e sistemit diellor ishte tymnaja kozmike, në anglisht "smoke". Më dërgoi haber ku më bënte me dije se unë kisha patur të drejtë në lidhje me çështjen në fjalë, pra se origjina e qiellit ishte tymnaja, gjë të cilën e gjejmë në fjalën e Allahut të Lartësuar: "Pastaj Ai-Allahu qëndroi në qiell teksa ai ishte tymnajë, duke i thënë atij edhe tokës a do vini me hir apo pahir? Ato të dy thanë, erdhëm me hir". Në fakt midis nesh patëm një bashkëbisedim të gjatë. Ai u shpreh se kjo dituri që i erdhi Muhamedit dhe të cilën ai e komunikoi nuk mund të ishte përveçse nga Zoti të Lavdishëm dhe të Lartmadhërishëm.

Një tjetër profesor është profesori nga Gjermania i quajtur Alfred Kronar, i cili është nga shkencëtarët më të shquar gjerman në lëmin e gjeologjisë. Ky profesor kur vërejti mrekullinë shkencore në Kuran dhe lexoi fjalën e Allahut të Lartmadhëruar dhe Lartësuar: "A nuk e shohin ata që nuk besuan se qiejtë dhe toka ishin një masë dhe Ne i ndamë veçmas", tha, është e pamundur që dikush të flas mbi të dhënën shkencore në fjalë dhe të tjerat që ne pamë prej të dhënave që përcjell Kurani përveç personit që i zbulohet dituria nga Allahu i Lartmadhëruar dhe i Lartësuar. Kjo pasi personi që sjell të tillë të dhënë duhet të ketë qenë i mirëinformuar lidhur me atomin dhe strukturën e tij dhe se i tërë ky univers është i strukturuar nga atomet. Është e paimagjinueshme për njeriun se uji, dheu dhe zjarri, që të gjitha ishin një masë e vetme e njëtrajtësuar, se toka ishte pjesë e diellit dhe se dielli ishte pjesë e yjeve të tjerë. As që mund të imagjinohet një gjë e e tillë. As që mund të kapej nga ndokush i gjeneratave të mëhershme fakti se origjina e universit kishte të bënte me atomet dhe thërrmijat elementare. Në fakt Muhamedi dhe koha e tij si dhe ata që jetuan në kohën e tij nuk dinin gjë prej gjëje

lidhur me këtë realitet. Së fundi tha, Kurani është libër i shkencës të cilin arrin t'a kuptojë njeriu i zakonshëm.

Një profesor tjetër është profesor Armstrong nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës që punon për Agjencinë Ndërhapësinore Amerikane NASA. Ne patëm qenë shumë të paqartë lidhur me thelbin e thënies së Allahut të Lartësuar: "E zbritëm hekurin që posedon një fuqi super të madhe…". Kjo vazhdoi derisa takuam profesor Armstrongun i cili lidhur me sa në fjalë u shpreh, është krejtësisht e pamundur që hekuri të jetë krijuar me tokën, madje është krejtësisht e pamundur që hekuri të jetë krijuar me tokën dhe me sistemin diellor. Kjo sepse kur ne studjuam energjinë e domosdoshme për formimin e atomikës së hekurit gjetëm se ajo ishte katërfishi i energjisë totale të sistemit diellor. Kështu që i bie që hekuri është një element i dobishëm i ardhur në tokë nga kozmosi dhe çdo copë hekuri që shohim në fakt ka ardhur nga kozmosi për t'u zbritur në tokë në formën e hekurit që ne shohim. Me këtë rast unë i lexova atij thënien e Allahut të Lartësuar: "E zbritëm hekurin që posedon një fuqi super të madhe…". Lidhur me këtë ai tha, vërtetë kjo është një gjë e mahnitëshme. I thashë, a ka bërë fjalë për të tillë gjë ndonjë nga shkencëtarët e mineralogjisë, gjeologjisë apo astronomisë? Tha, e dhëna në fjalë u bë e ditur për shkencëtarët vetëm me hyrjen ¼-tës së fundit të shekullit XX.

Kemi edhe profesorin tjetër anglez, profesor Nelsonin, i cili kur u vu në dijeni rreth dispozitave sheriatike dhe parimeve mjekësore higjenike të ardhura në Kuran dhe në Traditën Profetike u mahnit. Tha, më habisin muslimanët, si e lexoni dhe nuk e zbatoni thënien autentike të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ku ai thotë: "Të mos urinojë ndokush nga ju në ujin në prehje e të lahet në të". Tha, nëse muslimanët do punonin me këtë do shmangnin 75% nga Bilharziasi që shkaktohet vetëm për shkak të urinimit në ujin e ndenjur-në prehje. Kur njeriu urinon në ujin e palëvizshëm ai lëshon vezore të Bilharizias dhe në ujin e ndenjur paraziti Bilharizias gjen kushte për jetë ashtu që nga vezët e vogla që bien me rënien e urinës në ujin në prehje formohen larva të vogla të Bilharizias, të cilat kur njerëzit lahen në këtë ujë, përmes lëkurës së tyre depërtojnë në gjak dhe u shkaktojnë njerëzve sëmundjen e Bilharzias.

Ai u mrekullua gjithashtu kur dëgjoi instruktimet dhe orientimet profetike të detajuara lidhur me rregullat higjenike dhe shëndetësore lidhur me parazitët dhe bakteriet. U shpreh se e tillë gjë nuk mund të ishte e mundur të dilte në dritë përveçse përmes zbulimit hyjnor të ardhur Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Një tjetër rast është ai i shkencëtarëve australian. Ja çfarë ngjau në një rast kur u takova me ta teksa gjendesha në mesin e një delegacioni të Bordit të Mrekullive Shkencore të Kuranit dhe Traditës Profetike. Ramë dakord që të bënim një minikonferencë vetëm për shkencëtarët e Australisë ku do diskutonim njëherazi ashtu që shkencëtarëve të çdo profili t'u jepej shansi të dëgjonin çfarë do i thonim kolegut të tyre të profilit tjetër. Pjesmarrësit që iu përgjigjën ftesës për në këtë minikonferencë që të gjithë ishin të gradave doktorë-profesorë në mjekësi, embriologji, astronomi, metereologji dhe në shkencën e hidrologjisë së detërave dhe oqeanisë. Biseduam me doktorin, që u dorëzua

se mrekullitë shkencore të mjekësisë të përmendura në Kuran dhe në Traditën Profetike nuk mund të konstatoheshin kurrësesi nga njerëzit e kohës në të cilën zbriti Kurani. Pastaj folëm me emriologjistin, pastaj folëm me astronomin, pastaj folëm me metereologun. Më pas biseduam me dy të shkencës së hidrologjisë së detërave dhe oqeanisë. Në ditën tjetër na erdhi profesori australian i astronomisë i cili na tha, thëniet ju i lexonit nga një libër Kurani që e kishit me vete. Ndërsa tani unë kam sjellë një libër Kurani që e bleva nga libraria, ju ka i keni komentimet e Kuranit në anglisht, pra unë dua nga ju të m'i lexoni thëniet kuranore për të cilat biseduam dhe të m'i tregoni në këtë kopje Kurani që solla. I thamë, si urdhëron. Ia lexuam dhe rilexuam thëniet përkatëse kuranore tanimë në Kuranin që ai vetë solli. Tha, edhe diçka tjetër, ju bëni fjalë dhe po thoni se çdo gjë që ne e zbulojmë gjendet në Kuran. Por a s'na thoni se a posedon Kurani thënie që kanë të bëjnë me çështje shkencore që ende janë objekt i debatueshëm ende në studim dhe hulumtim e sipër ndër shkencëtarë? Tha, për shembull dihet ndër shkencëtarët se universi zgjerohet. Ndërkaq astronomët kanë hedhur hipotezat e tyre se si do të jetë fundi i universit. Momentalisht ekzistojnë dy hipoteza; njëra prej tyre thotë se universi do vazhdojë të zgjerohet derisa të shpërbëhet dhe zhduket; teksa teorija tjetër thotë se universi pas këtij zgjerimi të vazhdueshëm do të tkurret dhe ndrydhet së dyti, gjë që do sjellë dhe fundin e universit përmes kësaj ndrydhje të tij. Tha, Kurani në lidhje me këtë realitet si pozicionohet, me cilën hipotezë është, me të parën apo me të dytën? Dhe vijoi, teksa tanipërtani hipoteza që gëzon pranueshmërinë më të lartë në mesin e shkencëtaërve është ajo se universi po zgjerohet në vazhdimësi, pastaj do ndrydhet sërisht dhe do bëhet një masë e vetme sikurse ç'filloi. I thashë, së pari përsa i përket faktit që ti përmende se universi është në zgjerim të vazhdueshëm, këtë fakt e ka përmendur Kurani, teksa ju nuk arritët në një të dhënë të tillë shkencore përveçse në vitin 1922. Në lidhje me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "Dhe Ne Qiellin e kemi ndërtuar me një superfuqi dhe Ne jemi zgjerues të tij." Që do të thotë vazhdojmë t'a zgjerojmë atë, pra e kemi zgjeruar, e zgjerojmë dhe do vazhdojmë t'a zgjerojmë në të ardhmen. Kështu sipas Kuranit universi është në zgjerim të vazhdueshëm. Emri foljor, kundrinori "zgjerues" trajton të tre kohët e veprimit, të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen. Pra kjo e dhënë shkencore në lidhje me zgjerimin e universit është në Kuran. Ndërsa përsa i përket fundit të universit hape Kuranin që ti vetë e solle në fundin e kaptinës kuranore Enbija. E hapi dhe i thamë lexoje vetë këtu, teksa ia vendosa gishtin të lexojë thënien e Allahut të Lartësuar: "Atë Ditë kur ne do t'a ndrydhim qiellin ashtu siç ndrydhet dorëshkrimi (fleta e shkruar). Ashtu siç e filluam krijimin e parë ashtu do t'a përsërisim atë". Pra në fillim universi u krijua duke qenë i ndrydhur dhe në vazhdimësi ai u zgjerua dhe ai do të kthehet siç u krijua herën e parë, nënkupton se ai sërisht do ndrydhet në një masë të vetme si në fillimet e tij. Tha, tani po, më keni në dispozicion që të vijë me ju në çdo konferencë kombëtare apo ndërkombëtare që do të bëni.

Dua të bëj fjalë gjithashtu për profesorin india Durja Ram, specialist në shkencën e hidrologjisë së detërave dhe oqeanografisë. I prezantova shumë fakte të mrekullive shkencore lidhur me hidrologjinë e detërave dhe oqeaneve të përmendura në Kuran dhe

në Traditën Profetike dhe mbeti vërtet i mahnitur lidhur me këtë. Tha, është e pamundur që kjo të bëhet evidente përveçse përmes zbulimit hyjnor të Allahut. Ai në një libër timin nuk nguroi të japë kontributin e tij. Dëshirova që ai të hynte në Islam dhe i thashë, o professor, është Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm Ai që e zbriti këtë Kuran dhe ti vetë e pranove faktin se ky Kuran është prej Allahut. Do vijë dita o profesor që do t'a lësh këtë botë, do vdesësh dhe do t'a takosh Allahun e Lartmadhëruar dhe Lartësuar. Ajo që vërejta ishte se ai po ndruhej për atë që po i sugjeroja, ndruhej nga njerëzit e tij, familja e tij dhe të afërmit e tij se do shokoheshin nëse ai do pranonte Islamin. Më pas atij i ndodhi një problem që e vuri në një pozitë vërtetë të vështirë. Erdhi tek unë një herë teksa ishte vërtetë me ndjenja të thyera. I thashë si e ke hallin? Tha e kam hallin kështu e kështu. I kujtova thënien e Allahut të Lartësuar: "Kush është Ai që si Allahu i përgjigjet nevojtarit që i lutet Atij…", pasi e dija fjalën e disa dijetarëve se kjo thënie kuranore përfshinte në të edhe atë që nuk i shte musliman. Thashë me vete, kjo është hapësira që më mundëson të prezantoj këtë profesor me Zotin e tij të Lavdishëm dhe të Lartmadhërishëm. I thashë, o profesor, a dëshiron t'i japësh zgjidhje hallit që ke? Tha, posi jo. I thashë, në kohën e një të tretës së fundnatës ne na ka ardhur në Traditën Profetike se Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm zbret në qiellin e dynjasë ashtu siç i takon hyjnisë së Tij dhe i përgjigjet lutjes së nevojtarit, e falë atë që i kërkon falje dhe i përgjigjet atij që i lutet. Premtoi Allahut se po t'u zgjidh problemi do bëhesh musliman dhe do e njohësh dhe adhurosh Atë. Tha në rregull dhe kështu veproi. Në kohën e një të tretës së fundnatës u ngrit dhe e luti Allahun. Të nesërmen, ende pa shkuar tek punonjësi që kishte në dorë zgjidhjen e problemit të tij, para se profesori të fliste ai i tha, profesor, problemi yt u zgjidh dhe mori fund. Me këtë rast erdhi tek unë tepër i kënaqur dhe mrekulluar. Më pas e pranoi Islamin por për arsye të ndryshme e pranoi atë fshehurazi. Dhe në fakt sa e sa prej shkencëtarëve ngurojnë t'a përqafojnë Islamin publikisht vetëm e vetëm për shkak të problemeve që do t'u sillte kjo në familjen apo rrethin ku ata jetojnë.

Të shumtë janë shkencëtarët që ne takuam. Prej tyre është edhe profesor Schroedor i cili u shpreh se përplasja që gjejmë midis shkencës dhe disa feve vjen si pasojë e faktit se ato kanë pësuar devijime, teksa ajo çfarë gjejmë sot të citojë Kurani e gjejmë në përputhje të plotë me atë që shkenca thotë. Atë çfarë Kurani përmend dhe atë çfarë shkenca përmend, i pari me gjuhën e tekstit dhe e dyta me gjuhën e zbulimit shkencor, i gjejmë në ujdi të plotë dhe madhështore me njëri-tjetrin.

Në këtë formë bëhet fakt para nesh se pionierët e shkencave bashkëkohore kur vihen në kontakt me mrekullinë shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike konfirmojnë dhe mësojnë se kjo është e vërteta dhe se feja Islame është feja e vërtetë që erdhi vërtetë nga Allahu. Për më tepër nëse kombet islame bëhen inisiatorë të përcjelljes dhe paraqitjes së këtyre mesazheve tek shkencëtarët e kombeve të tjera joislame, e tillë gjë me lejen e Allahut do bëjë që shumë e shumë prej të ekuilibruarve prej tyre të ndërgjegjësohen dhe reflektojnë karshi vërtetësisë së padyshimtë të Islamit. Me ç'rast ne do jemi të vetëdijshmë dhe po kështu edhe mbarë njerëzia se mrekullia kuranore është një

mrekulli e përherëshme, rezistuese dhe gjithmonë e freskët për të gjithë gjeneratat. Po po, argumenti i këtij Kurani gjendet brenda tij, ashtu siç vërtetësisht e përçoi Allahu të tillë fakt në fjalën e Tij, në Kuranin Fisnik kur Ai lidhur me këtë thotë: "Do t'ua bëjmë atyre të shqueshme argumentet tona në horizont dhe në vetvetet e tyre derisa atyre t'u bëhet fare e qartë se ai-Kurani është e vërteta e pakontestueshme. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?!"

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Meditim rreth universit (15)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Ftesë për meditim, meditim rreth universit…

Le ta fillojmë nga toka, planeti ynë, le të meditojmë rreth saj…

Është fakt që disa planete kanë ose vetëm natë ose vetëm ditë, natë të përhershme ose ditë të përhershme. Toka mund të kishte qenë njëri prej këtyre planetëve. Por në fakt dukuria e ditës dhe natës në tokën tonë është sinkronizuar në një formë të tillë që çdo anomali do kishte qenë fatale për gjallesat në të. Dita dhe nata këmbehen në mbështjellën ajrore të tokës në një formë vërtetë të mahnitshme, perfekte dhe precize. Ky këmbim është rezultat i shumë elementëve që kanë të bëjnë me minisistemin hënë-tokë-diell, orbitat e tyre, këndët e tyre në akset e tyre, shpejtësitë e lëvizjeve të tyre shumëfishe etj etj. Çdo anomali në këto elemente do kishte sjellë pasoja fatale për gjallesat në tokë, por kjo s'ka ndodhur prej miliona e miliona vitesh. Kush i këmben natën me ditën kaq përsosshmërisht?! Padyshim Ai është Allahu, lartmadhërimi i takon Atij.

Medito sesi Allahu tokën në aksin e saj nuk e bëri vertikale por e bëri me një kënd të caktuar dhe pikërisht e pozicionuar në këtë kënd rrotullohet ajo në orbitën e saj rreth diellit dhe për pasojë të kësaj përftohen në tokë katër stinët dhe ndryshimi klimaterik, dukuri këto me rëndësi jetike për jetën në tokë.

Le të meditojmë tani rreth shtresës atmosferike që mbështjell tokën! Allahu këtë mbështjellë atmosferike e bëri mburojë, blindë. Përveçse kjo atmosferë bart në të oksigjenin aq të domosdoshëm për frymëmarrjet tona, krahas kësaj ajo siguron mbrojtjen dhe ruajtjen për organizmat e gjalla. Kjo blindë lejon të kalojnë në tokë nga hapësira kozmike vetëm rrezet e dobishme. Kurse rrezet e dëmshme i thith ose i kthen mbrapsht. Rrezet diellore që zbresin në tokë i përkasin valëve të ndryshme, nga të cilat lejohen të depërtojnë në tokë vetëm valët e dobishme për qeniet e gjalla. Nuk arrijnë në sipërfaqen e tokës përveçse rrezet e dobishme për ne, ndërsa rrezet e dëmshme si rrezet X etj, absorbohen ose kthehen mbrapsht. Mbështjella atmosferike posedon një dendësi dhe peshë të caktuar. Nga përllogaritjet astronomike që i janë bërë mbështjellës atmosferike u gjet se ajo peshon 5 trilion (5×10^9) ton dhe falë trysnisë së dendësisë së mbështjellës së rëndë atmosferike avionët mund të ngjiten dhe të rrinë pezull në atmosferë. Mbështjellës atmosferike Allahu i ka dhënë një trashësi të caktuar që është përgjegjëse për neutralizimin e meteorëve të cilët sulen si rrebesh drejt tokës porse

digjen në shtresën atmosferike, gjë të cilën çdokush nga ne ka patur rastin t'a dëshmojë. Nëse këto meteorë do kishin arritur në tokë do kishin shkatërruar çdo gjë, do kishin djegur qytetet, pallatet dhe pyjet… Qe Allahu ai që bëri për ne këtë blindë mbrojtëse që siç e thamë më herët, përveçse është burim i ajrimit tonë është gjithashtu një mburojë e blinduar që na mbron ne nga rreziku i rrezeve të dëmshme dhe meteorëve. Allahu bëri gjithashtu që të ketë një balancim midis peshës së kësaj atmosfere dhe trysnisë së gjakut tonë, prandaj ne nuk e ndiejmë presionin e ajrit. Kjo ndodh pasi gjaku dhe fluidet e tjera brenda trupit tonë janë paisur me një presion të brendshëm të mirëbalancuar me presionin atmosferik. Një shembull demonstrativ për të kuptuar të tillë gjë është një letër. Nëse e fikson atë nga të katër anët dhe e shpon me gisht ajo shpohet, por nëse mbi të do të ushtrohet presion i balancuar nga të dyja anët, si presioni që ushtrojnë dy gishtat e mi tani për ta mbajtur atë, në këtë mënyrë presioni i gishtit nuk do ndikojë negativisht mbi këtë letër, nuk do ta grisë atë. E njëjta mund të thuhet për presionet tek ne nga brenda dhe jashtë nesh, presion i gjakut dhe fluideve nga brenda nesh dhe ai i ajrit jashtë nesh, midis tyre ka një mirëbalancim dhe harmoni falë Vullnetit të Allahut. Ky ajër i mahnitshëm është akumulim i nitrogjenit, oksigjenit dhe dioksidit të karbonit, ku nitrogjeni nëpërmjet shkrepëtimës unifikohet me oksigjenin duke bërë fertilizimin dhe ushqimin e tokës dhe bereqetit të saj. Për sa i përket oksigjenit, ai na shërben për procesin e frymëmarrjes dhe shërben gjithashtu si katalizator aktiv për ndezjen e materialeve të djegshme për të cilat jemi të nevojshëm, prej të cilëve theksojmë ndezjen e zjarrit. Ndërsa dioksidi i karbonit depërton tek trupi i bimësisë dhe vetëm përmes atij bima arrin të na jap frytet e saj të cilat ne i hamë dhe për to jemi aq të nevojshëm për ecurinë tonë fiziologjike. Medito pak lidhur me përbërjen e mrekullueshme të ajrit nga lloje precize të gazeve që janë në harmoni me jetët tona dhe të dobishëm për to. Shiko se si Allahu e ka realizuar këtë kompozim perfekt, këtë përbërje të përsosur?! E tillë gjë tregon për mëshirën e Krijuesit, urtësinë e Tij, perfektshmërinë e Tij, diturinë absolute të Tij përkundrejt krijesave të gjendura mbi tokë si dhe çfarë këto krijesa kanë nevojë prej përkujdesjes, mbrojtjes dhe ndjeshmërisë. I Lavdishëm është Ai. Pastaj medito sesi ky ajër mbart në të retë, zbresin rreze nga dielli që shkaktojnë avullimin e ujit dhe këto avuj uji kur ngrihen në lartësitë e ftohta kondensohen dhe formojnë retë. Retë nuk formohen ulët por formohen lartë si pasojë e kondensimit, kjo pasi temperatura e ajrit vjen duke u ulur sa më lart të ngjitesh, edhe pse ne kështu i afrohemi më shumë diellit dhe ajo që duhej të ndodhte është që temperature të vinte duke u rritur. Por ajo që ndodh është e kundërta. Allahu bëri të ngjante kështu përmes një planifikimi perfekt ashtu që sa më lartë ngrihemi në ajrin e atmosferës së tokës, temperatura ulet, prandaj temperatura e zonave malore është më e ftohtë se e atyre fushore. Kjo është bërë që retë të akumulohen në shtresat e ftohta kondensuese për t'u ruajtur në to avujt e ujit që u ngritën lartë, përndryshe nëse temperatura e shtresës ajrore në gjitje do vinte duke u rritur, këto avuj uji do ishin larguar nga toka dhe do kishin fluturuar lart në hapësirë, drejt planeteve apo yjeve për të derdhur ujin e tyre s'dihet se ku. Për këtë Allahu e bëri këtë ligj të funksionojë në kundërshtim me atë që duhet të ishtë, pra bëri që në vend që temperatura e atmosferës të vinte duke u rritur sa më shume që i afrohemi diellit, të

ndodh e kundërta ashtu që temperatura të vijë duke u ulur. E gjitha kjo u bë vetëm e vetëm që të mundësohet formimi i reve dhe të mundësohet lundrimi i tyre në mbështjellën ajrore të atmosferës. Pastaj retë lëvizin në mbështjellën atmosferike nën ndikimin e rrymave ajrore të erërave prezente në të, që bëjnë të mundur komandimin e reve të shiut deri sa ato arrijnë sipër kokave tona. Pastaj shiu zbret nga retë e shiut, por jo njëherësh. Përkundrazi ai zbret duke pikuar dhe zbret në disa intervale kohore, duke mos i shkaktuar asnjë dëm bimësisë apo qenieve të gjalla. Ky krijim i mrekullueshëm dhe i përkryer në këtë mbështjellë atmosferike dhe në shërbimet të cilat ajo kryen, tregon se ajo është vepër e të Gjithdijshmit, të Urtit, Ruajtësit që na ruajti neve nga rreziqet nëpërmjet kësaj mburoje atmosferike. Allahu e ruajti tokën gjithashtu nëprmjet dy fushave magnetike. Rreziqet që i kanosen tokës nuk vijnë vetëm nga rrezet e dëmshme diellore por vijnë gjithashtu edhe nga rrezet kërcënuese të yjeve të tjerë. Këto dy fusha magnetike shmangin nga toka elementët kozmik kërcënues për jetën në tokë. Ato i devijojnë elementët kozmik në fjalë larg tokës duke e ruajtur tokën dhe banorët e saj. I Lavdishëm është Allahu, Ruajtësi që e perfeksionoi krijimin e Tij dhe e përsosi.

Për ujin që pimë, Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhëruar na tregon në Librin e Tij dhe na thotë: "A nuk e shikojnë mosbesimtarët se qielli dhe toka ishin njësh (një masë) dhe Ne i ndamë…". Shkenctarët e astronomisë dhe gjeologjisë kanë rënë dakord se toka ka qenë pjesë e qiellit, duke e konfirmuar faktin se toka ka qenë element i qiellit dhe më pas është veçuar prej tij, gjë të cilën e ka thënë në interpretim të thënies kuranore në fjalë Ibn Abasi mëse 1400 vjet më parë. Thënia kuranore në fjalë vijon: "… çdo gjë të gjallë Ne e bëmë prej ujit. A nuk besojnë?!". Pra bëri që toka të posedojë vlerën e duhur të ujit të nevojshme për tokën dhe të gjitha format e jetës në të. Nëse sasia e këtij uji do shtohej atëherë ai do mbyste çdo gjë dhe nëse do ishte më pak nuk do sigurohej vlera e duhur ujore e cila shërben për ecurinë e ciklit të reshjeve atmosferike. Porse Allahu e zbriti atë në një vlerë precizivisht të caktuar. Rezervuari ku Allahu e ka ruajtur ujin janë detërat dhe oqeanet, të cilët nëse do kishin qenë të ëmbël do ishin qelbur. Për këtë Allahu ujin e tyre e bëri të krypur që të mos qelbet e prishet. Por kur Ai don të na jap ne njerëzve, gjallesave dhe bimëve, të pijmë nga ky ujë, e bën atë ujë të ëmbël përmes avullimit dhe kondensimit që janë proceset përgjegjëse për zbritjen e shiut që ushqen burimet e ëmbla ujore prej ku ne përftojmë ujin e pijshëm, ashtu sikurse ka thënë i Lartësuari: "A e keni parë ujin që pini?! A ju e zbritë atë nga retë?! Apo ne jemi Ata që e zbritëm?! Nëse do kishim dëshiruar do e kishim bërë atë të krypur. A nuk po tregoheni falenderues?!"

Përmes avullimit që mundësohet nga rrezet e diellit Allahu e ngren ujin e detit lartë në lartësitë mbimalore dhe pikërisht këtu formohen retë. Përse retë formohen këtu? Kjo pasi temperatura është më e ulët në shtresat ajrore përmbi zonat malore, edhe pse aty jemi më pranë diellit, porse ky qe sistemi të cilin e strukturoi Allahu në tokë për procesin në fjalë, përndryshe nëse do rriteshin temperaturat në shtresat ajrore sa më afër diellit të shkonim, sikurse e përmendëm më herët, kjo do bënte që shiu të binte në hapësirë dhe jo në tokë. Gjithashtu rënia e brishtë e shiut është një tjetër përkujdesje

hyjnore që vlen të ripërsëritet. Falë mëshirës së Allahut dhe mirësisë së Tij shiu zbret në formën e pikëzave të brishta. Allahu i Lartësuar thotë: "Ne zbritëm nga qielli ujë në një vlerë të caktuar të cilin e depozituam në tokë, teksa Ne ishim të mundshëm t'a bënim atë të ikte dhe humbiste". Pra, do e kishim të lehtë të tillë gjë thjesht duke ndërhyrë në temperaturën globale. Uji vlon në temperaturën 100^0Celcius megjithëse ai konsiderohet nga fluidet më të tretshme në sipërfaqen e tokës. Gjenden edhe tretësira të tjera si benzina dhe alkooli, por temperature e vlimit të tyre është e ulët. Nëse temperature e vlimit të ujit do kish qenë si e këtyre do kishin avulluar në qiell mbarë sipërfaqet oqeanike dhe me to do ndodhte sikurse me ujërat prezente në Venus. Por falë mirësisë së Allahut situata për ujin është stable, avullimi kryhet si duhet, po kështu edhe formimi i reve, pastaj erërat i komandojnë këto re që kur shkojnë në destinacionet e duhura prej tyre zbret shiu.

Uji është një element i cili ka dendësinë e tij të caktuar e cila varion kur është i lëngshëm-fluid, dhe kur ngrin. Të gjithë lëndët e ngurta kanë temperaturën e tyre të shkrirjes. Ne për shembull shohim lëngje që ngurtësohen, sikurse edhe e anasjellta, lëndët e ngurta që shkrijnë. Densiteti dhe masa e një lënde janë më të mëdha kur ajo ngurtësohet dhe më të vogla kur ajo lëngëzohet. Kthehemi tek uji. Themi se uji është i ngurtësuar kur ai bëhet akull. Nëse dendësimi apo ngurtësimi i ujit do realizohej në 0^0C cili do të ishte rezultati? Nëse atmosfera e tokës bëhet 0^0C me këtë rast formohet bora dhe akulli. Porse akulli është i rëndë, gjë që do bëjë që ai të zbresë në oqeane ku do akumulohet në vazhdimësi derisa masa ujore e oqeaneve të shndërrohet në një bllok të tërë akulli, gjë që do qe katastrofike për banorët e detërave dhe oqeaneve, si dhe për botën mbarë. Që kjo të mos ndodhte Allahu e ndryshoi ligjin e densitetit-rëndesës lidhur me ujin në mënyrë të tillë që bëri që uji densitetin dhe peshën më të rëndë t'a arrijë në 4^0C teksa ende është i lëngshëm, dhe bëri që akulli në po këtë gradë (4^0C) të peshojë më pak se uji në po këtë gradë. Prandaj dhe i shohim ajsbergët të pluskojnë sipër ujit dhe poshtë tyre mbetet ujë, që gjallesat e oqeaneve të kenë mundësi të jetojnë dhe të realizohet për to një lloj ngrohje nënujore. (Gjithashtu bëri që akulli të mos shkrijë në temperaturën 4^0C). I Lavdishëm është Allahu, Krijuesi, i Gjithdijshmi lidhur me përshtatjen e ligjësive të ujit në dobi të kushteve jetike për gjallesat e detit. Allahu ujin e ka bërë tretësin më të fuqishëm, nëse zbret përmbi shkëmbinj ai i tret ato duke bërë të përfohen prej kësaj ndërhyrje elementët e domosdoshëm për bimësinë të cilat lundrojnë drejt terres përmes vërshimeve gjë që në mënyrë të vazhdueshme bën fertilizimin dhe pasurimin e tokës që ajo të bëhet sa më pjellore.

Uji tret oksigjenin. Lind pyetja përse oksigjeni tretet në ujë? Kjo bëhet në dobi të gjallesave nënujore për procesin e frymëmarjjes së të cilave oksigjeni dhe ajri janë një domosdoshmëri, gjë për të cilën Allahu i pajisi këto gjallesa me velëza të cilat i mundësojnë ato të përftojnë oksigjenin që gjendet i tretur në ujë. Shiu me pikëlzat e tij që bien zbresin të ngopura me oksigjenin pa të cilin nuk mund të bëjnë kurrsesi gjallesat nënujore në brendi të detërave dhe oqeaneve.

Uji është gjithashtu tretës i mirë i dioksidit të karbonit, prania e të cilit nëse shtohet në atmosferë shkakton rritje të temperaturës në grada të larta të papërballueshme, porse Allahu bëri që oqeanet dhe detërat t'a thithin sasinë e tepërt të dioksdit të karbonit duke e lënë atë në proporcionin e duhur për gjallesat dhe bimësinë. Medito rreth këtij krijimi të mrekullueshëm, medito për këtë perfektshmëri.

Poeti Abdurahman Kadi lidhur me këtë ka bërë një poemë ku rreth ujit dhe sistemit të funksionimit të tij shprehet me fjalët:

Hidhe vështrimin o vëlla tek retë,

Si u bënë rëke që fluturojnë,

Allahu i dërgoi ato mëshirë për ty o neri,

Për këtë mirësi a e falenderove Allahun ti?!

Diellit i dha pushtet përmbi detëra,

Që të ngrejë prej tij avujt e ujit,

Bëri ngritjen e ujit të detëravë në qiell,

Sipër maleve me kreshta të heshtura.

I mbështolli avujt e ujit me ajrin e ftohtë,

Duke mundësuar të depozitohen në qiej,

Nëse do donte vtëm temperaturën duke shtuar,

Asnjë pikëlz uji s'do kishim përftuar.

U komandoi reve erërat që i fryjnë,

Disa formuese të reve që sjellin me duf shi,

Malet kurrsesi retë nuk mund t'i pengojnë,

Ato me Vullnetin e Allahut mbi male qëndrojnë.

Krijuesi Suprem bëri që prej reve të ketë një mori,

Që ujin e lëshojnë sipas caktimit dhe përllogaritjeve të Tij

Nëse do kishte rënë ky shi nga qielli me hov,

Për njerëzit kjo do kish qenë vërtetë një katastrof.

Kjo nëse me rrebesh do kish rënë shi,

Lëre më po t'ish zbritur kështu bréshëri?!

Medito, a është ky një planifikim,

I kujt nuk posedon ndërgjegje dhe arsyetim,

I natyrës apo një idhulli memec,

Që në konstrukt janë rob të Zotit të vet?!

Apo e tillë gjë dëshmon me zë,

Se Krijuesi i tyre është Një dhe vetëm Një.

Ky shi, kur zbret në tokë, toka e thithë atë por nuk e përthith në thellësitë e skajshme të saj. Shiu nuk përthithet për në zemër të tokës, por zbret brenda në tokë dhe lëvron brenda duke u akumuluar në shtresa pranë sipërfaqes së tokës në formë damarësh ujorë. Pastaj vijmë ne dhe e gjejmë atë të rezervuar në formë burimesh dhe currilash ose gërrmojmë puse derisa të arrijmë tek burimi i këtij uji. Allahu thotë: "Më thoni, nëse uji juaj do fundosej kush do t'ju sillte ujë të rrjedhshëm?!"

Gjejmë gjithashtu në shkretëtira oazet falë rezervimeve të ujit në formë depozitimesh nënujore apo pusesh që janë afër sipërfaqes tokësore dhe që nxjerrin currila.

Medito vëlla i dashur reth veprës së Zotit tënd Madhështor lidhur me ujin dhe karakteristikat e tij të mrekullueshme.

Uji përmban një gradacion temperature të një nxehtësie specifike që është 5 fishi i nxhetësisë specifike të shkëmbinjve, prandaj nëse duam t'a ngrejmë nxehtësinë specifike të 1 cm^3 uji një grad do të na nevojiteshin 5 njësi më shumë se sa do na nevojiteshin për ngritjen e nxehtësisë specifike të të njëjtës vlere (1 cm^3) shkëmbinjsh. Cili është kuptimi i kësaj? Kuptimi është se uji bën rolin e një kondicioneri të përgjithshëm. Kondicionerët janë aparatura për të cilët ne jemi shumë të nevojshëm në shtëpitë tona. Allahu i bëri detërat kondicionerë të përgjithshëm për tokën. Nxehtësia e diellit zbret në dete dhe duke qenë se nxehtësia specifike e detërave është e lartë ato kanë nevojë për një masë vërtetë të madhe nxehtësie, duke thither kështu një masë gjigandë nxehtësie dhe sërisht temperature e detit nuk ngrihet kollaj, aq sa ditën mbi rërën e brigjeve tropikale ndoshta nuk mund të ecësh, kjo pasi rërërat e tyre janë karikuar me nxehtësi të lartë duke qenë se kanë thithur një masë gjigande nxehtësie, teksa po gjatë ditës ftohtësia e ujërave të detërave i bën erërat të freskohen dhe ashtu të freskëta të barten për në viset e tjera, duke bërë kështu kondicionimin e mbarë kontinenteve të tokës. Po natën çfarë ndodh? Nëse ecim në breg natën gjejmë se rëra është ftohur ndërsa uji i detit është ngrohur gjë e cila bën që erërat të karikohen me nxehtësi përmbi detëra dhe që aty të shpërndahen duke fryrë dhe përçuar këtë ngrohtësi në mbarë klimën e kontinenteve të tokës. Po të mos ishte ky sistem kondicionimi i tokës atëherë ditën temperatura e saj do ishte rritur aq shumë saqë

gjallesat nuk do kishin mundësi t'a përballonin, ndërsa natën do ulej aq shumë sa sërisht nuk do mund të përballohej nga gjallesat.

Medito rreth këtij krijimi të mrekullueshëm të strukturës së tokës, medito lidhur me ujin e saj dhe terren e saj gjithashtu.

Të flasim për cipën e tokës. Ne jetojmë mbi një cipë, lëvozhgë. Cipa e tokës në raport me gjithë tokën është si cipa e mollës në raport me gjithë mollën.

Në një maket të tokës të marrë nga hapësira vërehet brendia e tokës të cilës i është bërë një prerje tërthore përmes së cilës del në pah zemra e tokës. Në këtë maket shquhen edhe valë që shërbejnë për të matur brendinë e tokës që shërbejnë për studimin e strukturës së brendshme të tokës. Spikat sipërfaqja e tokës, cipa e tokës pra, që është një pjesë shumë e hollë e tokës. Lind pyetja: Çfarë ka poshtë nesh, poshtë këmbëve tona, poshtë kores apo cipës së tokës? Poshtë nesh gëlojnë vullkanë dhe vatra zjarresh. Porse këtë masiv shkëmbor të tokës që arrin trashësinë midis 33-74 km Allahu e ka bërë një shtrojë përmes së cilës mbrohemi nga nxehtësia përvëluese e zjarreve që gjenden poshtë këmbëve tona. Medito pra sesi Allahu na mbrojti! Pastaj a mendon se kjo brendi e tokës është në gjendje prehje?! Në fakt ajo në vazhdimësi lëviz, është në lëvizje, gëlon nga lëvizjet, ashtu sikurse na e ka bërë të ditur këtë Allahu i Lartësuar në Kuran, ku thotë: "A u garantuat nga Ai që është në qiell, që të mos ju gllabëroj toka, ku të gjeni se ajo vërtitet". Nënkupton që nëse ndonjë copë e tokës ju gëlltit do e gjeni veten në një vend që vërtitet brendazi, gjë kjo e ardhur nga të dhënat e shkenctarëve të cilët kanë zbuluar se barku vullkanik dhe magmatik i tokës vërtitet. Teksa ne e ndiejmë veten të palëvizshëm, posht nesh toka vërtitet e vërtitet. Presupozohet që nga kjo lëvizje e brendshme të ndikoheshin dhe të lëviznin kontinentet dhe të përplaseshin e ndërfuteshin në vazhdimësi midis tyre. Por kjo nuk ndodh pasi Allahu i bëri malet fiksues të tokës dhe këtyre maleve u bëri rrënjë të thella që zhyten thellë në shtresën e ngjizur të magmës vullkanike duke patur ndikim vendimtar në mbajtjen statike të tokës.

Të ftoj të meditosh thellë lidhur me ndërtimin e tokës sonë dhe se si Allahu i dha asaj një pozicion të përshtatshëm në hapësirë, dhe e tillë gjë është vetëdëshmuese për faktin se sa në fjalë buron nga dituria e të Gjithdijshmit, mëshirës së Mëshiruesit. Medito se si Allahu i perfeksionoi lëvizjet e tokës rreth vetes, rreth diellit, lëvizjen brenda galaksisë si pjesë e tërësisë së sistemit diellor si dhe lëvizjet e tjera në këtë univers! Gjithë sa në fjalë dëshmon se kjo është vepër e të Gjithdijshmit, të Urtit, të Përsosurit.

Medito rreth faktit të animit këndor të tokës në aksin e vet në një kënd perfekt! Medito rreth mburojës, blindës atmosferike dhe asaj magnetike që na mbrojnë dhe japin imunitet përkundrejt rreziqeve që na vijnë nga hapësirat kozmike! Kjo dëshmon se e tillë gjë është vepër e të Gjithdijshmit, Mbrojtësit dhe Mëshiruesit, i Lartësuar është Ai. Medito sesi shiu mbartet dhe sesi ai i ndihmon bimët të çelin dhe rriten, gjë e cila tregon se kjo është vepër e Mëshiruesit, të Lavdishmit dhe të Lartmadhëruarit. Medito rreth karakteristikave të ujit, vlimit të tij, ngurtësimit dhe densitetit të tij, nxehtësisë së tij

specifike dhe qenies së tij tretës i përgjithshëm në këtë tokë! Medito rreth ciklit të ujit! Medito për sipërfaqen e tokës të cilën Allahu e bëri të shtrirë duke e përshtatur për ne dhe duke bërë që ne nga kjo sipërfaqe të sigurojmë ushqimin, ujin, ajrin, bereqetin tonë, vendqëndrimin tonë, dhe sesi Allahu e bëri këtë tokë ultësirë. Medito sesi është prehur toka nën këmbët e tua dhe pyet Kush e ka bërë këtë të gjithën?! Atributet e Kujt janë këto atribute pro të cilave dëshmon toka dhe që i gjejmë të manifestuara në të?! Kujtoni në një episod prej episodeve që përmendëm shembullin e llambës së neonit ku thamë se kjo vepër tregon se ai që e ka bërë atë posedon xham; është i aftë t'a trajtësojë llambën në formën që ka; posedon metalin anësor të anëve të llambës dhe është i aftë t'a trajtësojë atë në formën që e shohim të jetë, heremetik në dy anët e llambës; posedon dituri rreth elektricitetit; ndërsa në këtë rast kemi tokën e mrekullueshme, dituria që refelektohet në krijimin e saj dëshmon se ajo është vepër e të Gjithdijshmit; mëshira dëshmon se ajo është vepër e Mëshiruesit; urtësia dëshmon se ajo është vepër e të Urtit; përsosmëria dëshmon se ajo është vepër e të Përsosurit; bereqeti dëshmon se ajo është vepër e Furnizuesit; mbrojtja dëshmon se ajo është vepër e Mbrojtësit; fuqia dëshmon se ajo është vepër e të Plotfuqishmit; dhe aftësia dëshmon se ajo është vepër e të Gjithmundëshmit. Më tej medito harmonizimin e përsosur midis tokës dhe sistemeve të saj, atij të ujit, ajrit, maleve, dheut, detërave, avullimit, reve, lëvizjeve të tokës, këmbimit të natës dhe ditës, distancimit të tokës dhe pozicionimit të saj! Kush e realizoi këtë harmonizim dhe e përgatiti të atillë që të mundemi të jetojmë në këtë tokë në prehje, jo vetëm ne por bashkë me ne edhe mbarë gjallesat e tjera?! S'ka dyshim se Ai është Allahu, Krijuesi, i Lavdishëm është Ai, i Vetmi dhe i Pashoqi. Edhe ne dëshmojnë ashtu sikurse dëshmon kjo tokë, se Krijuesi i saj është Zoti i Urtë, i Gjithdijshëm, Mëshirues, Mbrojtës, Furnizues, i Plotfuqishëm, i Gjithmundshëm, Ai që është i Vetmi që meriton t'a adhurojmë dhe t'i bindemi. Prej këtu ne dëshmojmë të njëjtën dëshmi që e dëshmon edhe ky univers, themi: ESH HEDU EN LA ILAHE IL ALLAH-NUK E MERITON TË ADHUROHET ASKUSH VEÇ ALLAHUT. Pamë kështu sesi Kurani lajmëron rreth disa prej sekreteve të tokës që provojnë se personi të cilit këto sekrete iu shpallën, profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, është i Dërguari i Allahut, pasi Ai që e njoftoi profetin Muhamed lidhur me këto sekrete të tokës, dhe mesazhin e të Cilit Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- e përcolli siç ia zbriti, nuk mund të jetë askush përveç Allahut, i Lavdishëm është Ai. Fakte këto të provuara në ditët tona dhe që evidentojnë dhe dëshmojnë të vërtetën e sigurtë se MUHAMEDUN RASULULLAH-MUHAMEDI -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ËSHTË I DËRGUARI I ALLAHUT.

Shohim kështu në ndërtimin dhe përsosjen e këtij universi argumentet dhe provat e pakontestueshme të Besimit, shohim mrekullitë Kuranore.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Misteret e reve në qiell (16)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Nga misteret e zbuluara nga Kurani lidhur me thellësitë e detërave dhe oqeaneve si dhe erërave në to, që nga tabani i tyre e deri në sipërfaqen e tyre, le të shkojmë sot tek misteret që Kurani zbulon lidhur me retë në qiell.

Kurani ashtu sikurse bëri fjalë për sipërfaqen e deteve dhe oqeaneve, për sipërfaqen, thellësitë dhe tabanin e tyre, po kështu ai përshkruan për ne retë nga të cilat formohen shirat që janë aq të dobishëm dhe vital për ne.

Retë klasifikohen në lloje të shumta teksa retë e shiut janë vetëm tre llojesh.

Përshkrimi kuranor vjen dhe përshkruan në detaj retë shisjellëse duke i dhënë secilit lloj përshkrimin e tij specifik në një mënyrë të tillë që shpalos karakteristikat me të cilat njëri lloj specifikohet dhe ndryshon nga lloji tjetër. Secili nga këto lloje reshë shiu formohet në një mënyrë specifike dhe procesi i formimit të secilit shoqërohet me dukuri që janë specifike vetëm për të dhe që janë të ndryshme nga ato të llojit tjetër. Gjithashtu edhe efektet që vijnë nga secili lloj janë specifike brenda llojit dhe të ndryshme nga ato të llojit tjetër.

Përshkrimin kuranor e gjejmë të përputhet tërësisht me çdo rast prej këtyre rasteve.

Çfarë s'duhet të harrojmë është fakti se Kurani ka bërë fjalë për të gjitha këto përpara mëse 1400 vjetësh, kohë në të cilën njerëzit, përfshirë dhe elitarët prej tyre, i imagjinonin dukuritë e natyrës në mënyrë mitologjike.

Kështu për shembull kinezët lidhur me vetëtimën kishin pikpamjen mitologjike se hyjnitë mbanin në duar pasqyra të cilat ua drejtonin diellit, dhe sipas tyre ishte pikërisht kjo gjë ajo që shkaktonte vetëtimën. Ndërsa për gjëmimin kishin shpjegimin se hyjnitë u binin daulleve.

Grekët e lashtë kishin përfytyrim se për çdo dukuri natyrore ishte përgjegjëse një perëndi. Ata shpreheshin për ekzistencën e shumë perëndive. Ata kishin në bestytninë e tyre perënditë që frynin erërat, perënditë që formonin retë, e kështu me rradhë.

Ndërkaq arabët nuk ishin dhënë pas shpjegimit të dukurive natyrore sidomos për dukurinë e shiut që ishte një fenomen i rrallë që ndodhte në vendet e tyre ku dominonte relieve shkretinor.

Kur shkenca progresoi ajo filloi të studionte dukuritë e natyrës përreth. Shkencat e natyrës filluan të studionin dukuritë që ndodhnin rreth e rrotull njeriut drejt njohjes së mistereve të tyre, ligjësive dhe shkaqeve të tyre. Këto dukuri dhe fenomene filluan t'u zbuloheshin njerëzve pak nga pak.

Një lëm për studimin e të cilit njerëzit treguan interes ishte edhe ai i studimit të reve dhe lidhjes së tyre me erërat.

Pyetja iniciuese ishte se nga se krijoheshin retë?

Ajo që mësuan ishte se deti avullonte dhe nga ai ngrihej avulli i ujit që në fakt nuk është i shqueshëm për sytë tanë, prandaj dhe e tillë dukuri nuk u bë e mundur të hetohej me sy të lirë. Pastaj këto avuj uji të ngritura nga detet dhe oqeanet erërat vinin duke i marrë dhe vozitur në atmosferë. Në këtë process marrin pjesë dy llojë erërash; erërat vertikale, që në procesin e gjatë të formimit të reve të shiut kanë rolin e ngritjes së avujve të ujit të deteve dhe oqeaneve në lartësi; dhe erërat horizontale, që më tej marrin përsipër t'i vozisin dhe komandojnë këto shtëllunga avulli të ujit përgjatë një trajektoreje horizontale.

Janë pikërisht këto erëra ato që i bartin avujt e ujit nga zonat e nxehta ku qenë në formë avujsh dhe i dërgojnë në zonat e ftohta të cilat për shkak të temperaturave të tyre të ulta shkaktojnë dendësimin dhe kondensimin e këtyre shtëllungave vozitëse të avujve të ujit. Përmes kondensimit avulli që më parë në zonat e nxehta ishte i padukshëm për sytë e njeriut tanimë bëhet i shqueshëm duke u shfaqur për sytë e njeriut në formën e tillë që njihet me emërtimin re.

Pra janë erërat ato që shkaktojnë formimin e reve fillimisht duke i bartur ato nga zonat e nxehta ku ndodh avullimi i avujve të ujit dhe pastaj duke i transferuar në zonat e ftohta.

Lëvizja e avujve të ujit që ngrihen në atmosferë nganjëherë bëhet përmes erërave të ngrohta por në rrugë e sipër këto avuj përplasen me fronte atmosferik erërash të ftohta, gjë që bën që ky masiv avulli derimëtani i pashqueshëm për syrin të shfaqet sakaq në trajtën e reve që ne njohim. Është pikërisht kjo që shpjegon faktin sesi ndodh që para syve tanë diku lart në horizont befasisht fillojnë e shfaqen retë. Më tej shtyrja e vazhdueshme e masivëve të avujve të ujit drejt masivit të resë e bën renë të rritet gjithnjë e më tepër. Këtë gjë shumëkush prej nesh e ka dëshmuar me sytë e tij sesi retë vijnë e formohen në formë kupole në rritje që është produkt i ndjelljes së vazhdueshme që era u bën avujve të padukshme të ujit, duke bërë kështu që masivi i resë të progresojë në rritje. Pra janë pikërisht erërat ato që janë përgjegjëse për shfaqjen e reve dhe për ndjelljen e tyre. Në gjuhën arabe ne kemi një fjalë që orienton pikërisht në dy kuptimet në fjalë, në atë të shfaqjes dhe në atë ndjelljes. Këtë fjalë ne vazhdojmë t'a përdorim edhe në ditët tona. Është fjala arabe "etheera". Kështu kur themi "filani 'etheera' një problem" kuptimi është që ai shfaqi një problem që nuk ishte i pranishëm

më parë. Pra njëri kuptim i "etheera" është shfaqi. Rasti tjetër i përdorimit të kësaj fjale arabe është me kuptimin "etheera-ndjell". Kështu kur për një person thuhet "filani 'etheera' zemërimin e tij" kjo vjen me kuptimin që ky person po e ndjell zemërimin e tij. Pra fjala arabe "etheera" vjen me dy kuptime, me kuptimin shfaq dhe me kuptimin ndjell. Kështu, raporti i erës me retë është pikërisht sipas kuptimit të foljes arabe "etheera", pra ka kuptimin shfaqje dhe ndjellje. Në fakt kjo është fjala e vetme arabe që orienton njëkohësisht në të dy këto kuptime, fjalë të cilën Kurani e përdori për të sqaruar raportin midis erërave dhe reve. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "Është Allahu që i dërgon erërat që ndjellin retë...". Pra janë erërat ato që i shfaqin retë dhe ndjellin rritjen e masivit të shtëllungave të tyre.

Më parë ne përmendëm se retë e shiut i përkasin tre llojeve kryesore teksa retë e rëndomta janë të shumëllojshme. Secili lloj prej këtyre llojeve të reve të shiut ka një rrugë specifike formimi të veçantë dhe ka efektet e veta të veçanta që rezultojnë prej saj.

Sot është bërë e mundur që proceset e formimit të reve të demonstrohen përmes pamjeve she skicave të ndryshme ku shpalosen grafikisht erërat e ngrohta që bëjnë ngritjen e avujve të padukshëm të ujit të cilët kur arrijnë në shtresat e ftohta të atmosferës kondensohen duke formuar shtresa të tëra reshë që fjollë-fjollë mbulojnë territore të tëra qiellore. Reja e shtresuar horizontalisht, pra reja e shtrirë, është edhe lloji i parë i reve që në formë pjate shtrihen në gjërësi të tëra horizontale në qiell. Porse retë e shtrira nuk mund të jenë re shiu në fillimet e tyre kur gjenden në shtresat e larta të atmospheres, por bëhen re shiun kur zbresin në lartësi më të ulëta nga toka.

Nëse do t'i shihnim këto re horizontalisht nga poshtë dhe nga sipër do t'i gjenim fjollë-fjollë dhe kjo vjen nga ngacmimi dhe ndjellja që erërat u bëjnë atyre. Janë pikërisht erërat e ngrohta ato që i bartin avujt e ujit lartë drejt lartësive të ftohta atmosferike ku ato shtrihen dhe tendosen në formën e masivëve gjigandë te reve të shtresuara. Qielli është i pushtuar nga këto shtresa reshë që janë pranë e pranë si të ishin një shtresë e vetme, ose shprehur më ekzaktësisht retë në fjalë pushtojnë 7/8 e qiellit. Këtë lloj të reve shkencëtarët e kanë quajtur reja e shtrirë apo e tendosur.

Jemi pra tek ky lloj i parë i reve të shiut, reja e shtresuar, e shtrirë ose e tendosur.

Lind pyetja si dhe kur kjo re produkton shi?

Prodhimi i shiut bëhet kur plotësohet procesi i shtresimit të reve njëra mbi tjetrën në stivë dhe më pas kur këto re të shtresuara e të bëra stivë fqinjëzohen me një masiv homolog reshë të stivosura, këtu zbret edhe shiu.

Le të shohim së bashku sesi shpjegimi shkencor në fjalë përputhet plotësisht me përshkrimin kuranor.

Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: "Është Allahu që i dërgon erërat që ndjellin retë dhe retë Ai i shtrin në qiell sikurse do…". Pra Krijuesi bëri ligje unikale që i

detyrojnë retë të tendosen në qiell. Edhe njëherë: "Është Allahu që i dërgon erërat që ndjellin retë dhe retë Ai i shtrin në qiell sikurse do dhe e bën atë (renë) stivë me ç'rast ti e sheh pikëlzën të dalë ndërmjet saj…". Pra shiu nuk bie përderisa retë e shiut të shtresohen duke formuar stiva që qëndrojnë pranë e pranë njëra-tjetrës të cilat sjellin një atmosferë të ngopur me ujë, duke lejuar në këtë formë prodhimin e pikave të rënda të ujit që zbret në formën e shiut.

Shiu që bie nga kjo lloj reje nuk shoqërohet me shtrëngata, as me vetëtima, as me gjëmima, as me breshër dhe as me ndonjë efekt tjetër negativ, porse ai bie butësisht dhe rregullisht, saqë njerëzit kur bie një shi tillë, me të gëzohen shumë. E falenderojnë Allahun që u dërgoi këtë shi që nuk u solli asnjë shqetësim dhe asnjë dëm, ndaj dhe ata i gëzohen shumë një shiu të këtillë.

Le të shohim tani sesi Allahu i Lavdishëm dhe i Lartësuar e përshkruan këtë në Kuranin Fisnik: "Është Allahu që i dërgon erërat që ndjellin retë dhe retë Ai i shtrin në qiell sikurse do dhe e bën atë (renë) stivë me ç'rast ti e sheh pikëlzën të dalë ndërmjet saj. Kur Ai e bën atë të bjerë te kush ai do prej robëve të Tij, ata ngazëllehen". Ky pra është ndikimi që ai len.

Në krahun tjetër Kurani Fisnik merr të përshkruaj edhe llojin tjetër të reve, bëhet fjalë për retë në formë pirgjesh që në mënyrë jouniforme bëhen pirg njëra mbi tjetrën. Retë në formë pirgu fillesat e tyre i kanë në formë pirgjesh të vogla reshë jouniformë të cilët akumulohen drejt linjës së horizontit të quajtur linja e akumulimit, gjë që vjen e demostruar në sa e sa material shkencor të skicuar, fotografuar dhe filmuar. Pra procesi i parë që kalojnë këto re është ai i akumulimit të pirgjeve të vogla të reve dhe pas kësaj vjen akumulimi vertical, tani në nivel të pirgjeve të mëdha që vendosen përmbi njëri-tjetrin në formën e një pirgu super të madh që bëhet si një mal i shpalosur lartë në qiell. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "A nuk e shikon se Allahu butësisht i bën të vozisin retë…". Deri këtu thënia kuranore bën fjalë se Allahu i bën erërat t'i vozisin retë butësisht nëpër qiell, gjë kjo që shquhet gjegjësisht në rastin e pirgjeve të vogla të reve të cilat në saj të erërave specifike vinë duke u tubuar në formë pirgu të madh. I kthehemi thënies kuranore: "A nuk e shikon se Allahu butësisht i bën të vozisin retë dhe më pas i bashkon ato së bashku…". Hidhet dritë mbi tubimin e tyre siç e cekëm drejt linjës së grumbullimit ashtu që çdo pirg i vogël reje bashkohet me pirgun tjetër duke vozitur kështu drejt linjës së grumbullimit total, ku këto re akumulohen duke formuar një pirg sa një mal. Deri tani thënia kuranore përmend dy proceset e para që diktojnë dukurinë e formimit të resë shtëllungore apo në formë pirgu; e para vozitja e shtëllungave të vogla të reve butësisht dhe e dyta tubimi dhe lidhja e tyre më njëra-tjetrën. Pastaj thënia kuranore vazhdon me procesin e tretë duke thënë: "…pastaj ato i bën shtëllungore (pirg njëra mbi tjetrën)". Pra pas tubimit dhe lidhjes midis tyre vjen procesi i tretë, akumulimi apo pirgëzimi i tyre që është ngritja reve që u formuan prej avujve të ujit në pirgëzim e sipër falë një force të brendëshme rryme ere që e ngrenë pirgun e reve lartazi. Kur pikat e shiut në këtë shtëllungë reshë rëndohen ashtu që kjo re

nuk mund t'i mbajë më, ateherë këto pika shiu bien poshtë. Në thënien kuranore po të shohësh me vërejtje do gjesh sesi janë përdorur rreshtazi dy lidhëza, njëra lidhësja arabe "thume-pastaj" dhe tjetra "fe-sakaq". E para "thume-pastaj" nënkupton avashësi sikur të thuash për shembull "hyra pastaj dola" pra nënkupton se kam ndenjur ca kohë.

Ndërsa nëse e përdor lidhëzën e dytë "fe-sakaq" si për shembull "hyra aty sakaq dola" nënkupton se ti, pasi ke hyrë, ke dalë aty për aty. Për të këtillë rast të shpejtë përdoret pjesorja arabe lidhëzore "fe-sakaq". Vëreni tani përdorimin e këtyre dy lidhëzave në thënien kuranore në fjalë: "A nuk e shikon se Allahu butësisht i bën të vozisin retë dhe më pas i bashkon ato së bashku pastaj ato i bën shtëllungore (pirg njëra mbi tjetrën)…". Dy lidhëzet "pastaj" të përdorura në këtë pjesë të thënies kuranore tregojnë se midis çdo procesi kalon një farë periudhe kohore ndaj dhe Allahu të tillë gjë e shpreh me lidhëzën përkatëse që është lidhëza "thume-pastaj". Pra thotë: "A nuk e shikon se Allahu butësisht i bën të vozisin retë dhe më pas i bashkon ato së bashku pastaj ato i bën shtëllungore (pirg njëra mbi tjetrën)…", por pasiqë të plotësohet pirgësimi dhe rryma e erës prezente në re që mban të ngritur avujt e ujit, kjo re dhe rryma e erës në të janë të paaftë ta mbajnë më tej pikën e rënduar të ujit të shiut e cila saka bie, pikërisht siç thënia kuranore vijon dhe thotë: "…sakaq e sheh pikëlzën të dalë ndërmjet saj". Vëreni sesi e ndryshoi lidhëzen ashtu që pasi tha: "…pastaj ato i bën shtëllungore (pirg njëra mbi tjetrën)…" vijoi duke thënë: "…sakaq e sheh pikëlzën të dalë ndërmjet saj. Dhe zbret prej qiellit nga malet…". Gjë që përputhet me realitetin e reve të tilla të cilat janë domosdoshmërisht në formën e maleve. Thënia kuranore fton të ngrejmë sytë në qiell kur thotë: "Dhe zbret prej qiellit nga malet…" …", pra thotë shihni në qiell retë që janë në formën e malit! Thotë: "Dhe zbret prej qiellit nga malet në të cilat ka sasi breshëri…". Pra në këtë re në formë mali është formuar një sasi breshëri. Vijimi i thënies kuranore është: "Dhe zbret prej qiellit nga malet në të cilat ka sasi breshëri duke goditur me të kë do…".

Shkencëtarët e studjuan gjatë dukurinë e mënyrës se si formohet breshëri. Gjetën tek retë shtëllungore në formë pirgu se temperatura e pirgut në pjesën e lartë të tij ndryshon nga temperature e tij në pjesën e poshtëme të tij ashtu që maja është e ftohtë ndërsa baza është më e ngrohtë. Ajo sasi breshëri që formohet produktohet pikërisht në pjesën e sipërme të resë shtëllungore. Pastaj breshëri zbret në pjesën e mesme të resë ku gjendet i depozituar ujë por në temperaturën minus, pra nën zero. Në fakt ky ujë duhej të ishte kristalizuar e bërë borë porse ai ka mbetur ujë për shkak se trysnia atmosferike e kulmit të pirgut të resë është e ulët gjë që nuk ndihmon në dendësimin e materilait të ujit dhe bën që ai të mbetet lëng. Sapo kokrra e breshërit zbret nga kulmi i resë në zonën e mesme të saj kjo zonë shndërrohet në një masiv të paparë kokërrash breshëri.

Tani që u formua kristali i ngurtë i breshërit çfarë pritet të ndodhë? Ajo që pritet është që ai të zbresë pasi rëndësa e tij e dikton të tillë gjë, pasi as reja dhe as rryma e erës prezente tek kjo re nuk mund t'a mbajnë atë.

Mirëpo çfarë gjetën shkencëtarët e meterologjisë? Gjetën se kokrra e breshërit zbret menjëherë pas formimit të saj dhe mund të ndodh të godas dhe dëmtojë njerëzit mbi të cilët ky breshër zbret. Por në shumë prej rasteve kokrra e breshërit zbret dhe kthehet sërisht në masivin e resë duke u shmangur kështu rënia e tij mbi njerëzit poshtë zonës ku breshëri funksionon në formën e një cikli të mbyllur brenda masivit të resë. Kokrrës së breshërit që ashtu i mbyllur në masivin e resë vërtitet sa lartë-poshtë, i bashkangjitet një tjetër kokërrz, duke zmadhuar dhe rënduar kështu masën e kokrrës së brëshërit që më së fundmi në një moment të caktuar shkëputet e stërzmadhuar për të rënë mbi kokat e njerëzve. Pastaj një tjetër shtresë masivi gjigand breshëri bëhet gati të zbresë, dhe në zbritje, ende pa rënë nga reja, rryma e erës që dominon renë e kthen sërisht atë në kulmin ku ishte, duke e bërë atë të qarkullojë përmes kësaj dukurie ciklike me skaje kulmin dhe bazën e resë. Kështu vazhdon kokrra e breshërit të qarkullojë në vazhdimësi në këtë cikël të mbyllur brenda resë deri në momentin e lejes hyjnore kur këto kokrra shkëputen e bien. Shih sesi ajo u formua, u rëndua, zbriti në skajin e poshtëm në rrugën e rënies por ndërkaq një rrymë e fortë vjen dhe e ngren atë duke e bërë element të këtij cikli të mbyllur brenda resë ku breshëri i robërohet vullnetit hyjnor, i Lavdishëm është Allahu i Cili bën që shmangia e breshërit të vazhdojë deri kur Ai do.

Le të vijojmë në përshkrimin e imtësishëm kuranor lidhur me sa në fjalë, gjë që shprehet përmes fjalës së Allahut të Lartësuar: “A nuk e shikon se Allahu butësisht i bën të vozisin retë dhe më pas i bashkon ato së bashku pastaj ato i bën shtëllungore (pirg njëra mbi tjetrën) sakaq e sheh pikëlzën të dalë ndërmjet saj. Dhe zbret prej qiellit nga malet (retë në formë mali) në të cilat ka sasi breshëri (zbret breshër) duke goditur me të që do dhe duke e shmangur atë nga kush do”. Ashtu që breshëri riciklohet duke mos u lënë të zbresë herën e parë “…duke e shmangur atë nga kush do”, pastaj riciklohet së dyti e me rradhë deri kur të lejojë dashja hyjnore.

Ishin tre shtete, Amerika, Japonia dhe besoj Australia që tubuan forcat shkencore në studimin dhjetë vjeçar për të ekzaminuar se cili ishte shkaku i formimit të vetëtimës dhe rrufesë. Pas dhjetë vjetë studimesh shkencore erdhi përgjigja se cili ishte shkaku i formimit të vetëtimës.

Gjetën se shkaku i formimit të vetëtimës ishte formimi i masiveve të ngurtë ujorë, pra breshërit, në brendinë e masivit të resë, proces ky që kryhet në një temperaturë fikse.

Duhej të vinte viti 1985 që të raportohej si fakt i kryer nga ana e meterologjistëve identifikimi i shkakut ekzakt të vetëtimës, që doli se ishte pikërisht breshëri.

U vërtetua prerazi se breshëri ishte shkaku i formimit të vetëtimës. Përse?

Kjo sepse kur uji brenda masivit të resë shndërrohet në breshër, pra me krijimin e breshërit në masivin e resë krijohen ngarkesa elektrike që posedojnë energji. Nëpërmjet ciklit lëvizës të breshërit në masivin e resë këto ngarkesa elektrike formojnë pole elektrike të kundërta; në kulmin e sipërm të masivit të resë kemi polin pozitiv dhe në

skajin e poshtëm të saj kemi polin negativ. Si rezultat i krijimit të këtyre ngarkesave elektrike me pole të kundërta dhe krahas ciklit të mbyllur aktiv nëpër të cilin kalojnë kokrrat e breshërit teksa dy polet ngelen në vazhdimësi të ngarkuara me energji, e tillë gjë bën që vetë lëvizja cikluese e breshërit si një trup i vetëm të mbyll qarkun midis dy poleve të kundërta, duke ndodhur për pasojë vetëtima.

Pra pikërisht breshëri është shkaku i vetëtimës.

Le të shohim së bashku përshkrimin e mahnitshëm kuranor lidhur me këtë: "...Dhe zbret prej qiellit nga malet (retë në formë mali) në të cilat ka sasi breshëri (zbret breshër) duke goditur me të kë do dhe duke e shmangur atë (breshërin) nga kush do, shkëlqimi i vetëtimës së tij (breshërit) sa nuk i verbon shikimet".

I Lavdishëm dhe i Dëlirësuar është Allahu nga të metat që i përshkruajnë mosbesimtarët. Një rrugë tjetër kjo e formimit të resë së shiut që në rastin në fjalë quhej reja shtëllungore ose në formë pirgu.

Allahi i Lartësuar kur foli në Kuran për renë e shtrirë nuk përmendi as breshër e as vetëtimë apo gjëmim. Nuk përmendi asgjë nga këto por përkundrazi e mbylli përshkrimin e tyre duke thënë "...Kur Ai e bën atë (pikën e shiut) të bjerë te kush ai do prej robëve të Tij, ata ngazëllehen". Ndërsa në rastin e këtushëm vëreni sesi përshkrimi ndryshon krejtësisht nga rasti i parë dhe vjen në përputhje të plotë me realitetin e reve shtëllungore apo në formë pirgu.

Kush ia mësoi Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- këto detaje shkencore?! Kush ia mësoi atij faktin se breshëri është shkaku i formimit të vetëtimës?!

Kush e mësoi atë se breshëri zbret në masivin e resë në fjalë dhe nuk lejohet të zbres por shmanget zbritja e tij gjë që duket qartë në përshkrimi kuranor: "...duke e shmangur atë (breshërin) nga kush do"?! Kush ia mësoi Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- faktin se mënyra e formimit të resë shtëllungore apo në formë pirgu ndryshon nga ajo e resë shtresore?!

S'ka dyshim se Ai që ia mësoi Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- këto mistere është Allahu, Ai që i di gjithë misteret e qiellit dhe të tokës.

Gjendet edhe një lloj i tretë i reve të shiut. Ky lloj i fundit formohet nga shkëmbimi i dy rrymave apo fronteve ajrore të erërave, që i vijnë rrotull njëra-tjetrës me shpejtësi, gjë që ndryshe është quajtur tornado, ashtu që në ngritjen e saj tornadoja merr me vete sipër masat e avujve të ujit duke i ngritur ata në lartësitë e atmosferës. Sa më lart që ngrihet reja e formuar në këtë formë, aq më i madh është shansi i formimit të pikave të rënda të ujit të shiut. Kështu pikat e rënda të shiut ngrihen gjithnjë e më lartë, deri në një farë largësie, ngrihen ashtu të rënda siç janë dhe kur rëndesa e tyre bëhet e papërballueshme për t'u mbajtur nga fronti atmosferik i resë, atëherë pikat e rënduara të shiut zbresin. Më pas të tjera pika uji që vijnë në rëndim e sipër ngrihen nga e tillë

rrymë ajrore në masivin e resë të formuar prej tyre, derisa rrymat e kësaj reje t'a bartin deri në lartësitë e të parave, ku pasi mbirëndohen edhe këto zbresin.

Pra siç vërehet, shiu nga retë e këtilla nuk zbret në mënyrë të vazhdueshme por zbret në formë rrebeshi apo rrëkeje, duf pas dufi, krejt siç është edhe definicioni i fjalës arabe "thexheexhe" të cilën e përdor Kurani për të përshkruar rënien e një shiu të tillë. Kurani e përshkruan në mënyrë shumë të shquar dhe të specifikuar edhe këtë lloj reje. Lidhur me këtë Allahi i Lartësuar thotë: "Ne zbritëm nga shtrydhëset…". Vëreni çfarë përshkrimi specifik përdor tani Kurani, nuk thotë re shtresore, as shtëllungore por shtrydhëse, procesi i tyre përkundrejt shiut është shtrydhës. Thotë: "Ne zbritëm nga shtrydhëset ujë rrëke". Pra shi me rrebesh që zbret duf pas dufi. Thotë: "Ne zbritëm nga shtrydhëset ujë rrëke. Që me të të bëhet dalja e drithërava dhe bimësisë". Dhe në fakt për të tillë qëllim është rënia e shiut nga të tre llojet e reve. Dhe thëniet kuranore vijojnë: "Edhe kopshte të dendura".

Në thënien e fundit Kurani na përmend kopshtnajat të cilat i përshkruan me një përshkrim specifik, thotë "kopshte të dendura". Çdo me thënë kopsht i dendur?

Normalisht përgjigja është se bëhet fjalë për kopshtet me pemë dhe bimësi aq të dendur saqë bimësia dhe pemët në to janë fare pranë dhe ndonjëher edhe të mbështjella në njëra-tjetrën.

Lind pyetja përse të dendura?

Dendësimi i bimësisë bëhet në këtë rast për shkak të pjellorisë dhe fertilizimit të tokës që një shi i tillë ndjell, duke stimuluar krijimin e pyjeve dhe një bimësie tepër të dendur dhe të ngjeshur, saqë edhe rrënjët e pemëve në të tilla zona pjellore përdridhen, ngjishen e ndërfuten dhe mbështillen në njëra-tjetrën. Një tjetër detaj ky lidhur me përshkrimin kuranor për këtë lloj reje shiu.

Fillimisht Kurani ceku ndryshimin në formën sesi u krijua dhe si produkton shi kjo re, duke e quajtur atë shtrydhëse, teksa detaji tjetër është që shiu që bie nga kjo re bie me rrebesh. Pra shihet qartë se ky lloj i reve nuk përmban ndonjë detaj të përshkrimeve të mëparëshme që u përmendën lidhur me renë shtresore apo atë shtëllungore, porse përshkrimi për retë e llojit të tretë është një përshkrim specifik.

Këto kopshtnaja e pyje të dendur gjenden më shumicë në pyjet australiane ku gjendet gjithashtu me shumicë pikërisht ky lloj i reve të shiut, retë shtrydhëse. Në përgjithësi këto lloj reshë shtrihen përsipër vijës ekuatoriale.

Medito, medito sesi i zbulon Kurani këto mistere të qiellit.

Kush mund t'i dinte këto mistere në kohën e Profetit tonë Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-?!

A e dimë se kur ishte hera e parë kur njeriu pati mundësi të ngjitej në qiell dhe të fluturonte?

Në fakt njeriu arriti të fluturoj në qiell tani shpejt.

Po misteret në fjalë kur arriti t'i mësojë njeriu? Si arriti t'i zbulojë këto mistere? Sa e sa pajisje dhe aparatura iu deshën njeriut të përdorte për të mësuar këto mistere? U vunë në dispozicion satelitët, anijet sipërfaqësore dhe nëndetëset enkas në shërbim të ekspeditave shkencore dhe stacioneve studimoro-shkencore të shpërndara anekënd rruzullit. U deshën vapor të sofistikuar me aparaturat më moderne e të bërë enkas për studimin e meterologjisë. Në fakt qenë këto aparatura që e mundësuan njeriun të arrijë të njohë misteret në fjalë.

Ku t'i gjente Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të tilla aparatura?!

Kësaj diturie (shkencave ekzakte) që na solli Kurani ne muslimanëve, i janë qepur pasë mbarë shkencëtarët bashkëkohorë që pas përpjekjeve të tyre vijnë e pohojnë po atë që raportoi Kurani Fisnik 1400 vjet më parë.

Pas zbulesës që iu bë Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- lidhur me këto mistereve qëndron shpallja hyjnore të cilës nuk mund t'i qaset trilli dhe e kota nga asnjë anë. I përshkruan këto dukuri shpallja hyjnore islame, Kurani, dhe pastaj shkenca vjen të pohojë pikërisht atë që ka pohuar Kurani më parë. Është pikërisht kjo ajo që ne kemi për qëllim me termin tonë Mrekullia Shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike, gjë që bazohet në orientimet ku vetë Kurani na orienton përmes fjalës së Alahut të Lartëusar: "Do t'ua bëjmë atyre të shqueshme argumentet tona në horizont dhe në vetvetet e tyre derisa atyre t'u bëhet fare e qartë se ai-Kurani është e vërteta e pakontestueshme….?!". Allahu thotë se do t'ua bëjë atyre të padyshimtë faktin se ky Kuran është i vërtetë dhe se ai erdhi me të vërtetën, fakt ky që qëndron në atë se Kurani zbriti duke bartur në të diturinë e Allahut, ashtu siç thotë dhe Allahu i Lartësuar: "Porse Allahu dëshmon pro atij-Kuranit që të zbriti. E zbriti atë (të pajisur) me diturinë e Tij…".

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Mrekullia e Besëlidhjes së profetëve (17)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Do bëjmë fjalë për një mrekulli tjetër prej mrekullive të nderuarit tonë Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- që është një fakt prej fakteve të qarta të mesazhit të tij.

Kjo mrekulli ka të bëjë me përgëzimet dhe lajmet e mira të ardhura në librat e shenjtë të mëparshëm të feve të tjera. Këto përgëzime dhe lajme të mira konsiderohen lajmërim dhe përcjellje paraprake prej Allahut dhe profetëve tek kombet dhe popujt, lidhur me ardhjen e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Urtësia lidhur me këto lajme të mira mbi ardhjen e Profetit Muhamd -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- është që të mos ndodh ndërprerje dhe shkëputje në udhëzimin hyjnor, ashtu që kur një profet i ri vjen mos t'a presin ndjekësit e profetit tjetër me diç prej mërisë, armiqësisë, urrejtjes dhe fanatizmit të shëmtuar, porse të ndjehet nga ana e këtyre ndjekësve se profeti që vjen është vijimësi e udhëzimit që solli profeti para tij; gjë e cila bën të eliminohet pështjellimi midis kombeve dhe bën që udhëzimi hyjnor të ketë një lidhshmëri dhe vazhdimësi dhe të gjithë të ndiejnë se i takojnë një kombi të vetëm dhe se që të gjithë janë fëmijët e të njëjtit baba, Ademit -paqja e Allahut qoftë mbi të-. Pikërisht tek ky kuptim orienton thënia kuranore ku Allahu i Lartësuar thotë: "O ju të dërguar, hani prej të mirave me të cilat u kemi furnizuar dhe bëni vepra të mira, Unë jam i Gjithdijshëm kundrejt asaj që ju punoni. Dhe kjo është feja juaj, një fe e vetme, dhe Unë jam Zoti juaj, tregoni devocion ndaj Meje".

Allahu i Lartësuar u mori profetëve besën e tyre që t'u mësojnë popujve të tyre rreth ardhjes dhe identitetit profetik të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe që kur Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të vijë ata që do të jenë gjallë prej tyre do të besojnë në të dhe do e pasojnë atë në çfarë ai përcjell nga Zoti i tyre dhe do t'ua mësojnë popujve të tyre këtë qëndrim kundrejt Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-; ashtu sikurse Allahu i Lartmadhëruar e përmend këtë gjë në Librin e Tij: "Kur Allahu u mori zotimin profetëve: 'Nga ajo se juve ju dhashë libër e urtësi, pastaj do ju vijë ju një i Dërguar vërtetues i asaj që ju posedoni ju patjetër do ta besoni atë dhe do t'a ndihmoni'. Tha-Allahu: 'A pranuat dhe e morët përsipër këtë obligim Timin lidhur me këtë?' Ata thanë: 'Pranuam!' Tha-Allahu: 'Dëshmoni pra, edhe Unë dëshmoj bashkë me ju!" Pra Allahu kërkoi dhe konfirmoi prej tyre besëlidhjen dhe ata pohuan. Me këtë rast Allahu u tha të dëshmojnë dhe u bë edhe vetë Dëshmitar për këtë besëlidhje.

I nderuari ynë Isai-Jezusi -paqja e Allahut qoftë mbi të- përgëzon dhe sjell lajmin e mirë lidhur me ardhjen e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se

Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- është i Dërguari i Allahut që do vijë direkt pas tij, dhe Isai-Jezusi -paqja e Allahut qoftë mbi të- dishepujt e tij i ngarkoi me misionin e përgëzimit dhe lajmit të mirë mbi ardhjen e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-; gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Kur Isai-Jezusi i biri i Merjemes tha: 'O bijtë e Izraelit, unë jam i Dërguari i Allahut tek ju, vërtetues i asaj çfarë është reveluar para meje prej Teuratit dhe përgëzues për një të Dërguar që vjen pas meje emri i të cilit është Ahmed. Kur ai u erdhi atyre me faktet e qarta thanë kjo është një magji e dukshme".

Imam Bukhariu dhe imam Muslimi transmetojnë në adresë të Xhubejr ibn Mut'im-it se ai ka thënë: Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të thotë: "Unë kam disa emra; unë jam Muhamedi, unë jam Ahmedi, unë jam El-Mahi nëpërmjet të cilit Allahu eliminon mosbesimin, unë jam El-Hashir në këmbët e të cilit (do të jem i pari pas të cilit) njerëzit do ringjallen dhe unë jam El-Akib (nuk ka Profet pas meje)".

Lidhur me emrin Ahmed të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- thuhet se është cilësi e shkallës sipërore që përftohet nga folja arabe "hamide-falenderoj" dhe kuptimi i "Ahmed" është "ai që është superfalenderues" pra që e falenderon më së tepërmi Allahun.

Isai-Jezusi -paqja qoftë mbi të- është konkretizues i lajmeve të mira të ardhura për të në librat e shenjtë të mëparshëm, pasi edhe për atë edhe për profetët e tjerë më përpara kanë ardhur përgëzime nga revelatat e profetëve që kanë qenë para tyre. Pra Isai-Jezusi -paqja qoftë mbi të- është konkretizues dhe verifikues i asaj që gjendet tek revelatat e mëparshme lidhur me ardhjen e atij vetë, teksa ai është në të njëjtën kohë përgëzues lidhur me ardhjen e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Përgëzimi për ardhjen e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- nuk vjen vetëm tek bijtë e Izraelit por vjen edhe tek ata që ishin para tyre, ashtu sikurse Allahu i Larëstuar thotë lidhur me këtë në Kuranin fisnik: "E ai (Muhamedi profet) vjen në shkrimet e shenjta të të hershmëve", pra në librat e shenjta të revelatave të hershme. Prandaj ne në vijim do të shohim sesi përmendja e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- vjen tek disa besime që kanë shëmbëlltyra shkresash të shenjta në të cilat gjendet i përmendur Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Përsa i përket asaj që mund të thuhet lidhur me dijetarët e hershëm hebrenj është se ata ishin krejtësisht të vetëdijshëm lidhur me Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe cilësitë e tij, e njihnin atë siç dinin dhe njihnin fëmijët e tyre. Kurani këtë dëshmi lidhur me këtë fakt që ka të bëjë me ta e sjell në fjalën e Allahut të Lartësuar: "Ata të cilëve u dhamë Librin e njohin atë (Muhamedin profet) sikurse njohin dhe dinë fëmijët e tyre dhe një grup prej tyre po e fshehin të vërtetën teksa janë të dijshëm për të".

Ky është dhe shkaku pse ne jemi bërë dëshmitar të një ngjarje që të tërheq vëmendjen, e që është fakti sesi medinasit e pranuan Islamin më shpejtë se mekasit. Jemi dakord se qenë emigrantët e parë mekas që shkuan në Medine ata që e përçuan Islamin në Medine

dhe pas kësaj ai u përhap në mas, por përpjekjet për përhapjen e Islamit në Meke gjithashtu qenë të shumta dhe ndërkohë mekasit nuk reaguan pozitivisht, teksa medinasit si popull e pranuan Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Cili ishte shkaku? Le t'a shohim.

Ibnu Is'haku, Ibnu Xheriri, Ibnu Mundhiri, Ebu Nuajmi dhe Bejhakiu transemtojnë në adresë të Asim ibn Umarit ibn Katede Ensariut, pra bëhet fjalë për Kateden prej medinasve, thotë, disa dijetarë prej nesh (medinasve) më kanë treguar dhe më kanë thënë: Askush prej arabëve nuk ka patur dituri mbi ardhjen e të Dërguarit të Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- më shumë se ne, dhe kjo sepse ne kishim në mesin tonë çifutët që ishin popull mbi të cilin kishte zbritur libër i shenjtë, teksa ne ishim idhujtarë. Çifutët kur u ndodhte nga ne diçka që e urrenin na thonin: Një Profet do dërgohet tani shpejt, koha e tij ka ardhur, ne do t'a ndjekim atë dhe do t'ju luftojmë dhe vrasim ju nën udhëheqjen e tij ashtu sikurse ç'ndodhi me Adin dhe Iramin. Kur Allahu dërgoi të Dërguarin e Allahut-Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ne e ndoqëm ndërsa ata nuk e besuan. E pra, betohem në Allah, lidhur me ne dhe lidhur me ata Allahu zbriti pjesën kuranore: "Dhe para kësaj ata prisnin triumfin (dhe hakërreheshin) kundër atyre që nuk besonin…".

I Lavdishëm është Allahu. Për shkak të pranisë së çifutëve në Medine dhe jetesës së tyre me arabët në të, ndodhte të kishin fërkime. Kur u ndodhnin këto problem ata u hakërreheshin arabëve dhe i kërcënonin duke u thënë se është koha e ardhjes së një Profeti, tani shpejt do dalë, ne do jemi ndjekësit e tij dhe nën udhëheqjen e tij do t'ju asgjësojmë ju; dhe këtë gjë ata e bënin për t'i frikësuar dhe tërhequr arabët prej të bëmurit keq atyre.

Thënien e plotë kuranore lidhur me regjistrimin kuranor për faktin se si u sollën çifutët në rastin në fjalë nuk e mohoi askush prej çifutëve edhe pse Kurani u përcolli atyre të dëgjojnë këtë prononsim të tijin mbi ta, duke u shprehur kundër këtij qëndrimi të paskrupullt të tyre me shprehjet më të mprehta, shfryrëse dhe kritikuese; e nëse ajo çfarë u shkruajt në Kuran do të ishte e pavërtetë atëherë kjo do qe një nxitës për çifutët të mohonin dhe përgënjeshtronin Kuranin që i zbriti Profetit Muhamed duke thënë se një gjë e tillë nuk ishte kurrësesi e vërtetë; porse ajo që ndodhi është se ata nuk e mohuan një gjë të tillë, për të qenë ky qëndrim i tyre argument i qartë që tregon se besimtarët mësuan se ajo çfarë u regjistrua në Kuran është e vërtetë dhe gjithashtu edhe çifutët, të cilët nuk bënë gjë tjetër vetëmse heshtën, gjë në lidhje me të cilën Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin fisnik: "E kur u erdhi atyre (çifutëve) prej Allahut Libri (Kurani) që është vërtetues i asaj çfarë ata posedonin paraprakisht, e që para se ai t'u vinte ata kërkonin ndihmën e tij (profetit që do vinte) kundër mosbesimtarëve; (pas kësaj) kur atyre u erdhi ajo që e dinin, e mohuan atë (Muhamedin). Mallkimi i Allahut qoftë mbi mosbesimtarët!".

Cili ishte shkaku që ata nuk besuan?

Çifutët janë nga bijtë e Isakut dhe kanë bindjen se ata janë më të mirë se arabët, bijtë e djalit tjetër të Ibrahimit, Ismailit, pasi Ismaili e kishte nënën robëreshë kurse Isaku të lirë. Nga ky këndvështrim ata i konsiderojnë arabët inferior dhe më me pak vlerë pasi

nëna e tyre ishte një robëreshë. Por fakti është se si çifutët ashtu edhe arabët janë bijtë e Ibrahimit -paqja qoftë mbi të-.

Kështu, kur Profeti që pritej erdhi nga bijtë e Ismailit dhe jo të Isakut, pra jo nga çifutët, krenaria e verbër dhe mendjemadhësia ua pushtoi krahërorët dhe tentuan t'a refuzojnë atë gjë për të cilën ishin në dijeni të qartë. Prandaj Allahu i Lartësuar u drejtohet atyre duke thënë: "E shëmtuar është ajo gjë për çka ata e shitën vetveten, duke mos e besuar atë që e shpalli Allahu, ziliqar që Allahu falë mirësisë së Tij i zbret Shpalljen Hyjnore atij që dëshiron nga robtë e vet. Andaj merituan zemërim mbi zemërim (ndëshkim mbi ndëshkim). Mosbesimtarët i pret dënim poshtërues". Komentuesit janë shprehur për zemërimin e përmendur rishtazi në thënien në fjalë se ky zemërim dhe ndëshkim dyfish do jetë për arsye se ata adhuran viçin dhe mosbesimit të tyre në Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ose për arsye të mosbesimit të tyre në Mesihun dhe mosbesimit të tyre në Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Besimtarët medinas nuk ua lanë në harresë çifutëve këtë pozicionim të tyrin. Kur ata takoheshin me çifutët u thonin, a nuk na thonit kështu kështu... Kjo gjë i vinte vërtet në pozitë të vështirë çifutët dhe ndodhte nga sikleti ndokush të thoshte edhe "mirë po besoj". Por kur ktheheshin në rrethin e tyre të ngushtë i ktheheshin njëri-tjetrit duke u thënë, si po ua pranoni këtë atyre; gjë të cilën Allahu sërisht e regjstroi gjithashtu në Kuranin famëlartë dhe ua lexoi t'a dëgjojnë. Lidhur me këtë pozicionim të tyre të dyjëzuar Allahu i Lartësuar thotë: "Kur i takojnë ata që besuan (në profetësinë e Muhamedit) ata (çifutët) thonë besuam, dhe kur vetmohen midis tyre thonë: 'A po u thoni atyre atë që Allahu u shpalli (në Teurat rreth Muhammedit), që ata para Zotit tuaj këtë t'a kenë për argument kundër jush. A nuk po arsyetoni?! A thua nuk e dinë ata (çifutët) se Allahu e di atë çfarë ata fshehin dhe atë që bëjnë hapurazi?!"

I Dëlirësuar është Allahu. Çifutët kanë bindjen se ata janë bijtë e Allahut dhe të dashurit e Tij, dhe se Allahu nuk i dënon ata përveçse nëse realitetet e tyre shihen dhe dëshmohen nga të tjerët, ndërsa në të kundërt ata kanë bindjen se Allahu i lajkaton dhe trajton ata ndryshe nga të tjerët.

Porse duhet thënë se ky pozicionim nuk ishte pozicionimi i të gjithë çifutëve. Kishte prej çifutëve, madje edhe prej dijetarëve të tyre, që e pranuan Islamin. Është përmendur nga burimet historike se numri i çifutëve që e pranuan Islamin arriti në njëqind persona, ndërsa përsa i përket të krishterëve që hynë në fenë e Allahut për shkak të këtyre lajmeve të mira mbi profetësinë e Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të ardhura dhe gjendura në shkrimet e tyre të shenjta, është shumë më i madh.

Vjen nga Ibn Xheriri, Ebu Jeale, Tabaraniu dhe Hakimi që e konfirmon këtë transmetim për të saktë në adresë të Auf ibn Malik El Eshxhaiut se ai ka thënë se ka qenë me të Dërguarin e Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- në faltoren (sinagogën) e çifutëve në ditën e festës së tyre me ç'rast Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i thirri të dëshmonin dy dëshmitë e Islamit porse ata nuk iu përgjigjën kështu që i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- bëri të largohej. Kur ja, teksa po largohej një burrë nga pas i tha, qëndro aty ku je o Muhamed! U afrua dhe nga aty pranë Profetit iu drejtua çifutëve, për ç'burrë më njihni o ju çifutë? I thanë, për

Allahun, nuk dimë në mesin tonë ndonjë person më të dijshëm për Librin e Zotit (Teuratin) dhe më të thelluar sesa ti, babai yt dhe gjyshi yt -duke i dëshmuar atij publikisht dhe duke e bërë të njohur faktin se ai, i jati dhe gjyshi i tij ishin më të dijshmit. Pas dëshmisë pozitive që ata i dhanë transmetuesi vijon- Sakaq ai tha: Unë dëshmoj në Allahun se ai është Profeti të cilin e gjeni të shkruajtur në Teurat dhe Ungjill. I thanë: Po gënjen; dhe iu kthyen atij duke i folur keq. Në rastin e tij zbriti fjala e Allahut: "...një dëshmitar nga beni israilët (çifutët) e dëshmoi si të tillë (Kuranin të zbritur prej Allahut mbi Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-) dhe i besoi, kurse ju u treguat kryeneç".

Ndërsa përsa i përket të krishterëve kemi rastin e Uerakas që ishte i krishterë dhe që në të parën herë që dëgjoi prej profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dëshiroi të ishte djalë i ri e t'a ndihmonte kur populli i tij t'a përzinin si dhe i tha se ai ishte Xhebraili që qe dërguar edhe tek Musai edhe tek Isai -paqja qoftë mbi ta-.

Tjetër rast është ai i Nexhashiut, mbretit abisinas, që kur i erdhi delegacioni i muslimanëve dhe Xhaferi i lexoi disa thënie të kaptinës kuranore "Merjemja" besoi dhe u bë musliman, duke thënë thënien e tij të famshme se, ata të dy (thëniet e Kuranit dhe ato që iu reveluan të nderuarve tanë Musait dhe Isait) dalin nga i njëjti pishtar.

Delegacione të tjera të krishterësh i erdhën Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe patën biseda me të; dhe pati prej pjestarëve të tyre që kur kuvenduan me Profetin sytë e tyre derdhnin lotë për të vërtetën që po mësonin, gjë pas së cilës ata besuan në profetësinë e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë në Librin e Tij: "Gjithqysh ti do të vëresh se jehuditë (çifutët) dhe ata që i përshkruan Zotit shok (idhujtarët) janë njerëzit me armiqësinë më të fortë kundër besimtarëve (kundër muslimanëve). Ndërsa do të vëresh se më të afërmit në miqësim me besimtarët janë ata që thanë: 'Ne jemi nesara-të krishterë'. Këtë (do t'a gjeshë) ngase prej tyre (të krishterëve) ka dijetarë dhe të devotshëm të cilët nuk janë kryeneçë. Kur e dëgjojnë atë që i është zbritur të Dërguarit (Kuranin), sytë e tyre derdhin lotë, ngase e kanë kuptuar të vërtetën dhe thonë: "Zoti ynë, ne kemi besuar, na shkruaj ne ndër dëshmuesit (ndër kombin musliman të Muhammedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-)".

Ka popuj të krishterë që kanë hyrë në fenë e Allahut, në Islam, dhe nuk ka dyshim se lajmet e mira të gjendura në shkrimet e shenjta para Kuranit kanë patur ndikim për pranimin nga ana e tyre të fesë së Allahut, Islamit. Hyrja e tyre në fenë e Allahut ka vazhduar në rang dijetarësh nga çifutët dhe të krishterët dhe edhe sot në ditët tona ata vazhdojnë t'i përkatësojnë fesë së Allahut.

Lajme të mira përgëzuese për ardhjen e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- vijnë edhe në librat e hindusëve, dijetarëve të tyre brahmansëve, për të cilët thuhet se kanë përkatësuar tek Ibrahimi -paqja qoftë mbi të- kur ata kaluan në Babil në kohën kur kaloi andej i nderuari ynë Ibrahimi -paqja qoftë mbi të- prej broshurave të të cilit ata morën dituri hyjnore; këtu qëndron dhe arsyeja përse ne gjejmë tek librat e këtyre hindusëve përmendjen e Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe e njëjta gjë mund të thuhet për librat e zjarrputistëve-mexhusëve.

Krahas asaj që thamë, duhet ditur se librat e Biblës (Ungjillit dhe Teuratit) të ditëve tona kanë pësuar ndryshime të ndryshme. Këtë fakt e kanë përmendur edhe kronologjistët historik jomuslimanë. Por megjithkëtë sërisht në Bibël gjenden lajmet e mira mbi ardhjen e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- që bëjnë të qartë se një Profet do të vijë. Për këtë gjë vijnë lajme të mira dhe përgëzime edhe nga Teurati edhe nga Ungjilli ku i nderuari ynë Isai-Jezusi -paqja qoftë mbi të- përgëzon në lidhje me këtë.

Lajmet e mira flasin se kush është ky Profet që do të vijë pas Isait, si e ka emrin, çfarë cilësish ka? Le t'i trajtojmë bashkarisht këto element duke filluar së pari me përshkrimin biblik se një Profet do të vijë.

Në Teurat (Dhjatën e Vjetër) në librin Deuteronomia, në citatet 18-19, vjen: "O Musa! Unë izraelitëve do t'u dërgojë një Profet nga vëllezërit e tyre, si ti. Fjalën Time do ta vendos në gojën e tij dhe ai do t'u thotë atyre atë çfarë Unë e urdhëroj të thotë. E ai që nuk e pranon fjalën e këtij Profeti i cili flet në emrin Tim, ndaj të tillit dhe nipërve të tij Unë do të hakmerrem". Kjo që rreshtuam më herët gjendet tek ata tani momentalisht, në Teuratin e ditëve tona. Kur vërejmë atë që thuhet këtu: "Unë izraelitëve do t'u dërgojë një Profet nga vëllezërit e tyre…"; kjo na bën të kuptojmë se ky Profet nuk do të jetë nga çifutët, pasi nëse Zoti do t'a dërgontë nga izraelitët këtë Profet atëherë do të thoshte: Unë izraelitëve do t'u dërgojë një Profet prej tyre; porse ajo që gjejmë është se Allahu nuk tha "prej tyre" por tha "prej vëllezërve të tyre". Pyetja është se kush janë vëllezërit e tyre? Përgjigja është se ata janë bijtë e Ismailit, arabët.

Në po këtë libër Musai u thotë izraelitëve: "Mos iu bindni fallxhorëve dhe as astrologëve. Zoti do t'ju dërgoj një Profet nga vëllezërit tuaj, si unë. E pra bindjuni këtij Profeti".

Shumë prej shkrimtarëve çifutë dhe të krishterë që kanë pranuar Islamin kanë argumentuar se kjo profetësi nuk përputhet me atë të Isait-Jezusit -paqja qoftë mbi të- pasi Jezusi-Isai nuk qe simetrik dhe i nëjtë me Musain, sepse ndryshe nga Musai ai nuk lindi me një lindje normale; as vdiq një vdekje normale, përkundrazi nuk vdiq por ende jeton; nuk pati funksion juridik drejtues tek populli i tij, etj. Në fakt cilësitë e të nderuarit tonë Musait -paqja qoftë mbi të- përputhen me ato të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Sa përmendëm ishte nga Teurati. Në Ungjill gjithashtu gjejmë lajme të mira përgëzuese mbi ardhjen e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Kështu në Ungjillin e Gjonit, kapitullin 16, citatet 7 dhe 16 vjen: "Në të vërtetë është më mirë që unë të shkoj, pasi nëse unë nuk shkoj nuk do t'ju vijë Farakliti (Trashëgimtari)…"; fjala Faraklit gjendet në botimet e vjetra të Biblës, ndërsa në Biblën e sotshme gjendet e ndryshuar në Ngushëlluesi, me kuptimin ai që do t'i ngushëllojë ata lidhur me çështjen e Isait -paqja qoftë mbi të-. "Në të vërtetë është më mirë që unë të shkoj, pasi nëse unë nuk shkoj nuk do t'ju vijë Farakliti (Trashëgimtari). Nëse iki do ua sjellë atë. Kur të vijë, ai ka për t'i tërhequr vërejtje botës për mëkatin. Unë vërtetë kam shumë fjalë që dua t'ua them porse ju nuk i mbani dot ato. Por kur të vijë Shpirti i së vërtetës, ai është ai i cili do t'ju orientojë tek e mira në tërësi, sepse ai nuk flet nga vetvetja porse flet nga ajo që dëgjon (me kuptimin se ai nuk di të lexojë por shpalljen e

merr përmes dëgjimit dhe e përcjell) dhe ju bën ju me dije rreth çdo gjëje që do të vijë". Kjo është thënie e Mesihut-Jezusit që gjendet tek ata në Ungjillin e tyre në lidhje me Profetin që do të vijë mbas Mesihut. E kush është ai Profet që erdhi dhe bëri me dije për çdo gjë lidhur me fenë si dhe u tregoi njerëzve lidhur me atë që do të ndodhë në të ardhmen?! Kush është ky veç Profetit Muahamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-?!

Në një tjetër vend në Ungjillin e Mateut, kaptina 21, citatet nga 42 deri 44 vjen se Jezusi-Isai -paqja e Allahut qoftë mbi të- u ka thënë atyre: "A s'keni lexuar asnjëherë në shkrimet e shenjta për gurin që e kanë refuzuar ndërtuesit e që është bërë prej Zotit kreu i kulmit. Kjo ka qenë e mahnitëshme në sytë tanë, prandaj po ju them se mbretëritë e Zotit do t'ju hiqen ju dhe do t'i jepen një populli që do t'i bëjë të japin fryte". Lidhur me këtë vjen dhe hedh dritë edhe hadithi profetik për atë se ndërtesa e profetësisë është plotësuar përveç vendosjes së një guri dhe unë –thotë Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- jam ai gurë. Në citatin ungjillor në fjalë Isai-Jezusi -paqja e Allahut qoftë mbi të- u thotë izraelitëve se "mbretëritë e Zotit"; term biblik ky që nënkupton Shpalljen Hyjnore; "mbretëritë e Zotit (Shpallja Hyjnore) do t'ju hiqen" dhe kujt do t'i shkojnë? Thotë, "mbretëritë e Zotit (Shpallja Hyjnore) do t'ju hiqen dhe do t'i jepen një populli që do t'i bëjë të japin fryte"; pra kuptimi është se Shpallja Hyjnore do t'u hiqet izraelitëve dhe do t'i jepet një kombi tjetër joizraelit që punon me to dhe i bën të japin fryte konkrete

Një tjetër pyetje do të ishte se çfarë thuhet në Shkrimet e Shenjta për emrin e këtij Profeti?

Në Teurat, në librin e Psalmeve, kapitulli 16, por sipas versionit hebre dhe në gjuhën hebraike, vetë professor Ahmed Didat më ka thënë se vjen citati në vijim: "HEKO HEKO MA MITAKIM VIKULU MUHAMEDIM". Pra Muhamedim, shikoni sesi vjen kjo duke bartur emrin Muhamed, teksa kur ky tekst është përkthyer nga hebraishtja në arabisht qëllimisht është deformuar trajta e tij. Profesor Muhamed Didati ka përmendur se domethënia e kësaj fraze është: "Fjala e tij është fjala më e mirë, ai është Muhamedi Madhështor". Ky është përkthimi i vërtetë i frazës hebraike në fjalë.

Një tjetër ungjill është ai i Bernabës të cilin e publikoi një prift latin nga bibloteka personale e Papës, afërsisht në shekullin XVII. Emri i këtij prifti ishte Framrino i cili kur u njoh me ungjillin e Bernabës u bë musliman dhe e publikoi atë.

Në këtë ungjill gjejmë të shkruajtur si në vijim: "Dhe kjo do mbetet derisa të vijë Muhamedi i Dërguari i Zotit i cili kur të vijë do e zbulojë këtë mashtrim për ata të cilët besojnë në ligjin e Zotit".

Emri i Profetit Muhamed gjendet i përmendur gjithashtu edhe në librin e shenjtë të hindusëve Semevida, kapitullin 2, artikujt 6 dhe 8 të cilat po i përcjell të marra nga libri "Prirjet Misterioze në Besimet e Hershme Indiane"; i një dijetari musliman indian të quajtur T-Muhamed, i cili është ekspert në religjionin indian. Tekstet në fjalë janë punë studimore e tij e sjellë në këtë kontekst. Pra në artikujt 6 dhe 8 të kapitullit 2 të këtij libri të shenjtë të Hindusëve vjen ky tekst: "Ahmedi mori ligjin nga Zoti i tij dhe ai është i mbushur përplot me urtësi. Ka marrë prej dritës siç merret nga dielli".

Në një tjetër librër të shenjtë hindus të titulluar "Idrua Vedëm-Athrava Veda", në volumin 20, kapitulli 127 artikulli 70, vjen: "O njerëz! Dëgjoni dhe arsyetoni! Dërgohet Muhamedi në mesin e njerëzve dhe madhështisë së tij i bëhen lavde edhe në Xhenet dhe Xheneti do të jetë në nënshtrimin kundrejt tij, ai është Mahamad (Muhamed)".

Në një tjetër libër hindus të titulluar "Bohoshbranum" në volumin 12, kapitullin 3, artikulli 3 e në vijim vjen: "Në këtë kohë dërgohet një i huaj që do ketë shokët e tij, emri i tij është Mahamad (Muhamed) dhe pseudonimi i tij është Mësuesi i Botës. Sunduesi-Zoti do t'a pastrojë atë me pesë pastrueset (bëhet fjalë për pesë namazet me të cilat Allahu pastron gjynahet)".

Natyrshëm lind pyetja se përse ne nuk e gjejmë të njëjtën qartësi në tekstet bashkëkohorë në Teurat (Dhjatën e Vjetër) dhe Ungjill (Dhjatën e Re)? Lidhur me këtë kronologjisti i shquar anglez Mr. Gibon në kapitullin 5 të librit të tij thotë: "Rabinët dhe priftërinjtë me daljen në skenë të Islamit bënë ndryshime dhe zëvëndësime në sa e sa prej shkrimeve të tyre të shenjta në Teurat (Dhjatën e Vjetër) dhe Ungjill (Dhjatën e Re).

Një shkrimtar historian ish-i krishter, i quajtur Bushra Zakhari Mikhail, të cilin Allahu e udhëzoi në Islam, në librin e tij "Muhamedi i Dërguari i Allahut" thotë: "Priftërinjtë bënë shumë ndryshime dhe zëvëndësime, gjë që del qartë në pah nisur nga variacionet e ndryshëm të ungjijve që variojnë dhe ndryshojnë nga një botim i Ungjillit në tjetrin; kjo në saj të ndërhyrjes së duarve ndryshuese dhe zëvëndësuese të priftërinjve".

Ish-Arqipeshkviu i Mousulit në Irak, i quajtur Abdul Ehad Daud Al-Eshoriu, i cili pranoi Islamin, në librin e shkruajtur prej tij "Bibla dhe Kryqi" thotë: "Shprehja e shquar në mesin e të krishterëve është "Falenderimi i takon Allahut në tejlartësitë, mbi tokë është paqja dhe për njerëzit është pëlqimi" dhe në fakt kjo shprehje nuk është kështu në origjinalin e Ungjillit, porse në zanafillën ungjillore ka qenë "Falenderimi i takon Allahut në tejlartësitë, mbi tokë është Islami dhe për njerëzit është Ahmedi". Ndodhi kështu sepse me kalimin e kohës ndodhën shumë ndryshime dhe devijime.

Gjithsesi dijetarët musliman i kushtuan vëmendjen e plotë lajmeve të mira përgëzuese të shkrimeve të shenjta për Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe në kohët kur jetuan bënë fjalë për ta, duke përpiluar dhe trajtuar faktin sesi shkrimet e hershme të shenjta bënin fjalë mbi emrin e Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Përgjatë historisë shumë dijetarë muslimanë i kemi gjetur të hynë në debate dhe ballafaqime me dijetarë hebrenj dhe të krishterë lidhur me tematikat në fjalë në Teurat (Dhjatën e Vjetër) dhe Ungjill (Dhjatën e Re) duke i sqaruar të gjitha këto nga vetë tekstet origjinale të nxjerra pro kontekstit të tyre biblik.

Në fakt sa në fjalë nuk është bërë vetëm nga dijetarët musliman por edhe nga dijetarë hebrenj dhe të krishterë të cilët kanë pranuar Islamin dhe tekstet në fjalë i kanë publikuar dhe anoncuar në librat e tyre të cilët u kanë rezistuar dhe mbijetuar kohërave dhe kanë ardhur të freskët dhe të pacënuar edhe në ditët tona, në duart tona.

Në të gjithë këto libra të përpiluar përgjatë kohërave, përmendet në kohë dhe vende të ndryshme të botës e vërteta lidhur me faktin e ardhjes qartazi dhe dukshëm të emrit të Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- në shkrimet e shenjta. Mbi këtë fakt hidhet dritë nga disa priftërinj që përcjellin se në Bibël, në Librin e Isaja-s thuhet: "Askujt veç tij nuk do t'ia jap atë. Ahmedi-I Lavdërauari që e lavdëron Zotin me lavd të ri (pra mesazh, lutje dhe adhurim të ri për Zotin). Atë që ia jap atij nuk ia jap tjetërkujt. Ahmedi-i Lavdëruari që e lavdëron Zotin me lavd të ri, që vjen nga toka më e mirë (teksa siç dihet zona më e mirë në tokë për Allahun është Bekja-Mekja të cilës Profeti i drejtohet me këtë prestigj duke i thënë 'O Meke, ti je më e mira prej viseve në tokë e s'do kisha dalë prej teje nëse banorët e tu nuk do të më kishin dëbuar'). Për ardhjen e tij do gëzohet terreja mbarë dhe banorët e saj do t'a njësojnë Allahun dhe do t'a madhërojnë Atë mbi çdo vend të ngritur dhe kodrinë (hidhet dritë mbi njësimin e Allahut përmes ezanit kur thuhet LA ILAHE ILA ALLAH-NUK E MERITON TË ADHUROHET ME TË DREJTË ASKUSH VEÇ ALLAHUT; ezan të cilin muslimanët me qëllim që ai të arrijë sa më larg bëjnë kujdes t'a thërrasin në vende të ngritura)". Kjo vjen në Librin Isaja sikurse ç'shprehet lidhur me këtë në librin e tij "Përgjigja e saktë për shtrembërimin e fesë së Mesihut" Ibn Tejmije (i vdekur në vitin 728 sipas kalendarit hënor), e hasim këtë në librin "Udhëzimi i hezituesve"të Ibnul Kajim El-Xheuzijes (i vdekur në vitin 751 sipas kalendarit hënor), e hasim në librin "Përgjigjet e shkëlqyeshme" të imam El-Karafit (i vdekur në vitin 682 sipas kalendarit hënor) e hasim në librin "Informimi" të imam Kurtubiut (i vdekur në vitin 671 sipas kalendarit hënor) e hasim tek Ebu Ubejde Al-Khazraxhiu (i vdekur në vitin 582 sipas kalendarit hënor) e hasim edhe tek një ish-prift spanjoll që pranon Islamin dhe merr emrin Abdullah Et-Turxhumen (i vdekur në vitin 832 sipas kalendarit hënor) në librin e tij "Kryevepra e Inteligjencës", e gjejmë edhe tek libri "Turpërimi i atyre që devijuan Teuratin dhe Ungjillin" i autorit imam Salih ibn Husejn El-Hashimiut (i vdekur në vitin 968 sipas kalendarit hënor).

Siç e shikoni, këta liderë fetarë pavarësisht nga kohët dhe vendet ku kanë jetuar, kanë debatuar me të krishterët dhe hebrenjtë, dhe ajo që na ka ardhur është transmetimi i çfarë ka ngjarë midis tyre, për të na shërbyer si burim i pakontestueshëm pro muslimanëve. Siç e thamë pati prej tyre kush pat qenë prift si në rastin e Abdullah Et-Turxhumenit emri i të cilit para se të bëhet musliman ka qenë Anslam Tormida nga Spanja.

Kuptimi i gjithë sa përmendëm më herët është se Allahu i Lartësuar dhe Lartmadhëruar në favor të Profetit të Tij Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ka bërë fakte dhe argumente të pranishme në shkrimet e hershme të shenjta dhe në librat e dijetarëve të hershëm, për të cilët edhe pse janë bërë tentative të shumta që të eliminohen, manipulohen dhe zhduken, Allahu deshi që ato të mbeten si fakte dhe argumente të cilat dolën qartazi në pah në kohën e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe pas jetës së tij, dhe më pas dijetarët musliman depërtuan tek këto fakte dhe të dhëna.

Ende në shkrimet e shenjta gjenden fraza të qarta që nuk i ka tjetërsuar dora e devijancës dhe që nuk mund të përputhen përveçse me Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Kështu del qartë në pah fakti se Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u dërgua nga Allahu dhe se Allahu ardhjes së tij i ka paraprirë me këto lajme të mira dhe përgëzime të ardhura në shkrimet e hershme të shenjta.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Mrekullia shkencore në Kuran (18)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Njerëzia ka progresuar dhe përparuar shumë dhe sa vijnë e bëjnë arritje të reja në lëmenjtë e zbulimeve dhe arritjeve shkencore. Sot ata kanë arritur të njohin realitetin e shkencave ekzakte për të cilat Kurani Famëlartë ka bërë fjalë qysh para mëse 1400 vjetësh.

Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "Porse Allahu dëshmon pro atij-Kuranit që të zbriti. E zbriti atë (të pajisur) me diturinë e Tij…" Pra, e zbriti Kuranin dhe në të është dituria e Tij, kështu janë shprehur komentuesit e Kuranit.

Mrekullinë e paskemi në duart tona, dhe aspekti i mrekullisë së tij është mrekullia shkencore, ashtu siç citon vetë Allahu i Lartësuar: "Porse Allahu dëshmon pro atij që të zbriti. E zbriti atë (të pajisur) me diturinë e Tij…" Natyra e kësaj mrekullie shkencore në Kuranin Fisnik është të folurit e tij rreth realiteteve ekzistenciale, qofshin ato në kuadrin e krijesave dhe universit ose qofshin ato në lidhje me rregullsitë, ligjet juridike dhe sjelljet.

Shkencëtarët bashkëkohorë termin "shkencë" e përdorin për shkencat e eksperimentueshme pasiqë ato janë të prekshme dhe ekzakte, të tilla që mundesh t'i shohësh, mbikqyrësh dhe masësh. Prej këtu ata emrin shkencë ia dhanë shkencave eksperimentale.

Ndërkaq termi që dijetarët muslimanë bashkëkohorë kanë vendosur të shprehen me të lidhur me mrekullitë shkencore islame që kanë të bëjnë me shkencat e universit është "Mrekullia Shkencore Kuranore dhe Profetike".

Njerëzve të kohëve të sotme argumenti islam u ka ardhur nga lëmi ku ata janë bërë më të famshëm, e që është lëmi i zbulimeve shkencore.

Si arritën njerëzit deri tek këto zbulime?

Njerëzit e kohës sonë arritën deri tek këto zbulime falë teknologjisë bashkëkohore që posedojnë dhe rekrutimit masiv shkencor në shërbim të zbulimeve shkencore, falë universiteteve dhe kolegjeve hulumtuese, falë aparaturave dhe mjeteve të larmishme që i mundësojnë të eksplorojnë planetin tokë në detaj dhe të vozisin në hapësirën qiellore kozmike dhe atë ndërhapsinore, gjë të cilën e realizojnë përmes satelitëve studimor që studiojnë planetin e kaltër dhe hapësirën, ose aparaturave që i kanë

mundësuar të zhyten e depërtojnë deri në thellësitë e ujërave të oqeanëve dhe detërave. Armata shkencëtarësh vrojtues dhe hulumtues survejojnë çdo dukuri duke vënë re çdo segment të tyre dhe më tej këto detaje të studiuara i unifikojnë ashtu që të dalë në pah imazhi i qartë lidhur me fenomenin apo dukurinë që studiohet.

Kur për pikëpamjen shkencore, fytyra e së cilës del qartë në pah dhe shpaloset plotësisht ashtu që shkencëtarët e publikojnë si një zbulim të ri të pakontestueshëm shkencor, gjejmë që Kurani (ose Tradita Profetike) të ketë bërë fjalë precizivisht për të, kjo gjë nxjerr qartazi në pah mrekullinë shkencorë të Kuranit. Dhe ata që e dëgjojnë bëhen njohës të faktit se ajo e vërtetë shkencore në të cilën ata arritën pas kërkimit të tyre tepër të gjatë gjendet e përmendur në Kuran ose në traditën Profetike. Është ky fakt ai që i bën bashkëkohësit tanë të binden dhe kenë besimin e palëkundur se ky Kuran është prej Allahut dhe se ai është një mrekulli e gjallë në duart tona.

Është pikërisht kjo ajo çfarë e quajmë mrekullia shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike.

Përkufizimi i mrekullisë shkencore në Kuran dhe në Traditën Profetike është: "Lajmërimi i Kuranit apo i Traditës Profetike mbi një të vërtetë që e ka verifikuar shkenca e eksperimentuar teksa është vërtetuar pamundësia e evidentimit të një të vërtete të tillë me mjetet që posedonte njerëzia në kohën e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Ne kemi patur kontakte dhe takime me shumë prej pionierëve të shkencave bashkëkohore. Disave prej këtyre shkencëtarëve u është dashur të zhyten në kërkimet e tyre, krahas ndihmës që u kanë dhënë asistentët e tyre nga muslimanët, derisa kanë arritur të konkludojnë këto realitete shkencore të përmendura në Islam. Unë kam patur mundësinë që të kem takuar një numër të konsiderueshëm prej tyre, rreth tridhjetë prej shkencëtarëve më të mëdhenj të botës.

Le të shohim së bashku sesi u shprehën ata!

Së pari a është mrekullia shkencorë një çështje që e ka raportuar vetë Kurani. Ajo që ne e quajmë sot mrekulli shkencore e që do shfaqej me kalimin e kohës a është një sajesë e dijetarëve dhe teologëve muslimanë apo ajo është një çështje e raportuar dhe e gjendur në Librin e Allahut.

Them, kjo çështje është një çështje e raportuar, e sqaruar dhe një çështje që është objekt i premtimit hyjnor ardhur në Librin e Allahut të Lavdishëm dhe Lartmadhëruar. Allahu i Lartësuar lidhur me Kuranin Fisnik thotë: "Ai-Kurani është në fakt vetëmse një përmendje për botën." Pra Kurani është përmendje-kështillë për botën mbarë, për njerëzit mbarë deri në Ditën e Kijametit. "Ai-Kurani është në fakt vetëmse një përmendje për botën. Lajmin e tij do t'a mësoni në mënyrë të sigurtë pas një farë kohe…" Nënkuptohet pas një farë kohe, pra pasi të kaloj një interval kohor i caktuar.

Cili është dhe kur do jetë ky interval kohor përmes të cilit do na konfirmohen në mënyrë të pakontestueshme disa prej lajmeve rreth të cilave na lajmëroi neve ky Kuran? Allahu i Lartësuar thotë: "Për çdo lajm është një moment kur stabilizohet (duke u bërë realitet) dhe do t'a mësoni..." Pra do t'a mësoni të vërtetën e këtij lajmi të dhënë nga Kurani kur të vijë momenti që ai të bëhet realitet dhe të spikasë domethënia e tij e vërtetë që më parë barte shumë kuptime. "Për çdo lajm është një moment kur stabilizohet...", pra nuk bëhet fjalë për një interval kohor të vetëm por për disa të tillë. Cilët janë këto intervale? Thënia kuranore thotë që për çdo lajm, për çdo lajm është një interval kohor në të cilin shquhet e vërteta e këtij lajmi. Mirë, por kur do të jetë intervali kohor lidhur me këtë lajm? Të tillë gjë Kurani e sqaron duke na bërë me dije se koha e tij është koha kur ai do të bëhet i shqueshëm për njerëzit, kur ai do të shihet dhe zbulohet, gjë mbi të cilën Allahun shprehet: "Dhe thuaj falenderimi suprem i takon vetëm Allahut. Ai do t'ua bëjë të shqueshme argumentet e Tij ashtu që ju do të bëheni të vetëdijshmë për to."

Koha dhe periudha e caktuar për zbulimin e këtyre sekreteve të Kuranit ku jepen këto lajme specifike është koha e zbulimeve shkencore, koha e shqueshmërisë së realiteteve të këtyre lajmeve kuranore.

Cili do të jetë konkluzioni i gjithë kësaj?

Konkluzioni do të jetë që dijetarët e familjarizuar me shkencat e universit që qëndrojnë pas këtyre zbulimeve do të vihen në dijeni se këto të vërteta -tek të cilat shkencëtarët nuk arritën vetëmse pasi u përpoqën pandarë dhe poseduan mjete precize e armata të tëra dijetarësh- që ky Kuran përmend, kurrsesi nuk ishte e mundur që të arriheshin nga Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- në atë kohë përveçse me informim dhe duke iu bërë kjo e ditur nga Allahu, pra këto të vërteta shkencore i erdhën Muhamedit + përmes Shpalljes Hyjnore, gjë që konkludon se ky Kuran zbriti duke mbartur në të diturinë e Allahut. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "Do t'ua bëjmë atyre të shqueshme argumentet tonë në horizont dhe në vetvetet e tyre derisa atyre t'u bëhet fare e qartë se ai-Kurani është e vërteta e pakontestueshme. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?!"

Është e drejtë e çdokujt që paskësaj të pyes se ku don të konkludojë ky episod?

Themi, ne tani jemi në epokën e zbulimeve shkencore teksa Kurani Fisnik është plotpërplotë me përshkrime lidhur me ekzistencën, universin dhe fenomenet në të. Më parë bëmë fjalë edhe për shkencëtarin e mjekësisë, doktorin e famshëm francez Maurice Bukay që pranoi Islamin pikërisht nga ky kapitull. Ai tha se dikush që ka bërë fjalë së tepërmi lidhur me dukuritë dhe përshkrimet e ekzistencës qysh para 1400 vjetësh duhet medoemos të bjerë në gabim, pasi ai domosdoshmërisht do përcjellë dhe transmetoj informacionet e kohës së tij dhe kulturën e asaj kohe, të kohës dhe ambientit të tij. Dhe tha, kjo nëse ka folur nga koka e tij, porse nëse ka folur nga dituria hyjnore që i është shpallur ai do vijë me informacione dhe dije kulminante me të cilat do u

paraprijë shkencave ekzakte bashkëkohore. Në fakt është pikërisht kjo ajo që gjejmë në Kuran.

Duke parë këtë aspekt të Kuranit muslimanët miratuan dhe bënë një organizatë të quajtur Bordi Mbarëbotëror i Mrekullive Shkencore të Kuranit dhe Traditës Profetike. Ai që e formoi Bordin Mbarëbotëror të Mrekullive Shkencore të Kuranit dhe Traditës Profetike ishte Këshilli Suprem Ndërkombëtar i Xhamive pikërisht në qendrën e Unionit Islamik Mbarëbotëror në Meke. Pastaj lidhur me këtë u mbajtën shumë konferenca ndërkombëtare, konferencë në Rijad ku morën pjesë një numër tepër i madh pjesmarësish, mbi 2000 shkencëtarë të ardhur prej anekënd botës. Salla e madhe iu dedikua diskutimit lidhur me Mrekullitë Shkencore të Kuranit dhe Traditës Profetike. Më pas u mbajt në Kajro një tjetër konferencë e cila ishte e specializuar për çështjet e mjekësisë që ishte dhe Konferenca e Parë Mjekësore e Mrekullive Shkencore Kuranore dhe Profetike e mbajtur në Kajro. Në këtë konferencë pati pjesmarrës të përkatësive të ndryshme si Unioni Islamik Mbarëbotëror, Bordi i Mrekullive Shkencore Kuranore dhe Profetike, Sindikata e Doktorëve Egjiptian, Universiteti i Ez'herit etj. Cila qe shtysa që i tuboi doktorët dhe sindikatat e tyre me Universitetin Teologjik të Ez'herit dhe Unionin Islamik Mbarëbotëror? Ajo që i tuboi të gjithë këta ishte shkenca, lëmi ku profilet e tyre kontaktonin. Gjithashtu të pranishëm në këto konferenca ishin shume prej shkencëtarëve më të mëdhenj të botës. Më tej u mbajt edhe një konferencë tjetër në Senegal ku qe i pranishëm vetë Presidenti i atëhershëm i Senegalit, kohë në të cilën Senegali ishte Kreu Organizativ i Konferencës Islamike.

Në Senegal konferenca pati një jehonë dhe bujë vërtet të madhe. Qe një fitore madhështore. Në të morën pjesë shtresat intelektuale që dëshmuan të vërtetën me sytë e tyre dhe pati prej pjesmarrësve edhe shumë prej jomuslimanëve që paraqitën hulumtimet e tyre lidhur me lëmin e Mrekullive Shkencore Kuranore dhe Profetike. Në vijim një tjetër konferenc u mbajt në Islamabad e cila u hap nga Presidenti i atëhershëm i Pakistanit Dijaul Haku -Allahu e mëshiroftë-. Pjesmarrësit në të ishin pokështu të shumtë në numër dhe pati të pranishëm edhe prej shkencëtarëve më të mëdhenj të botës që erdhën nga anekënd globit. Në konferencën në fjalë morën pjesë Universiteti Islamik i Islamabadit, Unioni Islamik Mbarëbotëror si dhe u ftua Akademia Pakistaneze nga ku morën pjesë një numër i madh dhe i konsiderueshëm prej shkencëtarëve të saj.

Cili qe motivi që i tuboi ata njerëz?

Ajo çfarë i tuboi ishte premtimi që Kurani bëri duke thënë: "Do t'ua bëjmë atyre

të shqueshme argumentet tona në horizont dhe në vetvetet e tyre derisa atyre t'u bëhet fare e qartë se ai-Kurani është e vërteta e pakontestueshme…?!" Kulminacionet qenë me konferencën e mbajtur në Moskë ku e habitshme mund të jetë për sa e sa prej njerëzve se rregullatore e kësaj konference qe vetë Akademia Mjekësore Ruse në bashkëpunim me Qendrën Islamike në Moskë dhe me Unionin Islamik Mbarëbotëror si dhe Bordi i Mrekullive Shkencore Kuranore dhe Profetike.

Çfarë e bëri Akademinë Ruse të bëhet palë e kësaj konference ku solli si përfaqësues të vet profesorin e saj të shquar Vladimirin, i cili në lidhje me këtë event u shpreh kështu: Kur na u tha hajdeni të prezantoni me ne, unë u çudita dhe thashë ç'është kjo, e ç'lidhje ka shkenca me fenë?! Tek ne feja dhe shkenca janë dy gjëra krejt të ndryshme madje kontradiktore. U thashë ftuesve, mire, na dërgoni fillimisht hulumtimet që do jenë objekt bisedimesh dhe kur ata na i dërguan ato hulumtime dhe i shqyrtova ato pashë se ato ishin hulumtime dhe studime shkencore serioze të detajuara. Me këtë rast thashë, kështu po, është një kënaqësi për ne të marrim përsipër organizmin e një konference të tillë…

Një tjetër konferencë e madhe është mbajtur edhe në Indonezi. Që të gjitha këto kanë qenë konferenca të nivelit ndërkombëtar ku kanë marrë pjesë shtresa të privilegjuara intelektualësh qofshin ata të shkencave ekzakte, qofshin ata teologë të mëdhenj ekspert islam. Librat me subjekt mrekullitë shkencore të Kuranit dhe Profetësisë mbushin bibliotekën islame në klëtë lëm.

Gjithashtu një tjetër organ i specializuar dhe specifikuar në mrekullitë shkencore të Kuranit dhe Profetësisë është revista e mrekullisë shkencorë që del periodikisht nga Bordi i Mrekullive Shkencore të Kuranit dhe Profetësisë.

Cili është kuptimi i gjithë kësaj?

Kuptimi është se premtimi është bërë realitet, pra premtimi që Allahu premtoi thënës: "Do t'ua bëjmë atyre të shqueshme argumentet tanë në horizont dhe në vetvetet e tyre derisa atyre t'u bëhet fare e qartë se ai-Kurani është e vërteta e pakontestueshme…?!", ky premtim është konkretizuar dhe bërë realitet, falenderuar qoftë Allahu Zoti i botërave.

Por si janë pozicionuar pionierët e shkencave bashkëkohore lidhur me mrekullitë shkencorë të Kuranit dhe Traditës Profetike?

Unë do t'u tregojë për njërin nga këto pozicionime. Kemi të bëjmë me një libër që vjen i specializuar në shkencën e embriologjisë dhe që është përkthyer në shtatë gjuhë, veç gjuhës angleze që është gjuha mëmë e autorit. Ndërkaq ky libër është një referencë e rëndësishme shkencore në mbarë botën. Autor i këtij libri të famshëm është Profesor Keith L. Moore. M'u dha mundësia që të takohesha kohë më parë me Profesor Keith L. Moore të cilit i parashtrova pyetjet e mia kundrejt të cilave ai m'u përgjigj. Në fund ai më pyeti se përse ia kisha bërë pyetjet në fjalë, ca prej të cilave ishin ende në zbërthim e sipër ende të paevidentuara nga konkludimet shkencore, ndërsa ca të tjera ishin të ditura edhe për nxënësit e fillores? Ia zbulova atij se ku qëndronte sekreti duke i thënë se Kurani dhe Tradita Profetike bënte fjalë rreth gjithë sa e kisha pyetur lidhur dhe më ishte përgjigjur. Në fakt ajo që sot është bërë e ditur për nxënësit e shkollave fillore ishte e panjohur për shumicën e dijetarëve të para vetëm 200-400 vjetëve. Kur i arriti kjo më pyeti, a e ka përmendur Kurani këtë. Iu përgjigja, po. Ia tregova këtë në Kuran dhe m'u

përgjigj se e tillë gjë ishte e habitëshme dhe e çuditëshme. Më pyeti nëse Kurani mund t'a kishte marrë sa në fjalë nga Ungjilli i tyre, ose nga Teurati? I thashë se përshkrimet në fjalë që kish shprehur Kurani nuk gjendeshin as në Teurat dhe as në Ungjill. Më tha se i jati ishte prift dhe kishte shokë priftërinj me peshë dhe se kur të kthehej në Kanada, në Universitetin e Torontos ku ai ishte Drejtues i Departamentit të Anatomisë dhe Embriologjisë, do fliste me të jatin dhe shokët e tij rreth gjithë kësaj. Kur ai kishte pyetur të jatin dhe shokët e tij ata i kishin thënë jo, nuk gjenden gjëra të tilla në Bibël. Unë e dija paraprakisht se midis kishës dhe shkencëtarëve të embriologjisë kishte patur përplasje kur Departamenti i Shkencave atje kish vendosur të plotësonte dhe evoluonte disa cikle të zhvillimit embrional njerëzor duke bërë eksperimentime tek kafshët. Përfaqësuesit e kishës kishin reaguar duke u thënë, si të vendosni embronin njerëzor tek kafshët dhe të barazoni midis njeriut dhe kafshës. Teksa pjesërisht, pozicionimi ynë si musliman lidhur me sa në fjalë nuk është i njëjtë me atë të kishës gjë e cila in she Allahu do të vijë në episodet tona në vazhdim, kjo pasi Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dha shembull lidhur me embrionin njerëzor duke e referuar atë tek deveja, qenie prezente ne kohën e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Kthehemi tek tema jonë. Kur profesor Moore pyeti të jatin dhe shokët e tij ata i thanë ne nuk disponojmë në librat tanë gjë lidhur me sa thua. Pas kësaj unë desha t'a takoj sërisht dhe ai më tha se dëshironte të mbante një ligjëratë. Erdhi në takimin që organizuam dhe e dha ligjëratën e tij atëherë kur unë punoja në Universitetin e Mbretit Abdul Aziz në Xhide të Arabisë Saudite. Njerëzit mbarë në Arabinë Saudite, prej tyre ata të ambienteve shkencore më së tepërmi, u surprizuan nga Prof. Keith L. Moore që referoi në disa prej universiteteteve të mjekësisë, në atë të Mbretit Abdul Aziz, të Rijadit dhe të Damamit. Tema e referatit që ai mbajti ishte "Përputhshmëria e Shkencës së Embriologjisë me atë çfarë gjendet në Kuran dhe në Traditën Profetike". Në këtë ligjëratë ai tha: Kjo dituri më dëshmon mua se ai-Kurani është nga ana e Allahut të Lavdishëm dhe të Lartmadhëruar dhe se Muhamedi duhet medoemos të jetë i Dërguar nga ana e Allahut. Kur ai u kthye në Kanada dhe muslimanët e atjeshëm dëgjuan për ligjëratat e tij i thanë nëse do qe e mundur t'u mbante dhe atyre ndonjë ligjëratë në ndonjë nga universitetet kanadeze? U përgjigj, me gjithë kënaqësi. E mbajti ligjëratën ku të pranishëm qenë gazeta të ndryshme të cilave ai u publikoi thënien kuranore "…pastaj (faza pasuese e embrionit njerëzor qe) nga Mudga (një si copëz mishi e kafshuar) e krijuar dhe e pakrijuar…" që flet për njërën nga fazat e mrekullueshme të embrionit njerëzor, atë ku embrioni njerëzor vijoi… Disa artikuj gazetash u publikuan duke pasur në krye të artikullit që publikuan në faqet e tyre pikërisht "Pastaj nga Mudga e krijuar dhe e pakrijuar". I thanë a do qe e mundur të flisje rreth kësaj në televizionin kanadez dhe ai doli foli në një prej televizionëve prestigjiozë kanadeze në një program të transmetuar drejtpërdrejt.

Një nga të pranishmit e pyeti, kuptimi i kësaj mr. Moore është se ti beson që Kurani është fjala e Zotit? Tha, nuk gjej ndonjë vështirësi për t'a pranuar një gjë të tillë. Kjo është përgjigjja "nuk gjej ndonjë vështirësi për t'a pranuar këtë fakt". Përse? Sepse

argumenti është brenda këtij Kurani, argumenti pro tij është brenda tij dhe atë e lexoi një dëshmitar prej kompetentëve të lëmit të argumentit, kështu pra prova pro Kuranit është brenda tij. Profesor Moore thotë: Nuk gjeta ndonjë vështirësi për të pranuar se Kurani është nga Zoti, kjo nisur nga provat dhe mrekullitë shkencore Kuranore që ai nxjerr në dritë. Më pas një tjetër nga audienca e pyeti një pyetje tjetër duke i thënë, si beson ti tek Muhamedi ndërkohë që beson edhe tek Jezusi (Mesihu)? Me këtë pyetësi tentoi t'i bënte presion psikologjik në prani të audiencës. Ai u përgjigj: Mendoj se që të dy janë nga e njëjta shkollë. Kjo më kujtoi mua me fjalën e Negjashiut, mbretit të Abisinisë, që tha për Kuranin duke u referuar edhe tek çfarë dinte rreth Teuratit dhe Ungjillit (Biblës), tha se Kurani dhe Bibla dalin nga i njëjti pishtar. Unë personalisht kur bisedova me profesor Moore i thashë, profesor ju në librin tuaj keni shkruar gjërë e gjatë dhe përsa i përket anës historike ke përmendur se epoka e mesjetës ka qenë e errët lidhur me të dhënat që përmend libri yt dhe njerëzit jetonin në errësirë asokohe, por shkencërisht kjo është e pasaktë pasi Kurani asokohe erdhi tek njerëzit. Pyetja ime është se përse nuk je treguar i drejtë me muslimanët, pse na ke hyrë në hak? Tha, ju jeni ata që na keni hyrë në hak, ju nuk na e publikuat ne këtë dituri. I premtova se do t'i shkruaja një përmbledhje të cilën ia shkrova dhe ai këtë përmbajtje që bën fjalë rreth Kuranit dhe Traditës Profetike e bashkangjiti tek libri i tij përgjatë një gjysëm faqeje. I thashë, profesor Moore ajo që ke shkruajtur nuk mjafton dhe unë besoj se ti je i vetëdijshmë se ajo nuk mjafton. Më tha kaq mund të përmendej tek paragrafët historik të librit. I thashë, ne muslimanëve të kërkojmë të na e jepësh hakun profesor Moore. Më tha, unë do të lejoj të shtosh shtojca përkatëse islame në librin tim dhe unë do bëjë një parathënie ku do flas për to. Unë i vendosa shtojcat islame për librin e tij dhe në kopertinën e librit të tij "The Developing Human clinically oriented embryology (Kieth L. Moore) With Islamic Additions correlation studies with Qur'an and Hadith (Abdul Majeed A. Azzindani), Third Edition – Zhvillimi njerëzor, embriologjia e orientuar klinikisht (Keith L. Moore) me Shtojcat Islame lidhjet reciproke me Kuranin dhe Hadithin (Majeed A. Azzindani), edicioni i tretë". Më tej ai i shkroi me dorën e tij dhe i vendosi në parathënien e librit orinetimet lidhur me versionin e pasuruar me shtojcat islame të apruvuara dhe firmosura me nënshkrimin e tij. Shtojca islame në këtë libër kap një numër mbi 70 faqe. Unë në çdo rast prej rasteve ku ai fliste për çështjen e embriologjisë shtoja shtojcat islame. Për shembull tek çështja e fazës embrionale të Nutfës-Pikëlzës teksa ai fliste për këtë fazë të embrionit unë vendosja në krye përshkrimin islam lidhur me këtë, e kështu me rradhë. Disa nga anëtarët e feve të tjera i thanë profesor Moore, si e ke lejuar atë të bëjë këtë gjë në librin tënd? Ai u tha, nëse keni edhe ju ndonjë gjë m'a sillni. Tha, pasi u thashë një gjë të tillë askush prej tyre nuk u kthye të më sillte gjë. Më tej në një bisedë që patëm unë i thashë, o profesor ti e di që shkenca e embriologjisë është e vështirë për studentët e mjekësisë dhe shkak për këtë janë terminologjitë që përdoren për fazat embrionale ashtu që ju për secilën fazë përdorni numrat një, dy, tre e me rradhë, që në fakt nuk e ndihmojnë nxënësin të bëj dallimin midis fazave. Përse nuk i përdor termat Kuranor, nutfa, alaka, mudga, idham, mveshja me mish? Për këtë diskutuam vërtetë gjatë dhe më së fundi u bind lidhur me

këtë duke thënë, vërtetë që terminologjitë kuranore janë përshkruese për secilën fazë embrionale, përfshirëse për fazën përkatëse dhe shumë precize në shpjegim. Pas kësaj në një libër tjetër shumë të suksesshëm të tij ku ka bashkëpunuar me një grup tjetër të shkencëtarëve të embriologjisë të cilët do kemi rast t'i përmendim in she Allahu, ai përpilon një studim ku bën thirrje për vendosjen e terminologjive të reja për shkencën e embriologjisë, të shkëputura këto nga Kurani i Lavdishëm. Kemi në grupin e autorëve të këtij libri një tjetër profesor kanadez me grada shkencore në embriologji emri i të cilit është T.V.N. Persand i Universitetit të Manitobës në Kanada, i cili është kreu i departamentit në këtë Universitet. Ai gjithashtu qe pjesmarrës në disa konferenca të Mrekullive Shkencore në Kuran dhe Profetësi dhe referoi hulumtimin me temë "A nuk është Allahu më gjykuesi i gjykuesve?!". Më tej ai qe pjesmarrës në shkrimin e librit në fjalë ku morën pjesë pesë nga krerët e shkencëtarëve me famë botërore të embriologjisë nga Kanadaja dhe Amerika, prej të cilëve edhe T.V.N. Persand. Pjesmarrja e tij në libër qe përmes një studimi rreth fazës embrionale të zhvillimit mbështetur në thënien e Allahut të Lartësuar: "…Pastaj e zhvilluam atë për të qenë një tjetër krijesë…" ku demonstrohet sesa shpejt bëhet zhvillimi i foshnjes nën dritën e "…Pastaj e zhvilluam atë për të qenë një tjetër krijesë. I Lartsuar është Allahu më i miri Krijues". Profesor Persandi ashtu sikurse profesor Moore thotë: Dëshmoj se kjo dituri që kemi në dorë nuk është e mundur t'i ketë arritur Muhamedit përveçse me anë të shpalljes hyjnore nga Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhëruar . Gjithashtu ai mbajti një studim tjetër në Konferencën Mbarëbotërore në Kajro lidhur me Mrekullinë Shkencore Mjekësore të Kuranit dhe Profetësisë ku bëri fjalë rreth Sidës ku theksoi thënien profetike: "Nuk ka ndodhur kurrsesi të shfaqet shthurja morale në një popull përveçse e në mesin e këtij populli shfaqet një epidemi a sëmundje që nuk ka qenë e njohur për paraardhësit e tyre." Sqaroi faktin se AIDS është një sëmundje dhe epidemi e re që nuk ka pas ekzistuar tek paraardhësit tanë dhe se ajo ka qenë rezultat i përhapjes së shthurjes morale dhe prostitucionit me gjithë trajtat e tij.

E pyetëm profesor Persandin rreth rrethprerjes (synetllikut) që bëjnë meshkujt musliman? Përmendi se edhe çifutët e kryejnë rrethprerjen dhe librat e mjekësisë janë të mbushura më sqarimin e avantazheve mjekësore të atyre që e kryejnë këtë dhe shmangien e disa sëmundjeve nga njerëzit me praktikimin e rrethprerjes. Unë e pyeta se ku mendonte ai se qëndron sekreti lidhur me orientimin islam që rrethprerja është mirë të bëhet në ditën e shtatë? Më tha, do më japësh afat dhe më vonë e solli përgjigjen, tha, veshka e foshnjes vazhdon të zhvillohet deri në ditën e shtatë pas lindjes. Veshka e foshnjes së porsalindur nuk mundet t'a prodhojë substancën që mundëson që gjaku të mpikset, trashet dhe të bëhet ndalimin e hemoragjisë, përveçse në ditën e shtatë të lindjes dhe siç dihet rrethprerja është një operacion që sjell hemoragji teksa hemoragjia duhet medoemos të mpikset dhe të ndalohet. Nëse kjo prerje do bëhej para ditës në fjalë hemoragjia nuk do ndalonte. I thashë shumë e qartë. Më tha, kjo pasi zhvillimi i veshkës kompletohet në ditën e shtatë të lindjes ndaj dhe urtësia këtu qëndron që kjo prerje e kësaj lëkure shtesë të bëhet pikërisht në këtë ditë dhe jo më parë. I thashë, po nëse e

vonojmë rrethprerjen pas ditës së shtatë? Tha nëse e lemë për më vonë, me zhvillimin e enëve të gjakut masa e hemoragjisë do shtohet. I Lartësuar është Allahu. Profesor Persandi gjithashtu mori pjesë në një sërë konferencash të Mrekullive Shkencore Mjekësore të Kuranit dhe Profetësisë duke qenë ai një tjetër dëshmitar prej krerëve të shkencave bashkëkohore se ky Kuran në realitet ka zbritur duke mbartur diturinë e Allahut dhe se çfarë i erdhi Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- është dituri të cilës nuk mund t'i avitet e kota dhe falsiteti nga asnjë anë.

Kështu u bë fakt konkretizimi i premtimit të Allahut që thotë: "Do t'ua bëjmë atyre të shqueshme argumentet tonë në horizont dhe në vetvetet e tyre derisa atyre t'u bëhet fare e qartë se ai-Kurani është e vërteta e pakontestueshme. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?!"

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Mumja e Faraonit (19)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Rrëfimet dhe historitë e popujve të hershëm të reveluara mbi Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, do të jenë objekt i këtij episodi të sotshëm.

Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe populli i tij nuk kanë qenë njohës të mirë të rrëfenjave dhe historive të hershmërisë. Në fakt e tillë gjë nuk ishte as prej veçorive kulturore të arabëve.

Vetë Kurani e përcjell këtë nuancë pas përmendjes së historisë të nderuarit tonë Nuhut -paqja qoftë mbi të- ku thotë: "Këto janë lajme prej fshehtësisë që ne t'i shpallëm. As ti dhe as populli yt nuk dinit gjë rreth tyre". Pra as ti o Muhamed dhe as populli yt. S'ka dyshim se arabët e dëgjuan këtë citat kuranor që u drejtohej atyre me përmbajtjen në fjalë dhe se atyre u arriti informacioni se Kurani mohonte që ata të dinin ndonjë gjë nga lajmet dhe të dhënat në fjalë. Po qe se ata do dinin gjë do e kishin shpallur gënjeshtar Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, do i thonin, si, po gënjen, thotë se ne nuk i dinim këto histori, jo, ne i dimë këto histori. Porse ata heshtin teksa Kurani u drejtohet atyre me sa në fjalë dhe me të vërtetat lidhur me këtë.

Kush ia mësoi Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- lajmet dhe historitë e të parëve, popujve të hershëm?!

Vetë pasuesit e librave qiellor patën divergjenca dhe kundërshti midis tyre lidhur me këto të dhëna, dhe kur Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i përcolli këto të dhëna, ai zbuloi gabimet dhe dobësitë e gjendura në këto lajme dhe në këto të dhëna të popujve të hershëm; gjë që u bë shkak që shumë prej këtyre klerikëve të hyjnë në fenë e Allahut dhe të pranojnë Islamin.

Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një mrekulli, me mrekullinë e lajmërimit të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- mbi të fshehtën dhe dhënien nga ana e tij zgjidhje problemeve që patën lënë në dilemë klerikët liderë të këtyre feve.

Prej këtyre lajmeve mbi hershmërinë të cilat ia zbulon Kurani Fisnik Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, është ajo çfarë na ka treguar rreth saj Dr. Maurice Bukay. Profesor Maurice Bukay ishte ndër pjesëtarët e ekipit francez që pritën mumjen e Faraonit, të cilën e dërgoi atje shteti egjiptian i cili iu frikësua një dëmtimi në rritje të mumjes së Faraonit, sepse atë filloi t'a prekte një brejtje në zonën e majës së hundës. Për këtë arsye ata e dërguan në Francë që t'a trajtonin për të evituar problemin

në fjalë. Profesor Maurice Bukay thotë, kur ajo arriti në Paris e pritëm me njëzetenjë të shtëna, ashtu siç priten presidentët. Më pas filluam t'i bëjmë ekzaminimet e duhura mumjes së Faraonit. Gjetëm se të gjithë argumentët shkencorë vërtetonin se ai ishte Faraoni i historisë së Musait. Përse? Sepse ne gjetëm mbetje të krypës së detit në kufomën e tij. Këtë e përforconte gjithashtu fakti tjetër që kockat e tij ishin të thyera teksa lëkura e tij nuk ishte e çarë; gjë që donte të thoshte se fraktura ishte shkaktuar nga një trysni e butë, e tillë që nuk kishte çarë as lëkurën dhe as mishin por kishte copëtuar dhe thyer kockat. E tillë gjë na linte të kuptonim se fraktura e tij kish ndodhur nga uji, nga trysnia që kish ushtruar mbi të shtypja e dy rrymave të dallgëve madhështore të detit që ishin puqur me furi me njëra-tjetrën, teksa ai ishte gjendur i ndërfutur midis tyre, duke ia copëtuar atij kockat brendazi. Sa më sipër është një shenjë ndër të tjera, pasi kocka kur thyhet nga shtypja e ujit lëshon një lëndë çimentoide. Kjo lëndë çimentoide gjendet në trupin e Faraonit, në kafkën e tij, gjë që tregon se ajo është coptuar dhe thyer nga shtypja e ujit ndërkohë që lëkura dhe mishi ngelën të pacënuar. Pamë tek ai shenjat e të mbyturit. Nga të gjitha këto mësuam se kjo është mumja e Faraonit të Musait.

Më pas dr. Maurice përpiloi një libër ku trajtonte se Teurati përmendte se trupin e Faraonit e kishte përpirë deti por nuk përmendte detaje se çfarë i kishte ndodhur atij më pas. Teurati nuk përmend asgjë lidhur me këtë.

Ndërsa Kurani përmend se trupi i Faraonit të mallkuar ka për t'u shpëtuar nga uji i detit; siç vjen në fjalën e Allahut të Lartësuar në Kuran: "E pra sot po të shpëtojmë ty me trupin tënd, që të mbetesh argument për ata që do vijnë pas teje. Vërtetë që shumë prej njerëzve qëndrojnë neglizhentë karshi argumenteve tona". Pra sot po e shpëtojmë trupin tënd nga deti. Rikthehemi tek ajo çfarë thotë dr. Maurice Bukay, i cili në vijim thotë: Ekzaminimet nxorrën se kufoma e Faraonit në fjalë nuk mbeti gjatë në ujin e detit, duke qenë se ajo nuk ka shfaqur asnjë shenjë të dëmtimit të plotë për shkak të qëndrimit të gjatë në ujin e detit; gjë që do të thotë se kjo kufomë është nxjerrë nga deti shpejt.

Do doja të qëndroja pak tek ideja e mumjëzimit të praktikuar tek Faraonët, gjë të cilën shkencëtarët ende e konsiderojnë një mister prej mistereve.

Kështu, kur u zgjidhën mbështjellat e mumjeve të faraonëve, ato i gjetën të mbushura me bakterie brejtëse. Po të kishin qenë këto mbështjellje mbrojtëset e trupave ato nuk kishin për t'u brejtur edhe vetë nga bakteriet. Pra i bie që ruajtja e trupave të tyre t'i dedikohet diçkaje tjetër dhe jo këtyre mbështjellave dhe materialeve në to. Egjiptianët e lashtë nuk dinin gjë rreth bakterieve dhe nuk posedonin as mikroskop dhe as paisje të kësaj natyre. Paisjet që ata përdornin ishin primitive. Pretendimi se ata posedonin diturimisterioze nuk qëndron, porse ata në fakt ishin në një nivel diturie dhe teknologjie që nuk i lejonte të kishin ndonjë ide rreth bakterieve dhe parazitëve mikroskopik. Domosdoshmërisht ruajtja e trupave të tyre është kryer me tjetër gjë. Pastaj përse misteri i mumjëzimit u zhduk dhe njerëzit e kohës sonë që i njohin më së miri bakteriet

dhe shkaqet e dekompozimit të materies së trupit, janë të paaftë të bëjnë një mumjëzim si ai që bëhej asokohe. Këtë fjalë njeriu nuk mund t'a kapërdijë.

Ajo që unë mendoj, dhe Allahu e di më së miri, është se Allahu shpëtoi Faraonin dhe të gjithë trupat e tjerë të shoqëruesve të tij që të dilnin dhe të bëheshin shkak për ardhjen e egjiptianëve që të merrnin trupat e njerëzve të tyre dhe t'i varrosnin. Në fakt gjenden tregues të shumtë që tregojnë se këtu bëhet fjalë për një ngjarje të vetme dhe se njerëzit erdhën dhe gjithsecili morri kufomën e të afërmit të vet dhe e varrosi. A të jetë ky shkaku i ruajtjes së trupit të Faraonit kur ne e dimë se Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm e deklaroi të tillë gjë në Kuran ku tha: "E pra sot po të shpëtojmë ty me trupin tënd, që të mbetesh argument për ata që do vijnë pas teje. Vërtetë që shumë prej njerëzve qëndrojnë neglizhentë karshi argumenteve tona".

Në vijim, do bëjmë fjalë për një tjetër të dhënë historike rreth së cilës kronologjistët e krishterë janë ende në mospërputhje dhe dilemë. Këtë dilemë e gjen ende në librat e Ungjillit të pranishëm në ditët tonë. Kështu në Ungjillët e njohur nga kisha përmendet se ngjarja e kryqëzimit ka ndodhur, teksa në po këto ungjillë përmendin se shokët, dishepujt e të nderuarit tonë Isait-Jezusit, e panë të nderuarin tonë Isain -paqja e Allahut qoftë mbi të- , me trupin e tij material, tre ditë pas ngjarjes së kryqëzimit. E panë pas ngjarjes së kryqëzimit, të gjallë shëndoshë e mirë, njeri që hanë dhe pinë.

Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "...fjala e tyre: Ne e vramë Mesihun, Isanë (Jezusin) të birin e Merjemes, të Dërguarin e Allahut. Në fakt ata nuk e vranë e as e kryqëzuan, porse ashtu iu duk atyre. Debatuesit rreth çështjes së tij janë në dyshim. Nuk kanë asnjë lloj njohurie të pakontestueshme përveçse kanë ecur pas një hamendësie. Në të vërtetë nuk e vranë atë".

Ca dorëshkrime të vjetra janë shfaqur në zonën e Detit të Vdekur në vitin 1945. Ato qenë nën disponimin e Qeverisë Jordaneze dhe më pas përfunduan nën disponimin e Shtetit Izraelit. Porse një kopje e këtyre shkrimeve gjendet në Vatikan, një kopje në Gjermani dhe një kopje në Amerikë. Shteti Izraelit (çifut) ka obliguar që këto dorëshkrime të mos bëhen publike.

Papa Johana VI u patë kushtuar vëmendje këtyre dorëshkrimeve. Në fakt njerëzit u bafasuan lidhur me thirrjen e këtij Pape që të mbahej një konferencë midis muslimanëve dhe të krishterëve, gjë për të cilën Ambasadori i Izraelit në Vatikan asokohe shprehu indiniatën dhe refuzimin e tij. Pak kohë pas kësaj ky Papë u gjend i vdekur mbi shtratin e tij.

Papa që erdhi pas tij e nuhati rrezikshmërinë e çështjes lidhur me thirrjen ku ftoi papa i mëparshëm dhe e kuptoi se një realizim i saj do të ishte i pamundshëm. Vendosi të bënte një konferencë ndërkristiane të mbyllur. Kjo konferencë u mbajt dhe zgjati plotë katër vjet. Pas katër vjetësh dolën nga kjo konferencë vendimet e saj. Komunikimi final i saj doli me këto kumtime:

Vendimi 1. Konsiderimi i muslimanëve ndjekës të një feje të saktë. Me kuptimin se ata janë ndjekës të një feje të vërtetë, pra se libri i fesë Islame, Kurani, është i vërtetë dhe i besueshëm dhe se i Dërguari i kësaj feje është i vërtetë dhe i besueshëm. Ky është vendim i konferencës të mbajtur nga të krishterët jo shumë kohë më parë, pak dekada më parë, rreth 1960.

Vendimi 2. Ndalohet aktiviteti i misionarëve të krishterë në mesin e muslimanëve. Pse ndalohet? Sepse muslimanët janë mbi një rrugë të drejtë, mbi një fe të saktë dhe nisur nga kjo krishterizimi vetëm sa do t'i ngatërrojë ata.

Vendimi 3. Kush do të njihet me personin e Mesihut (Jezusit apo Isait) le të pyes muslimanët. Vendime të guximshme. Kur i fola reth kësaj dr. Abdullah Nasifit, Kreut Drejtues të Ligës së Botës Islame, pasi lajmi në fjalë u bë publik në disa revista, më tha, po, është e vërtetë, Papa është ai që e nxorri këtë vendim. Ai u publikua dhe kopje të tij u janë dërguar insitucioneve islame prestigjioze si Ez'herit në Egjipt, Ligës së Botës Islame etj. Ne posedojmë një kopje të vendimeve të kësaj konference të të krishterëve.

I Lavdishëm është Allahu. Përgjigja lidhur me mëdyshjen dhe hezitimin e tyre rreth personit të Mesihut është tek ne në Kuran. Klerikët më të mëdhenj të krishterë ulin kokën të nënshtruar para këtij fakti. Kush prej të gjithë njerëzve ia mësoi këtë të vërtetë pikërisht Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe ia zbuloi atij këto të fshehta?! Sa në fjalë ka të bëjë me lajmërimin mbi të fshehtën. Dorëshkrimet e Detit të Vdekur, që përkatësojnë tek shkrimet e shenjta të krishtere të hershme, vijnë dhe e përforcojnë atë që Kurani që iu zbrit Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- thotë. Këto dorëshkrime lajmërojnë se një Profet tjetër do shfaqet në Hixhaz-Arabi, ai do triumfojë kundër armiqve të tij dhe do korrigjojë keqkonceptimet dhe keqkuptimet që do jenë mbi Mesihun-Isain -paqja e Allahut qoftë mbi të-. Sa në fjalë janë dorëshkrimet e Detit të Vdekur.

Këto janë lajmërime mbi të fshehtën e të kaluarës së largët.

Po kështu Kurani bën fjalë edhe për të dhëna dhe lajmërime që kanë të bëjnë me situatën dhe gjendjen e njerëzve në kohën e Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, të cilat Allahu ia zbulonte atij. Sa e sa gjëra hipokritët dyfytyrësh qenë të angazhuar t'i ruanin brenda vetes së tyre, sa e sa çështje njerëzit i mbanin përbrenda dhe kur erdhën tek i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- shfaqnin tjetër gjë, por Profeti Muhamed i reveluar nga Allahu u zbulonte atyre se si qëndronte e vërteta.

Ngjarja ndodhte në tjetër shtet dhe shpallja hyjnore vinte e ia zbulonte atë Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Nga historitë e natyrës në fjalë është edhe historia e Hatib ibn Ebu Belta' -Allahu qoftë i kënaqur me të-, të cilën e përcjellin Kurani dhe hadithet e sakta. Kjo vjen ndër të tjera në një transmetim të Aliut -Allahut qoftë i kënaqur me të- i cili thotë: I Dërguari i Allahut -

lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- na nisi mua, Zubejrin dhe Mikdadin, dhe na tha: "Do ecni derisa të vini në kopshtnajën e quajtur Khakh! -Bëhet fjalë për një zonë që quhet Khakh-. Aty do gjeni një grua udhëtare që ka një shkresë". Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i lajmëroi ata lidhur me vendin dhe se në këtë vend do të gjenin këtë grua. I lajmëroi se kjo grua ishte në udhëtim e sipër dhe se ajo kishte me vete një shkresë. Aliu -Allahut qoftë i kënaqur me të- thotë, u nisëm galop mbi kuajt tanë derisa arritëm në kopshtnajën e quajtur Khakh, kur ja, aty gjejmë gruan udhëtare. Kur e panë atë i thanë, nxirre vetë shkresën që ke me vete ose ke për të hequr rrobat. Ose do e nxirrte vetë shkresën ose do e kontrollonin imtësisht. Gruaja, pasi pati mohuar fillimisht të kishte letër, ndjeu se çështja ishte serioze, pasi ata e dinin se ajo e kishte shkresën me vete dhe e kishin vënë para një konfrontimi të mundshëm. Bindet se duhej t'a nxirrte shkresën dhe e nxjerr atë nga bishtalecja e saj. Kur ja, në këtë shkresë gjendej një mesazh që Hatib ibn Ebu Belta', i cili ishte prej luftëtarëve që patën prezantuar Betejën e Bedrit, ia dërgonte disa njerëzve prej idhujtarëve të Mekes. Në të u tregonte atyre lidhur me disa lajme nga lajmet e të Dërguarit të Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- po përgatitej të çlironte Meken. Ky mesazh përbënte zbulimin e një sekreti të cilin Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- nuk donte që të dilte që të mos i jepte shanse armikut të parapërgatitej e të bënte rezistencë, gjë që do shkaktonte dëme luftarake në njerëz dhe do trashëgonte edhe më shumë mëri dhe smirë. Porse Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- donte t'a shtinte në dorë Meken me një zbarkim të befasishëm dhe pa konfrontime, gjë e cila kështu ndodhi në realitet. Mesazhi i Hatibit mund të kish qenë një shkak që t'ua zbulonte çështjen kurejshve dhe të çonte në mobilizimin luftarak të idhujtarëve mekas.

Kur Porfeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- mori vesh se si qëndronte puna, e pyeti Hatibin se përse e kishte bërë këtë. Hatibi iu përgjigj, për Allahun nuk e kam bërë këtë për blasfemi (nuk e kam bërë në shërbim të mosbesimtarëve kundër Islamit), por unë kam qenë një person periferik tek kurejshët, (jo prej barkut të tyre), dhe mekasit që kanë emigruar këtu në Medine kanë të afërmit e tyre (prej idhujtarëve mekas) atje që i mbrojnë njerëzit e këtyre emigrantëve (ndërsa Hatibi nuk kishte asnjë) -dhe vijoi-, e bëra këtë që t'iu bëhesha atyre krahë dhe duke e ditur se kjo nuk ka për të të dëmtuar ty dhe se Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm ka për të ndihmuar dhe nxjerrë triumfator.

Pra i shpjegoi se ai nuk e kishte bërë këtë se e kishte lënë fenë apo duke synuar të dilte kundra fesë Islame. I nderuari ynë Umar ibn Khatabi nuk i mori për të mirëqena këto fjalë dhe i tha Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, lejomë t'ia këpusë kokën këtij hipokriti o i Dërguar i Allahut! Por siç thamë Hatibi ishte nga besimtarët që kishin qenë pjesmarrës në Betejën e Bedrit dhe në fakt edhe Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ndaj sjelljes së rrëmbyer të Umarit reagoi me fjalët: "Allahu ka parë tek ata që qenë të pranishëm në Betejën e Bedrit dhe u ka thënë atyre: 'Bëni ç'të doni se Unë ju kam falur".

Kurani zbret të lajmërojë rreth kësaj çështje duke e përjetuar atë në Librin e Allahut ku lidhur me këtë Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- iu revelua: "O ju që keni besuar! Mos i bëni armiqtë e mi dhe armiqtë tuaj shokë e miq duke u hedhur në anën e tyre me dashamirësi…". Pra mos u tregoni dashamirës e t'u zbuloni atyre sekretet e muslimanëve. Por siç shihet Allahu i referohet Hatibit me "O ju që besuat!". Kurani nuk vjen t'a identifikojë Hatibin pas veprimit të tij si të dalë nga feja Islame, përkundrazi e cilësoi atë besimtar duke e thirrur për besimtar ndërkohë që e kritikoi me thënien: "O ju që keni besuar! Mos i bëni armiqtë e mi dhe armiqtë tuaj shokë e miq duke u hedhur në anën e tyre me dashamirësi, teksa ata nuk kanë besuar tek ajo çfarë ka ardhur prej të vërtetës. Ata e nxorrën të Dërguarin dhe ju ngaqë besuat në Allahun, Zotin tuaj…". Si pra krijoni me ta dashamirësi, miqësi dhe afrimitet, ndërkohë që ata ju nxorrën ju nga vendbanimi juaj vetëm për shkak të besimit tuaj në Allahun. Kjo qe dëshmi direkte nga Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm për Hatibin se ai ishte besimtar. Ajo çfarë kuptohet qartë nga sjellja profetike në rastin e Hatibit dhe në përgjithësi në raste të tjera të shumta, është butësia dhe elasticiteti i Profetit me njerëzit.

Prej përmbajtjes së asaj që cekëm është edhe sesi Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm i zbuloi Profetit Muhamed atë që bëri Hatib ibn Ebi Belta si dhe vendin ku do të ishte gruaja e historisë që përmendëm kur t'a arrinin atë Aliu, Zubejri dhe Mikdadi -Allahu qoftë i kënaqur me ta-. Sesi Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i orientoi të dërguarit e tij fiks në vendin e duhur ku çdo gjë rrodhi sipas informacionit që u dha atyre Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Gjithsa përmendëm hyn tek çështja e fshehtësisë të cilën nuk e di askush përveç Allahut.

Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ashtu si çdo njeri tjetër është përballur me sa e sa probleme dhe sprova gjatë jetës së tij. Dhe si njeri që ishte i ka ndodhur që në rrethana të ndryshme i kanë ardhur njerëz jo të ndershëm apo të tjerë dyfytyrësh dhe ai u ka besuar për sa i kanë thënë apo i janë qarë dhe ankuar; por shpallja hyjnore ka zbritur dhe i ka nxjerrë personat në fjalë të zbuluar duke demaskuar hipokrizinë e tyre.

E pra njerëzit nuk e besuan Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- kalimthi, jo jo, çdokush nga ata që i besuan u vu para fakteve, mrekullive dhe argumenteve të pakontestueshëm, të cilat lidhur me Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- kanë ardhur gjithmonë e në rritje.

Një tjetër histori e kategorisë në fjalë është ajo e Benu Ubejrik-ut. Ata ishin tre djem që nuk ishin mirë nga gjendja financiare, pra thënë ndryshe ishin të varfër. Një herë mësynë një shtëpi ku vodhën armë dhe ushqim. Shtëpia që u vodh ishte shtëpia e xhaxhait të Katede ibn Nu'manit. Pasi i ndodhi kjo xhaxhai i Katedes erdhi tek djali i vëllait të tij Katedeja dhe i tregoi për çfarë kishte ndodhur. Ndër të tjera i tha, të gjithë treguesit orientojnë se ata që e kanë kryer vjedhjen janë tre djemtë e Ubejrikut. Një prej

treguesve është fakti se ata po atë natë ndozën zjarr dhe i kanë parë të hanë mirë; gjë që s'është në mundësitë e tyre, prandaj edhe njerëzit kanë folur rreth kësaj mundësie.

Krerët e fisit Benu Ubejrik u mblodhën dhe e studjuan situatën dhe arritën në konkluzionin se rrugëzgjidhja ishte që të shkonin tek i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe t'i ankoheshin për këta njerëz që po u cënonin nderin duke i akuzuar pa asnjë argument dhe pa asnjë provë.

Kur Katede shkoi tek i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, Profetit i kishte arritur ankesa se fisi i Katedes po akuzonte dhe nëpërkëmbte nderin e disa njerëzve të pafajshëm të cilët po i akuzonte pa asnjë të drejtë dhe pa asnjë provë…

Vetë Katede e përcjell këtë situatë duke thënë, shkova tek i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe i tregova sesi qëndronte puna. Ai më tha: "A po rëndon njerëz, për islamin (fenë) dhe mbarëvajtjen e të cilëve flitet vetëm mirë?! A po i akuzon me vjedhje pa sjellur asnjë fakt dhe provë?!" Katede vijon dhe thotë, dëshirova të mos kisha biseduar fare rreth kësaj me Profetin e Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe dëshirova më mirë të kisha humbur një pasuri shumë të madhe sesa t'ë kisha dëgjuar prej tij atë që dëgjova. Katede u kthye shumë i mërzitur dhe kur arriti tek xhaxhai i tij ai i tha, ç'të tha i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-? I tha, më tha kështu kështu. Xhaxhai i tij i tha, Allahu është Ndihmëtari. Sakaq Allahu zbriti përgjigjen: "Ne t'a zbritëm ty Librin vërtetësisht që të gjykosh midis njerëzve në dritën e asaj që Allahu të bëri të shohësh, mos e mbaj krahun e manipuluesve…!" Pra, mos i mbro tradhëtarët e besës, njerëzit e pabesë. "…mos e mbaj krahun e manipuluesve! Kërkoji falje Allahut…!" Kërkoji falje Allahut për atë çfarë i the Katedes dhe xhaxhait të tij. "…Allahu është Falës Mëshirues. Mos debato pro atyre që janë të pabesë edhe me veten e tyre. Allahu nuk e do atë që është i pabesë dhe mëkatar. U turpërohen njerëzve dhe nuk i turpërohen Allahut që është i pranishëm kur ata pabesisht dhe në fshehtësi bien dakord për të thënë atë fjalë që Allahu nuk e do. Allahu ka qarkuar gjithë sa ata punojnë. Ja ku jeni ju e po debatoni në favorin e tyre në jetën e kësaj bote por kush do debatojë me Allahun në Ditën e Kijametit në favorin e tyre. E kush do jetë garantues për ta?!".

I Lavdishëm është Allahu. Shikoni se si vjen kjo përgjigje kuranore e vazhdon deri kur Allahu në vazhdimësi në thëniet që i zbriti me këtë rast thotë: "E kush ndërmerr një gabim apo mëkat e pastaj atë ia mvesh një të pafajshmi…". Kjo sepse ata -fisi i Benu Ubejrikut- akuzuan një person të tretë, që të mbronin veten; me ç'rast shpallja hyjnore zbriti duke zbuluar të vërtetën, lojrat dhe pabesitë e fshehta që u bënë nga ky grup njerëzish; vjen dhe i demaskon ata në sytë e të gjithë njerëzve. "E kush ndërmerr një gabim apo mëkat e pastaj atë ia mvesh një të pafajshmi, i tilli ka ngarkuar veten me një shpifje dhe mëkat të qartë. E nëse nuk do ishte mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij një grup prej tyre do tentonin të të shtinin në gabim, teksa ata nuk humbin askënd veç vetes së tyre, ty nuk mund të të bëjnë asnjë lloj dëmi…". Përse si bëjnë dot dëm Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-? Sepse ai ndihmohet nga shpallja hyjnore e

Allahut të Cilit s'i shpëton asgjë. Ai ndihmohet nga Allahu i Lartësuar dhe Lartmadhëruar që ia zbulon atij brendinë e njerëzve dhe e informon atë rreth asaj çfarë ata fshehin brenda tyre.

Kush është ai që ka mundësi të depërtojë në atë çfarë fshihet në zemrën e njeriut?!

Lidhur me këtë vjen rasti i Fudale ibn Umejrit, pas çlirimit të Mekes. Fudale ishte ende mosbesimtar por pas amnisitisë që u dha mekasve Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, ai lëvizte lirisht në Meke. Ai shquhej për guximin e tij. Një ditë vendosi t'a vriste Profetin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Me këtë synim në zemrën e tij i shkoi Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të cilin e gjeti duke bërë tavaf (rrotullim) rreth Qabes. Aty për aty Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i tregoi për atë që Fudalja fshihte në zemrën e tij; gjë që u bë dhe shkak që Fudalja nga atentator për vrasje i Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, të pranonte po në ato momente Islamin, ku Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i kish ftuar atë dhe gjithë mekasit prej kaq e kaq kohësh.

Nuk arrin askush të depërtoj tek këto fshehtësi përveçse atij të cilin Allahu e ndihmon, përkrah dhe suporton nëpërmjet shpalljes hyjnore, përveç Profetit të vërtetë -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, gjë nëpërmjet të cilës Allahu bën të mundur të shfaqen mrekullitë dhe faktet e shumta me të cilat Ai fakton profetësinë e të Dërguarit të Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Të shumta qenë të dhënat e sakta që i Dërguari i Allahut dha për gjëra që i takonin ngjarjeve të ndodhura në distancat që gjendeshin shumë larg tij, si vdekja e Nexhashiut -Allahut qoftë i kënaqur me të-, si rasti i personazheve të Mue'tes, si rënia dëshmor e Xheafer ibn Ebi Talibit dhe Abdullah ibn Rauehas -Allahu qoftë i kënaqur me to-, ngjarje të cilat Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i ka përcjellur duke qenë në distancë të largët prej vendodhjes së tyre. Madje ai ia fail xhenazen Nexhashiut dhe i urdhëroi edhe muslimanët e pranishëm t'ia falnin atij xhenazen, dhe u desh të kalonte shumë kohë derisa lajmet për vdekjen e Nexhashiut erdhën nga Abisinia në rrjedhën e tyre normale.

Kush e informonte Profetin për sa në fjalë?! Kush ia mësonte atij këto të fshehta? Kush ia zbulonte atij atë çfarë strehohet në thellësitë e shpirtrave njerëzor dhe atë që ngjante tutje larg në anët e kësaj hapësire të gjerë e të paanë. S'ka dyshim se atë e lajmëronte dhe informonte për sa në fjalë shpallja hyjnore, mbështetja hyjnore, mrekullitë me të cilat Allahu e mbështeti dhe përkrahu të Dërguarin e Tij, me qëllim që njerëzit të dëshmojnë dhe të binden se Muhamedi është i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed. Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Nga Vdekja deri tek Llogaria (20)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Në episodet e shkuara kemi bërë fjalë mbi argumentet e besimit në Allahun e Lartësuar dhe mbi argumentet e besimit në Botën Tjetër të Amshimit, drejt të cilit shkojnë të gjitha gjeneratat njerëzore dhe kombet…

Bota Tjetër e Amshimit fillon me vdekjen.

Thotë Allahu i Lartësuar: "Ai-Allahu është i Plotfuqishëm mbi robërit e Tij dhe është Ai që dërgon mbi ju mbrojtës; derisa kur dikujt prej tyre i vjen vdekja të dërguarit tanë (engjëjt e vdekjes) e vdesin atë duke mos bërë asnjë lëshim".

Direkt me momentin e vdekjes, për ata që futen në Jetën e Amshueshme fillon nderimi ose poshtërimi. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "E, sikur t'i shihje mizorët në momentet e agonisë së vdekjes, teksa engjëjt kanë shtrirë duart e tyre (ndëshkues) e (u thonë): 'Shpëtojeni pra vetveten (por s'u ngelet veçse t'a dorëzoni shpirtin tuaj)'. Sot shpërbleheni me ndëshkimin poshtërues për shkak të të pavërtetave që thonit në adresë të Allahut duke qenë ndaj argumenteve të Tij kryeneç". [6:93]

T'a kenë frikë Allahun ata që kanë rol drejtues dhe edukues tek masa, ata që japin direktiva dhe fetua fetare, t'a kenë frikë Allahun shkrimtarët, mendimtarët dhe të gjithë ata që kanë të bëjnë me përçime mesazhesh dhe që u ecën fjala tek masa e gjerë e njerëzve.

Muslimi në "Sahihun-Autentikun" e tij transmeton në adresë të Ebu Hurejrës -Allahu qoftë i kënaqur me të- se ai ka thënë: "Kur shpirti i robit besimtar del, atë e marrin dy engjëj që ngjiten me të lart. -Hamedi (një nga transmetuesit) tha: "Dhe foli për parfumosjen dhe miskun (aromëzimin e këtij shpirti)."- (vijon) Banorët e qiellit thonë: Një shpirt i mirë ka ardhur nga ana e tokës, Allahu të begatoftë ty (o shpirt i mirë) dhe trupin tënd të cilit i ke dhënë jetë. Dhe me të ecin për tek Zoti i tij i Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm i Cili thotë: 'Merreni atë në fundin e tij të destinuar'. Ndërsa po qe se është mosbesimtar, kur të dalë shpirti i tij… -Hamedi thotë: Dhe foli për erën e shpifur dhe neveritshmërinë e tij-; Banorët e qiellit thonë për të: Një shpirt i fëlliqur ka ardhur nga ana e tokës. Thuhet: 'Merreni atë në fundin e tij të destinuar'. -Ebu Hurejra tha:- I dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- një copë pëlhure të hollë që kishte mbi hundën e tij e ktheu kështu (e ilustroi duke e shtrënguar pëlhurën mbi

hundë me gishtin e madh dhe atë tregues dhe pjesën tjetër të dorës mbyllur)"; për të treguar për erën e rëndë dhe tepër të fëlliqur të këtij shpirti.

Ndërkaq fillon dënimi i varrit, i cili sqarohet në transmetimin e të nderuarës sonë Aishes -Allahu qoftë i kënaqur me të-, transmetim ky që është verifikuar si autentik nga Bukhariu dhe Muslimi, ku e nderuara jonë Aishja -Allahu qoftë i kënaqur me të- thotë: Një çifute erdhi tek unë dhe (ndër të tjera) tha, Allahu na mbrojtë nga dënimi i varrit. Aishja -Allahu qoftë i kënaqur me të- pyeti rreth kësaj të Dërguarin e Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. I Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- tha: "Po, dënimi i varrit është një vërtetësi".

Në varr, për ata që e meritojnë, do të ketë ndëshkim. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "Ata (shpura e Faraonit) i nënshtrohen zjarrit mëngjes e mbrëmje, e ditën e Kijametit (u thuhet engjëjve): "Shpurën e Faraonit futini në dënim më të rëndë!" [40:46] Bazuar në këtë thënie kuranore, suita e Faraonit mëngjes dhe mbrëmje i nënshtrohen ndëshkimit të Zjarrit dhe pasi të ndodhë Kijameti i pret një ndëshkim më i madh. Pra ata i nështrohen zjarrit nga vdekja e tyre deri në ditët tona dhe do vazhdojnë kështu deri kur të bëhet Kijameti. Ibn Kethiri e komenton kështu këtë thënie kuranore: "Shpirtrat e tyre kalojnë ndëshkim mëngjes dhe mbrëmje deri në ndodhinë e Kijametit. Në Ringjallje shpirtërat e tyre të bashkuar me trupat e tyre do të futen në Zjarrin e Xhehenemit".

Ndonjë dyshues mund të pyes se si do të realizohet ndëshkimi i varrit ndërkohë që trupat e disa të vdekurve ka ndodhur të jenë bërë thërrime, disa të tjerë janë djegur e bërë hi, ose janë gllabëruar nga bishat e egra; gjë që ka bërë që këto trupa të jenë shpërbërë?! Nisur nga aparenca e përgjigjes që jep Ibn Kethiri, ndëshkimi i varrit do të jetë mbi shpirtin, por vlen të përmendet fakti se kjo thënie nuk përbën një unifikim midis dijetarëve musliman, porse me të janë shprehur vetëm një pjesë e tyre.

Gjithsesi pyetja që vjen në përgjigje të kësaj është se cili do ishte problemi që ndëshkimi i varrit të ketë të bëjë edhe me shpirtin e edhe me trupin e të vdekurit në varr?! Allahu është i Gjithmundshëm të bëjë çdo gjë që do.

A nuk e shohim për shembull se biseda direkte që arrin tek teleshikuesit përmes kanaleve të largëta televizive, sidomos atyre satelitorë, përçohet dhe bartet nga mijëra e madje ndoshta miliona aparatura televizive, teksa që të gjitha e përcjellin atë në të njëjtin moment tek milionat e teleshikuesve, me figurë dhe zë?! E çuditshme kjo, edhe pse këto televizione janë të shpërndare anekënd tokës?! E pra Allahu i Lartmadhërishëm a nuk mundet t'a përçojë ndëshkimin e varrit tek çdo pjesë prej pjesëve të trupit të të vdekurit sado e sido qofshin shpërbërë, thërrmuar dhe distancuar?! Sigurisht që po, Allahu është i Gjithmundshëm të bëjë çdo gjë që do.

Kur dita e premtuar të vijë dhe t'i fryhet bririt së pari për Kijametin dhe pastaj së dyti për Ringjalljen, njerëzit do ngrihen me trupat dhe shpritërat e tyre, sikurse e trajtuam në episodin e kaluar, dhe kështu të ringjallur me trup dhe shpirt do jenë në pritje…

Po për ku do të shkojnë?! Ata do tubohen në Vendtubim-Mahsher. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Pra, largohu (distancohu) prej tyre. Ditën kur thirrësi (Israfili) kumton një gjë të tmerrshme. Dalin prej varreve si karkaleca të shpërndarë e me shikim të përulur; duke shpejtuar drejt atij që i thërret; jobesimtarët thonë: "Kjo është ditë e vështirë". [54:6-8] Kjo thënie kërcënuese kuranore erdhi në përmbyllje të veprimit abuziv të idhujtarëve mekas në rastin e çarjes mëdysh të hënës, për të cilin ata thanë kjo është magji; me ç'rast Kurani i kërcënoi me këtë thënie të tij. Kuptimi është, ti o Muhamed lëri mënjanë ata që thanë magji, për këtë mrekulli që të dha Allahu; këta përgënjeshtrues të çdo argumenti që u vjen, do t'i shohësh në Ditën e Ringjalljes kur thirrësi të thërrasë, ditë në të cilën vështrimet e tyre do të jenë të poshtëruara, teksa -siç tregon thënia kuranore- ata dalin nga varret e tyre nxitimthi.

Ky është Tubimi, lidhur me të cilin Allahu i Larëtsuar thotë: "Ditën kur të devotshmit i tubojmë tek Mëshiruesi në delegacione, teksa shkelësit e rendit (kriminelët) i komandojmë për në Xhehenem si bagëtitë e etura". Dihet fakti se si priten dhe barten delegacionet, me respekt dhe nderim të madh, teksa kush më mirë se Allahu di t'i respektojë dhe nderojë delegacionet që vijnë tek Ai... Ca të tjerë tubohen fytyrëpërmbysur, ndërkaq disa të tjerë që patën qenë prej mendjemëdhenjve tubohen në madhësinë e milingonëzave që do të shkelen me këmbë, kjo si shpërblim i mendjemadhësisë që patën treguar në dynja. Lidhur me ata njerëz që do tubohen fytyrëpërmbysur Allahu i Lartësuar dhe Lartmadhëruar thotë: "Ata të cilët do tubohen në Xhehenem fytyrëpërmbysur do t'i takojnë vendit më të keq dhe janë më rrugëhumburit". [25:34] Po kështu në një hadith të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- vjen se njerëzit do tubohen në tre kategori, thotë i Dërguari i Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-: "Njerëzit në Ditën e Ringjalljes do tubohen në tre kategori; njëra katëgori këmbësorë, njëra të hypur (të bartur) dhe njëra fytyrëpërmbysur". I thanë, o i Dërguar i Allahut! E si do ecin ata mbi fytyrat e tyre? Tha: "Ai që i bëri ata të ecin mbi këmbët e tyre është i Aftë t'i bëjë të ecin mbi fytyrat e tyre".

Për ku do të jetë ky destinim?! Do të jetë për tek vendqëndrimi madhështor... i cili do të zgjasë 50 mijë vjet. Pikërisht lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Një pyetës pyeti për ndodhinë e Ndëshkimit, prej të cilit mosbesimtarët nuk do ketë kush t'i mbrojë. Ai ndëshkim vjen nga Allahu, Poseduesi i shkallëve të larta (në qiej). Engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) ngjiten tek Ai në një ditë vlera e së cilës është pesëdhjetë mijë vjet". [70:1-4] Kështu pra, koha e ditës së vendqëndrimit të njerëzve ne vendtubim në pritje të bëhet zgjidhja e çështjes njerëzore, është pesëdhjetëmijë vjet.

Dielli ulet dhe afrohet përnga njerëzit, teksa ai do të jetë paisur me specifika që vijnë në përputhje të plotë me këtë situatë. Ligjësitë në masën më të madhe do të ndyshojnë në këtë ditë, aq sa dielli aq shumë do të afrohet mbi njerëzit saqë do të jetë mbi ta pak milje dhe normalisht ai siç e thamë do të jetë paisur me specifika dhe kondita që vijnë në përputhje të plotë me këto rrethana dhe situata. Njerëzit do t'i përvëlojë nxehtësia e madhe e diellit. Ata do të kridhen në djersë; do të ketë prej tyre kush djersët do t'i

mbulojnë thembrat e këmbëve; do të ketë prej tyre njerëz të cilëve djersët do t'u arrijnë deri në gjunjë, do të ketë prej tyre kush djersët do t'i arrijnë deri në brez, do të ketë prej tyre kush djersët do t'i arrijnë deri në krahëror dhe do të ketë prej tyre njerëz të cilët do të mbyten në djersë. Teksa ka prej tyre njerëz të cilët Allahu do t'i mundësojë të jëne nën hije. Këta persona të cilët Allahu do t'i fus në hije në atë ditë kur s'ka hije veç hijes së Tij, hadithi i përmend të jenë shtatë kategori; Bukhariu, Tirmidhiu, Nesaiu, Ahmedi dhe Maliku kanë publikuar transmetimin profetik ku Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- thotë: "Shtatë do t'i fus nën hijen e Tij Allahu në atë ditë kur nuk ka hije tjetër veç hijes së Tij; (kategoria e parë) imami (prijësi) i drejtë (ku hynë edhe qeveritari që qeveris drejtësisht sipas Kuranit dhe Traditës Profetik kombin e tij); (e dyta) një i ri që është rritur duke e adhuruar me përkushtim Zotin e tij (rinia është periudhë e mbushur me forcë dhe energji, por që i riu e përdori në adhurimin e Allahut të Lavdishëm dhe Lartmadhërishëm); (e treta) një person (burrë) zemra e të cilit është lidhur me xhamitë; (e katërta) dy persona janë dashur për hatër të Allahut, janë bashkuar për hatër të Tij dhe janë ndarë për hatër të Allahut (kur bashkohen ata bashkohen për gjëra që e kënaqin Allahun dhe për të lartuar fjalën e Allahut, teksa kur ndahen gjithsecili bën atë që Allahu i ka obliguar, duke qenë kështu bashkimi dhe ndarja e tyre, që të dyja, vetëm për hatër të Allahut); (e pesta) një burrë të cilit i është vardisur një grua e bukur dhe me pozitë të lartë në shoqëri, ndërsa ai ia kthen duke i thënë "Unë kam frikë Allahun" (mjafton që gruaja të jetë e bukur që mashkulli të anojë nga ajo, e si më pastaj kur ajo është edhe me pozitë të lartë shoqërore dhe është ajo që i vardiset mashkullit; këtë burrë, ai që e frenon, është patjetër besimi); (e gjashta) një person që ka dhënë lëmoshë fshehurazi aq sa e majta e tij nuk e di se çfarë ka dhënë e djathta e tij (ky person nuk e shfaq në publik dorëdhënien e tij, porse e fsheh atë në kulm); (e shtata) një person që teksa është i vetmuar e ka kujtuar Allahun dhe lotët i kanë shkuar çurg (i kanë shkuar lotët çurg nga frika prej Allahut të Lartmadhëruar).

Në këtë situatë të vështirë njerëzit do kërkojnë shpëtim; do duan që Allahu t'i japë drejtim gjithsecilit, ta gjykojë dhe penalizojë gjithkënd; dhe kjo vetëm e vetëm nga ashpërsia, tmerri dhe vështirësia e kësaj situate; dhe në këtë gjendje ata shkojnë tek profetët e Allahut, pikë së pari tek Ademi -paqja e Allahut qoftë mbi të-, pas tij shkojnë tek i nderuari ynë Nuhu -paqja e Allahut qoftë mbi të-, dhe kështu me rradhë shkojnë tek të nderuarit tanë profeti Ibrahim -paqja e Allahut qoftë mbi të-, profeti Musa -paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe profeti Isa-Jezus-paqja e Allahut qoftë mbi të-; ndërkaq gjithsecili prej këtyre profetëve nuk është i aftë të ndërhyjë dhe kërkon ndjesë duke thënë "Allahu nuk është zemëruar kurrë më parë si sot…".

Derisa ata vijnë tek Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i cili e merr përsipër atë ndërhyrje, e cila në fakt është një ndërhyrje prej ndërhyrjeve ekskluziviteti i së cilës i është lënë prej Zotit vetëm Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-; dhe kështu është Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ai që duke e lutur dhe falenderuar Allahun si kurrë më parë, i gjendur në sexhde dhe përmes fjalëve që Allahu ia inspiron atij pikërisht në këto

momente, ndërmjetëson dhe ndërhyn që gjykimi të fillojë. Allahu ia pranon atij këtë ndërmjetësim dhe pastaj situata vijon si në Librin e Allahut: “Ata nuk janë duke pritur tjetër, por vetëm që t'ju vijë Allahu në kupolë reshë, (t'ju vijnë) edhe engjëjt dhe çështja të jetë e kryer (kush për Xhenet e kush për Xhehenem). Vetëm tek Allahu është fundi i të gjitha çështjeve”. [2:210] Ashtu siç thënia kuranore në fjalë hedh dritë, në Ditën e Ringjalljes, vjen Allahu i Lartësuar që të bëhet gjykimi vendimtar.

Të gjithë njerëzit paraqiten dhe dalin para Zotit të Botërave në rresht. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë: “Dhe vihet Libri (i veprave), e i sheh mëkatarët të frikësuar nga shënimet që janë në të dhe thonë: "Të mjerët ne, ç'është puna e këtij libri që nuk ka lënë as (mëkat) të vogël e as të madh pa e përfshirë?"; dhe atë që vepruan e gjejnë prezente, e Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt”. [18:49] Kjo është Dita e paraqitjes para Allahut, Dita kur njeriu do i paraqitet kësaj marrje në llogari. Lidhur me po këtë situatë Allahu i Lartësuar thotë: “Dhe ato do të paraqiten para Zotit tënd të rreshtuar (e u thuhet atyre): ‘Na erdhët ashtu siç ju krijuam herën e pare; ju patët menduar se Ne nuk kemi caktuar për ju takim (ringjallje)". [18:48] Ky është takimi, kjo është paraqitja para Allahut të Plotfuqishëm dhe kjo është Dita e Llogarisë. Në thëniet në fjalë tregohet se kemi të bëjmë me një Libër-Regjistrues që “nuk ka lënë as (mëkat) të vogël e as të madh pa e përfshirë”. Regjistruesi në fjalë do të vijë me vetë punën që robi patë bërë jo me kopjimin apo regjistrimin e saj. Ju tani për shembul përmes këtij transmetimi nuk jeni në studio me mua, por po dëshmoni një pamje apo transmetim televiziv që u vjen në distancë. Njeriu me aftësitë e tij të kufizuara arriti të regjistrojë nga aktiviteti i njeriut figurën dhe zërin. E çmund të thuhet për Krijuesin e njeriut dhe të gjithë botërave?! Allahu i Lartësuar sjell atë ditë vetë punën apo veprimin e kryer; gjë lidhur me të cilën thotë në thëniet në fjalë “dhe atë që vepruan e gjejnë prezente”, ndërsa në një tjetër thënie kuranore thotë: “Ky është Libri-Regjistruesi Ynë (ku janë regjistruar veprat tuaja) që dëshmon vërtetësisht mbi ju, Ne kemi kërkuar të regjistrohet ajo që ju vepronit”. [45:29] Në një thënie profetike të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- që ka ardhur në shpjegim të thënieve kuranore të kaptinën “Zelzele”: “Kur toka të dridhet me dridhjen e saj të fuqishme; dhe kur toka të nxjerrë rëndesën e saj; e njeriu të thotë: "Çfarë ka kjo (toka)?!" Atë ditë ajo i tregon kallëzimet e veta”; transmetohet se Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ka pyetur: “A e dini se cilat janë kallëzimet e saj?!” Thanë, Allahu dhe i Dërguari i Tij janë më të dijshëm. Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- tha: “Kallëzimet e saj janë të dëshmojë mbi çdo rob dhe roberëshe (prej njerëzve) se çfarë vepre bëri mbi shpinën e saj, të thotë ‘Bëri kështu kështu, në këtë e këtë ditë’; këto janë kallëzimet e saj”. Pjesa tjetër e thënieve të kaptinës kuranore “Zelzele” e komenton këtë kështu: “Atë ditë ajo i tregon kallëzimet e veta; ngase Zoti yt e ka urdhëruar atë (pra për shkak se ajo është nën efektin e inspirimit hyjnor). Atë ditë njerëzit shfaqen të ndarë në grupe që të shohin (më sytë e tyre) veprat e tyre. Kush punoi një të mirë sa grimca, do t’a shikojë atë (më sytë e tij) dhe kush punoi një të keqe sa grimca do t’a shikojë atë (më sytë e tij)”. Shkencëtarët bashkëkohorë kanë studjuar rreth faktit nëse veprimet e bëra mbeten apo

zhduken. Lidhur me këtë ata kanë arritur që me një kamera speciale e cila filmon me rreze termodinamike të filmojnë një person të kërkuar që ka qenë në një ambient të caktuar; mua për shembull; një orë pasi është larguar. Më pas e zhvilluan këtë teknologji ashtu që kjo kamera u bë e aftë të filmojë personin një ditë pasi ka lënë vendin; më pas dy ditë; derisa tani kanë arritur t'a filmojnë makinën (për shembull) dhe nisur nga gjurmët inkandeshente të ngjyrave të makinës ata gjejnë me ekzaktësi se sa ishte shpejtësia e kësaj makine që ka kaluar në këtë vend para një ose dy ditësh.

Çfarë domethënie ka kjo?

Kjo do të thotë se vepra le gjurmë pas. Është pikërisht kjo gjurmë e mbetur që u dha mundësi këtyre kamerave speciale që të bëjnë regjistrimet që përmendëm.

Ndërkaq Kurani na tregon se toka do dëshmojë mbi ne, se ne do t'i shohim me sytë tanë veprat tona; dhe kjo është dëshmia e tokës mbi ne, mbi veprat tona, ashtu që "Atë ditë njerëzit shfaqen të ndarë në grupe që të shohin (më sytë e tyre) veprat e tyre. Kush punoi një të mirë sa grimca, do t'a shikojë atë (më sytë e tij) dhe kush punoi një të keqe sa grimca do t'a shikojë atë (më sytë e tij)". Dhe po mbi këtë realitet sollëm edhe thënien e Allahut të Lartësuar: "Ky është Libri-Regjistruesi Ynë (ku janë regjistruar veprat tuaja) që dëshmon vërtetësisht mbi ju, Ne kemi kërkuar të regjistrohet ajo që ju vepronit".

Në vijim Llogaria merr rrjedhën e saj…

Në llogari e sipër, Bukhariu, Muslimi dhe Ibn Maxhe publikojnë në adresë të Abdullah ibn Umarit -Allahu qoftë i kënaqur me të- se ai ka thënë: Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të thotë: "Allahu e afron pranë tij besimtarin, e strehon atë dhe e fsheh (nga shikimet e të tjerëve). I thotë: 'A e di këtë mëkat (që ke bërë)?! A e di këtë mëkat (që ke bërë)?!...". LA ILAHE IL ALLAH-I VETMI I MERITUESHËM TË ADHUROHET ËSHTË ALLAHU. Kemi të bëjmë me një bisedë dhe diskutim të veçantë në llojin e tij, midis Krijuesit dhe robit të Tij, teksa e ka fshehur robin nga të tjerët, po i tregon për mëkatin e tij të bërë, e robi po e pranon atë. Hadithi vijon: "…Deri kur robi e pohon mëkatin e tij (ashtu që kur Allahu e pyet 'A e di këtë mëkat (që ke bërë)?!; thotë 'Po o Zoti im'; sërisht i thotë 'A e di këtë mëkat (që ke bërë)?! Dhe sërisht i thotë 'Po o Zoti im'; duke pohuar se e ka bërë) dhe (robi) po mendon se i ka ardhur fundi (s'ka nga t'ia mbajë); (në këtë situatë të robit) atij Allahu i thotë: "T'i fsheha ato në dynja dhe Unë po t'i falë ato sot". Atij i jepet Libri i të mirave të tij. Ndërsa jobesimtarit dhe dyfytyrëshit dëshmitarët u thonë: "Këta janë ata që gënjyen ndaj Zotit të tyre. Padyshim që mallkimi i Allahut është mbi keqbërësit!"

Bëhet llogaria; do të ketë njerëz të cilët Allahu do t'i shpërblejë dhe shpërblimi i tyre do të jetë siç di Ai të shpërblejë, këta janë ata që kanë qenë durimtar, të cilët do të jenë në krye të njerëzve që nuk do merren në llogari dhe nuk do pyeten (por do futen në Xhenet pa llogari). Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "Durimtarëve u ruhet i pacënuar shpërblimi i tyre që është i pallogaritshëm". Shpërblim pa llogari. Përse kjo? Kjo sepse

ata bënë durim. Kundrejt çfarë bënë durim? Bënë durim pik së pari kundrejt belave dhe vuajtjeve që i ndodhin sojit njerëzor. Mbi këtë fakt Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Do t'ju sprovojmë me diç prej frikës, urisë, humbjes në pasuri, në të vjela dhe në njerëz. Ti përgëzoji durimtarët, të cilët kur i prek një fatkeqësi thonë 'Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi". Këta njerëz bënë durim pamvarësisht nga vështirësitë dhe sprovat e rënda; ky durim i tyre ishte i vetëdijshëm pasi ata mund t'i bënin bisht këtyre sprovave duke rënë në mëkat dhe zemëruar Allahun, porse ata e refuzuan të tillë gjë dhe duruan duke duke qenë të bindshëm ndaj Allahut. Tjetër formë e durimit të durimtarëve në fjalë është durimi në të bëmurin adhurim. Bindshmëria ndaj Allahut është adhurim që ka nevojë për durim; duhet durim që të bësh kujdes për faljen e namazit në kohën përkatëse; duhet durim për të kryer Agjërimin, për të dhënë Zekatin, për të realizuar Haxhin, për t'u mobilizuar ushtarakisht kundër armiqve, për të urdhëruar në të mirë dhe ndaluar nga e keqja. Duhet durim që t'a nënshtrosh vetveten kundër epshit dhe tekave të saj, që t'i vësh asaj kufi karshi gjërave që Allahu i Lavdishëm dhe i Lartmadhërishëm ka ndaluar, dhe që të vazhdosh me durim në këtë gjë; edhe kjo ka të bëjë me durimin për të cilin po bëjmë fjalë. Pra durimin e kemi disa llojesh; një lloj është durimi kundrejt fatkeqësive e vuajtjeve; lloji i dytë është durimi në të bëmurin adhurim Zotit dhe në treguarjen bindje karshi Tij; dhe lloji i tretë i durimit është durimi karshi mëkateve, dihet sesi tekat dhe epshet e unit, të afërmëve, shokëve dhe djajve, e nxisin dhe vënë në lëvizje njeriun që të bëjë mëkate. Kur njeriu duron në të tre këto dimensione ai e konkretizon durimin dhe hynë në gradën e durimtarëve të cilët Allahu do t'i fusë në Xhenet pa i marrë në llogari.

Gjenden 70 mijë nga kombi i Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të cilët Allahu do t'i fusë në Xhenet pa i marrë fare në llogari. Kur Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- u pyet rreth tyre tha: Këta janë ata të cilët nuk mjekohen përmes djegies, as përmes rukjes (këndimit të Kuranit), as i përdorin supersticionet (parandjenjat), dhe që mbi Zotin e tyre mbështeten". Në një transmetim që ka të bëjë me po këtë, vjen se Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i kërkoi Allahut të Lavdishëm dhe të Lartmadhërishëm që t'a rriste numrin e tyre dhe Allahu ia dha këtë që kërkoi ashtu që me secilin prej këtyre 70 mijë personave futen edhe 70 mijë të tjerë. Ukeshe ibn Muhsani e pyeti Profetin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- teksa Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- po u fliste lidhur me sa në fjalë, i tha: Unë a jam prej tyre o i Dërguari i Allahut? Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i tha: "Po". Tregohet se një tjetër person u ngrit dhe i bëri Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të njëjtën pyetje dhe atij Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i tha: "U tregua më i shkathët në të Ukeshja". Këtë thënie profetike e transmetojnë Bukhariu, Muslimi, Tirmidhi dhe Ahmedi.

Një tjetër kategori e atyre që do të jenë prej të shpëtuarve në Ditën e Gjykimit janë ata që do të gjykohen në kushte lehtësuese. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Përsa i përket atij të cilit Libri i tij do t'i jepet nga e djathta e tij, ai ka për t'u gjykuar me një gjykim të lehtë dhe do të kthehet tek familjarët e tij i gëzuar.

Ndërsa përsa i përket atij të cilit Libri i tij do t' i jepet pas shpinës, ai do t'i ndjellë vetes shkatërrim, e do të hyjë në Seair (zjarrin e ndezur fort)". Të dytit, libri i është dhënë në dorën e tij të majtë të kthyer nga pas shpinës, shenjë kjo e dështimit që e pret.

Ahmedi, Ib Humejdi, Ibn Xheriri dhe Hakimi që e ka konfirmuar për të saktë, kanë transmetuar se Aishja -Allahu qoftë i kënaqur me të- e pyeti të Dërguarin e Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- duke i thënë: Çfarë është gjykimi i lehtë? Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- tha: "T'i vështrohet në Librin e tij dhe t'i anashkalohet ai. E atij të cilit i merret në shqyrtim Libri i tij do shkatërrohet". Kemi të bëjmë pra me thjesht një lloj ekspozimi para Allahut, në të cilin njeriut do t'i shihet Libri i tij dhe më tej nuk do t'i merret në shqyrtim, diskutim dhe llogari; pasi nëse njeriut i merret në llogari dhe shqyrtim Libri i tij, ai e pëson keqazi.

E kush do të jetë i pari që do të merret në llogari?

Lidhur me këtë na informon vetë ai të cilit Allahu ia ka zbuluar përpara se të ndodhin skenat e ardhëshme të Ditës së Gjykimit, Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, në transmetimin e tij ku thotë se:

"I pari njeri të cilit do t'i bëhet gjyqi në Ditën e Gjykimit është një person që ka rënë dëshmor (shehid në sytë e njerëzve). Sillet dhe i bëhet e ditur mirësia e Tij që iu dha (në dynja), të cilën ai e konfirmon. I thotë-Allahu: 'Çfarë bëre me të?' Thotë: Luftova për Ty derisa rashë dëshmor. I thotë: 'Gënjeve! Në realitet ti luftove që të thuhej për ty guximtar, dhe u tha një gjë e tillë'. Pastaj jepet urdhër dhe tërhiqet me fytyrë përmbys derisa hidhet në Zjarr. -vijon transmetimi profetik:-

Edhe një person që e mësoi diturinë dhe ua mësoi të tjerëve e që ishte edhe këndues i Kuranit (në sytë e njerëzve). Sillet dhe i bëhet e ditur mirësia e Tij që iu dha (në dynja), të cilën ai e konfirmon. I thotë-Allahu: 'Çfarë bëre me të?' Thotë: E mësova diturinë, ua mësova të tjerëve dhe Kuranin e këndova për Ty. I thotë: 'Gënjeve! Në realitet ti e mësove diturinë që të thuhej për ty dijetar, dhe e lexove Kuranin që të thuhet për ty është këndimtar i Kuranit; dhe u tha një gjë e tillë.' Pastaj jepet urdhër dhe tërhiqet me fytyrë përmbys derisa hidhet në Zjarr.

Edhe një person të cilit Allahu i kish dhënë bollëk, i kish dhënë pasuri të të gjitha llojeve. Sillet dhe i bëhet e ditur mirësia e Tij që iu dha (në dynja), të cilën ai e konfirmon. I thotë-Allahu: 'Çfarë bëre me të?' Thotë: Nuk lashë ndonjë rrugë ku Ti dëshiron të shpenzohet pasuri përveçse shpenzova në të për Ty. I thotë: 'Gënjeve! Në realitet ti e bëre që të thuhej për ty bamirës, dhe u tha një gjë e tillë'. Pastaj jepet urdhër dhe tërhiqet me fytyrë përmbys pastaj hidhet në Zjarr".

LA ILAHE IL ALLAH-I VETMI I MERITUESHËM TË ADHUROHET ËSHTË ALLAHU. Si është puna e këtyre? Problemi i këtyre është se ata në fakt nuk po e adhuronin Allahun, nuk po synonin vetëm Fytyrën dhe Kënaqësinë e Allahut; porse ata synonin tjetër gjë.

Ndërsa ata të cilët në kryerjen e të tillë punëve kishin për qëllim vetëm Allahun, dhe pasi i bënë këto vepra atyre u erdhën lavdërime dhe falenderime, kjo nuk i dëmton, pasi ato nuk kishin për qëllim lavdërimet dhe falenderimet e njerëzve, porse për qëllim kishin vetëm shpërblimin e Allahut. Nëse të tillëve u vijnë falenderime dhe lavdërime këto s'janë veçse përgëzime preludore për të mirën që e pret besimtarin.

Këta janë të parët të cilëve do t'u bëhet gjyqi dhe me ta do ndizet Zjarri Ditën e Gjykimit.

Cila është e para gjë për të cilën do t'u bëhet gjyqi njerëzve, cila është ajo gjë me të cilën fillon marrja në llogari?

Në një hadith të publikuar nga Bukhari, Muslimi, Tirmidhi, Nesaiu, Ibn Maxhe dhe Ahmedi, vjen se Ebu Hurejra transmeton në adresë të të Dërguarit të Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se ai ka thënë: "E para gjë për të cilën do të merret robi në llogari është namazi dhe e para gjë që do shpagohet midis njerëzve është gjakmarrja". Pra kemi të bëjmë me dy seksione llogarie; një seksion ekskluziv për Allahun e Lavdishëm dhe të Lartmadhërishëm, ashtu që e para gjë me të cilën do filloj llogarimarrja është puna e faljes së namazit që po qe se ka qenë mirë edhe punët e tjera do të jenë mirë; seksioni tjetër është ai i marrëdhënieve ndërnjerëzore ku e para gjë me të cilën do fillohet është gjakmarrja, nëse ke vrarë ose ke derdhur gjak padrejtësisht. Në këto gjëra do jetë fillimisht marrja në llogari.

Njerëzit do të paraqiten para Zotit të tyre në disa forma; gjë në lidhje me të cilën Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- thotë: "Njerëzit do të paraqiten në Ditën e Gjykimit tre paraqitje; dy të parat janë debat dhe justifikime (ky polemizon e ky justifikohet); ndërsa e treta është fluturimi i shkresave të punëve ashtu që do të ketë kush do t'i marrë ato me të djathtën e tij dhe do të ketë kush do t'i marrë ato me të majtën e tij". E lusim Allahun të na i japë shkresat e veprave tona t'i marrim me të djathtën tonë. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: "E qielli çahet, e ai atë ditë është i rraskapitur. Dhe engjëjt qëndrojnë në skajet e tij, e atë ditë tetë (engjëj) e bartin Arshin e Zotit tënd. Atë ditë ju do të paraqiteni (para Zotit), duke mos mbetur i fshehtë asnjë sekret i juaji". [69:16-18] Askush nuk do mundet të fsheh gjë.

Në Ditën e Gjykimit njerëzit merren në pyetje dhe llogari rreth çfarë dhe kujt patën adhuruar përveç Allahut dhe merren në pyetje dhe llogari për veprat që patën bërë. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Po, betohem në Zotin tënd, do t'i pyesim (marrim në pyetje dhe llogari) që të gjithë ata për çfarë patën punuar". Në Ditën e Gjykimit do pyeten personat dhe profetët që u dërguan tek ata; gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Ne patjetër që do t'i marrim në llogari ata të cilëve u është dërguar (profet) dhe do t'i marrim në pyetje edhe të dërguarit. Dhe duke e ditur mirë Ne do t'u rrëfejmë atyre (për atë që punuan), se Ne nuk ishim të papranishëm". [7:6-7] Allahu i Lartësuar nuk ishte i papranishëm, përkundrazi Ai ishte dëshmitar mbi çdo gjë që ata punuan, i Lavdishëm dhe i Lartëmadhëruar është Ai.

Po kështu Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- lidhur me marrjen e robit në llogari në një transmetim autentik të tij thotë: "Nuk ka për të lëvizur këmba e robit Ditën e Gjykimit derisa të pyetet për katër gjëra: për jetën e tij në ç'e kaloi; për diturinë e ti se ç'punoi me të; për pasurinë e tij se nga e fitoi dhe në çfarë e shpenzoi dhe për trupin e tij në çfarë e brejti".

Gjitkush nga ne do pyetet se ç'bëri me mirësitë e panumërta që i dha Zoti "...e nëse do i numëronit mirësitë e Allahut nuk do i llogarisnit dot"; gjë për të cilën Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Pastaj medoemos do të pyeteni atë ditë rreth mirësisë".

Gjithsecili nga ne do të pyetet për të dhënat që ka dhënë dhe ka përçuar tek njerëzit, për informacionin që u ka dhënë të tjerëve pa qenë kompetent; gjë për të cilën Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Mos iu qep asaj gjëje për të cilën nuk disponon dituri, vërtetë që dëgjimi, vështrimi dhe arsyeja, që të gjitha do të përgjegjësohen rreth kësaj".

Do të ketë dëshmi dhe dëshmitarë atë ditë...

Përveç faktit se Allahu është Dëshmitar për çdo gjë, Ai ka bërë që në këtë ditë dëshmitë e tyre t'i sjellin edhe profetët, engjëjt dhe toka; madje dëshmi do ketë edhe nga disa dëshmitarë special, nga dëgjimet, shikimet dhe lëkurët e njerëzve; gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Derisa ata (mosbesimtarët) i afrohen atij (Xhehenemit), dhe kundër tyre dëshmojnë të dëgjuarit e tyre, të parit e tyre dhe lëkurët e tyre për çdo gjë që ata kanë punuar." [41:20]

Nga Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- është transmetuar se pasi të dëshmojnë dëshmitarët dhe të dëgjohen e bëhen konstatimet dhe shqyrtimet në këtë gjyq suprem drejtësie, pas kësaj vendosen peshojat e drejtësisë ku peshohen punët; gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Dhe në Ditën e Gjykimit Ne i vendosim peshojat e drejtësisë absolute; e askujt nuk i bëhet asnjë padrejtësi; e edhe nëse (vepra e bërë prej njeriut) është sa pesha e një kokrre të melit Ne do ta sjellim atë. E mjafton që Ne do të jemi ata që do t'a bëjmë marrjen në llogari". [21:47]; këto peshoja do të jenë specifike dhe në përkatësi me objektin e tyre që do masin... A nuk e shohim sesi njerëzit sot kanë arritur të masin rrymën elektrike përmes matësve specifikë të cilët janë specifik për matjen e rrymës elektrike dhe që edhe pse ato janë matës s'është e thënë që të funksionojnë me gur peshe. Po kështu punët e njerëzve do të maten me matësa specifikë; do të peshohet fjala, shikimi etj; çdo gjë do të peshohet dhe matet; gjë për të cilën -siç u cek më herët- Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Dhe në Ditën e Gjykimit Ne i vendosim peshojat e drejtësisë absolute; e askujt nuk i bëhet asnjë padrejtësi; e edhe nëse (vepra e bërë prej njeriut) është sa pesha e një kokrre të melit Ne do ta sjellim atë. E mjafton që Ne do të jemi ata që do t'a bëjmë marrjen në llogari." [21:47] Dhe thotë gjithashtu: "E sa i përket atij të cilit peshorja e e tij (e veprave të mira) i peshon rëndë, Ai është në një jetë të këndëshme. Ndërsa përsa i përket atij të cilit peshorja e e tij (e veprave të mira) i peshon pak, vendi i

tij do të jetë në Hauije. E ku e di ti se ç'është ai (Hauije)?! Është zjarri shkrumbues." [101:6-11]

E lusim Allahun e Lartësuar të na bëjë ne dhe ju prej fitimtarëve të suksesshëm.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin amshimisht mbi profetin Muhamed, familjen, shokët dhe ndjekësit e tij.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Qeniet e gjalla (21)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Realiteti qëndron se ne mundemi të kapim disa prej cilësive të Zotit tonë përmes veprave dhe krijimeve të Tij, i Lavdishëm është Ai.

Në këtë episod do të diskutojmë rreth qenieve të gjalla…

Allahu i Lartësuar thotë: "Në krijimin tuaj dhe të gjallesave në ecje që kemi shpërndarë në tokë ka argumente për një popull që binden." Bindshmëria vjen përmes mendimit të thell tek argumentet dhe provat e evidentueshme.

Qeniet e gjalla ndryshojnë nga sendet dhe jofrymorët. Ndryshimet midis tyre janë përmendur nga studiuesit e kësaj sfere. Lidhur me këto ndryshimi ata kanë thënë:

- Qenia e gjallë ushqehet, ndërsa jogjallesa nuk ushqehet.
- Qenia e gjallë zhvillohet dhe rritet, ndërsa jogjallesa jo.
- Qenia e gjallë merr frymë, ndërsa jogjallesa nuk merr frymë.
- Qenia e gjallë shtohet dhe riprodhohet, ndërsa jogjallesa jo.

Pra qenia e gjallë ushqehet, rritet dhe zhvillohet, merr frymë si dhe shtohet dhe riprodhohet, gjëra këto që nuk janë evidente për jogjallesat.

Ne të gjithë kemi qenë të vdekur dhe jetën na e dhuroi Allahu pastaj vdesim dhe pastaj Allahu na ringjallë, na jep jetë sërisht. Allahu i i Lavdishëm dhe Lartmadhëruar thotë: "Si e mohoni Allahun, e dihet se ju ishit të vdekur e Ai ju ngjalli, pastaj jua merr jetën, pastaj ju ringjall, e më pas tek Ai do të ktheheni?".

Le të meditojmë lidhur me dukurinë jetësore që e shohim të pranishme tek qeniet e gjalla, duke filluar me qelizat bimore dhe duke mbaruar me njeriun.

Ateistët u dorëzuan para faktit se jeta përbënte për ta një mrekulli dhe sfidë, pasi pas jetës fshihet një mirëstrukturim, përsosje, planifikim, perfektshmëri, mrekulli dhe shenja të tjera që reflektojnë bindshëm diturinë e Allahut, Urtësinë dhe Vullnetin e Tij.

Për këtë disa nga flamurtarët e komunizmit në Moskë në vitin 1942 i thanë ekspertit kimist më të madh të tyre Obarinit, na krijo një gjallesë nga jogjallesa. Ai u tha t'i jepnin kohë dhe mbështetje lidhur me këtë. I dhanë sa dhe çfarë kërkoi. U kërkoi gjithashtu asistentë t'a ndihmonin dhe ata i sollën kë deshi. Pas 20 vjetësh në vitin 1962 Oberini deklaroi rezultatin e përpjekjes së tij, tha: U bindëm se është e pamundur të krijohet jeta nga jogjallesat dhe substancat pajetë. Kjo ishte shkolla e lindjes.

Ndërsa shkolla perëndimore u orinetua drejt hulumtimeve lidhur me sekretin e jetës në elementin më të vogël ku strehohet jeta. Gjetën se elementi më i vogël ku strehohet jeta është një aminoacid që e kanë emërtuar ADN. Thanë se ADN nuk mund të përftohet përveçse nga qenia e gjallë. Gjetën se miza e mollës Drosophila u siguronte atyre ADN-në me përmasat më të lakmueshme e cila ishte e mundshme të studiohej. Gjithë studimet e tyre i përqëndruan dhe ngritën duke pasur për objekt këtë mizë, ADN-në e përftuar nga kjo mizë. Pas këtij studimi thanë arritëm të zbulojmë sekretin e ADN-së. Pas kësaj thanë tani ne jemi të aftë të strukturojmë AND, pra jemi të aftë të strukturojmë jetën. Fakt është se ata arritën t'a produktonin aminoacidin ADN ekzaktësisht sikurse ADN-ja tek miza e mollës. Porse kur nga ADN-ja e mizës së mollës merrej uji ajo shndërrohej në një lëndë pajetë dhe kur uji i ktheheshte jeta në të gjallëronte sërisht. Ndërsa aminoacidit ADN që produktuan sado që i fusnin ujë nuk përftontë dhe reflektonte asnjë lëvizje dhe gjallëri. Së fundi deklaruan të njëjtin rezultat si shkolla lindore, pra se jeta nuk mund të krijohet nga subsatncat dhe sendet pajetë. Mrekullia qëndron se Kurani i sfidon të tillë njerëz të krijojnë pikërisht atë gjë me të cilën ata tentuan t'a fillojnë orvajtjen e tyre për të krijuar jetën, i sfidon të krijojnë qoftë edhe mizën. Thotë Allahu i Lartësuar: "O ju njerëz, po ju jipet një shembull, vërjani veshin mirë: Vërtet ata që po i adhuroni në vend të Allahut nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe nëse mblidhen të tërë për të tillë gjë…". Mrekullia tjetër qëndron në faktin se ekspertët e fushës pas zbulimit të ADN-së u mblodhën në një konferencë të cilën e emërtuan Konferenca e ADN-së, ku të tërë ranë dakord për të krijuar jetën, duke pasur objekt fillestar në këtë përpjekje tyren të dështuar pikërisht mizën, teksa Allahu i Lartësuar thotë pikërisht këtë që ndodhi: "O ju njerëz, po ju jipet një shembull, vërjani veshin mirë: Vërtet ata që po i adhuroni në vend të Allahut nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe nëse mblidhen të tërë për të tillë gjë, e edhe nëse miza u rrëmben atyre diçka, ata nuk do të mund t'a shpëtojnë atë prej saj. I dobët është edhe lutësi edhe i luturi (që lutet përveç Allahut). Ata nuk e madhëruan Allahun me madhështinë që i takon, Allahu është i Fuqishëm, Triumfues". E bukura qëndron edhe se Allahu i sfidon ata të kthejnë mbrapsht atë çfarë zhvat prej tyre miza. Përse? Kjo sepse miza kur zhvat ndonjë ushqim apo diçka tjetër nuk e konsumon atë vetëm se pasi të hedh mbi të jargët e saj, duke e shndërruar kështu në një substancë likuide të tjetërsuar nga origjina që të ketë mundësi t'a thithë atë. Pra nëse miza zhvat nga ne diçka nuk do mundemi t'a kthejmë mbrapsht sepse miza e ka transformuar atë në tjetër gjë. "…I dobët është edhe lutësi edhe i luturi (që lutet përveç Allahut)."

Thamë se një nga veçoritë dalluese të qenies së gjallë është aftësia për t'u ushqyer. Le të meditojmë pakëz lidhur me këtë ushqim. Ushqimi është depozita që e furnizon trupin e gjallesës me energji dhe me lëndët përmes të cilave trupi rritet dhe zhvillohet. Që trupi i gjallesës të lëviz ajo ka nevojë për energji dhe që të mbajë trupin në rritje ajo ka nevojë për lëndët zhvilluese jetike që furnizojnë këtë trup. Kjo lëndë specifike dhe kjo energji bëhen evidentë përmes ushqimit.

Le të shikojmë se si ia mundësoi Allahu çdo qenie të gjallë ushqimin e saj.

Fetusit në barkun e nënës Allahu ia mundësoi ushqimin teksa ai për plotë nëntë muaj gjendet brenda barkut të nënës së tij. Po kështu nëse thyen ndonjë shkëmb ka shumë mundësi që në brendinë e tyre të gjesh ndonjë krymb, edhe pse të betonuar në zemër të shkëmbit atë do t'a gjesh të gjallë. Kush e furnizon atë?

Medito rreth fetusit të farës së bimës që çel në kreshtat e bimës, sesi ushqimi i shkon atje lartë dhe më pas kur mbillet sërisht ushqimi i arrin këtë rradhë nën tokë ku zhvillohet dhe prej saj del e tërë bima.

Allahu e ka garantuar ushqimin për të gjitha gjallesat. Balena në thellësitë e oqeaneve e ka atje ushqimin e saj. Zogthi brenda vezës e ka aty ushqimin, falë garantimit të Allahut. Thotë Allahu i Lartësuar: "Nuk ka ndonjë nga gjallesat lëvizëse të shpërndara në tokë, përveçse Allahu ia ka garantuar furnizimin, Ai e din vendodhjen e saj dhe depozitën e saj."

Medito se si pasi krijoi për gjallesën ushqimin në krahun tjetër krijoi edhe aparatin përkatës në trup që e mundëson gjallesën të shfrytëzojë ushqimin që Allahu e krijoi për të. Medito rreth aparatit tretës të harmonizuar në varësi të fizionomisë dhe anatomisë së çdo gjallese. Tartabiqët dhe kacabujtë kanë një sistem tretës që bën për ushqimin e tyre, po kështu luanët kanë një sistem tretës të përshtatshëm për mishin me të cilin ushqehen, edhe peshqit kanë një sistem tretës të përshtatshëm me ushqimin e tyre, gjë kjo që është evidente për çdo qenie të gjallë.

Allahu u krijoi atyre ushqimin dhe u krijoi një aparat tretës që i mundëson të përfitojnë nga ky ushqim. Për çfarë tregon kjo? Tregon se të gjitha këto sistemime lidhur me të gjitha qeniet e gjalla në çështjen e ushqimit janë vepër e Furnizuesit, deshi Ai t'i furnizojë ato. A është natyra e ditur, e mëshirshme, e mençur, furnizuese, mendon dhe arsyeton lidhur me çfarë duhet bërë, apo këto shenja të mrekullueshme që shohim janë prej përkujdesjes dhe planifikimit të Allahut të Lavdishëm dhe Lartmadhëruar.

Shohim gjithashtu rritjen dhe zhvillimin e gjallesës, tjetër argument prej argumenteve të mrekullueshëm. E gjejmë trupin të rritet dhe zmadhohet. Si rritet ai? Bëhet fjalë për praninë e një planifikimi, kemi të bëjmë me një programim. Rritja fillon nga një qelizë e vetme. Të gjitha qeniet e gjalla zanafillën e kanë pasur nga një qelizë e vetme dhe më pas kjo qelizë shumohet. Qeliza unike në fakt erdhi nga një baba dhe një nënë, lëngu gjenital i të cilëve kur tubohet formon embrionin e qenies së re, dhe paçka nëse kjo qenie ka qenë deve, elefant, mushkonjë, mizë, gjarpër, peshk, fillesa e të gjitha këtyre ka qenë një qelizë e vetme. Brenda kësaj qelize mëmë gjendet një program gjë të cilin shkenctarët e dinë mirë, madje e njohin në detaj. Është një program i mirëplanifikuar, i dizenjuar enkas për këtë qelizë që ajo të bëhet një qenie e plotë. Kjo qelizë shumohet përmes ndarjes duke u bërë miliona, madje miliarda qeliza në disa gjallesa. Porse ajo ecën në një rrugë të dizenjuar dhe të specifikuar ku e komandon ky program. Një pjesë qelizash do kenë detyrën e formimit të dorës, një pjesë tjetër janë të predispozuara për të formuar këmbën, një tjetër për të formuar syrin, një tjetër për të formuar gojën, një tjetër për të

formuar stomakun, tek shpendët për të formuar flatrën apo krahun, tek peshqit për të formuar luspat... Është një program i dizenjuar. Kush është ai që e vendosi këtë program? Kush e vendosi këtë programim dhe kodifikim të mrekullueshëm tek të gjithë qeniet e gjalla, në çdo qelizë mëmë nga e cila formohen këto gjallesa? Program që përcakton se prej kësaj zygote do të vijë një deve, prej kësaj një elefant, prej kësaj një mushkonjë... Programimi nuk mund të realizohet dhe përmbushet përveçse me qëllimshmëri, synim, përvojë dhe dituri. Kush është ai që e bëri këtë programim dhe planifikim? Natyra e shurdhër, memece dhe e verbër?! I Lavdishëm është Allahu, Thënësi: "Allahu çdo krijesë që lëviz dhe është shpëndarë në tokë e ka krijuar nga uji..." Uji është përbërësi i parë i qelizës së parë spermatozeidale nga e cila vjen e formohet qenia e gjallë. Kush i udhëzon këto qeliza në vendet e duhura të tyre? Kush i thotë qelizave, ti do formosh zemrën, ti do formosh mushkëritë, ti do formosh stomakun, ti do formosh flatrën e një shqiponje, ti do formosh kthetrat e maces, ti do formosh dhëmbin e qenit tek luani. Kush i udhëzon ato tek vedi i tyre dhe që të kenë komponentët e duhur për funksionim? Ky është krijim i Allahut, Krijuesit që vepron me krijesat e Tij sipas Vullnetit të Tij. Është Ai që tregon për to përkujdes, i rrit dhe zhvillon pasiqë ishin vetëm një pikëlz uji, duke i bërë krijesë të kompletuar dhe të përsosur: "I Lavdishëm është Ai në dorën e të Cilit është sundimi absolute, Ai është i Gjithmundshëm për çdo gjë. Është Ai që krijoi vdekjen dhe jetën, që t'ju provojë se cili prej jush do jetë më vepërmirë." Kush është Ai që i posedon cilësitë në fjalë? Kush është Ai që u përkujdes për mbarë këto gjallesa që kur ato ishin një qelizë e vetme derisa u bënë këto qenie të mrekullueshme?! Kush i udhëzoi qelizat përkatëse në vendet e duhura?! Kush i urdhëroi organet e trupit të ndërmarrin funksionet përkatëse?! Kush i trajtësoi ato krijesa?! Kush i dha luanit pamjen e tij, njeriut atë të tijën, zogut atë të tijën, gjarprit atë të tijën dhe u dha mbarë krijesave pamjet e tyre përkatëse që ato kanë?! Kush posedon pra cilësitë prej trajtësuesi, udhëzuesi, furnizuesi, jetëdhënësi dhe jetëmarrësi?! Kush veç Tij, veç Allahut të Lavdishëm dhe Lartmadhëruar.

Tani le të meditojmë së bashku lidhur me shqisat... Ka krijesa fushëveprimi i të cilave është e shumë e shtrirë, fluturojnë e vrapojnë, ndaj Allahu i pajisi ato me shikim të mprehtë e të largët, me dëgjim shumë të mprehtë e që dëgjojnë tej largë.

Ndërkaq gjenden disa gjallesa të tjera fushëveprimi i të cilave është shumë i limituar sikurse insektet apo peshqit që jetojnë në thellësitë e oqeaneve. Atyre Allahu u dha shqisa që përkatësojnë me ambientin e kufizuar ku ato jetojnë.

Lidhur me shikimin kemi sikurse dihet shqiponjën ose skifterin, me një shikim të mprehtë me të cilin mund t'a shikojë prenë nga shumë larg, ashtu që e sulmojnë prenë atje ku do të jetë kur t'a arrijnë. Shikimin përmes të cilit gjallesa shikon gjithësa gjendet rreth e rrotull saj, kush e solli në ekzistencë?! Kush e krijoi shikimin dhe strukturoi kaq mrekullueshëm?! Kush i krijoi sytë?! Natyra që vetë është e verbër, e shurdhër dhe memece, a mund të jetë ajo bërësja e sa në fjalë?! Po dëgjimin kush e krijoi, kush i krijoi komponentët e dëgjimit dhe i strukturoi e vendosi ashtu si duhen?! Jo,jo. E tillë gjë nuk

mund të jetë vetëmse vepër e Atij që prej atributeve të Tij ka dëgjimin dhe shikimin. Këto janë shenja nga shenjat e Allahut që tregojnë për aftësinë e Tij supreme dhe Fuqinë e Tij absolute, i Lavdishëm është Ai.

Duke qenë se krijesat e krijuara prej Krijuesit posedojnë shikim dhe dëgjim, Krijuesi për më tepër i bie të jetë Gjithshikues dhe Gjithdëgjues. Prania e shikimit dhe dëgjimit tek krijesat na dëshmon se Krijuesi, i Lavdishëm është Ai, i posedon të tillë atribute në kulminacionet absolute të tyre. Sa në fjalë kurrsesi nuk mund të jetë vepër e natyrës shurdhe, memece dhe të verbër, që as mund të shohë apo dëgjojë gjë prej gjëje.

Sërisht le të meditojmë, por tani lidhur me një tjetër shenjë të Allahut, krijimin e frymëmarrjes. Ne dhe krijesat e tjera jemi të nevojshëm të marrim frymë, por si dhe pse ndodh kjo? Kjo sepse ushqimit, që të arrijë deri tek qelizat, i duhet t'i nënshtrohet procesit të djegies që të prodhojë energjinë e nevojshme që i mundëson trupit funksionimin pro aktivitetit të tij jetik. Ajo që kërkohet është që oksigjeni të arrijë në çdo qelizë të trupit. Qeniet e gjalla janë lloje të ndryshme, ca prej tyre janë njëqelizorë, disa të tjerë janë shumëqelizor dhe disa të tjera përbëhen nga miliarda qeliza sikurse kafshët dhe njerëzit. Si mundësohet arritja e oksigjenit tek çdo qelizë me qëllim që të realizohet procesi i djegies për t'u prodhuar energjia e kërkuar?

Le të mësojmë diçka më shumë rreth kësaj!

Gjallesat njëqelizore Allahu i pajisi me një membranë e cila është në kontakt direkt me ajrin dhe ambientin e jashtëm. Allahu bëri të mundur që oksigjeni të depërtoj tek njëqelizori përmes kësaj membrane të njëqelizorit, sikurse në krahun tjetër bëri të mundur që po kështu përmes membranës të njëqelizorit të realizohet edhe dalja apo largimi i dioksidit të karbonit. Pra membrana është shtegu i hyrjes së oksigjenit dhe daljes së dioksidit të karbonit. E njëjta gjë vlen edhe për gjallesën disaqelizore, ku është po membrana ajo që kryen funksionet e përmendura më lartë.

Çfarë mund të thuhet lidhur me organizmat mijëra apo milionaqelizorë, frymëmarrja e të cilëve është paksa më e sofistikuar, si për shembull karkaleci apo ngjashëm me të në strukturë prej insekteve, apo lidhur me organizmat dhe gjallesat që jetojnë nën tokë? Allahu të tillë insekte, sidomos ato prej tyre që fluturojnë, i ka pajisur në anët, barkun dhe krahërorin e tyre me të çara për frymëmarrje që quhen vrima ajrimi dhe të cilat janë pajisur me ca gypëza ku ajri pasi hyn degëzohet e futet kryq e tërthor në trup duke arritur çdo qelizë, kjo sepse kërkohet që ajri të arrijë në çdo qelizë ashtu që të mundësohet pajisja me energjinë të cilën insektet e përdorin për të realizuar lëvizjet dhe mbarë aktivitetet e tyre jetike. Por gypëzat në fjalë mund të jenë rrjedhës të fluidit fiziologjik prezent tek insektet, gjë për të cilën Allahu këto gypëza i strukturoi me qimëza dhe valvula që pengojnë daljen e fluidit nga organizmi i gjallesave në fjalë, teksa perfektshmërisht realizohet po nëpërmjet këtyre gypëzave dalja e mirëkalkuluar e ajrit të dëmshëm.

Por çfarë mund të thuhet lidhur me qeniet e gjalla të stërmëdha si elefantët, devetë apo qeniet njerëzore, që posedojnë qeliza të shumta në dorë, këmbë, sy, në tru etj? Duhet medoemos që oksigjeni të arrijë në çdo qelizë prej këtyre miliarda qelizave. Pikërisht për realizimin e sa në fjalë Allahu bëri aparatin e frymëmarrjes enkas për këto qenie të gjalla. Ky aparat fillon me hundën, pastaj ezofagun dhe pastaj mushkëritë. Pastaj çdo gjë në këtë aparat kryhet automatikisht, madje edhe teksa gjallesa fle aparati i frymëmarrjes brenda saj funksionon automatikisht dhe pandërprerje duke thither oksigjenin dhe nxjerrur dioksidin e karbonit. Kur oksigjeni hyn brenda dy mushkërive aty takohet me gjakun që mbart dioksid karboni. Gjaku dioksidin e karbonit e hedh në mushkëri dhe merr oksigjenin dhe gjaku me oksigjenin i bien kryq e tërthor të gjithë trupit duke arritur në çdo qelizë. I Lavdishëm është Allahu, i Urti, Shpikësi, i Gjithdijshmi që është në dijeni të plotë për çfarë nevojash ka çdo qelizë dhe ia mundëson asaj atë çfarë i nevojitet si dhe i strukturon çdo qelize rrugën e përshtatshme përmes së cilës atyre u arrin gjithë çfarë u lypet. I Lavdishëm është Allahu, Dhuruesi, Fisniku, Krijuesi, Shpikësi.

Porse ka disa gjallesa që jetojnë në ujë të spostuara nga ajri sikurse peshqit dhe gjallesat e tjera të detit. Allahu i pajisi ato me aftësinë që të filtrojnë dhe shkëpusin oksigjenin që gjendet i tretur në ujë. Allahu u mundësoi atyre prezencën e oksigjentit në gjendje të tretur në ujin ku ato jetojnë dhe gjithashtu i pajisi me aftësinë që të filtrojnë dhe shkëpusin oksigjenin nga uji për procesin e tyre jetik të frymëmarrjes gjë që ndodh kur oksigjeni kalon përmes pjesës së tyre specifike të gushës. Më pas oksigjeni prej aty arrin mbarë qelizat e trupit duke realizuar procesin përkujdesës për ecurinë jetike të tyre. Vepër dhe planifikim i Kujt është ky? Është planifikimi dhe vepra e të Qëllimshmit, të Gjithdijshmit, të Gjithmundshmit, Mëshirbërësit, atribute këto prej atributeve ekskluzive të Allahut. I Lavdishëm është Allahu që krijoi dhe përsosi, përcaktoi dhe orientoi.

Le të hedhim një tjetër vështrim tek gjallesat! Do t'i shohim se ato formohen nga dy bashkëshortët, mashkulli dhe femra. Gjallesat pra vijnë në këtë ekzistencë nga çiftëzimi dhe ndërkohë gjejmë se numri i meshkujve është i mjaftueshëm për numrin e femrave. Themi mjafton jo është i njëjtë, pasi dihet se në botën e gjallesave ndodh që një mashkull i vetëm të mjaftojë për një numër shumëfish femrash sikurse shembulli i gjelit me pulat etj. Kjo në fakt është e vlefshme për shumë e shumë soje nga bota e gjallesave. Ajo që mund të thuhet është se midis dy sekseve ka balancim dhe mjaftueshmëri ashtu që meshkujt e secilës specie janë të mjaftueshëm për femrat. Një tjetër shembull është ai i bletës mbretëresh, ajo është një por që të fertilizohet është i nevojshëm një numër i madh meshkujsh, gjithsesi mjaftueshmëria është evidente edhe në rastin e bletës mbretëreshë me meshkujt që e fertilizojnë atë. Kështu pra, gjejmë se Allahu ka bërë të mundur të ketë një balancim midis meshkujve dhe femrave. Po brenda jetës në çift, gjejmë se Allahu ka bërë të mundur që ajo çfarë i nevojitet mashkullit gjendet e natyrizuar tek femra dhe gjithashtu çfarë i nevojitet femrës gjendet e natyrizuar tek mashkulli. Kjo gjë hedh dritë mbi faktin se Ai që bëri krijimin e çifteve është i Dijshëm

lidhur me nevojat reciproke midis tyre si dhe çfarë është e nevojshme për vazhdimësinë riprodhuese të sojit, Ai është i Gjithdijshëm dhe i Vetëdijshëm për numrin e meshkujve dhe numrin e femrave, gjë që shpjegohet nga vetë fakti se si Allahu mirëpërcaktoi numërin e tyre në total dhe bëri që midis dy sekseve të ketë balancim dhe mjaftueshmëri.

Një tjetër gjë që vlen të përmendet është fakti sesi -siç përmendet nga Edison dhe hulumtues të tjerë- pas luftërave ku numri i meshkujve pëson ulje drastike është gjetur se numri i bebeve meshkuj që lindin dominon mbi atë të femrave, gjë me të cilën Krijuesi bën kompensimin dhe balancimin meshkuj-femra. Kush është Ai që e bëri dhe rregulloi të tillë balancim?! S'ka dyshim se Ai është Allahu i Lavdishëm dhe Lartmadhëruar.

Një tjetër meditim ku ftohet njeriu është ai sesi Allahu i krijon dhe përgatit embrionet e gjallesave në një ambient të caktuar që ato më pas të jetojnë në një tejtër ambient. Medito rreth farës që gjendet e varur sipër në pemë, ajo vërtet gjendet atje lartë por ajo posedon në vetvete një embrion ku gjendet pjesëza e rrënjës që kur fara mbillet do të futet thellë në tokë duke u zhytur thellë e më thellë në dheun e tokës. Kush është Ai që pjesëzën e rrënjës së farës e krijoi në farën e varur në lartësitë e pemës?! Medito rreth fetusit njerëzor që teksa në mitër nuk gjendet ajër dhe nuk shkëmbehet frymëmarrje ky fetus krijohet dhe pajiset me aparatin e frymëmarrjes. Në këtë vend tepër të ngushtë pa hapësirë të mjaftueshme për të vepruar fetusit njerëzor i krijohen gjithashtu dy duart dhe dy këmbët, i krijohet aparati i tretjes teksa fetusi nuk han gjë aty brenda e të ketë nevojë për këtë aparat. Krijuesi e përgatiti çdo fetus me atë që do t'i nevijitet, shqiponjën për shembull, teksa ende gjendet në vezë e pajisi me dy flatrat që më pas do zhvillohen e do jenë dy krahët e mëdhenj të saj me të cilët do çaj qiellin. Ndërsa gjarpërin teksa gjendet ende në vezë e pajisi me vertebrat që do t'i duhen që të zvarritet mbi tokë. Po kështu edhe peshqit në vezët e tyre Allahu i pajisi me krahët e tyre specifik pasi Ai e dinte se ato do të jetojnë në një tjetër ambient, që është deti. Medito gjithashtu nënat e gjallesave, medito rreth ndjeshmërisë dhe mëshirës me të cilën ato sillen gjithmonë karshi të vëgjëlve të tyre. Kush ua dha atyre këtë mëshirë dhe dashuri që posedojnë?! A mos ishte natyra, porse a posedon natyra ndjenja dhe emocione?! Apo gjithësa në fjalë ka ardhur falë përcaktimit dhe vullnetit të të Urtit, të Gjithdijshmit?!

Medito rreth gjallesave që jetojnë në komunitete dhe bashkësi sikurse bletët apo milingonat dhe sesa përsosmërisht merren vesh midis tyre! Kush ua mësoi atyre të tillë komunikim, sesi të mirren vesh midis tyre?! Kush i pajisi ato me atë çfarë u nevojitet lidhur me sa në fjalë?!

Medito lidhur me këto gjallesa sesi ato instiktivisht e ruajnë veten nga rreziqet herë duke marrë aratinë, herë duke u fshehur, herë duke u maskuar ashtu që marrin ngjyrën e ambientit ku ndodhen, ose duke fluturuar, ose duke u strehuar thellë në të çarat e thella të tokës… Disa krijesa si breshkat pët t'u mbrojtur kanë ato guaskat e forta, ndërsa disa pemë kanë një llojë membrane mbrojtëse përreth rrënjëve të tyra. I

Lavdishëm është Allahu, Udhëzuesi, i Urti, Furnizuesi, i Gjithdijshmi që ua krijoi jetën këtyre qenieve të gjalla. Të gjitha krijesat janë dëshmi e gjallë e përcaktimit të Tij, perfektshmërisë së Tij, planifikimit të Tij, aftësisë së Tij, mëshirës së Tij, mirësisë dhe fisnikërisë së Tij, që në vetvete dëshmojnë për lavdinë dhe lartmadhërinë e Tij. Të gjitha gjallesat dëshmojnë njëzëri për diturinë e Tij të përsosur, për mëshirën e Tij, fuqinë e Tij absolute, bujarinë e Tij, mirësinë e Tij, aftësinë e Tij të pafund, i Lavdishëm dhe Lartmadhëruar është Ai.

Edhe ne përkrah mbarë gjallesave dëshmojmë se Zoti ynë është i Urti, i Gjithdijshmi, Furnizuesi, Shpikësi, i Përsosuri, Formëdhënësi, i Vetmi dhe i Pashoqi, nuk ka perëndi përveç Tij, është Ai i Vetmi që meriton të adhurohet dhe Ai është i Vetmi të Cilit na takon t'i bindemi.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Të provuarit dhe të pamurit (22)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Allahu ka krijuar tek ne mekanizma perfekt për të përfituar diturinë, dëgjimin, shikimin, logjikimin. Ai gjithashtu na ka urdhëruar të mendojmë, të shikojmë, konkludojmë dhe njohim Zotin tonë nisur nga gjurmët e Tij Hyjnore që kanë mbushur anekënd universin rreth e rrotull nesh. Pastaj përmes një metode praktike Ai na prezanton me Vetveten e Tij. Kjo metodë praktike njohje e Allahut erdhi në përgjigje të pyetjeve që bënë shokët e Profetit, sahabët -Allahu qoftë i kënaqur me ta-, të cilët i thanë Profetit: O i Dërguar i Allahut, Zoti ynë a është afër e t'i flasim me zë të ulët apo është largë e t'i flasim me zë të lartë?!, gjë lidhur me të cilën nuk vonoi dhe erdhi përgjigjja hyjnore: "Nëse robtë e Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes së lutësit kur më lutet. Le të më përgjigjet edhe ai Mua (në çfarë i kam obliguar) dhe le të më besojë Mua ashtu që të jenë prej të udhëzuarve."

Shkencat moderne janë ngritur mbi principin "eksperimentim dhe vrojtim-të provuarit dhe të pamurit". Njeriu fillimisht bën eksperimentin, vrojton rezultatet e tij dhe pas kësaj nxjerr faktin shkencor. Këtë e kanë konsideruar argumentimin më të arrirë ku mbështetet njeriu për të fituar dituri.

Ne muslimanët në kapitullin e besimit posedojmë argumentimin praktik që është i njohur për besimtarët dhe njerëzit e ndershëm dhe është i njohur për çdo person që është udhëzuar përkah Zoti i tij i Lavdishëm dhe Madhërishëm. Njeriu i varfër, i dobët, nevojtar, i sëmurë, i frikësuar etj, strehohet tek Zoti i tij i Lavdishëm dhe Madhërishëm, Atij i lutet, Atij i kërkon ndihmë. Shumë prej atyre që i luten Zotit marrin përgjigje për lutjet e tyre edhe nëse ndodh që lutja të vonohet, ndërkaq nëse përgjigja hyjnore ndaj lutjes vonohet kjo i kthehet ndonjë arsyeje të mundshme. Por realitet është se shumë prej atyre që i janë lutur Allahut kanë marrë përgjigje për lutjen e tyre.

Dera e lutjes është një derë e hapur, e gjerë, tek e cila mund të strehohet çdokush nga ne, t'a përjetojë personalisht dhe t'a bëjë provë. Ne jemi nevojtar ndërsa Allahu është Dhuruesi, Bujari, i Lavdishëm është Ai. Këtë gjë Allahu e ka bërë për të qenë argument për njohjen e Tij. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar ka thënë: "E kush si Ai-Allahu i përgjigjet nevojtarit (të mjerit) kur i lutet, duke ia larguar të keqen dhe juve ju bën mbizotërues të tokës. A ka zot tjetër përveç Allahut?!..."

Prej rrugëve tona përmes të cilave ne mund t'a njohim Allahun e Lavdishëm dhe Madhërishëm është të shohim përgjigjen që i jep Allahu lutjes që i bëjnë Atij njerëzit në

shtrëngesë dhe nevojtarët të cilët strehohen tek Ai përmes lutjeve të tyre, e lusin dhe i kërkojnë Atij ndihmë.

Do ju paraqes disa dëshmi dhe prova të cilat i kam marrë direkt nga personat të cilëve u kanë ndodhur si dhe ca të tjera të cilat unë i kam dëshmuar vetë.

Thirrësi i shquar i sotëm që ka qenë një prej këngëtarëve më të shquar anglez i njohur me emrin Cat Stevens asokohe ndërsa tani me emrin Jusuf Islam, e takova dhe e pyeta se isha kurioz t'a dija se si kishte hyrë në Islam?

"M'u përgjigj, isha duke notuar dhe u largova vërtetë larg nga bregu dhe ndjeva një lodhje të madhe muskulare që më bëri të ndihesha se nuk do mundja të vazhdoja të notoja më. Ndërkaq e hodha vështrimin për nga bregu i largët. E kush do t'a dëgjonte zërin tim?! Kush do më shpëtonte?! U binda se ky ishte fundi. Por m'u kujtua Zoti dhe në këtë moment u përmenda dhe ndjeva se unë e kam një Krijues që më ka krijuar. Ia drejtova Atij lutjen time duke i thënë: O Zot, po më shpëtove, pjesën tjetër të jetës do t'a shkoj në ndjekje të fesë tënde të vërtetë. Asokohe në fakt isha në kërkim të fesë së vërtetë por as që e çoja nëpërmend se ajo ishte feja islame, kjo nisur nga gjendja kritike e muslimanëve në vendet tona. Sapo mbarova lutjen time, kur ja, më erdhi një dallgë që më mori e nxorri drejt e në breg. Kështu dola nga deti. Më pas harrova çfarë më ndodhi. Harrova lutjen time dhe se çfarë i thashë Zotit tim. Pas një viti u sëmura dhe në një vizitë që më bëri im vëlla më solli komentimin e Kuranit në anglisht, duke e zgjedhur atë si një dhuratë nga Orienti, të cilën e kishte blerë në Kuds (Kryeqytetin e Palestinës) kur kishte qenë atje. Vendosa t'a lexoj dhe kështu bëra. Direkt nga leximi që i bëra Kuranit mësova se kjo është feja e vërtetë. Kështu u futa në fenë e Allahut të Lavdishëm dhe Madhërishëm."

Po, Allahu i Lavdishëm dhe Madhërishëm i përgjigjet lutjes së njeriut në nevojë dhe i përgjigjet lutjes që bën lutësi i sinqertë që strehohet tek Ai. Por kjo s'do të thotë që të biem në një gabim kuptimor lidhur me çështjen e lutjes ashtu që dikush të mendojë që mjafton të ulesh në vend e të lutesh o Zot o Zot pa u munduar fare dhe pa zbatuar shkaqet, dhe të të zbresë gjithë sa kërkon. Jo, Allahu na ruajtë, ky mendim është i gabuar.

Që tema në fjalë lidhur me lutjen drejtuar Allahut të Lartmadhëruar të bëhet më e qartë, le të japim një shembull përafrues me një qeveri. Kemi një qeveri që ka rregullat, ligjet dhe mbështetësit e saj të cilët punojnë për konsolidimin e ligjeve dhe rregullave të saj. Japin maksimumin në mbrojtje të qeverisë dhe ligjeve të saj. Vetë ata i binden ligjeve të qeverisë dhe nuk bien ndesh me to. Por disa individëve prej këtyre në fjalë ndodh që të gjenden në pozita dhe situata shtrënguese në të cilat pikërisht për arsye të angazhimit të tyre proqeveritar ata përfitojnë privilegjime. Kështu për shembull nëse dikush prej tyre sëmuret origjina është që ai duhet të shkoj në spital të vizitohet, por për shkak të afrimitetit që ai gëzon në qeveri ai ua qan hallin atyre dhe ata e dërgojnë doktorin tek ai

në shtëpi në vend që ai të shkonte tek doktori. Ky është një privilegjim që bëhet për aktivistët pro qeverisë, mbështetësit, të afërmit dhe rrethin e ngushtë të kësaj qeverie.

Për Allahun është shembulli më i lartë. Allahu këtë univers e bëri me ligje, shkaqe dhe pasoja, dhe muslimanët veprojnë pro këtyre ligjeve duke e adhuruar Allahun sipas ligjeve që Ai ka vendosur si dhe angazhohen të ecin pro rregullave të Allahut dhe përcaktimeve të Tij mbi bazën e të cilave Ai planifikoi dhe bëri çdo gjë në këtë univers. Por ndodh që muslimani të gjendet në pozita dhe situata shtrënguese, si për shembull të ketë një nevojë urgjente materiale apo shëndetësore, mund të jetë në rrezik prej ndonjë armiku etj. Pikërisht në këto raste muslimani strehohet tek Allahu i Cili reflekton më së miri karshi dobësisë së robit të vet dhe e di se robi i tij nuk mund të bëjë gjë prej gjëje në situatën e ndodhur, porse nisur nga pozicioni që ky rob ka tek Allahu i Lavdishëm dhe Madhërishëm atij i vjen fitorja, i vjen mbrojtja hyjnore, i vjen shërmi për sëmundjen që i ka rënë, i vjen pra zgjidhja për pozitën e vështirë dhe shtrëngesën ku gjendet.

Kjo është një gjë në shembullin priviligjues…

Gjëja tjetër është për shembull se mund të ndodhë që në një zonë të caktuar energjia elektrike mund të ndërpritet dhe pësoj defekt. Ose mund të ndodhë të prishen linjat që sjellin ujin teksa dihet se uji është gjëja bazë pa të cilin njeriu dorëzohet dhe kapitullon. Personat në fjalë marrin kontakt me qeverinë dhe qeveria u dërgon energji (me gjeneratorë) apo ujë kudo që të ndodhen… Për Allahun është shembulli më i lartë…

Kështu kur thatësira pllakos dhe nuk bie shi, e tillë gjë do të thotë vdekje dhe mbarim për bimët dhe gjallesat. Askush nuk mund të bëj të bjerë shi. Në të tilla raste muslimanët strehohen tek Zoti i tyre duke iu lutur o Zoti ynë… Me këtë rast falin namazin për rënien e shiut, strehohen tek Allahu duke iu falur Atij dhe nëse Allahu sheh nga ata sinqeritet dhe pendim u jep atë që i kërkuan duke iu përgjigjur lutjes së tyre.

Lidhur me sa në fjalë ka shembuj vërtetë mbreslënës që janë bërë shumë popullorë në zonat dhe ndër njerëzit ku kanë ndodhur dhe ka të tillë që janë bërë të famshëm edhe në shumë vende islame. Unë do të përmend disa nga këto shembuj:

Bëhet fjalë për në Turqi, në Stamboll. Qyteti i Stambollit asokohe u prek nga një thatësirë e madhe teksa Stambolli pat qenë i njohur për rezervuarët e mëdha ujorë. Në rezervuarët e ujitjes mbeti aq pak ujë saqë një person mund të ujiste një deri maksimumi dy herë në muaj. U mbyllën lavazhet e makinave duke qenë se larja e tyre me ujë u ndalua. Asokohe kryebashkiak i Stambollit ishte një person që kish dalë nga një shkollë fetare islame. U kujtua se rruga për të dalë nga situata në fjalë ishte që njerëzit të dilnin të falnin namazin për rënien e shiut. E bëri publike një gjë të tillë ku do dilnin gjithë së bashku të falnin namazin për rënien e shiut. Imami i xhamisë "Fatih" shejkh Emin Siraxhi, i cili e pat përjetuar vetë këtë ngjarje, është ai që m'a ka treguar me gojën e tij këtë histori. Kjo ngjarje nuk ka shumë kohë që ka ngjarë dhe shejkh Emin Siraxhi është ende gjallë. Pas publikimit të sa në fjalë gazetat laike filluan të talleshin me

kryebashkiakun dhe njerëzit fetar duke u thënë se do kishte qenë më mirë të kishit sjellur një grup specialistësh të produktonin shi artificial e jo këto gjëra metafizike që po thoni. Po më thoshte shejkh Siraxhi, u vendosëm para një sfide të dytë e cila u bë më primare për ne, sfida se si t'i pushonim këto gojë provokatore që po cënonin dhe ngacmonin çështjen e besimit. Dhe erdhi dita kur do dilnim për të kërkuar shi. Dolëm duke i kërkuar Allahut të na i zbardhte fytyrat dhe të na ndihmonte. Menjëherë pasi dolëm për namazin e rënies së shiut Allahu zbriti shi ditën e nesërme dhe ky lajm u përhap anekënd përmes gazetave. Lajmi u përhap midis njerëzve në Turqi saqë ata filluan të thoni ky është shiu i Kryebashkiakut, duke e nënkuptuar kështu pasi përndryshe ai është shiu i Zotit të botërave. Gjithë Turqia foli lidhur me këtë shi që erdhi pas faljes së namazit për rënien e shiut.

Një tjetër rast është ai i Etiopisë, në ditët e fundit të Mengistu Hilae Mariam, pushtetarit komunist. Asokohe Afrika u prek nga një thatësirë e paparë. Midis shteteve që u prekën nga kjo thatësirë ishte edhe shteti i Etiopisë. Të krishterët shkuan tek qeveria komuniste dhe u thanë: Duket se jemi në rrezik të madh, rrezikohemi të vdesim. Na lejoni t'i lutemi Zotit dhe të falemi që Zoti të zbresë shi. Pas kësaj udhëheqësi komunist u dha atyre leje për një gjë të tillë. U falën të krishterët në kishat e tyre por shiu nuk ra. Me këtë rast komunistët u tallën me të krishterët që qenë lutur dhe falur për të rënë shi duke kryer veprime metafizike, sikurse shpreheshin komunistët.

Pas kësaj sheikh Abdullahut, imamit të Xhamisë së Madhe të Adis Ababas, i cili konsiderohej i pari i muslimanëve, i shkuan disa muslimanë dhe i thane, pse të mos i ftoshë muslimanët të dalin të falin namzin për rënien e shiut. E kam takuar vetë sheikh Abdullahun pas kësaj ngjarje. Ai vetë më tregon dhe më thotë se në vazhdim të kësaj morra guximin dhe kërkova prej muslimanëve të pendoheshin tek Allahu, t'i kërkonin falje, të shtonin adhurimet e vullnetëshme si agjërimin, sadakanë, si dhe të eliminonin mëritë dhe urrejtjet midis tyre dhe në ditën e caktuar të dilnim me shpirtra të drejtuar për nga Allahu i Lavdishëm dhe Madhërishëm. Dita dhe momenti erdhi dhe komunistët prisnin të thumbonin muslimanët ashtu siç qenë tallur me të krishterët që patën dalur të luteshin për shi. Kështu dolën muslimanët të faleshin për rënie shiu dhe shiu - menjëherë pasi u falëm- zbriti në të gjithë zonat nga ku ishin muslimanët e Etiopisë që dolën të faleshin për rënien e shiut. Njerëzit thonin ky është shiu i muslimanëve, ky është shiu i muslimanëve. Kjo gjë u përhap anekënd Etiopisë. Vetë sheikh Abdullahu më tha se ky shi pat qenë shi për tokën dhe për zemrat ashtu që i forcoi zemrat e të rinjve tanë duke u ngjallur atyre shpresën tek Allahu i Lavdishëm dhe Madhërishëm dhe shtuar besueshmërinë dhe besimin.

Një tjetër rast është ai të cilin m'a ka treguar gojarisht sheikhu i Ez'herit në Egjipt, sheikhu i nderuar Xhedul Hak. Më tha se Kryetari i Bashkisë së Sinasë i ishte ankuar për thatësirën që kish pllakosur atje. Tha, u thashë falni namazin për rënien e shiut, thirrini njerëzit të falin namazin për rënien e shiut. Kështu veproi Kryetari, i mblodhi njerëzit, solli imamllarët fetarë të zonës dhe e falën namazin për rënien e shiut. Shpejt shiu zbriti

dhe vazhdoi të bjerë pandalim për shumë kohë. Kryetari u lidh me mua dhe më tha, o shejkh shiu sa mund bie dhe është rënduar… Shejkhu i Ez'herit tha, e kështillova atë të falenderojnë Allahun dhe t'i luten t'a spostojë shiun majave dhe shkretinave.

Sa më sipër, janë gjëra të cilat janë bërë të famshme dhe për të cilat vetë popujt janë dëshmitarë okularë përgjatë viteve. Të shpeshta kanë qenë raste kur ne vetë jemi bërë dësmitarë sesi në Qabe apo tjetër vend, pas thatësirave muslimanët kanë dalë dhe i janë falur dhe lutur Allahut t'u zbresë shi dhe Allahu ua ka zbritur atyre shiun. Mua vetë më ka ndodhur shumë herë që të kem qenë një ndër ata që kanë falur në Qabe namazin për rënien e shiut dhe kemi dëshmuar përgjigjen e Allahut të Lavdishëm dhe Madhërishëm.

Një herë, tani po bëj fjalë për një ngjarje që e kam përjetuar unë vetë dhe që unë personalisht jam personazh i kësaj historie, qemë për vizitë në një zonë në Jemen që quhet Jefia që bie në rajonet jugore, dhe kjo ka ndodhur pas bashkimit të Jemenit të Veriut me atë të Jugut. Përshtypjet që banorët e këtyre zonave gëzonin për dijetarët muslimanë dhe fetarët në përgjithësi ishin jotëmira, ishin të shpërfytyruara. Në këtë situatë unë shkova të bëjë një sensibilizim fetar ku fola rreth argumenteve të Allahut, aftësive të Allahut dhe shenjave të ekzistencës së Tij, ku u përmenda atë që u përmenda dhe së fundmi u përmenda atyre se Allahu është Gjithdëgjues, i Pranishëm dhe është Ai i Cili i përgjigjet lutësit që i lutet Atij. Në fundin e ligjëratës nja nga të pranishmit më dërgoi një shkresë ku më thoshte, o sheikh shikoji bimët tona që janë varur dhe bimët e kafesë që pothuajse janë tharë, a nuk po falë me ne namazin për rënien e shiut? Unë në fakt u stepa pasi kisha frikë se nuk do isha i denjë që Allahu t'a pranonte lutjen dhe të bëhej e tillë gjë shkak përçarje për ta. Saqë pas ca kohësh më erdhën fjalët sesi njëri prej të pranishmëve kishte thënë se nëse Allahu do zbresë shi unë do falem që sot. Me këtë shkresë që me erdhi fillova të tubojë ndërmend madhështinë e Zotit tim, solla ndërmend Zotin, Krijuesin tim, mëshirën dhe përkujdësin e Tij, bujarinë e Tij, ndërkohë që na duhej të largoheshim shpejt për disa arsye tonat. Përfundimisht u thashë unë po lutem dhe ju thoni amin-përgjigju o Zot. Ekzaktësisht zona ku ndodheshim ishte Jear, në bashkinë e Jefias. Kështu e luta Allahun teksa ata të gjithë bënin amin dhe pastaj lëvizëm dhe u nisëm për në objektivin tjetër që kishim. Sapo u ngjitëm nga lugina në rrugën në kreshtën malore ndjemë të binin pikat e shiut. Në fakt edhe kur u larguam nga zona në fjalë në udhë e sipër unë e lusja Allahun me insistim që të mos na ulte në sytë e banorëve të zonës në fjalë dhe që lutjen tonë t'a bënte shkak për zbritjen e shiut. Sapo ndjemë pikat e shiut të binin mbi makinë kryetari komunës që ishte me ne u kthye nga Jeari dhe kur pa andej u kthye duke na thënë, në Jear po bie shi. Ndalëm makinat dhe dolëm. Pamë sesi shiu po binte në Jear. Pashë orën dhe gjeta se koha midis lutjes për të rënë shi dhe përgjigjes që e pamë me sytë tanë tanimë por që në fakt kish filluar të binte më parë nga ç'e pamë ne, ishte një orë e njëçerek deri një orë e gjysëm. Me këtë rast e falenderuam Allahun së tepërmi. Në ditën tjetër në kthim kur mbajtëm asaj rruge pamë gjurmët e shiut dhe rrëkesë që ai kish shkaktuar pikërisht në këtë zonë. Njerëzit kur na panë na përshëndetën të gëzuar dhe me dashamirësi.

Pra Allahu është pranë, është Gjithdëgjues. Ai është pranë, i përgjigjet lutjeve të lutësve. Kjo jo vetëm duke zbritur shi, porse në çdo gjë. Vetë Allahu na e ka bërë me dije një gjë të tillë duke na treguar në Kuran se: "E kush si Ai-Allahu i përgjigjet nevojtarit (të mjerit) kur i lutet, duke ia larguar të keqen dhe juve ju bën mbizotërues të tokës?!"

Një herë në Universitetin e Imanit këtu në Jemen, më erdhi një student spanjoll i cili pasi kishte pranuar islamin kishte ardhur të mësontë çështjet e fesë, kur befasisht i del se i biri foshnje vuante nga kanceri në laring i cili kishte evoluar ashtu që i vogli as mund të hante e as mund të pinte, teksa trupi i tij kish filluar të tretej. Kjo i kish shqetësuar dhe pikëlluar së tepërmi dy prindërit e të voglit. Studenti spanjoll më tha, tani më duhet të kthehem në Spanjë sërisht, dhe nga sytë i rridhnin lotët çurg për shkak të gjendjes mjerane në të cilën kishte arritur i vogli i tij. I thashë, dëgjo, nëse doktorët janë të paaftë të bëjnë gjë lidhur me sa në fjalë, Allahu është i Aftë të bëjë çdo gjë. Porosia imë për ty është të ngrihesh në një të tretën e fundit të natës, të marrësh abdes, të falesh i ndrojtur dhe i frikësuar, dhe kur të arrish gjendjen e ndrojtjes dhe frikës më kulminante duke qenë në sexhde lute Allahun t'a shëroj të sëmurin tuaj dhe t'ia largojë atij sëmundjen në fjalë. Pastaj lexoje Fatihanë tre herë, kaptinën Ikhlas tre herë, Felekun dhe Nasin tre herë, Ajetin Kursi tre herë, duke pështyrë lehtazi pëllëmbët e bashkuara dhe me to fërkoje laringun e sëmurë të të sëmurit tënd…

Pas dy ditësh e pashë teksa fytyra i shndërriste nga gëzimi. I thashë hë si është puna? Tha falenderoj Allahun. I thashë si është fëmija? Tha është mirë shyqyr Zotit. Pasiqë më the të falem natën (bëra gjithësa më the dhe) me të ardhë sabahu filloi të pijë e të hajë. I thashë, a e dërgove te doktori. Më tha po, e dërgova te doktori dhe ai më tha, ç'i kë bërë, kush ia eliminoi sëmundjen që kishte?! Tha, ia tregova doktorit si qëndronte puna. Falenderimet i takojnë Allahut të Lavdishëm dhe Madhërishëm .

Një herë tjetër, bëhet fjalë para dy vjetësh, u sëmurë një prej kryepleqve të fiseve tek ne, emri i tij është sheikh Muhamed Abdullah Bedru Din që është gjallë sot e kësaj dite që flasim, ishte sëmurë rëndë nga veshkat. Unë me disa të tjerë shkuam t'i bëjmë një vizitë. Kishim me vete persona që i mendonim (me lejen e Allahut) të përkushtuar dhe lutjeve të të cilëve shpresonim që Allahu do t'u përgjigjej. E gjetëm të shtrirë. Që prej dhjetë ditësh, ditë këto që i takonin Ramazanit, sëmundja e kishte rënduar aq sa ai nuk po mundej të agjëronte, madje nuk ishte në gjendje që të ngrihej dhe mirrte abdes prandaj merrte tejemum. Vëllezërit e pranishëm bënë dua për të. Ne e vizituam atë për iqindi (mbasdite) dy tre orë para saj dhe qe pikërisht koha e akshamit kur ai erdhi të falej me ne në xhami. Kjo i takoi ditës së premte, ndërsa ditën e shtunë erdhi në Sana shëndoshë e mirë. I thanë çfarë ngjau me ty? Tha falenderuar qoftë Allahu, guri që pata në veshka doli i copëzuar.

Betohem në Allah sa e sa ngjarje si kjo e edhe më të arrira se këto kam dhe keni dëgjuar.

Ajo që dua të them është, i drejtohem atij person që është i vetëdijshëm karshi mirësisë së madhe që ka përftuar prej Allahut të trajtës së lartpërmendur, këtë mirësi të Allahut

që i ka ardhur pasi i është lutur Allahut, t'ua tregojë vëllezërve të tij besimtar pasi e tillë gjë hynë tek proklamimi i mirësive të Allahut dhe nëse ka frikë të bjerë në syefaqësi mos t'a adresojë historinë që tregon tek vetja e tij por për shembull të thotë kam parë një person i cili e luti Allahun dhe Allahu i zbriti shërimin... Thotë Allahu i Lartësuar: "...Kujtoni mirësinë e Allahut mbi ju..." Dhe thotë: "Proklamoje mirësinë e Zotit tënd."

Disa njerëz mund të mendojnë se sa në fjalë nuk është një realitet porse ajo që dihet është se e tillë gjë është një realitet i pakontestueshëm, pasiqë Allahu nuk na krijoi dhe braktisi. E tillë gjë është (blasfemi) sikurse thonë ca filozof që shprehen se Allahu po, e krijoi ekzistencën, por pas kësaj e braktisi atë dhe që prej asaj kohe universi funksionon në mënyrë automatike. Jo për Allahun, Allahu është i Gjalli, Vetekzistuesi, Ai kontrollon çdo gjë qoftë më e vogla apo më gjigandja në këtë univers. Është Allahu Ai që përkujdeset për robtë e Tij dhe për mbarë këtë univers dhe çështja e Tij është e tillë që asgjë nuk e preokupon Atë kundrejt dominimit dhe sundimit të universit si dhe asgjë nuk e privon dhe pengon Atë karshi asaj çfarë Ai do. I Lavdishëm dhe Lartmadhëruar është Ai. Ai është vazhdimisht me ne. Në këtë moment kur po flasim Ai na shikon, na dëgjon, i Lavdishëm dhe Madhërishëm është Ai. Ai natyrisht e dëgjon lutjen e nevojtarit që i lutet Atij, e dëgjon lutjen e lutësit të sinqert që i lutet Atij. Ky e lut në një gjuhë të ndryshme e ky në një tjetër gjuhë, teksa Allahu i njeh të gjithë gjuhët dhe i dallon të gjitha timbrat zanorë, i përgjigjet gjithsecilit për lutjen specifike të tij. Nëse Ai çdo lutësi do t'i ishte përgjigjur për lutjen e tij që bën, e tillë gjë nuk do zbriste nga sundimi dhe dominimi i Tij asgjë, i Lavdishëm dhe Madhërishëm është Ai.

Allahu është i Plotfuqishëm ndërsa ne jemi të dobët, Allahu është Gjithdominuesi dhe ne jemi të varfër, Allahu është Udhëzuesi e ne mund të devijojmë. Nevoja jonë për Allahun është e paevitueshme. Allahu është Gjithdhënësi e ne jemi nevojtarë, Allahu i Lavdishëm dhe Madhërishëm është Ai që shëron dhe ne jemi krijesa që sëmuremi, Allahu është Ai që jep dhe nuk mban kur robtë strehohen tek Ai me lutjet e tyer, i Lavdishëm dhe Madhërishëm është Ai. Le ta përforcojmë lidhjen tonë me Zotin tonë. Gjithkush dëshiron të bindet për sa në fjalë le të pyes adhurimtarët e përkushtuar dhe të lidhur me Allahun e Lartmadhëruar, të cilët e lusin Allahun e Lartmadhëruar.

Shumë njerëz mund të pyesin se përse gjejmë që disa njerëz të zakonshëm janë me besim më të fuqishëm se disa filozofë dhe se disa e disa? Themi besimi i tyre është më i fuqishëm pasi ata e shohin me sytë e tyre ndikimin e lutjes, e shohin me sytë e tyre përgjigjen që me caktimin e Allahut u vjen aty ku ndodhen dhe në përputhje me nevojën specifike të tyre.

Nëse duam të jemi prej personave lutjet e të cilëve marrin përgjigje duhet të jemi korrekt me të drejtat e të tjerëve, të urdhërojmë në të mirë, të ndalojmë nga e keqja, ushqimi dhe të pimurit tonë të jetë në rregull, të vishemi në rregull...

Duam që Allahu t'u përgjigjet lutjeve tona?!, atëherë na del detyrë t'i përgjigjemi urdhëresave dhe udhëzimeve të Tij, po dëshëm që edhe Ai të na përgjigjet ne...

Në fund të fundit ti do jesh përfituesi, ti je nevojtari ndërsa Ai është Gjithdhururesi, ti je i varfëri ndërsa Ai është Gjithsunduesi, ti je nevojtar për Allahun, përforcoji pra lidhjet e tua me Allahun, afroju pra Allahut të Lartmadhëruar së pari me obilgimet që të ka obliguar dhe pastaj me adhurimet vullnetare, që Allahu të të dojë. Dëlirësohu kur t'i lutesh Atij, lutju me gjithë zemër, mos e lut duke qenë i preokupuar me diçka tjetër. Lutjen tënde filloje duke e falenderuar dhe lavdëruar Allahun, duke rënë në salavat dhe duke paqëtuar Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- dhe po kështu lutjen tënde përfundoje duke e falenderuar dhe lavdëruar Allahun dhe duke rënë në salavat dhe paqëtuar Profetin Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-.

Po qe se tregohesh koshient para Allahut për gjynahet e tua dhe i kërkon Atij të të falë, e tillë gjë është ndikuese që Ai t'i përgjigjet lutjes tënde. Ki bindjen e pakontestueshme se Allahu do të përgjigjet si dhe insisto në të luturin e Allahut të Lavdishëm dhe Madhërishëm, pasi Allahu është Ai i cili nuk zhgënjen askënd, i Lavdishëm dhe Madhërishëm është Ai.

Mos u ngut, mos thuaj po unë bëra lutje e lutja ime nuk mori përgjigje. Zërin tënd kur të lutesh ngrije midis psherëtimës dhe ngritjes, mos e ulë aq sa të jetë i padëgjueshëm dhe mos e ngri shumë atë.

Gjithashtu shfrytëzoi kohët specifike kur bën lutje, prej të cilave përmendim: natën e Kadrit; një të tretën e fundit të natës në të cilin Allahu zbret -ashtu siç i takon hyjnisë së Tij- në qiellin e dynjasë për t'u zgjidhur hallet robëve të Tij që i qajnë hallet, për t'iu përgjigjur lutjes së lutësve, për të kryer nevojat e nevojtarëve që i luten. Sa e sa prej adhurimtarëve dhe njerëzve të mirë e kanë dëshmuar të tillë gjë, janë ngritur natën dhe i janë falur dhe lutur Allahut dhe kanë parë ndikimin e lutjeve të tyre në ditën në vazhdim, falenderuar qoftë Allahu, Zoti i botërave. Gjithashtu nga kohët kur lutja merr përgjigje është ajo midis ezani dhe ikametit, teksa dëgjohet ezani, kur zbret shiu; të gjitha këto dhe të tjera veç këtyre janë kohët kur lutja merr përgjigje, hetoi këto kohë. E prej të tillave është edhe momenti i konfrontimit luftarak në Xhihad; një moment kohor i ditës së Xhuma (të Premte) lidhur me të cilin dijetarët i kanë dhënë epërsi mendimit se bëhet fjalë për periudhën e fundit kohore të ditës së premte. Lutje që merr përgjigje është edhe ajo e bërë përgjatë muajit të bekuar të Ramazanit, lutja në udhëtim, lutja kur je agjërueshëm dhe çelë agjërimin, lutja në Arafat.

Në të gjithë rastet që përmendëm njeriu është më pranë që lutja e tij të marrë përgjigje prej Allahut të Lavdishëm dhe Madhërishëm, por gjithsesi këto lutje që të marrin përgjigje janë të nevojshme për dëlirësi dhe sinqeritet.

S'ka dyshim se Allahu është me ne, gjë lidhur me të cilën Allahu thotë: "A nuk e di se Allahu din gjithësa gjendet në qiej dhe në tokë?! Nuk bëhet bisedë e fshehtë midis tre vetave e të mos jetë Ai i katërti; e as midis pesë vetave e të mos jetë Ai i gjashti, e as midis më pak vetave dhe as midis më shumë vetave, e të mos jetë Ai me ta, kudo që të

jenë…" Pra Allahu është me ta kudo që të jenë, kudo që të jemi Allahu na dëgjon dhe shikon.

Kur Allahu urdhëroi të nderuarin tonë Musain dhe Harunin të shkonin tek Faraoni që të dy ata shprehën frikën e tyre se Faraoni do të ushtronte dhunë mbi ta, por përgjigja e Allahut erdhi sakaq: "Mos kini frikë! Unë jam me ju, dëgjoj dhe shikoj." Allahu është me ne, na dëgjon, na shikon dhe i di mirë nevojat tona. Le t'i afrohemi Atij dhe atëherë do të shikosh me sytë e tu përgjigjen e Zotit tënd duke parë kështu përgjigjen praktike të LA ILAHE IL ALLAH dhe do njohësh kështu madhështinë e Muhamedit, të Dërguarit të Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- i cili na orientoi ne drejt kësaj lidhje të çeliktë që lidh midis nesh dhe Krijuesit.

E lusim Allahun t'i përgjigjet lutjeve tona dhe të na bëjë prej robëve të tij të sinqertë.

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Toka (23)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Kurani Fisnik kur e përshkruan universin jep përshkrime edhe të fillesave të tij teksa jep përshkrime edhe për gjendjen në të cilën ai është. Pastaj bën fjalë për ardhmërinë e tij drejt së cilës ai shkon.

Gjithë sa në fjalë janë fusha ku mendimi njerëzor duhet të hulumtojë dhe meditojë, madje Allahu i Lartësuar dhe Lartmadhëruar na ka urdhëruar në Kuran duke na thënë: "Thuaj, udhëtoni në tokë dhe vështroni sesi filloi krijimi".

Njerëzit mendonin se toka është krijuar me kushtet aktuale që kemi gjetur në të. Ky ishte edhe mendimi i Aristotelit që u adoptua nga Kisha Katolike.

Me ardhjen e shekullit XVIII kur shkenca kishte arritur të ecte me hapa të shpejtë përpara, doli në pah se aktualiteti nuk është veçse produkt i së kaluarës dhe se në tokën tonë ka gjurmë që gjenden këtu e atje dhe ku ne mund të udhëtojmë për t'u njhur me ato shenja dhe gjurmë që do na shërbejnë t'i kemi si referencë për sekretet e së kaluarës që të arrijmë të bëjmë konkludime lidhur me hershmërinë e të kaluarës.

Kur ndodhi kjo gjë një luftë shpërtheu midis klerikëve të lartë të kishës dhe shkencëtarëve.

Në fakt në Kuran, Librin e Allahut të Lartësuar, puna ndryshon nga bindja që adoptoi kasha katolike.

Shkencat bashkëkohore kanë bërë hapa para në njohjen e realiteteve që kanë të bëjnë me fillesat e krijimit, sidomos krijimit të tokës dhe formacionit të saj gjeologjik. Pastaj pas një shtegtimi vërtetë të gjatë, pas posedimit të aparaturave shumë të sofistikuara dhe metodave moderne të studimit dhe hulumtimit shkencor, shkencëtarët arritën në konkludime përkatëse. Kur ja, këto konkludime ku shkencëtarët mundën të arrijnë vetëm pas rrugës së tyre të gjatë shkencore, i gjejmë të përmendura në Kuran, Librin e Allahut i Lavdishëm dhe i Lartmadhërishëm.

Të shikojmë çfarë thotë Kurani për fillimin e krijimit.

Allahu i Lartësuar thotë: "A nuk e shikojnë mosbesimtarët se qiejtë dhe toka kanë qenë një masë e vetme e Ne i ndamë. Dhe prej ujit bëmë çdo gjë të gjallë. A nuk po besojnë?!".

Çfarë komentimi i kanë dhënë thënies kuranore në fjalë dijetarët kompetentë të komentimit të Kuranit, dhe si e kuptuan ata këtë thënie kuranore?

Të shohim Ibn Abasin, Kateden, Dahakun, El Hasen, Ataun, Seid ibn Xhubejrin, Keabin… Që të gjithë këta komentues të Kuranit e kuptuan në kuptimin aparencial këtë thënie kuranore, thanë se sipas kësaj thënie kuranore qiejt dhe toka kanë qenë një masë, kanë qenë njësh dhe pastaj janë ndarë. Ky është komentimi që dhanë për thënien kuranore në fjalë këta komentues të shquar të Kuranit qysh para mëse 1400 vjetësh.

Pas një udhëtimi të gjatë, hulumtimi shkencor vjen të raportojë pikërisht atë që raportoi Kurani. Librat shkencor na sjellin foto nga hapësira kozmike që tregojnë rreth fillimit të krijimit. Në njërën prej tyre ilustrohet sesi fillesa ishte një tymnajë, pastaj ilustrohet sistemi diellor të jetë ndarë pikërisht nga tymnaja në fjalë, dhe pastaj nga dielli erdhi sistemi planetar me diellin në qendër dhe planetët rreth tij.

“A nuk e shikojnë mosbesimtarët se qiejtë dhe toka kanë qenë një masë e vetme e Ne i ndamë…?!”.

Ibn Kethiri për këtë thënie kuranore ka sjellur komentimin: “Ishin bashkarisht (qiejt dhe toka) të njësuar në njëri-tjetrin, të lidhur, të ngjitur, të stivosur njëri përmbi tjetrin në fillimin e çështjes dhe e ndau ktë nga kjo”.

Le të shikojmë shkencërisht cili është realiteti i origjinës nga e cila është shkëputur universi ynë me komponentët e tij.

Në një foto të publikuar nga Agjencia Hapësinore Amerikane NASA bëhet fjalë për yjet teksa krijohen. Yje që krijohen nga çfarë? Pikërisht nga një tymnajë kozmike që shkencëtarët e quajtën Nebulozë. Nga nebulozë nuk krijohet thjesht një yll i vetëm por nga aty krijohen galaktika.

Thotë Allahu i Lartësuar: “Pastaj qëndroi në qiell teksa ai ishte tymnajë dhe atij edhe tokës u tha: Do vini me hir apo me pahir? Ato thanë: Do vimë me hir”.

Gjejmë ende në ditët tona tymnajë nga ku formohen yjet, gjë e cila na tregon ne rreth fillesës së mëparëshme të formimit të sistemit tonë diellor.

Profesor Jeff Hester, i Universitetit të Arizonës, kreu i ekipit të ekspeditës hapësinore që shkëputi pamjet e mrekullueshme të nebulozave (tymnajave) nga hapësira, thotë:

Shkencëtarët lidhur me lindjen e yjeve kanë sjellë teori të cilat e meritonin të vlerësoheshin. Derisa arritëm të shkëpusim këto foto ndërhapësinore krejt të pazakonta që na befasojnë teksa na sjellin atë çfarë ndodh në kupolën kozmike.

E ka fjalën se ti ke mundësi që me sy të lirë të shohësh sesi formohen yjet nga kjo tymnajë kozmike.

Po pas ndarjes çfarë i ndodhi tokës? Ajo u shkëput nga një masiv i zjarrtë tymnajor i nebulozës. A ka patur toka cipë sipërfaqësore? Koreja e saj a kështu ka qenë në fillesat e saj?

Kurani tregon se korja e tokës nuk ka qenë në fillesat e saj porse më vonë ka dalë në skenë. Rreth këtij fakti ne argumentojmë përmes fjalës së Allahut të Lartësuar: "A nuk i shikojnë devet se si janë krijuar?! Edhe qiellin se si është lartuar?! Edhe malet se si janë tendosur?! Edhe tokën se si është shtresuar?!" Pra nuk ka qenë e shtresuar dhe është shtresuar më pas. Kurani na urdhëron dhe fton të meditojmë dhe vështrojmë në si-në e shtresimit të tokës.

Shkencat moderne dhe hulumtuesit kanë lëvizur në këtë linjë duke na sjellë sa e sa dëshmi nga dëshmitë e shumta që grumbulluan lidhur me faktin se si erdhi në skenë korja apo shtresa sipërfaqësore e tokës.

Për të folur lidhur me këtë do bazohemi tek librat dhe studimet shkencore prezente të disponueshme që flasin rreth fillesave të shtresëzimit të tokës dhe krijimit të kores së saj. Këto studime shkencore bëjnë me dije se toka në fillesat e saj pas shkëputjes ishte e shtresëzuar me një kore shumë të imët, gjë për të cilën studjuesit sjellin edhe ilustrime demonstrative. Mbi këtë kore të tokës binin sa e sa meteorë që shpërthenin në masivin e tokës ende të zjarrtë. Nga korja e tokës mund të gjurmohet zjarrmia e brendshme që shfaqet aty-këtu mbi cipën e hollë të kores së tokës.

Nëse një pjesë të tokës e ndajmë në diagonal si thelen e shalqinit do shohim brendinë e zjarrtë të tokës dhe koren e jashtme që ka filluar të ftohet. Do vëresh aty oxhaqe vullkanesh aktivë dhe një llavë dhe brendi aktive të barkut të tokës. Këto llava vullkanike dilnin herë pas here nga krateret vullkanike dhe binin mbi koren e tokës. Këto vullkane me gazrat që çlironin ishin produktuesit e shtresës atmosferike primitive të tokës dhe fillesave të ujësive e të maleve. Pastaj filluan të formohen retë që do zbrisnin shiun.

Kështu pra, studimet bashkëkohore shpalosin për ne se korja e tokës nuk ka qenë në formën e kontinenteve të trashëzuar, madje korja e tokës ishte shumë e hollë dhe kontinentet nuk ekzistonin. Kjo kore e brishtë shpejt u shpërbë dhe korja e trashë filloi të formohej nëpërmjet vullkaneve që dilnin duke hedhur hirin vullkanik dhe duke shpërndarë llavën. Këto vullkane aktivë llavëhedhës të gjendur pranë e pranë njëri-tjetrit qenë pikërisht ato që formuan koren e kontineteve të tokës.

Në ditët tona gjendet një vullkan aktiv të cilin shkencëtarët e kanë evidentuar si dëshmi të hershmërisë. Ky vullkan quhet vullkani i Kilaueas në ishullin me të njëjtin emër. Një pamje e kujdesshme e këtij vullkani nxjerr në pah sesi llava e tij që zbret nga krateri qetësisht në disa drejtime të ndryshme, ka formuar një kore hiri vullkanik nga hiri vullkanik i lëngëzuar që derdhet krahas llavës. Një shtrese e re koreje e shtresuar është formuar si pasojë e sa në fjalë në shtratin e ishullit të Kilauea.

Komentin për formimin e maleve shkencëtarët e shpjegojnë mbi baza shkencore me anën e vullkanëve fqinjë, pra malet patën qenë në fillesat e tyre vullkane që rrodhën nga brendia e tokës duke hedhur në ajër hirin dhe llavën e tyre që më pas u derdh dhe u shtri horizontalisht. Dhe në fakt luginat që shohim nuk janë veçse shtresa të formuara nga hiri i vullkaneve që rrodhi nga krateret vertikalë të vullkaneve dhe formoi luginat.

Sipas përshkrimit tepër ekzakt shkencor koreja e tokës është hedhur nga poshtë, ashtu që lënda vullkanike nga e cila u formua toka gjendej në barkun e tokës dhe prej aty poshtë u hodh me vrull për së larti. Pas kësaj ajo rrodhi dhe u shtresëzua duke formuar koren e tokës dhe më tej tabanin e oqeaneve. Gjatë këtij procesi krahas lëndës formuese të kores së tokës dolën nga barku i tokës dhe u hodhën me shfryrjet vullkanike edhe mineralet kristaloid të ujit si dhe shtresa atmosferike e tokës.

Nëse i ndjekim thëniet kuranore që bëjnë fjalë për fillesat e formimit të tokës dhe kontinenteve, i gjejmë ta përshkruajnë në detaje sa në fjalë. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "Dhe tokën ne e shtrimë…". Pra toka, korja e saj nuk ka qenë e shtrirë porse korja e tokës së kontinenteve është përftuar nëpërmjet shtrirjes dhe shtresëzimit. "Dhe tokën Ne e shtrimë dhe hodhëm në të malet edhe mbollëm në të çdo çift lulëzues bime…". Vëreni foljen "e shtrimë" është në kohën e shkuar pra që ka të bëjë me historikun e tokës në të kaluarën… Më tej Allahu i Lartësuar dhe Lartmadhëruar në kaptinën kuranore Rad thotë: "Është Ai i Cili e shtriu tokën dhe në të bëri malet dhe lumenjtë." Uji doli me daljen e maleve dhe me koren e tokës që u shtri. Gjejmë në kaptinën kuranore "Kaf" të njëjtin përshkrim. Këtu Allahu i Lartësuar thotë: "Tokën e shtrimë dhe në të lëshuam kreshtat e maleve edhe mbollëm në të çdo çift lulëzues bime". Dhe në të mbollëm çdo çift lulëzues bime. Vëreni në këtë thënie sesi bëhet lidhja ndërmjet shtrirjes së tokës, kores apo dheut të saj, me ujin, me malet dhe me lumenjtë.

Allahu i Lartësuar thotë gjithashtu në përshkrimin e kësaj fillese: "A është më i rëndë krijimi juaj apo ai i qiellit? E Ai e ngriti atë! Ngriti kupën e tij dhe e përsosi atë. Natën ia errësoi e ditën ia ndriçoi. E pastaj tokën e sheshoi."

Fjala arabe "deha-sheshoi" vjen me disa kuptime. Kuptimi më stabël i saj është sheshoi. Një tjetër vkuptim i saj është të hedhurit, pra të hedhësh diçka. Kur hedh diçka thuhet "deha-hodhi" diçka.

"Dhe prej saj nxori ujin e saj dhe kullosat e saj. Kurse kodrat ia përforcoi". Më e sakta lidhur me fjalën arabe "deha" është kuptimi sheshoi. Zemekhsheriu në librin e tij "Esrarul Belega" thotë: "deha' një gjë" do të thotë e sheshoi atë gjë, e shtriu dhe zgjeroi. Dhe "deha" vjen edhe me kuptimin hodhi, kuptim me të cilin kjo fjalë vjen në fjalorin "El Lisenul Arabi" si edhe në disa fjalorë të tjerë.

Thënia kuranore thotë: "E pastaj tokën e sheshoi". Fjala "deha-sheshoi" veç sheshoi ka edhe kuptimin e dytë "hedhje", pra ka dy kuptimet; 1. hedhje dhe 2.shtrirje apo sheshim. Është pikërisht kjo fjalë adekuatja dhe fjala e përpiktë që mbulon procesin e formimit të

kores së kontinenteve, pra tokës. Toka doli nga barku i rruzullit tokësor në formën e hireve dhe magmave vullkanike. Pastaj u ftoh. Kjo dalje nga poshtë-lartë është hedhje në korrespondim të plotë me fjalën arabe "deha". Pastaj rrjedhja e magmës dhe hirit vullkanik horizontalisht në shtrirje po kështu është në korrespondim të plotë me fjalën arabe "deha". Pra fjala arabe "deha" mbulon që të dy proceset; atë vertikal përmes daljes së magmës formuese të tokës në formën e vullkanit duke u hedhur së larti dhe procesin horizontal të shtrirjes së magmës dhe hirit vullkanik përmes së cilit u krijuan kontinentet, pra korja e tokës.

Të flasim për malet. Të gjithë malet e parë kanë qenë vullkanik dhe këtë e predikon edhe historia e tokës. Prandaj ardhja e tyre në skenë ka qenë sërisht në formën e hedhjes lartazi. Janë hedhur prej poshtë-lartë, përmes daljes së magmës dhe hirit vullkanik duke u hedhur prej poshtë-lartë. Kjo qe rruga e formimit të maleve, hedhja nga poshtë-lartë, e njëllojtë me atë të formimit të kores së tokës. Në ilustrimet demonstrative bëhet e qartë pamja e një vullkani, magma dhe hiri vullkanik i të cilit përmes kraterit nga poshtë ngjitet lartazi duke u hedhur dhe rënë sa djathtas majtas. Në rënie bëhet stivë duke formuar masivin e malit. Kjo nxjerr në pah sesi mali në fakt u hodhë nga poshtazi lartazi. Këtu qëndron edhe fakti i të shprehurit të Kuranit duke thënë: "Ai i krijoi qiejt pa shtylla, sikurse po i shihni, dhe në tokë hodhi kreshtat e maleve që toka të mos tronditet dhe t'ju trondisë. Dhe shpërndau në të nga të gjitha gjallesat". Pra është e qartë sesi Allahu hodhi në tokë kreshtat e maleve, funksioni dhe roli i të cilëve qe që toka të mos tronditet dhe t'na trondisë ne njerëzve. Në vijim Krijuesi shpëndau në tokën që e përgatiti me kushtet për jetë, nga të gjitha gjallesat.

Pra fillesat e maleve të hershëm ishin nga malet vullkanike përmes hedhjes së tyre. Ndërkaq hadithin profetik i cili është shpjegues i Kuranit, e gjejmë të na e përmend këtë çështje dhe më në detaj. Kjo i kthehet faktit se hadithi duke qenë komentues dhe sqarues i Kuranit vjen në një mënyrë edhe më të detajuar dhe edhe më të përpiktë.

Hadithi në fjalë transmetohet nga Enes ibn Maliku i cili transmeton në adresë të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se ai ka thënë: "Kur Allahu e krijoi tokën ajo bëri të lëkundet. Ndërkaq krijoi malet të cilat i ktheu mbi të (tokë)…". Shikoni përshkrimin e detajuar të hadithit profetik, toka bëri të lëkundej, ndërkaq i krijoi malet të cilat i ktheu mbi të, pra mbi tokë. Pra vetë malet kur i krijoi i ktheu mbi tokë, gjë që shpjegohet me faktin se ashtu siç dihet, magma dhe hiri vullkanik nga ku u formuan malet teksa hidhet me vrull lartazi nga vullkani, shkëputen nga toka dhe pastaj falë forcës tërheqëse të tokës ato kthehen sërisht në tokë. Vëreni se çfarë përshkrim i detajuar ka ardhur. Thotë Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-: "Kur Allahu e krijoi tokën ajo bëri të lëkundet. Ndërkaq krijoi malet të cilat i ktheu mbi të (tokë) dhe ato u stabilizuan". I Lavdishëm është Allahu. Doli mali dhe u krijua. Krijimi i tij u bë përmes nxjerrjes së tij nga barku i tokës, pastaj bëri të drejtohej lartazi, e ktheu atë (malin) mbi të (tokë) përmes forcës tërheqëse të tokës, duke formuar kështu strukturën tërësore të malit. Mali, kur zbriti dhe u bë pirg, formoi një rëndesë që falë

peshës së saj u zhyt në tokë, në shtresën e ngjizur vullkanike, duke i dhënë malit mundësi të shtrijë rrënjët e tij thellë në këtë shtresë të ngjizur vullkanike, gjë e cila bëhet shkak për përforcimin dhe moslëkundshmërinë e tokës. Mali fiksohet, rrënjëzohet dhe stabilizohet përmes zhytjes së rrënjëve të tij deri në kufinjtë e thellësive të shtresës së ngjizur të llavës vullkanike, gjë që konkludohet me fiksimin e maleve dhe përforcimin dhe fiksimin që ato i bëjnë kores së tokës.

Sa më sipër është raportuar nga Revista Shkencore Amerikane në volumin e nëntë në vitin 1993. Kjo revistë bën fjalë rreth vullkanit të Kileuejit dhe sesi ai na jep informacione rreth njohurive që na qartësojnë se si ka qenë krijimi më herët.

Kjo revistë citon: Magma që del nga vullkani i Kilauejit shtrihet dhe shtresohet duke na pasuruar me lëndën e saj që zhytet përgjatë dhjetëra e madje qindra kilometrave brenda tokës. Çdo rrethanë e këtyre skenave na paraqet një ekspoze të çmuar të proceseve vullkanike që formuan mëse 80% nga koreja tërësore e tokës si mbi ashtu edhe nën sipërfaqen e tokës.

Një tjetër pyetje që shtrohet është ajo mbi ujin, thënë ndryshe këto detëra dhe oqeane gjigandë nga ku erdhën?

Vetëm pas vitit 1950 shkencëtarët arritën të mësojnë se detërat dhe oqeanët aktualë nuk ishin veçse ujëra të rezervuar në brendinë e barkut të tokës që më pas dolën me shpërthimet vullkanike. Pikërisht tek ky kontekst aludon edhe thënia kuranore ku Allahu i Lartësuar thotë: “E pastaj tokën e sheshoi. Dhe prej saj nxorri ujin e saj dhe kullotat e saj. Kurse malet ia bëri për përforcim”.

Profesor Uilliam Stocks, profesor i gjeologjisë në Universitetin Ottava në Amerikë, në librin e tij “Fillesat e historisë së tokës” thotë: Konceptimi imitues në periudhat e shkuara para periudhës shkencore thoshte se terrja-korja e tokës dhe oqeanet u shfaqën befasisht nën sistemacionin e një procesi të përgatitur. Ndërsa konceptimi modern përfton se uji dhe gazet e shtresës atmosferike dolën nga barku i tokës. Pra realisht ato kanë dalë nga barku i tokës.

Shkencëtari britanik i gjeologjisë David Earos në librin e tij “Hyrje në Oqeanografi” thotë: Burimi i ujit është aktiviteti vullkanik, burimet e nxehta termike dhe nxehja e shkëmbinjve të zjarrtë magmatik.

Ky pra është lajmi kuranor në lidhje me sipërfaqen e tokës, për mënyrën e formimit të maleve, për mënyrën e shtrirjes dhe shtresimit të këtyre kontinenteve dhe maleve si dhe për mënyrën e daljes së ujit nga barku i tokës.

Në vijim ky Kuran na flet rreth maleve, rrënjëve dhe rolit të tyre.

Nëse peofesorët e gjeografisë do t’i pyesnim për malet ata do na flisnin për malet duke marrë në konsideratë se mali është pjesa e dukshme që ne shohim mbi tokë. Ata e

përkufizojnë malin se ai është një pirg i ngritur mbi tokë. Ky është përkufizimi i tyre bazë për malin. Ata nuk bëjnë fjalë për pjesën e malit të zhytur në barkun e tokës, për rrënjën e malit. Nuk ka mal që të mos ketë rrënjën e tij të zhytur në barkun e tokës.

Këndvështrimi aktual për malin ku arriti shkenca na nxjerr në pah realitetin se mali nuk është vetëm pirgu sipërfaqësor i tij që ne shohim mbi sipërfaqen e tokës. Këto gjetje të reja aktuale na bëjnë me dije se pirgu sipërfaqësor i malit përbën një pjesë relativisht të vogël të tij. Dhe se vazhdimësia e malit vijon me rrënjën e malit disa herë më të madhe se pirgu sipërfaqësor që vjen pingul me pirgun sipërfaqësor dhe zhytet në shtresën e ngjizur vullkanike të barkut të tokës. Kjo gjë është evidente për çdo mal. Malet paskan pra rrënjët e tyre që i fiksojnë ato dhe tërë koren e tokës.

Ky është fakti pse Kurani i përshkruan malet kështu: “Dhe malet i bëri pyka (kunja)”.

Po t’i shikojmë ilustrimet lidhur me tërësinë e malit ku gjendet dhe rrënja e tij, do t’a gjejmë malin vërtetë në formë pyke.

Gjithashtu Kurani thotë për malet: “Dhe hodhi në tokë fiksuese (malet përforcuese)”.

Kështu janë në fakt malet, si spirancat e anijes që përforcojnë anijen në det që të mos lëkundet dhe lëvizë. Po kështu është dhe puna e maleve, ato janë spiranca që anijen “koreja e tokës” në të cilën ne gjendemi e fiksojnë mbi detin “shtresa e ngjizur vullkanike e brendisë së tokës” ku ajo gjendet.

Kur u bë i njohur një fakt i tillë?

Mendimi i parë rreth rrënjëve të malit u bë evident në vitin 1855 kur një ekspeditë gjeologjike britanike bëri një turne hulumtues dhe survejues të maleve Himalaja. Atje ata gjetën aparaturat të lexonin lexime të ndryshme të gravitetit me ç’rast një prej shkencëtarëve bëri një hulumtim për këtë fenomen i cili konkludoi me një çudi, madje e quajti “çudia e Indisë”. Ndërkaq ai ia përcolli këtë hulumtim shkencëtarit britanik G.B. Airy që pas dy muajsh studjoi orientimet e këtyre leximeve në konkludim të të cilave Airy tha, unë nga këto lexime të gravitetit konkludoj se poshtë çdo mali prej këtyre maleve gjendet rrënja e tyre e zhytur në shtresën e poshtme të brendisë së tokës. Ky ishte komentimi që tha Airy.

Ndërsa Brat, një shkencëtar i kohës së tij, iu kundërvu mendimit të Airy duke thënë jo, unë e komentoj këtë fakt me atë se poshtë malit ka ndodhur një trysni falë së cilës është larguar masivi i rëndë i rëndesës në të dy krahët.

Një tjetër shkencëtar që erdhi pas tyre në vitin 1930 i quajtur Minesis tha: Mali ushtron trysni përposhtë dhe si rezultat i kësaj, shtresa që gjendet poshtë tij përthyhet, jo se kjo shtresë përposhtë zgjatet në formë rrënje siç është shprehur Airy.

Që të tre këto pikpamje shkencore janë skicuar dhe shpjeguar në librat bashkëkohorë të gjeografisë. I pari Brat që thotë se poshtë malit ka ndodhur eliminim i shtresë ashtu që materiali i rëndë është spostuar në të dy anët e malit. I dyti Airy thotë se mali së poshtmi ka shtrirjen e tij vertikale rrënjësore të zhytur poshtazi malit. I treti është Minesis që thotë se mali ka ushtruar trysni anekënd tij në shtresën poshtë tij duke e përthyer atë në të gjithë këtë shtrirje por jo se bëhet fjalë për rrënjë apo shtrirje vertikale me zhytje të shtresës poshtë malit.

Le të shohim vërejtjet dhe leximet që u bëhen këtyre tre shpjegimeve lidhur me realitetin e strukturës tërësore të maleve dhe se cili është konkludimi përfundimtar bashkëkohor.

Në Revistën Shkencore Amerikane, botim i Korrikut 1986, publikuesi shkencor thotë: Studimet tektonike dhe sizmike që janë bërë përgjatë dhjetëra viteve të shkuara kanë përkrahur atë çfarë patë parashikuar Airy, duke konkluduar se trashësia e kores së tokës ndryshon tërësisht nga komponentët e tjerë të tokës dhe ajo varion në trashësi nga një kontinent në tjetrin nga 30-40 km thellësi, porse poshtë maleve ajo rritet duke arritur në 75 kilometra. Janë pikërisht rrënjët e kores së tokë që bëjnë kompensimin në thellësi, të pirgut sipërfaqësor shtesë të malit, nëpërmjet shpërbërjes së rrezonancës me dendësi më të lartë.

Ky pra është raporti i dalë nga Revista Shkencore Amerikane dhe kur? Vetëm në vitin 1986. Pra afërsisht më shumë se 100 vjet ose një shekull e një çerek pas ideimit të Airy, dhe mëse 1400 vjet pas zbulimit të këtij fakti prej Kuranit.

Zbulimi i aparaturave të sofistikuara që masin tërmetet dhe identifikojnë rrezonancat sizmike dhe tektonike të dridhjeve të tokës, mundësuan që të theksohet ajo çfarë raportoi Airy, pra se çdo mal posedon një rrënjë që zgjatet në shtresën poshtazi.

Në vitin 1960 u zbulua roli apo funksioni i maleve ashtu që u konkludua se roli i tyre ishte fiksimi dhe përforcimi i krejt kores së tokës.

A nuk është sa u tha më herët pikërisht ajo çfarë raporton dhe shpall Kurani 1400 vjet më parë?! A s'është kjo përshkrimi i Kuranit rreth formimit të tokës, kores së tokës dhe kontinenteve?! A s'është kjo ajo çfarë Kurani para 1400 vjetësh na zbulon lidhur me formimin e ujit, detërave dhe oqeaneve?! A s'është kjo ajo çfarë Kurani na zbulon lidhur me formimin e planetit tokë dhe se ai nuk ishte veçse një pjesë e masivit unik të qiellit?!

A s'është kjo ajo çfarë Kurani na zbulon lidhur me faktin se qielli dhe toka ishin një masë e vetme, teksa qielli ishte tymnajë?! Siç thotë Allahu i Lartësuar lidhur me këtë: "Pastaj qëndroi në qiell teksa ai ishte tymnajë…".?!

Kush ia zbuloi të gjitha këto të vërteta shkencore dhe të gjitha këto mistere Muhamedit - lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-?! Kush e lajmëroi atë lidhur me misteret e qiellit dhe misteret e tokës?! Kush e lajmëroi atë lidhur me misteret e ujit?!

S'ka dyshim se ky Kuran i zbriti atij nga Ai që i di sekretet dhe misteret e qiejve dhe të tokës, gjë në lidhje me të cilën Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: "Thauj (o Muhamed për Kuranin) se atë e zbriti Ai që e di të fshehtën në qiej dhe në tokë".

Dhe thotë: "Porse Allahu dëshmon pro atij-Kuranit që të zbriti. E zbriti atë (të pajisur) me diturinë e Tij…".

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Urtësia prej krijimit të njeriut (24)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Cila është urtësia për të cilën u krijua ky njeri?

Mbi këtë pyeti një ndër poetët e mëparshëm duke thënë:

Erdha, nuk e di se nga?

Por di që erdha.

Pashë rrugë para meje dhe eca.

Do ngelem në ecje desha apo nuk desha.

Si erdha? Si e pashë rrugën time?

Nuk e di…

E përse nuk e di?

Nuk e di…

I Lavdishëm është Zoti ynë!

Vërtetësia dhe realiteti i kësaj jete del në pah me vdekjen. Me ardhjen e vdekjes dhe ndodhinë e saj, realiteti dhe e vërteta mbi jetën zbulohet. Teksa njeriu që po jep shpirt i hedh sytë në jetën e tij të shkuar e gjen atë pa pikë vlere, dhe në këtë moment e mëson se realiteti i përhershmërisë, përjetësisë dhe amshimit është realiteti drejt të cilit ai po shkon me hir apo me pahir. Në këtë moment e pyet veten se përse u krijua ai në këtë dynja, përse erdhi në të? Por kur e bën këtë pyetje? E bën teksa po del nga kjo dynja. Vërtet ky njeri pati qenë shumë i pavëmendshëm, shumë neglizhent dhe naiv karshi gjë-së më të rëndësishme, karshi pse-së së jetës së tij.

Dije -dhe lypset t'a dijë këtë çdo njeri i arsyeshëm- se ne njerëzit jemi krijuar për një qëllim, për një urtësi. Nuk qëndron ajo që mendojnë disa injorantë se njeriu u krijua në tym dhe më kot.

Nëse do mendosh dhe meditosh rreth çdo pjese prej pjesëve të trupit tënd do të gjesh se ajo është përsosur për një urtëësi dhe qëllim të caktuar. Shkencëtarët e mjekësisë do të dëshmojnë ty rreth kësaj përmes shkencës së themeluar prej tyre të quajtur

“Funksionimi i Organeve”. Nuk ka asnjë organ apo aparat në trupin e njeriut që të mos ketë funksionin e tij perfekt. Doktorët do të bëjnë ty me dije se çdo organ dhe pjesë prej atyre që përbëjnë trupin e njeriut është e lidhur me tërësinë trupore dhe është në funksion të saj. Kështu, stomaku, zorrët dhe mbarë kompenentët e tjerë të aparatit të tretjes janë përsosur në funksion të këtij aparati. Teksa aparati i tretjes nga ana e tij është përsosur që të funksionojë në funksion të tërësisë trupore të qenies njerëzore. Kjo gjë është evidente edhe për çdo qelizë, organ dhe aparat tjetër të trupit të njeriut.

Lind pyetja: A mundet që një pjesë e diçkaje të jetë funksionale dhe për një qëllim, ndërsa tërësia që ajo formon të jetë jofunksionale dhe e paqëllimtë?!

I lavdishëm është Zoti ynë!

Po, po; krijimi i njeriut nuk ka dyshim që është bërë për një qëllim, për një funksion, për një urtësi; po, po; sepse çdo gjë që ka të bëjë me krijimin tonë është e qëllimtë dhe bart urtësi.

Porse realiteti është se ende shumica dërrmuese e njerëzve nuk e dinë se përsë u krijuan, nuk e dinë se cili është qëllimi dhe funksioni për të cilin u krijuan. Për ta qëllimi i krijimit ka mbetur një mister.

Përse? Përgjigja është; sepse ky qëllim fshihet tek Krijuesi i Lavdishëm dhe i Lartmadhërishëm i Cili e krijoi njeriun për qëllimin që deshi Vetë. Ky qëllim fshihet tek Zoti i njeriut i Cili është edhe Zoti i çdo gjëje që ka të bëjë me njeriun.

Supozo se do të binte në dorë një paisje elektronike shumë e sofistikuar dhe e ndërlikuar dhe do tentoje të gjeje se cili është qëllimi apo funksioni i saj. Si do t’a gjeje këtë? Rruga e vetme që të mësosh qëllimin dhe funksionin e kësaj paisje të ndërlikuar, të kushtueshme dhe të vlefshme; është që të lidhesh me atë që e ka bërë atë, ose përmes përfaqësuesit të tij që ai ka caktuar që të përçojë udhëzimet e tij lidhur me të. Kështu do e mësonim qëllimin dhe funksionin e kësaj paisje, prëndryshe do e prishnim atë.

Kjo vlen edhe për njeriun. Ende njeriu nuk ka arritur që të depërtojë tek misteret e përbërjes dhe përmbajtjes së tij humane. Shpesh njeriu nuk di ç’përgjigje të jap për vetë shpirtin e tij, realitetin e tij; për mendjen dhe realitetin e saj funksional, sesi ajo funksionon, si e mundëson njeriun të arsyetojë dhe kuptojë. Mistere të shumta vazhdojnë t’a rrethojnë njeriun në rrugën e tij drejt njohjes së vetvetes. Pas kësaj, si do arrijë i gjori njeri që mbështetur në mendjen e tij t’a gjejë qëllimin dhe funksionin e krijimit dhe ekzistencës së tij?!

Jo,jo; asnjë rrugë tjetër nuk ka për t’ia mësuar këtë përveçse ajo e njohjes së Atij që e krijoi dhe lidhjes me Të.

Disa njerëz nuk i përmbahen kësaj, por nxitojnë t’i vendosin vetes së tyre qëllime dhe funksione. Njëri thotë qëllimi dhe funksioni për të cilin u krijova është që të jem lidership; tjetri thotë që të jem gjeneral ushtrie; tjetri thotë të grumbulloj pasuri; tjetri thotë të arrijë grada dhe prestigje të larta shoqërore dhe shkencore; tjetri të bëhem sportist, tjetri këngëtar, tjetri…

A kështu duhet të jetë; thënë ndryshe a duhet që qëllimi i krijimit të njeriut dhe funksioni i tij të jetë i ndryshëm nga njëri tek tjetri?!

Dihet që urtësia e krijimit të njeriut ka të bëjë me krijimin e tij, i cili është i njëtrajtëshëm dhe unikal. Trupi yt, i imi, i liderëve, ministrave, doktorëve, oficerëve…; tek të gjithë ka të njëjtën strukturë; shpirtërat tanë kanë të njëjtën strukturë, që të gjithë duam dhe urrejmë, kemi frikë dhe lakmojmë; pra edhe strukturimi ynë fiziologjik edhe ai shpirtëror apo psikologjik është i njëtrajtshëm tek të gjithë njerëzit. Nisur nga e gjithë kjo duhet që qëllimi i njeriut dhe funksioni i tij të jetë unik. Nuk bën që unit tonë t'i shpikim dhe fabrikojmë qëllime dhe funksione dhe më pas jetën tonë t'a çojmë në përmbushje të këtyre qëllimeve dhe funksioneve të fabrikuara, fallso dhe të pavërteta; e po të mos ishin ato fallso përse njeriut i duhet të vdesë pa i përmbushur ato gjatë jetës së tij, e për më keq duke sajuar pas arritjes të disa prej tyre qëllime të reja në kërkim të qëllimit të vërtetë… Nëse themi se qëllimi i filanit dhe funksioni i tij në jetë është qeverisja; përse i duhet të dështojë dhe në rastin më të mirë t'a realizojë provizorisht këtë qëllim dhe funksion dhe më pas t'i këputet ky qëllim përgjysëm kur ai vdes me vdekje të befasishme apo biologjike…; nëse do të ishte kështu përse ky njeri vdes?! Kjo vlen edhe për atë që qëllim të jetës së tij bën arritjen e titujve dhe gradave shkencore; në fund të fundit përse ky njeri vdes?! Nëse qëllimi i vërtetë për të cilin ai u krijua do ishte që të bëhej lider apo shkencëtar, këtë qëllim do duhej t'a arrinte pa stërmundim, dhe në fund të fundit nuk do duhej që të vdiste, sepse me vdekjen e tij do ndërpritej qëllimi i krijimit dhe ekzistencës së tij...

Konkluzioni është që ne jemi krijuar për një qëllim dhe funksion dhe se ai duhet të jetë unikal dhe njëlloj i realizueshëm për çdo njeri mbi shpinën e tokës, sepse njerëzit janë të të njëjtës strukturë fiziologjike dhe psikike.

Po kështu qëllimi dhe funksioni i njeriut nuk pëson ndryshim nga një brez apo gjeneratë në tjetrën. Njerëzia përgjatë gjithë brezave, nga i pari deri tek i fundit, i takon të njëjtit qëllimi dhe funksioni; është ky një qëllim dhe funksion unikal; kjo sepse krijimi im dhe i yti është po ai krijim që karakterizoi njerëzit që jetuan qindra, mijëra e edhe më shumë vite më parë.; sepse të gjithë faktet tregojnë se struktura dhe kreatura njerëzore nuk ka pësuar asnjë ndryshim dhe transformim.

Bazuar në gjithë sa u tha del si domosdoshmëri që qëllimi i krijimit të njeriut dhe funksioni i tij duhet të jetë unikal.

Sado që të mundohen njerëzit të hlumtojnë rrreth këtij realiteti, duhet ditur se rruga për të arritur tek ky qëllim, tek kjo urtësi dhe ky funksion është një; përmes njohjes së kësaj nga Krijuesi nëpërmjet lidhjes me Krijuesin që e krijoi njerëzinë dhe çdo gjë që i shërben asaj. Vetëm Krijuesi i njeriut e di më së miri se për çfarë qëllimi dhe funksioni e krijoi njeriun.

Ndonëse njeriut që synon t'a zbulojë qëllimin e ekzistencës së tij në rrugën pa krye që përmendëm, e tillë gjë i bëhet tepër e komplikuar dhe e pafryt; gjithsesi po qe se i bindemi arsyetimit të thjeshtë do arrijmë fare thjeshtë në atë ku Mesazhi Hyjnor fton lidhur me qëllimin e vërtetë të krijimit të njeriut.

Kështu qëllimi dhe funksioni i çdo mjeti, le të themi lapsit për shembull, gjejmë se përcaktohet nga ai që e bëri lapsin; qëllimin dhe funksionimin e makinës e përcakton ai që e bën makinën; qëllimi dhe funksioni i aeroplanit, nëndetëses etj dhe çdo gjëje apo mjeti pa përjashtim prej kujt përcaktohet?; natyrisht përcaktohet nga ai që e bën apo produkton atë.

Çështja tjetër pas faktit se qëllimin e çdo gjëje e përcakton ai që e bën atë, është se kjo vepër e bërë funksionin sipas qëllimit apo synimit të atij që e bëri. Sipas kësaj arsye sa modeste por aq edhe të pakontestueshme gjejmë se lapsi është bërë që të funksionojë sipas qëllimit të atij që e bëri; se qëllimi i makinës dhe funksioni i saj është që të funksionojë sipas qëllimit të atij që e bëri; dhe kjo vlen për aeroplanin e edhe për çdo gjë tjetër.

Nisur nga ky arsyetim i pakontestueshëm i bie që qëllimi dhe funksioni im, i yti, i atij, si dhe i të gjithë njerëzve, është që të veprojmë dhe funksionojmë sipas qëllimit për të cilin na krijoi Ai që na solli në këtë ekzistencë; qëllimi i njeriut dhe funksioni i tij është që të funksionojë sipas Vullnetit të Krijuesit që e krijoi.

Krejt e thjeshtë por kjo është e gjitha, ky është qëllimi i krijimit tonë. Pasi a do ishte e arsyeshme që Krijuesi të na bënte dhe krijonte që ne të funksionojmë dhe veprojmë sipas qëllimit të tjetërkujt, për më tepër në kundërshtim me udhëzimet e Tij?!

E pra qëllimi për të cilin ne jemi krijuar është shumë i qartë; është që të veprojmë dhe funksionojmë sipas Vullnetit të Allahut të Lartësuar dhe të Lartmadhëruar; teksa veprimi ynë sipas Vullnetit të Tij Hyjnor përbën definicionin e quajtur adhurim.

Adhurimi pra qënka "të vepruarit sipas Vullnetit Hyjnor" të cilin ne e mësojmë përmes udhëzimit hyjnor. Ky është dhe kuptimi i fjalës së Allahut të Lartësuar: "Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për tjetër gjë, përveçse që të më adhurojnë Mua. Nuk dua prej tyre të më japin ndonjë bereqet a furnizim dhe as të më ushqejnë. Allahu është Gjithfurnizuesi, i Plotfuqishmi, i Pamposhturi".

Ky qëllim hyjnor nuk pranon t'i bëhet ndonjë tjetërsim, manipulim apo modifikim.

Medito! A do qe e mundur t'a ndyshoje qëllimin e syrit dhe funksionin e tij?! Të thoje për shembull, unë nuk dua që syri im të jetë për të parë por dua që syrit tim t'ia ndryshoj apo modifikoj qëllimin dhe funksionin e tij. Edhe po të kishe dashur nuk do mundeshe, pasi syri është strukturuar enkas për këtë qëllim dhe funksion, që të shikojë; nuk është e mundur t'ia ndryshosh syrit funksionin origjinal me këtë strukturë që ai ka; për shembull të hashë me të... E njëjta gjë vlen edhe për veshin, qëllimi dhe funksioni i tij nuk mund të ndryshohet, të thuhet për shembull, unë veshin tim do t'a modifikoj dhe bëj hundë…

I nderuar im, syri yt, veshi yt, trupi yt, shpirti yt, që kur u krijuan u krijuan dhe strukturuan pro qëllimit dhe funksionit që përcaktoi për to Ai që i krijoi. Dhe kjo tërësi që të përbën ty, sipas të njëjtit arsyetim, u krijua për një qëllim dhe funksion të cilin e ka përcaktuar Ai që të krijoi, funksion ky që është i patjetërsueshëm dhe i pamodifikueshëm. Nuk mundet njeriu t'i shmanget këtij Vullneti Hyjnor. Ajo që njeriu

mund të bëj është vetëm të ecë pas këtij Paracaktimi Hyjnor dhe t'a konkretizoj, duke qenë i vetëdijshëm se në të dhe vetëm në të fshihet arritja e lumturisë dhe përmbushja e vërtetë e qëllimit dhe funksionit të jetës së tij.

Solemnisht dhe në mënyrë të pakontestueshme arrihet në faktin se "Qëllimi dhe funksioni i njeriut është që të veprojë sipas Vullnetit të Allahut të Lartësuar dhe Lartmadhëruar"; fakt ky të cilin Allahu i Lartësuar e sqaron në thënien kuranore që përmëndëm më herët: "Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për tjetër gjë, përveçse që të më adhurojnë Mua. Nuk dua prej tyre të më japin ndonjë bereqet a furnizim dhe as të më ushqejnë. Allahu është Gjithfurnizuesi, i Plotuqishmi, i Pamposhturi".

Thënia kuranore në fjalë sqaron se qëllimi i krijimit të njeriut dhe funksioni i tij, të cilin ia ka përcaktuar Ai që e krijoi, është që njeriu t'a adhuroj Këtë Krijues Një të Vetëm, teksa konkluduam se adhurimi është "të vepruarit sipas Vullnetit Hyjnor të Krijuesit në përputhje me Udhëzimin Hyjnor të Tij".

Pikërisht për të përçuar Udhëzimin Hyjnor Allahu i Lartësuar dërgoi profetët -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi ta-. Janë profetët -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi ta- , ata të cilët Allahu i përkrahu dhe mbështeti me mrekulli dhe fakte, ata që përcjellin në formën më të përsosur dispozitat dhe detajet e adhurimit. Më herët në këtë cikël episodesh ne kemi bërë fjalë për mrekullitë dhe faktet mbi profetësinë e Profetit tonë Muhamedit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-; të cilat na bëjnë të bindemi ashtu që prej tij -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- të marrim orientimet hyjnore, duke qenë të bindur, besues dhe të qetë se ai është Profeti të cilin Allahu e dërgoi tek ne.

Profetët e Allahut pra, ishin ata të cilët përcjellin Vullnetin Hyjnor të Krijuesit të Lartësuar dhe Lartmadhëruar; gjë në lidhje me të cilën Allahu i Larëtsuar thotë: "Kemi dërguar në çdo komb Profet që t'a adhuroni Allahun dhe t'a lini adhurimin e Tagutit (çdo të adhuruari përveç Allahut)"; kërkohet lënia dhe shmangia e "adhurimtarisë të tjetërkujt krahas Allahut" që në arabisht quhet "tagut". Dijetarët kanë thënë se tagut quhet çdogjë dhe çdokush që adhurohet përveç Allahut. Fjala arabe "tagut" vjen nga folja arabe "taga" që do të thotë "kaloi kufijtë dhe caqet që i takojnë", dhe në fakt gjithkush që kërkon të adhurohet përveç Allahut i ka kaluar caqet dhe kufijtë e tij pasi po kërkon diçka që është mbi kapacitetet e tij. Gjithkush hamendëson për qëllimin e krijimit të vet qëllime dhe funksione ose që i bindet në këtë tjetërkujt veç Allahut të Lartësuar dhe Lartmadhëruar, i tilli i ka kaluar caqet përmes këtyre ideve njerëzore antihyjnore apo idhujve të tij që ndjek; pasi në fund të fundit e gjitha kjo është në nivelin e krijesës së Zotit, dhe krijesa e Zotit ngelet brenda caqeve për sa kohë nuk vepron në kundërshtim me Vullnetin e Zotit. Duke iu bindur krijesës në çfarë përbën lënie të bindjes së Krijuesit i ke kaluar caqet, ashtu që këtë rob e ke ngritur nga pozita e robit në pozitën e Zotit. E tillë gjë padyshim që përbën kalim të caqeve dhe kufijve dhe quhet dhunim. Ndërkaq besimi në kompleksitetin e tij kërkon që të mohojmë dhe mos t'i besojmë dhunuesit-zotat fallso që kalojnë caqet e tyre krijesore; dhe kërkon gjithashtu krahas kësaj që Allahun e Lartësuar dhe Lartmadhëruar t'a adhurojmë Një të Vetëm. Këdo që direkt apo indirekt kërkon që të adhurohet përveç Allahut, duhet t'a mohojmë dhe vlerësojmë si fals; pasi ne domosdoshmërisht duhet t'a adhurojmë Allahun Një, të Vetëm, e të Pashoq.

Kjo botë në ligjet dhe rregullat që disponon, thënë me gjuhën e inxhinierëve, është dizenjuar që të sinkronizohet, përputhet dhe vijë përshtat me qëllimin dhe funksionin e krijimit tonë në të; është dizenjuar të jetë bota e sprovës dhe provimit për çështjen e adhurimit.

U kuptua se ne kemi ardhur në këtë botë që të adhurojmë Allahun por dikush mund të pyes, çfarë përfitohet prej adhurimit? Pas kësaj fshihet fakti sesi Allahu këtij adhurimi i ka dedikuar një vlerësim dhe shpërblim. Pra kjo botë është bota e provimit kundrejt këtyre bindshmërive hyjnore, kundrejt këtyre adhurimeve, dhe ligjet dhe rregulat e Allahut të Lartësuar dhe Lartmadhëruar mbi të cilat e ka krijuar botën mbarë janë përshtatur në formë të tillë që ne të arrijmë t'a përmbushim qëllimin dhe funksionin tonë në të.

Erdhëm në këtë botë që të provohemi dhe testohemi kundrejt çështjes së adhurimit-bindshmërisë së Allahut; ashtu që Allahu në kontekstin e orientimit të Tij Hyjnor na thotë "Nëse më bindeni Mua dhe të Dërguarit Tim duke përmbushur adhurimin do ju jap Xhenetin ku do t'ju shpërblejë më jetën e lumturisë së përjetëshme; ndërsa nëse kundërviheni është një tjetër botë që ju pret, është një tjetër rang, a i Zjarrit të Xhehenemit, të përgatitur enkas për mosbesimtarët kundërvënës; prandaj hyni në këtë botë në botën e sprovimit dhe testimit, ku bëhet ekzaminimi juaj nëse do e adhuroni Krijuesin tuaj apo do i kundërviheni Atij".

Për më tepër, që ky provim të na bëhet sa më i lehtë, Allahu e stolisi këtë botë duke e bërë të bukur në vështrimet tona; teksa Amshimit-Botës Tjetër i jep stolisjen kulminante; ndërkaq bëri të disponueshme rrugë që mundësojnë arritjen e kënaqësive të dynjasë-kësaj bote në vijimësi të arritjes së kënaqësive sublime dhe supreme të Botës Tjetër. Ndaj dhe personi që nuk ndjek këto shtigje dhe e devijojnë dhe preokupojnë të devijojë prej tyre ngacmimet dhe joshjet e shfrenuara të kësaj bote ashtu që do t'i arrijë ato me çdo kusht dhe përmes rrugëve të palegjitimuara nga Allahu i Lartësuar dhe Lartmadhëruar; i tilli nuk arrin të lumturohet realisht as në këtë jetë dhe për më tepër as në jetën tjetër. I tilli e sheh botën si një joshje dhe pre, të cilës i sulet me çdo çmim, lakmitar t'a bëjë të tijën. Atë asgjë nuk e frenon në përmbushjen e tij makute të epsheve, lakmive dhe pasioneve; që gjithësesi nuk arrin t'i përmbushë.

Teksa Ligji Hyjnor Islam vjen dhe i pren rrugën lakmisë makute, duke mundësuar që njeriu të japë e marrë me këtë botë përmes Rrugës Hyjnore, Programit Hyjnor; dhe Allahu i Lartësuar teksa këtë dynja e ka bërë të lakmueshme për sytë tanë, në krahun tjetër, Botën Tjetër e bëri të lakmueshme për besimtarët që besojnë në të duke sjellë përshkrime të mrekullueshme kuranore lidhur me Xhenetin që i pret besimtarët e vërtetë në Botën Tjetër. Nëse besimi i robit është i fuqishëm, ai i jep përparësi asaj që ka rezervuar Allahu në Botën Tjetër duke iu bindur Vullnetit Hyjnor dhe duke bërë durim në këtë bindshmëri; ndërsa po qe se besimi i tij është i dobët ngjet ajo situatë për të cilën Allahu i Larrtësuar në Kuranin Fisnik thotë: "Ka prej njerëzve kush e adhuron Allahun me mëdyshje (luhatshëm), nëse e godet ndonjë e mirë ai qetësohet me të, e nëse e godet ndonjë e pakënaqësi, ai kthehet në fytyrën e vet të vërtetë (të mëparëshme), ai i ka humbur Dynjanë dhe Botën Tjetër, e ky është ai dështimi i qartë".

Pra kjo botë është bota e provimit dhe kontrollimit. Në kontekstin e sa u cek, Allahu i Larëtsuar thotë në Kuranin fisnik: "Në fakt atë që gjendet mbi tokë e kemi bërë stoli të saj që t'i provojmë ata (njerëzit) se cili prej tyre do jetë më vepërmirë. E gjithë sa gjendet mbi të-tokë do t'a bëjmë dhé të pavlerë". Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë: "I Madhëruar është Ai-Allahu, në dorën e fuqisë së të Cilit është i tërë sundimi dhe që është i Plotfuqishëm mbi gjithçka. Ai ka fuqi mbi çdo send. Është Ai që krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është Ngadhënjyesi, Mëkatfalësi". Dhe thotë: "Njerëzve u është stolisur dashuria për kënaqësitë që ndjellin gratë, fëmijët (sidomos djemtë prej tyre), pasuria e depozituar në ar dhe argjend, kuajtë e stolisur, bagëtia dhe bujqësia. Këto janë kënaqësi të shkurtra të jetës së dynjasë, teksa tek Allahu është ardhmëria e përsosur".

Më tej medito sesi kur merret në analizë kjo dynja, del qartë në pah fakti sesi ajo është dizenjuar enkas për t'u provuar dhe kontrolluar. Kur unë, ti, mbretërit, presidentët, liderët drejtues, që të gjithë, kur hyjmë në këtë dynja hymë të zhveshur duke mos poseduar asgjë. Pastaj fillohet të na jepet; të na jepet nga të mirat, pusuria, dituria, begatia, pushteti, prestigji, etj; na jepet ekskluziviteti dhe përgjegjësohemi në sa e sa të tilla posedime në të cilat na jepet e drejtë vendimarrje dhe veprimi për dhjetëra vite, dyzet, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë, tetëdhjetë, thuaj njëqind; derisa vjen afati i dorëzimit, vdekja, dhe na thuhet, dorëzojini, kthejini mbrapsht amanetet, sillini. Sërisht dalim nga dynjaja të zhveshur, pa asnjë gjë nga çfarë posedonim, krejt siç ishte çështja jonë kur hymë në të.

I Dëlirësuar është Allahu! Cili është komenti i kësaj? Hymë duke mos poseduar asgjë dhe dalim po kështu. Pikërisht lidhur me këtë fakt Allahu i Lartësuar thotë: "Na erdhët më vete ashtu siç u krijuam herën e parë dhe çfarë u dhamë e latë pas jush".

Me këtë rast dalin dy pyetje:

Përse Allahu na e dha atë që poseduam teksa Ai do na e merrte sërisht atë? Përgjigjja është se Ai nuk na dha ne çfarë na dha, që t'i sundojmë në pafundësi por na i dha që t'i sundojmë përkohësisht, gjë që del qartë në pah nga fakti se Ai na i mori sërisht ato që na dha.

Pyetja tjetër është përse Allahu na i mori ato gjëra që vetë na i dha? Përgjigjja është një, t'i mori pasi t'i dha që të të provojë se si ke për të vepruar?

Përderisa Allahu të dha çfarë të dha, dhe pikaset se qëllimi nuk ishte që të t'i bënte pronë të patundëshme, pasi t'i mori sërisht; dhe përderisa t'i mori dhe qëllimi nuk ishte që të nxirrte në pah forcën e Tij, pasi Ai vetë me zgjedhjen e Tij t'a dha atë që t'a dha, teksa ti nuk kishe asgjë para kësaj; lind pyetja se "cili ishte qëllimi i gjithë kësaj"?

Pra Allahu t'a dha atë që t'a dha dhe nuk kishte për qëllim që të t'i bënte pronë të përherëshme, si dhe t'a mori dhe nuk e bëri për zhvatje dhe që të nxirrte në pah forcën; lind pyetja cili është qëllimi atëherë?

Qëllimi është që të të provojë dhe testojë.

Krejt si puna e studentit, sidomos në universitetet e shkencave ekzakte ku studenti që të testohet futet në laborator ku i jepen instrumentet dhe mjetet përkatëse të cilat ai është i lirë t'i përdorë për një farë kohe dhe pastaj i thuhet, mbaroi, dil tani. Krejt ngjashëm është edhe dynjaja.

Dhe që ky testim të bëhet sa më efikas Allahu zemrat e njerëzve i bën të përjetojnë situata dhe rrethana nga më të ndryshmet, përmes të cilave del në pah realiteti i tyre; ashtu që Allahu na provon me të mira dhe të këqija, pasuri dhe varfëri... Ka prej njerëzve kush në vështirësi dhe vuajtje tregohet i qëndrueshëm falë karakterit të tij të fortë dhe fanatik që posedon, porse po ky person nuk arrin të tregoj qëndrueshmëri kur përballet me situata tunduese, joshëse dhe luksi, teksa sprovohet me shëndet, joshje dhe pasione. Këtë fakt e gjejmë të ceket nga Kurani Famëlartë ku Allahu i Lartësuar bën fjalë sesi Ai i sprovon njerëzit me vështirësi dhe vuajtje: "Do t'ju sprovojmë me diç prej frikës, urisë, humbjes në pasuri, në jetët tuaja, në të vjelat; e ti përgëzoi durimtarët; të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: "Të Allahut jemi dhe tek Ai kthehemi!".

Pastaj Allahu i ndryshon këto komponentë dhe elementë të provimit jetë, e ndryshon rrethanën dhe skenarin dhe jep bollëk. Kurani tregon pikërisht për këto dy elementë të sprovimit, gjë në lidhje me të cilën Allahu i Larëtsuar thotë në Kuranin Fisnik: "Do t'ju provojmë me të keqen dhe me të mirën, si sprovë, e tek Ne ju ktheheni". Dhe thotë: "Ju kemi bërë ju sprovë për njëri-tjetrin…". Ti ke nevojë për atë, ai ka nevojë për ty, ky më i fortë e ky më i dobët, ky kështu e ky ashtu… enkas për t'u realizuar testimi i drejtë i njeriut. Edhe mbarë ligjet dhe rregullat e jetës dhe universit vijnë në funksion dhe për llogari të këtij testimi.

Këtij provimi i është dhënë një formë mëkëmbësie dhe vetëvendosje në tokë ashtu që njeriu e gjen veten të veprojë dhe manovrojë si të jetë ai padroni dhe sundimtari sovran, teksa e vërteta qëndron se njeriu nuk është sundimtari i vërtetë, aq sa ai as nga vetja e tij nuk posedon dhe ka në dorë gjë prej gjëje dhe nuk mund të ndërhyjë dhe veprojë si të dojë lidhur me të; madje njeriu nuk e sundon as zemrën e tij, as shqisat e tij se ka patur në dorë t'i ketë ashtu siç i gjeti t'i kishte, as fëmijët e tij nuk ishte ai që zgjodhi të jenë ata që janë… Nuk ishe ti o njeri që zgjodhe ajrin apo ujin që të jenë për ty kompenentë jetik pa të cilët s'jeton dot; nuk ishe ti që zgjodhe tokën ku jeton dhe as qiellin që të mbulon.

Në fakt, në kuptimin e vërtetë të fjalës ti nuk je poseduesi dhe krijuesi; porse sa çudi, me gjithë këtë ti je mundësuar të manovrosh si të ishe padroni.

Shëmbulli tjetër i goditur që mund të përshkruhet për këtë pozitë të njeriut është ai i një përgjegjësi në një fabrikë, punishte apo plantacion; që nuk është padroni i saj por që manovron në të krejt lirshëm, si të ishte ai vetë padroni; lidh marrëveshje, shet, blen, zgjedh stafin e punonjësve, u jep urdhëra punëtorëve etj etj… Kur e pyesin, a ti je padroni? Thotë, jo jo. I thonë, po ti po vepron kaq lirshëm këtu. Thotë, po, e kam këtë të drejtë. Po si kjo? Thotë jam mëkëmbës, i përgjegjësuar prej padronit real.

Ky është shembulli i njeriut, që vepron në këtë botë si të jetë ai vetë padroni, teksa asgjë s'është bërë prej tij dhe asgjë s'është e tij, madje as vetvetja e tij… I bie pra që për analogji me shembullin e masipërm, ky njeri të jetë mëkëmbës dhe i përgjegjësuar nga Sunduesi i vërtetë i Botës.

Porse a me të vërtetë mëkëmbësi, i përgjegjësuari apo i autorizuari, mund të veoprojë si t'i teket? Përgjigjja është jo. Përgjegjësi apo drejtuesi i fabrikës, punishtes apo plantacionit në rastin e mëparshëm, ka dorë të lirë të veprojë në çfarë i është lënë në dorë, porse ai vetë i bindet urdhërave dhe udhëzimeve të atij që e ka përgjegjësuar dhe bërë mëkëmbës të tij.

Kështu duhet të jetë edhe shembulli i njeriut në sundimet e Zotit, le të veprojë në to si t'a shohë të arsyeshme porse duke qenë nën urdhërat dhe orientimet e Atij që e bëri krijesë që posedon vullnet të lirë dhe e bëri mëkëmbës dhe sovran në tokë. Në këtë kontekst Allahi i Lartësuar dhe Lartmadhëruar thotë: "A s'e shikoni sesi Allahu ju nënshtroi gjithë sa ka në tokë dhe nënshtroi anijet që sipas dëshirës së Tij të lundrojnë në det. Ai e mban qiellin të mos bie në tokë pos nëse Ai dëshiron. S'ka dyshim se Allahu është Mirëbërës dhe Mëshirues ndaj njerëzve". Dhe thotë gjithashtu: "Nënshtroi për ju sa ka në qiej dhe sa ka në tokë, që të gjitha prej Tij…".

Ndërsa në thënien kuranore në vijim Allahu i Lartësuar e nxjerrë qartë në pah faktin se përse e bëri njeriun mëkëmbës në tokë; gjë në lidhje me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Dhe ju bën ju mëkëmbës në tokë që t'ju provoj se si do veproni". Kjo është e gjitha, na ka bërë mëkëmbës dhe krijesa të vullnetshme e sovrane me qëllim që të na provoj se si do sillemi dhe veprojmë. Ky është i gjithë realiteti.

Pas kësaj vdekja vjen. Hajde dil!… Po unë jam president… Ec dil! Unë jam mbret… Dil hajt! Po ne jemi një popull që arritëm majat e teknologjisë, shpërthyem atomin, pushtuam hapësirën… Dilni, tutje!

S'të ngelet përveçse të përgjigjesh. S'je veçse një rob që po kryeje sezonin e provimit dhe ekzaminimit. Dorëzohu!

Thotë Allahu i Lartësuar: "Përse, pra kur arrin shpirti në fyt, e ju në atë moment shikoni (se ç'po i ngjet). E Ne jemi më afër tek ai se ju, por ju nuk shihni. Dhe përse, nëse ju nuk jeni përgjegjës (për vepra), (përse) Nuk e ktheni atë (shpirtin të mos dalë)"; pra nëse pretendoni se nuk keni për t'u marrë në llogari dhe nuk do pyeteni për përgjegjësitë të cilat u qenë lënë në dynja; pasi mëkëmbësia dhe qeverisja kur të jepet ka pas saj edhe përgjegjësinë, ashtu që po t'u dha vetvendosje dhe vendimarrje të pret përgjegjësia, domosdoshmërisht do pyetesh për këtë; e nëse pretendon se nuk ke për të dhënë llogari dhe nuk ke për t'u përgjegjësuar për sa në fjalë, hajde e na jep prova duke u bërë i pavdekshëm, duke eliminuar vdekjen e cila në fakt demaskon qëllimet e rreme që njeriu i paarsyeshëm i vuri vetes dhe nxjerr qartë në pah faktin se njeriu ishte në një botë prove. Provo o njeri t'a eliminosh vdekjen nga të tjerët dhe nga vetja jote, por moseliminimi i vdekjes shpalos qartë faktin se ti nuk je veçse një rob i Vullnetit të Krijuesit që hyre në këtë botë pa dëshirën tënde, qëndrove në të me pahir, sërisht kjo pa qenë zgjedhja jote, jeton duke qenë një krijesë që të mposht gjumi, uria, etja, malli, frika, nevojat jetike të cilat je i destinuar t'i përmbushësh etj; por përderisa t'i nuk eliminon dhe modifikon asgjë nga sa më sipër e aq më shumë vdekjen, s'të ngelet vetëmse t'i bindesh dhe dorëzohesh Zotit tënd, s'je veçse një rob i sunduar.

Së fundi po me pahir kur të dojë Zoti yt i Lavdishëm dhe i Lartmadhërishëm, nxirresh nga kjo botë pa qenë i aftë të vonosh gjë rreth gjithë këtij destinimi.

Po për ku po dal?

Marsh, dil! Pasi punove të ka mbetur vetëm të merresh në llogari.

Pra qëllimi i kësaj dynjaje është vepra e njeriut e cila nuk zhduket, teksa çdo gje tjetër përveç saj është e destinuar që të zhduket.

Vepra ngelet. Kuptoje këtë të ilustruar me rastin në vijim: Presupozo se ti shumë vite pasi i ke bërë një të keqe një personi e takon atë dhe të thotë, m'a ke borxh filan të keqe. Nëse i thua, o vëlla ka ndryshuar çdo gjë pas gjithë këtyre viteve… a ka vlerë e tillë gjë?! Jo jo, çdo gjë mund të ketë ndryshuar por vepra nuk humbet, as e mira dhe as e keqja nuk humbasin. Kemi Faraonin që edhe sot e kësaj dite vazhdon të mallkohet. Vërtetë që Faraoni i takon shumë e shumë viteve të shkuara por vepra e tij ka ngelur, nuk ka humbur.

Kjo dynja është regjistruese e veprës së njeriut sepse dizenjimi dhe strukturimi i ligjeve, rregullave dhe natyrës së saj është bërë enkas për të mbetur në të gjurma e veprës së njeriut.

Ndërsa dalja prej kësaj bote do të thotë të bëmurit gati për Botën e Llogarisë dhe Përgjegjësisë, drejt së cilës njeriu drejtohet për të gjetur në të veprën e tij mbi bazën e së cilës ai shpërblehet ose ndëshkohet. Lidhur me këtë fakt Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin fisnik: "Çdo njeri do t'a shijojë vdekjen, e shpërblimet tuaja u ruhen të pacënuara për në Ringjallje, e kush i shmanget zjarrit e futet në Xhenet i tilli realisht ka shpëtuar, e jeta e kësaj bote nuk është tjetër përveçse një përjetim mashtrues".

Ky është realiteti, që nuk bëhet i dukshëm përveçse kur kjo botë të mbarojë. Hidhi sytë tek mosha jote që ke lënë pas nga ky moment e përpara. Pyete veten tani, ç'vlerë ka për ty jeta jote që shkoi?! Të tillë vlerë do ketë e gjithë jeta jote e shkuar në momentin e vdekjes. Kjo jetë është pra "një përjetim mashtrues", mos u mashtro!

Pastaj për ku shkohet? Nuk do lihesh në tym… Asnjë neglizhencë... Jo, jo, çdo gjë në këtë ekzistencë është përsosur për një qëllim dhe funksion që nga atomi e deri tek galaktika… Po kështu edhe krijimi yt është përsosur që nga qeliza mikrsoskopike e deri tek aparatet më të sofistikuar të perceptueshme dhe të paperceptueshme që të bëjnë të jeshë kjo qenie komplekse e mrekullueshme fiziologjike dhe shpirtërore.

Jo jo, ti nuk do të bëhesh pre e kotësisë. Kotësia është cilësi e urryer e të marrëve dhe parazitëve.

A s'e ke parë sesi njerëzit e mençur nuk mund të epitetohen me kotësinë pasi ata nuk bien viktima të kotësisë. E si atëherë Krijuesi i njerëzve të mençur, të arsyeshëm dhe të urtë, Krijuesi që krijoi tokën dhe mbarë universin e përsosur, të presupozohet se e krijoi njeriun më kot, në tym.

Kurrësesi, nuk mundet që misoni i vdekjes të jetë për t'i kaluar miliardat e krijesave të përsosura njerëzore në tymnajat dhe hedhurinat e harresës, kotësisë dhe vakumit. Pikërisht lidhur me këtë fakt Allahu i Lartësuar thotë: "A mos mendon njeriu se do të

lihet ashtu më tym (pa u marrë në llogari). (Si po i duket e pamundur ringjallja?!) A nuk ka qenë ai një pikë uji që derdhet. E pastaj u bë gjak i mpiksur, e Ai-Krijuesi e krijoi dhe e përsosi? Dhe prej tij Ai i bëri dy llojet: mashkullin dhe femrën"; nënkupton thënia kuranore se nëse Allahu do kish dashur t'a humbiste njeriun do e humbiste pa nam dhe pa nishan atëherë kur njeriu ishte pikëlz uji gjenital, zigotë mikroskopike.

Nëse i pyet embriologjistët për fillesën e njeriut të thonë se ajo ishte zigota mikroskopike ku gjendeshin mikropërzierjet kromozonale nga ku vjen njeriu. Ajo nuk mund të shquhet me sy të lirë pasi është dhjetëra herë më e vogël se milimetri. Me fjalë të tjera po deshe t'a shohësh mbretin në fillesat e ekzistencës së qenies së tij kur ai ishte vetëm një lëng mikroskopik nuk do mundje; nuk do mundje në këtë fazë të shikoje as presidentin e ardhshëm, as liderin dhe askënd. Ky fillim është fillimi yt, imi dhe i çdo njeriu. Nëse Allahu do kishte dashur të të çonte dëm do të të kishte çuar dëm kur ishe ende kjo pikëlz mikroskopike lëngu gjenital, apo në ndonjë fazë ende të hershme si ajo e fillesës së fetusit; por nuk shkon fare që të të mbrojë dhe garantojë atëherë kur krijesa jote rrodhi në ekzistencë në këto etapa dhe identitete mikroskopike të pakapshme nga syri, dhe më pas të të çoj dëm pasi u bëre krijesë e plotë që rende, bëre dhe veprove.

Jo për Allahun! Vetë Allahu i Lartësuar i derjtohet njeriut të arsyetojë lidhur me këtë fakt, duke i thënë: "A mos mendon njeriu se do të lihet ashtu më tym (pa u marrë në llogari). (Si po i duket e pamundur ringjallja?!) A nuk ka qenë ai një pikë uji që derdhet. E pastaj u bë gjak i mpiksur, e Ai e krijoi dhe e përsosi? Dhe prej tij Ai i bëri dy llojet: mashkullin dhe femrën. A nuk është i Tilli i mundshëm që t'i ngjall të vdekurit?!"; sigurisht që po, Allahu është i Gjithmundshëm për çdo gjë.

E pra nuk u krijuam mëkot dhe as do të shkojmë dëm pas vdekjes.

Qëllimi i krijimit tonë, qëllimi i jetës sonë në këtë botë është që t'a adhurojmë Allahun Një, të Vetëm e të Pashoq; gjë që përbën dhe subjektin e provimit tonë në këtë dynja.

Por ç'është adhurimi?

Një përkufizim i bukur i dhënë për adhurimin nga disa dijetarë të Islamit është se: "Adhurimi është një artikull gjithpërfshirës për gjithësa Allahu do dhe kënaqet"; thënë edhe më thjesht "Adhurimi është që të veprosh sipas Vullnetit të Zotit tënd", e ky përkufizim është i mjaftueshëm. Ai i përgjigjet pyetjes se përse u krijove. Pra nëse pyetesh pse u krijove, përgjigjja është "Që të veprojë sipas Vullnetit të Zotit tim, dhe ky është dhe adhurimi"; gjë që në fakt është një princip prej principeve të pakontestueshëm. Që të gjitha veprat e bëra funksionojnë sipas vullnetit të atyre personave që i kanë bëre ato; e edhe ti o vëlla vepro dhe sillu sipas Vullnetit të Atij që të krijoi dhe të solli në ekzistencë. Nisur nga fakti që nuk je ti ai që krijove vetveten, në mënyrë të pakontestueshme i bie që ti ke një Krijues që të ka krijuar, e për pasojë qëllimi dhe funksioni yt është të veprosh sipas Vullnetit dhe synimit të Këtij Krijuesi që të krijoi.

Personin tënd në çdo gjë personale duhet t'a dorëzosh tek Krijuesi yt, tek udhëzimet e Tij, që në fund të fundit kanë ardhur vetëm për të mirën tënde. Dorëzim total, siç thotë Allahu i Lartësuar lidhur me këtë në Kuranin fisnik: "Nuk i mbetet një besimtari dhe

besimtareje që të ketë dorë të lirë të veprojë diçka pasi Allahu dhe i Dërguari i Tij të ketë vendosur lidhur me legjitimitetin e saj". Ky orientim vjen lidhur me të gjithë çështjen e besimtarit duke qenë se feja jonë Islame është e plotë dhe gjithëpërfshirëse, nuk ka lënë aspekt prej aspekteve të jetës pa përfshirë, porse përkundrazi i ka përfshirë të gjitha dhe i ka rregulluar dhe orientuar më së miri në të gjithë lëmenjtë e jetës, në atë ekonomik, politik, shoqëror, organizativ, moral, marrëdhëniet ndërpersonale, marrëdhëniet ndërkombëtare etj. Islami ka trajtuar çdo dimension, nga më i madhi tek më i vogli. Këtu aludon thënia kuranore ku Allahu i Larëtsuar thotë: "Sot ua plotësova fenë tuaj, ua përmbusha mirësinë Time dhe jam i kënaqur që ju të keni Islamin për fe". Dhe ashtu siç është detyrë që individi t'i bindet Allahut, në të njëtën mënyrë është detyrë që mbarë kombi musliman t'i bindet Allahut të Lartësuar dhe të Lartmadhëruar, t'i nënshtrohet urdhërit të Tij dhe me devocion t' a konkretizoj adhurimin e Tij në këtë tokë.

Allahu u drejtohet besimtarëve duke thënë: "Jo, betohem në Zotin tënd (o Muhamed) se ata nuk besojnë përderisa të të kenë ty gjykatës në rastet kur bien në konflikte midis tyre, dhe nuk duhet pas kësaj të ndiejnë ndonjë pakënaqësi rreth gjykimit që ti jep, dhe duhet të dorëzohen me hir".

Disa njerëz polemizojnë duke u shprehur se, ne i takojmë këtij aktualiteti që ka evoluar dhe progresuar shumë, teksa Ligji i Sheriatit që predikon Kurani daton 1400 vjet përpara, dhe si i tillë vështirë të jetë i përshtatshëm për kohët tona.

E njëjta stiuatë më ka ndodhur mua me një ambasador të një vendi të evropës perëndimore në Sana që më tha, a konsiderohet feja Islame të jetë kompletuar? I thashë, po. Tha: "Po jeta a është kompletuar? Sepse ti kështu po më thua se një fe e kompletuar prej mëse njëmijë vjetësh, do t'i përgjigjet kërkesave dhe risive të një jete që është ende në kompletim e sipër?" Në përgjigjë të kësaj dileme në dukje i thashë: Qëllimi dhe funksioni i syrit tënd a është i nëjtë me atë të një personi që jetonte në kohën e Profetit Jezus-Isa dhe Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të dy-?! Po tha, i njëjtë. I thashë, e çfarë mund të thuhet lidhur me hundën, këmbën, dorën, mëlçinë, zemrën dhe trupin mbarë? Tha, po, funksioni i tyre ka mbetur po ai, pasi struktura anatomike ka mbetur e pandryshueshme. I thashë, po përsa i përket strukturës psikike, unë e ti duam dhe urrejmë ashtu sikurse edhe gjeneratat e hershme donin dhe urrenin?! Tha, po. Struktura psikike njerëzore ka mbetur gjithashtu e pandryshueshme. I thashë, pra ne gjendemi para një personi human që pamvarësisht nga kalimi i kohës mbetet mbi të njëjtën strukturë fiziologjike dhe psikike. Ai më miratoi. I thashë, feja ka ardhur duke trajtuar pikërisht këtë natyrë humane, qoftë fiziologjike, qoftë psikike që është e pandryshueshme, që nuk ka ndryshuar dhe as ka për të ndryshuar. Kemi të bëjmë me një njeri të kompletuar pamvarësisht nga koha në të cilën ai ka jetuar, sepse kreatura e tij ka qenë e tillë e kompletuar që në zanafillë të saj. Kemi të bëjmë me një fe të kompletuar që ka ardhur prë një natyrë humane të kompletuar; dhe është fakt se feja erdhi në ujdi me natyrën humane dhe në dobi të saj.

Një shembull që mund të sqaroj rreth kësaj është shembulli në vijim:

Kemi një makinë që po produktohet sipas një projekti inxhinierik të dizenjuar dhe projektuar nga inxhinierët ekspert. Është ky projekt që dikton sesi do funksionojë kjo

makinë. Pasi makina kompletohet, ajo shoqërohet me këtë manual funksionimi që sqaron sesi dhe për çfarë ajo funksionon, manual i cili quhet katalog. Nëse do presupozonim se kemi miliona makina si kjo, pra të të njëjtit model dhe të të njëjtës structure, dhe do t'i shpërndanim kudo në botë duke i nxjerrë në periudha kohore të ndryshme, katalogu i vendosur do mbetej funksional dhe i vlefshëm; pamvarësisht nga pozicionimi gjeografik i vendodhjes së makinës dhe koha e nxjerrjes së saj; dhe kjo sepse struktura dhe konstrukti i makinës në fjalë nuk ka ndryshuar dhe as është tjetërsuar.

Kjo është e vlefshme edhe për ty o njeri. Krijimi dhe natyra jote humane nuk ka pësuar as ndyshim dhe as tjetërsim, ndaj ajo çfarë ishte e vlefshme dhe e dobishme për njerëzit në kohën e Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- është po ajo që u bën dobi njerëzve edhe sot dhe që ka për t'u bërë dobi atyre edhe në të ardhmen, sepse natyra humane nuk ka ndryshuar dhe as ka për të ndryshuar, sepse ajo është krijuar e tillë që të funksionojë në përputhje të plotë më udhëzimet e Sheriatit, Jurisprudencës Islame; gjë për të cilën Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin fisnik: "Drejtoje fytyrën tënde përnga feja e origjinalitetit (Islami), natyra e (zgjedhur prej Vullnetit të) Allahut mbi të cilën Ai i natyrizoi njerëzit, nuk mund të bëhet alternim (manipulim dhe tjetërsim) në krijimin e Allahut. Është kjo feja e vlefshme porse shumica e njerëzve nuk e dinë".

Natyra ime dhe natyra jote është e njëjtë, ndaj dhe qëllimi dhe funksioni ynë është po i njëjtë; është të adhurojmë Allahun e Lavdishëm dhe të Lartmadhërishëm; nëse duam të kemi sukses dhe të jemi prej fitimitarëve.

E lus Allahun që ne dhe ju, dhe të gjithë muslimanët, të na bëj prej fitimtarëve dhe të suksesshmëve!

Falenderimi suprem i takon vetëm Allahut, Zotit të Botërave, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin amshimisht mbi profetin Muhamed, familjen, shokët dhe ndjekësit e tij.

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Xheneti (25)

Ideator dhe Udhëheqës i Programit: Abdul Mexhid Ez-Zendani

Selam alejkum ue rahmetullahi ue bereketuhu.

Falenderimet janë për Allahun, Zotin e botërave, salavatet dhe selamet janë për Profetin tonë, Muhamedin -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, familjen, dhe shokët e tij tërësisht.

Në këtë episod do flasim për Xhenetin, për Botën e Shpërblimit që Allahu e përgatiti për robërit e Tij besimtar.

Allahu i Lavdishëm dhe i Lartmadhërishëm krijoi tek ne mekanizmat e diturisë, paraqiti për ne argumentet universale, na dërgoi nga soji ynë profetë të cilët i mbështeti dhe përkrahu me mrekulli dhe pikërisht këta profetë ishin ata që na njohën me Zotin tonë të Lavdishëm dhe na përçuan Udhëzimin e Tij Hyjnor, ndër gjërat kryesore të të cilit është njohja e njeriut me destinacionin e tij përfundimtar drejt të cilit ai shkon pas jetës së kësaj bote.

Në kuadrin e kësaj Allahu i Lartësuar, na bëri me dije në lidhje me Xhenetin të cilin e përgatiti për robërit e tij besimtar, teksa është vetë Allahu Ai i Cili e krijoi atë. Po për këtë Xhenet na tregon i Dërguari i Allahut, Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, i cili u mundësua nga Allahu që t'a vizitojë dhe shohë Xhenetin me sytë e tij.

Xheneti është i përjetshëm dhe të përjetshëm janë edhe ata që hynë në të; gjë mbi të cilën hedh dritë Kurani Famëlartë ku lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "S'ka dyshim se ata që besuan dhe bënë vepra të mira, vendpritje për ta janë Xhenetet e Firdeusit. Aty do të jenë përgjithmonë, e nuk kërkojnë të largohen nga ai". [18:107-108] Ky është Xheneti, të cilin Allahu e përgatiti të përjetshëm për robërit e tij të zgjedhur.

Disa njerëzve mund t'u tingëllojë e çuditëshme përjetësia e Xhenetit, mund të pyesin se si dhe sa mund të bëhet e realizueshme përjetësia, se si mund të kuptohet një jetesë pa praninë e kohës?!

Përgjigjen vëlla i dashur e ke tek një fenomen që të shoqëron jo pak, por për një të tretën e jetës tënde, e ke tek gjumi; ashtu që kur hyn në gjum ti nuk e ndjen më kohën. Pra duke qenë në këtë dynja dhe ti nuk e ndjen më kohën… E si më në Botën Tjetër ku ligjet dhe normat janë ndryshe nga këto të botës ku jetojmë aktualisht?!

Xheneti nuk ka shoq, ai është i pashembullt. Pikërisht lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Dhe kur të shikosh aty, sheh begati të mëdha e sundim të madh." [76:21] Dhe thotë: "…nuk di askush për kënaqësinë e shpirtit që u është surprizuar atyre si shpërblim kundrejt sa patën punuar". [32:17]

Ky është Xheneti… Kur të deleguarit e tij besimtar arrijnë në të, dyert e tij hapen aty për aty; gjë për të cilën Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "…e kur arrijnë aty, dyert e tij-Xhenetit i gjejnë të hapura dhe kujdestarët e tij u thonë atyre: "Selamun alejkum-Paqja qoftë mbi ju!", ishit të pastër, andaj hyni në të, aty do të jeni përgjithmonë." [39:73] Ky është nderimi i parë që u bëjnë kujdestarët e Xhenetit banorëve të tij në ardhje, teksa ata hyjnë në dyert e Xhenetit.

Nga Imam Ahmedi konfirmohet në adresë të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se ai në përshkrimin e tij mbi ndërtesat e Xhenetit thotë: "Në të (Xhenet) një tullë (e ndërtesave) është prej ari, një tullë prej argjendi dhe llaçi i tyre është misku më i mirë…"

Xheneti posedon grada të avancuara në varësi të meritave të banorëve të tij, gjë për të cilën Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Shiko se si Ne kemi bërë që njerëzit të kenë avantazhe njëri nga tjetri (në mirësitë që u kemi dhënë) porse Bota Tjetër është më superiore në gradat dhe avantazhet (e mirësisë)." [7:21] Shikoni sesi njerëzit në jetën e kësaj bote në mirësitë që posedojnë u takojnë rangjeve të ndryshme dhe dijeni se ato në Botën Tjetër do të jenë më të mëdha.

Në Xhenet Allahu ka përgatitur grada superiore për luftëtarët në Rrugën e Tij; gjë për të cilën Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Allahu luftëtarët i ka avanacuar me një shpërblim madhështor karshi atyre që (me arsye) mbetën pa dalë në luftë". Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ka bërë me dije se midis njërës dhe tjetrës gradë të Xhenetit gjendet një distancë sa midis tokës dhe qiellit, teksa Xheneti posedon njëqind gradë.

Ata që hyjnë në Xhenet, gjejnë pallatet dhe çifligjet e mrekullueshme që i presin; gjë për të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "…pallate madhështore në Xhenetet e Adnit…". Dhe thotë gjithashtu: "Ndërkaq, ata që u ruajtën për hir të Zotit të tyre, për ta do të ketë dhoma (banesa) të ndërtuara njëra mbi tjetrën, nën të cilat rrjedhin lumenjtë". [39:20]

Në një hadith të publikuar nga Ahmedi dhe Ibn Hibani në adresë të Malik el Eshariut -Allahu qoftë i kënaqur me të- si dhe të publikuar nga Tirmidhiu në adresë të Ali ibn Ebi Talibit -Allahu qoftë i kënaqur me të- vjen se Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ka thënë: "Në Xhenet gjenden banesa pjesa e jashtme e të cilave shihet nga brendia e tyre dhe brendia e tyre (shihet) nga pjesa e jashtme e tyre; i ka përgatitur ato Allahu i Lartësuar për kë jep ushqim, flet butësisht, agjëron në vazhdimësi dhe falet natën teksa njerëzit janë duke fjetur".

Gjithashtu në Xhenet gjenden tenda dhe ngrehina luksoze. Prej tyre janë ato ku rrinë hyritë e Xhenetit, gjë për të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Ato janë hyritë-vashat sybukura që e kufizojnë qëndrimin (e tyre) vetëm në tendat (e xhenetliut)." [55:72] Muslimi publikon në adresë të Abdullah ibn Kajsit, i cili transmeton në adresë të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se ai ka thënë: "Në Xhenet është një

ngrehinë e tendosur e bërë nga një perlë e vetme e gërryer përbrenda që ka një lartësi 'në qiell' 60 milje 'dhe edhe gjerësia e saj është 60 milje'. Besimtari në të ka familjet e tij me të cilat dëfrehet dhe që (këto familje) nuk shikohen ndërmjet tyre".

Gjithashtu në Xhenet gjenden lumenj të cilët rrjedhin përposhtë robërve të devotshëm të Allahut të cilët Allahu i futi në Xhenet. Allahu i Lartësuar i ka përshkruar këto lumenj duke thënë: "Shembulli i Xhenetit që u është premtuar të devotshmëve, është i tillë që në të ka lumenj prej uji të mire që nuk prishet, ka lumenj prej qumështi shija e të cilit as prishet dhe as ndryshon, ka lumenj prej vere të shijëshme (që nuk shkakton dehje, as dhimbje barku dhe as dhimbje koke) dhe ajo shumë u shijon pirësve të saj dhe ka lumenj prej mjalti të kulluar. E ata kanë aty edhe gjithëçfarë pemësh dhe frutash…". [47:15] Të gjithë këto lumenj rrjedhin në Xhenet. Bukhariu publikon në adresë të Enesit -Allahut qoftë i kënaqur me të- që transmeton se Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ka thënë: "Ndërkohë që po ecja në Xhenet, kur ja, u gjenda përpara një lumi dy anët e të cilit ishin kupola prej diamanti të gërryer për brenda. I thashë: "O Xhibril! Çfarë është ky?" Më tha: "Është lumi Keuther të cilin t'a ka dhënë ty Zoti yt…"

Xheneti ka dhe kronjë e burime që gëlojnë; gjë që vjen në thënien e Allahut të Lartësuar: "Të devotëshmit janë (në Xhenet) në mes lulishteve (bahçeve) të Xhenetit dhe kronjve."

Xheneti ka në të pemë të mrekullueshme, gjë që vjen në thënien e Allahut të Lartësuar: "S'ka dyshim se të devotshmit kanë përfitime të mëdha. Kopshte e vreshta rrushi." [78:31-32] Dhe ka thënë gjithashtu: "Në të dy ato (xhenete) ka pemë frutash, ka edhe hurma dhe shegë." [55:68] Frutat e Xhenetit janë të shumta e të llojllojshme, gjë për të cilën Allahu i Larëtsuar thotë: "(Kanë në Xhenet) frute nga të cilët zgjedhin (sipas dëshirës)". (Kanë) Edhe mish shpezësh si të dëshirojnë." [56:20-21]

Kush janë ata që do të hyjnë në Xhenet, kush janë banorët e Xhenetit?!

Ata janë besimtarët… Ndërkaq besimtarët duhet të përgatiten dhe të familjarizohen për të hyrë në Xhenet duke u çliruar më parë nga ndonjë mëri dhe urrejtje që ka mbetur në zemrat e tyre nga jeta e dynjasë. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: "Ne kemi hequr prej zemrave të tyre çfardo urrejtje, e ata (besimtarët në Xhenet) qëndrojnë në mbështetëse ballë për ballë njëri-tjetrit duke qenë të vëllazëruar." [15:47] Ndërsa Bukhariu publikon një hadith ku Abu Said el Khudriu -Allahu qoftë i kënaqur me të- përcjell në adresë të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se ai ka thënë se besimtarët pasi i shpëtojnë Xhehenemit ndalohen në një urë midis Xhenetit dhe Zjarrit, dhe më tej vijon se Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- ka thënë: "…dhe ndalohen (futen) në një urë mes Xhenetit dhe zjarrit (të Xhehenemit). Shpagohen nga padrejtësi të bëra midis tyre në dynja derisa dëlirësohen dhe pastrohen e (pas kësaj) u lejohet atyre që të hyjnë në Xhenet. Pasha Atë-Allahun në dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, secili prej tyre (prej besimtarëve) e di shtëpinë e tij në Xhenet më mirë se shtëpinë e tij që ka patur në dynja." Pra pas këtij dëlirësimi dhe pastrimi i

drejtohen Xhenetit teksa gjithkush prej tyre e di rangun, çifligun dhe banesën e tij atje në Xhenet.

I pari që do të hyjë në Xhenet dhe do t'a trokasë derën e Tij është Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-. Pas tij futet kombi i tij dhe më pas me rradhë të gjithë kombet besimtare…

Grupi i parë që do të hyjë në Xhenet përshkruhet nga hadithi të cilin e kanë publikuar Bukhariu, Muslimi dhe Tirmidhiu në adresë të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se ai ka thënë: "Grupimi i parë që hyn në Xhenet është në pamjen (pra hijeshinë) e hënës së plotë... Ata (banorët e Xhenetit) nuk urinojnë (aty), as kryejnë nevojën, as nxjerrin ndytësira nga hundët dhe as pështyjnë. Enët e tyre janë prej floriri. Krëhërat e tyre janë prej floriri dhe argjendi. Aromëzimi i tyre bëhet me ulu-ueh (dru që kur digjet çliron tym me erë të mire). Djersët e tyre do çlirojnë erë misku (parfumi aromëmirë). Secili prej tyre do të ketë dy bashkëshorte, hijeshia e kërceve të këmbëve të të cilave duket nga sipër mishit për shkak të bukurisë së tyre. Ata nuk do hyjnë kurrë në polemikë midis tyre dhe as do kenë mëri. Zemrat e tyre janë (përsosur) si zemra e një personi të vetëm. Ata i thurrin lavde Allahut mëngjes dhe mbrëmje." Shiko sesi do të jetë zbukuruar, hijeshuar dhe përsosur në Xhenet kreatura e besimtareve dhe e bashkëshortëve të tyre.

Në Xhenet hyjnë ata që janë përgëzuar me Xhenet. Masa më e madhe e banorëve të Xhenetit janë të varfërit. Fukarenjtë hyjnë në Xhenet përpara besimtarëve që në dynja qenë të pasur dhe në krahun tjetër të pasurit vetëm pas të varfërve do hyjnë në Xhenet.

Më në fund vjen rradha që në Xhenet të hyjnë mëkatarët e mëdhenj prej atyre që e patën besuar Allahun dhe nuk i patën bërë shokvurje Atij, por që bënë mëkate të rënda të cilat peshuan më shumë se veprat e tyre të mira, në varësi të të cilave ishte dhe periudha e ndëshkimit të tyre të merituesëhm në Xhehenem. Këta mëkatarë Allahu do t'i nxjerrë nga Zjarri atëherë kur Ai të jap leje që të hyjë në fuqi amnistia nëpërmjet ndërmjetësimit që profetët dhe besimtarët do të bëjnë për këta mëkatarë. Lidhur me këtë Muslimi publikon në adresë të Ebu Said el Khdriut i cili ka transmetuar në adresë të Profetit Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se ai ka thënë: "Përsa i përket banorëve të Zjarrit që janë prej atyre që do jetojnë në të (përjetësisht) ata as vdesin në të dhe as jetojnë (në kuptimin e vërtetë të fjalës jetë). Porse disa njerëz të cilët i ka prekur Zjarri për shkak të mëkateve të tyre [gabimeve të tyre] janë vdekur në ndëshkim derisa janë bërë qymyr; këtu jepet leje për ndërmjetësimet dhe ata sillen grupe-grupe. Shpërndahen nëpër lumenjtë e Xhenetit dhe u thuhet: O banorët e Xhenetit hidhuni ujë atyre dhe ata çelin si çelja e farës së gjendur në rrjedhën e përroit."

Ndërmjetësimi që do ndodhë nuk është i trajtës me të cilën jemi mësuar t'a gjejmë në dynja ku ndërmjetësimi dhe ndërhyrja është e tillë që dendur bëhet pa lejen e atij për të cilin do të ndërmjetësojmë, në kundërshtim me këndvështrimin e tjetrit dhe bëhet me

ndërmjetësues të padëshirueshëm nga ana e personit për llogari të të cilit bëhet ky ndërmjetësim.

Ndërkaq ndërmjetësimi që Allahu do lejojë është i kushtëzuar me kushte specifike, të cilat Allahu i Lartësuar i ka cekur në disa thënie kuranore. Prej tyre është thënia e Tij ku thotë: "...Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai-Allahu, përveçse me lejen e Tij..."; nga ku del në pah se kushti i parë është që Allahu i Lavdishëm dhe i Lartmadhërishëm të lejojë të ndodhë ky ndërmjetësim. Kushti i dytë është, që ai për të cilin bëhet ndërmjetësimi të jetë prej kujt Allahu lejon të bëhet ndërmjetësim për të; gjë në lidhje me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "E di atë që qëndron para dhe pas tyre dhe nuk ndërmjetësojnë përveçse për atë që Allahu është i kënaqur (të ndërmjetësohet për të) e ata përdëllohen nga frika që kanë për Të." Kusht tjetër është që ndërmjetësuesi të fitoj lejen e Allahut për të qenë i tillë duke i plotësuar në vetvete kriteret hyjnore të vendosura për të fituar këtë privilegj; gjë lidhur me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "E sa engjëj ka që janë në qiej, ndërmjetësimi i të cilëve nuk bën dobi, vetëmse pasi Allahu të japë leje (ndërmjetësimi) për atë që dëshiron dhe për të cilin është i kënaqur." [53:26]

Ndryshe nga ndërmjetësimi që jemi mësuar të shohim dhe gjejmë në dynja, tek Allahu, pa plotësimin e këtyre kritereve, nuk do të bëhet i mundur ndërmjetësimi jashtë kritereve; gjë për të cilën Allahu ka thënë: "...Atyre nuk do t'u bëjë dobi ndërmjetësimi i ndërmjetësuesve."

Ndërmjetësim do të bëjë Profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të-, profetët e tjerë, dëshmorët, të devotshmit dhe më pas Allahu fal mëshirës së Tij të pashoq do nxjerrë nga Xhehenemi kë do prej njësuesve të Tij. Bukhariu dhe Muslimi kanë publikuar në adresë të Profetit -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- se ai lidhur me personin e fundit që del nga Zjarri dhe hynë në Xhenet ka thënë: "Me të vërtetë që unë e di të fundit nga banorët e Zjarrit të Xhehenemit që del prej tij dhe të fundit prej banorëve të Xhenetit që hyn në të. Është një person që del nga Zjarri duke u zvarritur. Allahu i thotë atij: 'Shko e futu në Xhenet!' I avitet Xhenetit e i duket se është i mbushur përplotë (dhe s'ka vend për të). Kthehet e i thotë: O Zoti im! E gjeta atë të mbushur. Allahu i Lavdishëm dhe i Lartmadhërishëm i thotë: 'Shko futu në Xhenet! Në të ti do të kesh sikurse dynjaja dhe dhjetëfishi i saj [ose ti ke në të sa dhjetëfishi i dynjasë].' I thotë: A po bën shaka me mua (a po qeshesh me mua) Ti që je Gjithsunduesi?" Transmetuesi tha: Pashë të Dërguarin e Allahut -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- sesi qeshi aq sa iu dukën paradhëmballët e tij. Abdullah ibn Mesudi -Allahut qoftë i kënaqur me të-, i cili është transmetuesi i këtij hadithi, thotë: E thuhej se ky është banori i gradës më të ulët të Xhenetit.

Ndërsa dëshmorët në rrugë të Allahut hynë në Xhenet direkt sa të vdesin; gjë për të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Kurrsesi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë te Zoti i tyre duke u ushqyer." [3:169]

Xheneti ka një erë të mirë që nuhatet nga distanca pesëqind vjet larg.

Ata të cilët e trashëgojnë Xhenetin Firdeus dhe hynë në Xhenet pasi kanë përmbushur kriteret hyjnore të vendosur për hyrjen në të, janë ata njerëz të cilët besuan dhe bënë vepra të mira; gjë në lidhje me të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "S'ka dyshim se për ata që besuan dhe bënë vepra të mira, vendpritje janë Xhenetet e Firdeusit." [18:107] Dhe thotë: "E, përgëzoi ata që besuan dhe bënë vepra të mira se ata do të jenë në Xhenete përposhtë të cilëve rrjedhin lumenj." [2:25]

Banorët e Xhenetit janë ata të cilët iu dorëzuan Allahut, besuan tek Ai dhe qenë të sinqertë në adhurimin e tyre për Allahun; gjë për të cilën Allahu i Lartësuar thotë: "Me përjashtim të robërve të Allahut që ishin të sinqertë; të tillët janë ata që kanë furnizim të dalluar; pemë të llojllojshme teksa ata janë të nderuar, në Xhenete të begatshme." [37:40-43]

Këta janë ata të cilët trashëgojnë Firdeusin Superior nisur nga puna që ata punuan.

Kaptina kuranore "Muminun" na përcjell disa nga cilësitë e besimtarëve që merituan Firdeusin Superior; thotë Allahu i Lartësuar: "Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët; ata të cilët janë të përulur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit; ata të cilët i shmangen të kotës (fjalë a punë qoftë); dhe ata të cilët rregullisht e japin zeqatin; dhe ata të cilët e ruajnë nderin e vet (sa i përket jetës intime), me përjashtim ndaj grave të veta (me kurorë) dhe ndaj atyre që i kanë në pronësinë e vet (robëreshave) e për to nuk janë të qortuar; ndërkaq kush kërkon përtej kësaj (dëfrim nga të ndaluarat), të tillët janë ata që kanë shkelur caqet; (cilësi pej cilësive vijuese të besimtarëve të shpëtuar janë se ndër të tillët janë) edhe ata të cilët me kujdes i ruajnë ato që u janë besuar (sende ose fjalë), e ruajnë edhe premtimin e dhënë; edhe ata të cilët i kushtojnë kujdes kohës së namazit të tyre. Të tillët janë mu ata trashëgimtarët, të cilët trashëgojnë Firdeusin dhe aty ata janë përgjithmonë." [23:1-11]

Në Xhenet hyjnë edhe fëmijët e besimtarëve dhe hyjnë gjithashtu edhe fëmijët e jomuslimanëve sipas thënies që ka më shumë epërsi në mesin e dijetarëve musliman, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "Se askush nuk e bartë barrën (mëkatin) e tjetrit." [53:38]

Lumturia në Xhenet është e përjetëshme ashtu që banorët e Xhenetit janë të rinj në përjetësi, nuk plaken, mosha e tyre është tridhjetëetre vjeç; gjë në lidhje me të cilën Ahmedi dhe Tirmidhiu në adresë të Profeti -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- publikojnë se ai ka thënë: "Banorët e Xhenetit do të hynë në të qose pa mjekër, me sy të makiazhuar dhe moshat e tyre janë tridhjetëetre."

Gjithësa ia ka ënda njeriut prej ushqimeve do të jenë për banorët e Xhenetit në Xhenet. Krahas ushqimit të tyre ata do të kenë të gjithë pijet e shijshme të lakmuara. Lidhur me këtë Allahu i Lartësuar thotë: "(Kanë në Xhenet) frute nga të cilët zgjedhin (sipas dëshirës)". (Kanë) Edhe mish shpezësh si të dëshirojnë." [56:20-21]

Dhe thotë: “Atyre në të-Xhenet u bëhet shërbim me enë të argjendta dhe me gota të tejdukshme. (Gota) Të tejdukshme nga argjendi të cilat ata (që ua servirin) i përcaktuan të jenë në dimensione ekzakte. Dhe u jepet të pijnë aty gota pijeje të përzier me zenxhebilë (bimë aromatike nga një); Burim aty që quhet selsebil (i lehtë në të pirë).” [76:15-18]

Pasqyra e lëndës së librit:

1. Rregullat logjike të Imanit-Besimit – fq. 2
2. Njohja e Allahut – fq. 10
3. Atributet e Allahut të Lartësuar – fq. 18
4. Si ishte zanafilla e këtij universi – f. 25
5. Anatomia-strukturimi i njeriut – fq. 31
6. Argumentet e Besimit në Botën Tjetër – fq. 41
7. Beteja e Ahzabit – fq. 54
8. Beteja e Bedrit – fq. 65
9. Bota e Përgjegjësimit – Xhehenemi – fq. 74
10. Fitorja e Romakëve – fq. 82
11. Jashtëzakonshmëritë – fq. 92
12. Kurani dhe shkencat e marinës – fq. 102
13. Lutja e Ibrahimit – fq. 112
14. Marshall Xhonson – fq. 120
15. Meditim rreth universit – fq. 130
16. Misteret e reve në qiell – fq. 138
17. Mrekullia e Besëlidhjes së profetëve – fq. 147
18. Mrekullia shkencore në Kuran – fq. 157
19. Mumja e Faraonit – fq. 166
20. Nga Vdekja deri tek Llogaria – fq. 174
21. Qeniet e gjalla – fq. 185
22. Të provuarit dhe të pamurit – fq. 193
23. Toka – fq. 202
24. Urtësia prej krijimit të njeriut – fq. 211
25. Xheneti (25) – fq. 224

Një profil i përmbledhur i përkthyesit të librit:

Altin Torba, lindur me 09.07.1975 në Bulqizë dhe po aty përfundoi Shkollën e Mesme të Përgjithshme (1987-1991) dhe kreu 2 vjet studime në Institutin Teologjik Islam "Ebu Hanife" (1992-1994). U diplomua në Universitetin "El-Iman", profili "Teologji Islame", në Sana të Jemenit (1995-2000) dhe pak vite më vonë u diplomua në Fakultetin e Shkencave Sociale, profili "Edukatë Qytetare", në Universitetin Aleksandër Xhuvani të Elbasanit (2004-2008).

Njeh në nivelin "shumë mirë" arabishten; ka punuar kryesisht në fushën e thirrjes islame si mësues i teologjisë dhe ligjërues xhamie në Shqipëri dhe jashtë saj.

Gjithashtu, ka një qasje të ngushtë me literaturën islame në lëmin e përpilimit, sidomos në atë të përkthimit. Në këtë kuadër, është autor i një sërë përpilimesh të përkthyera, por edhe autoriale, të botuara në një sërë revistash si: "Drita Islame", "Familja", "Etika", "Vepra" etj.

Sa i përket lëmit të përkthimit, është autor i një vargu përkthimesh për një kohë relativisht të gjatë, fillimisht për faqen elektronike "Ikra" dhe më pas për portalet elektronikë "Ardhmëriaonline" dhe "ProfetiMuhamed.info". Së fundi është anëtar i stafit të përkthyesve shqiptar të portalit të njohur "IslamHouse.com". Ndërsa në fushën e botimit të librit islam është angazhuar si përkthyes për një sërë librash të botuar nga disa shtëpi botuese, si: "Furkan ISM", "Mesazhi" etj.

Në periudhën (2011-2013) ka pasur një angazhim radiofonik të karakterit fetar dhe social në Radio Kontakt, ku ka drejtuar emisione të formatit fetar dhe social.

Po kështu, është përgjegjës i faqes "Jeta e Vërtetë – Pyetje-Përgjigje Fetare Islame (facebook)" dhe portalit teologjik islam "http://jetaever8.de (Jeta e Vërtetë)".

Nga viti 2011-të shërben në faltoren "Ikra" si imam për muslimanët shqiptarë të qytetit Siegen në Gjermani dhe prej vitit 2015 është anëtar i komisionit të fetvave pranë Unionit të Bashkësive Islame Shqiptare në Gjermani (UBIShGj).